RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)

BASHKIA POGRADEC

Tiranë, korrik 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	5
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-12
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	13-15
II.	**HYRJA**	16
1.	Objekti i auditimit	16
2.	Qëllimi i auditimit	16
3.	Identifikimi i çështhes	16
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	16-17
5.	Përgjegjësitë e audituesve	17
6.	Kriteret e vlerësimit	18
7.	Standardet e auditimit	18
8.	Metodat e auditimit	19
9.	Dokumentimi i auditimit	20
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**21-150**
1.	Informacion i përgjithshëm	21
2.	Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	22
3.	Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	22-25
	- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. - Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Infrmimi/komonikimi si dhe monitorimi. - Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.	
4.	Auditimi mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm ..... - Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm - Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.	25-31
5.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar, ligjet vjetore ñPër buxhetin e shtetitòtë vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	32-42
	- Programimi i PBA dhe i buxhetit vjetor 2019-2020. - Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. - Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. -Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave. -Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.	
6.	Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	

	- Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre ..... - Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor	43-80
7.	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi	81-85
	- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjes ekonomike. - Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnjësisë. - Opinioni mbi pasqyrat financiare.	
8.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikòi ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjensisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò...	86-133
	- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve ... Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara. - Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit). - Auditim mbi zbatimin e kushteve të kontratave në realizimin të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike. - Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punëve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues.	
9.	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .	
	- Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve. - Realizimi programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. - Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.	134-138
10.	Të ndryshme	139-149
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET .....**	**150-167**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
AK	Autoriteti Kontraktor
SHA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtësr i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e LSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 102/1, datë 04.02.2021, ndryshuar me nr. 102/2 prot, datë 04.03.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 08.02.2021 deri në datën 02.04.2021, për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2020 në Subjektin: Bashkia Pogradec, u krye auditimi ñMbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisëò nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **S. M.,** ***Përgjegjës Grupi***
2. **Sh. H.,** ***Auditues***
3. **L. Gj.,** ***Auditues***
4. **E. V.,** ***Auditues***

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua rregjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave për punë publike, shërbime dhe mallra, zbatimi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit.

Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2019. Pasqyrat financiare të vitit 2020 deri në datë 02.04.2021, datë në të cilën ka përfunduar puna audituesve në terren, nuk kanë përfunduar.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 17 akte konstatimi dhe 3 akt verifikime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Pogradec, brenda afatit të periudhës së auditimit.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Mbështetur në punën audituesve në terren, në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituesve, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituesve përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 71,739,473.28 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi shoqëria ñ4 A. M.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve të kryera ñGërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji, kategori III, me shkarkim në tokë në punimet KUZ në zonën e Drilonit dhe fshati Gurasò, në vlerën **737,200 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3044/15 prot datë 29.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñ4 A. M.ò SHPK.	119-120	E lartë	Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **737,200** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñ4 A. M.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3044 prot, datë 29.06.2020 me objekt ñ*Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
2	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 68,194,693.70 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volum pune të zërit të punimeve: Shtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunete t = 10 cm, në vlerën **490,380 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5532/1 prot datë 20.07.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR.ò SHPK.	120	I lartë	Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot, datë 20.07.2018 me objekt ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
3	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit për shtesën e kontratës ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 13,144,368 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñShtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunetë t = 10 cmò dhe ñVijëzim shirita tërtho, kalim këmbësorë 15 cm, biokomponentò, në vlerën **69,600 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5288 prot datë	120	I lartë	Kontraktori ñR,ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot, datë 20.07.2018 me objekt për një shtesë fondi në kontratëñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas

	18.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR,ò SHPK.			volumeve të situacionuara.
4	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"* Bashkia Pogradec, me vlerë 13,144,368 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve , ñFV pllaka betoni C 25/30, t = 8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t = 10 cmò dhe ñFV pllaka betoni C 25/30, t = 8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t = 10 cmò, në vlerën **652,543 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1757/15 prot datë 14.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR.ò SHPK.	122	I lartë	Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot, datë 14.09.2020 të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
5	Nga auditimi i zbatimit të punimve të kontratës me objekt ñ*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"* Bashkia Pogradec, me vlerë 73,669,667 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñShk.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñF.V Dyer druri cilësia I brendshmeò, ñKastë shkarkimiò, ñF. Instalim pompë qarkulluese me prurje deri në 3 m^3/orë, presion deri në 7 mkH2O e kompletuar me ventila 1 ¼ò, hollandeze, lidhjet elektriek etjò dhe ñRadiator me 10 elementë së bashku me aksesorët e montimit, valvula radiatori ½" me hollandes, ajërnxjerrës ½ ", tapë ½ " etj me çmim 26,500 lekëò, në vlerën **633,295 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4964/3 prot datë 18.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñShk.ò SHPK.	124	I Lartë	Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **633,295** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñShk.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4964/3 prot, datë 18.07.2019 të kontratës me objekt ñ*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
6	Nga auditimi i zbatimit të punimve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 123,257,868 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive **"I." SHPK & "Sh." SHPK**, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñShtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunetë t=10 cmò, ñFV mbjellje peme dekorative Bli Ø 16-18 cm në trotuarò dhe ñVijëzim me shirit gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm", në vlerën **793,871 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me	124	I Lartë	Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **793,871** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i përkohshëm i shoqërive ñI.ò SHPK & ñSh.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7137 prot, datë 28.09.2019 të kontratës me objekt ñ*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në

	kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7137 prot datë 28.09.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe BOE **"I." SHPK & "Sh." SHPK**.			buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
7	Nga auditimin e 21 procedurave me vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 14 procedura me vlerë kontrate 224,926 mijë lekë ose 31 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **224,926 mijë lekë**, **respektivisht**: **- 3,950,000 lekë** në procedurën e prokurimit *"Vrojtimi dhe sinjalizimi me kamera, sistem alarmi dhe akses kontrolli për vitin 2019"*, me FL 4,166,500 lekë, me fitues BOE ñIò shpk & ñShk.ò SHPK me vlerë të ofertës 3,950,000 lekë. **- 9,516,666 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Karburant për nevojat e bashkisë Pogradec dhe të N.I.R"*, me FL 9,516,666 lekë, me fitues OE ñG.ò SHPK me marzh fitimi 7%. **- 61,921,356 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Rehabilitim i shkollës së mesme Gjergj Pekmezi"*, me fond limit 64,913,231 lekë, me fitues OE ñShk.ò SHPK me ofertë 61,921,356 lekë. **- 7,951,469 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Shërbime për dru zjarri për ngrohje"*, me FL 7,985,386 lekë, me fitues BOE ñL. B.ò SHPK & ñKò SHPK me ofertë 7,951,469 lekë. **- 8,011,692 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Mirëmbajtje ndërtesash"*, me FL 8,198,333 lekë, me fitues OE ñA.l. -Dò SHPK me ofertë 8,011,692 lekë. **- 19,574,639 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim blloku tek ish ferma loti I"*, me FL 19,574,639 lekë, me fitues BOE **"I." SHPK & "Sh." SHPK** me ofertë 19,574,639 lekë. **- 10,953,640 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim rrugësh blloku Goricë"*, me FL 10,958,968 lekë, me fitues OE ñR,ò SHPK me ofertë 10,953,640 lekë. **- 23,456,764 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Përmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec"*, me fond limit 24,246,649	90-	I lartë	Kryetari i Bashkisë Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **224,926 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

	lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 23,456,764 lekë. **- 19,591,210 lekë**, **në** procedurën e prokurimit *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Kabashit"*, me fond limit 20,823,715 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 19,591,210 lekë. **- 14,326,357 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*, me fond limit 15,259,601 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 14,326,357 lekë. **- 11,411,885 lekë,** në procedurën e prokurimit *"Ndërtim Ura Zall i Torrës, Njësia Administrative Proptisht"*, me fond limit 12,417,536 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 11,411,885 lekë.			
8	Nga auditimi mbi raportimit financiar për periudhën 2019, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, nuk është realizuar inventarizimi fizik i mallrave dhe aktiveve afat mesëm dhe afatgjatë: - Nuk është ngritur komisioni i vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata për Nësitë Administrative të Bashkisë Pogradec. - Nuk është ngritur komisioni për nxjerrjen jashteperdorimi të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata ne Bashki dhe Njesite Administrative. Për sa më siper është vepruar në kundershim me Udhezimin Nr 30 date 27.12.2011 ñPer menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publikò, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò si dhe ligjin 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.			Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që në vazhdimësi në realizojnë në kohë ngritjen e komisioneve për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të papërdorshme, për të krijuar hartimin me saktësi të pasqyrave financiare në fund të vitit ushtrimor.
9	Për vitin 2019, IMT ka vendosur 25 gjoba me vlerë totale 4,410,000 lekë, për vitin 2020 janë vendosur 20 gjoba me vlerë totale 4,750,000 lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se gjobat e vendosura nga IMT në vitin 2019 janë kontabilizuar si detyrime, ndërsa gjobat e vendosura në vitin 2020 nuk janë kontabilizuar si detyrime sepse IMT nuk ka përcjellë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrim kontabël pas vendosjes së gjobës si dhe në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura.			Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve që nuk kanë paguar gjobat e vendosura. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të

				rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.
10	Policia Bashkiake Pogradec për vitet 2019-2020 ka vendosur 186 gjoba me vlerë 338,500 lekë. Nga auditimi rezulton se, struktura e Policisë Bashkiake nuk ka dërguar pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrimin kontabël të gjobave si dhe nuk ka bërë akordimin në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1[1], pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.			Policia Bashkiake të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve që nuk kanë paguar gjobat e vendosura. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të kryejë kontabilizimin në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.
11	Nga analizimi dhe krahasimi i të dhënave të marra nga DTTV dhe DMT rezulton së ka mospërputhje në sipërfaqen e tokës të marrë nga familjet me AMTP. Përkatësisht, sipërfaqja totale mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore nga DTTV është **2,289 ha** me detyrim vjetor për tû arkëtuar **2,464,800 lekë**, ndërsa nga të dhënat e DMT sipërfaqja e tokës që familjet kanë me AMTP është **6,957 ha,** sipërfaqe e cila duhet të tatohet për detyrimin e taksës së tokës, me vlerë detyrimi vjetor **7,704,050 lekë**. Për vitin 2020 sipas të dhënave të DTTV, planifikimi i taksës së tokës është **5,171,000 lekë**, ndërsa referuar të dhënave nga DMT, pritshmëria për taksën e tokës bujqësore është **7,704,050 lekë**, **diferenca në planifikim është 2,533,050 lekë për vitin 2020 dhe 2,543,050 lekë për vitin 2019, duke sjellë të ardhura të planifikuara më pak në buxhetin e bashkisë për të dy vitet në shumën 5,076,100 lekë.**			Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës për evidentimin e të gjitha familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën 2,533,050 lekë.
12	Nga analizimi i të dhënave mbi pagesën e taksës së tokës bujqësore konstatohet se për vitin 2019 janë			Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të

[1] ..... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për tû paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

	debitorë për taksën e tokës bujqësore 3773 familje me vlerë 2,542,219 lekë dhe për vitin 2020 janë debitorë 5311 familje me vlerë 2,709,529 lekë, në total për periudhën e auditimit 2019-2020 detyrimet e pa arkëtuara për taksën e tokës bujqësore janë në shumën **5,251,748 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**			angazhohet në marrjen e masave dhe identifikimin e mekanizmave për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet që nuk e paguajnë atë nëpërmjet agjentit tatimor UK Pogradec, por dhe ato familje që paguajnë në faturën e ujit të pijshëm, me qëllim rritjen e arkëtimeve për taksën e tokës nga familjet debitorë në vlerën 5,251,748 lekë.
13	Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 329 subjekte të legalizuara, me vlerë **11,442,106 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin e tarifës së planit të detajuar vendor 329 subjekte të legalizuara me vlerë **21,204,148 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. Në total **të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec** nga mos arkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës së planit të detajuar vendor që përbëjnë *taksën për legalizimet*[2] janë **32,646,254 lekë.**	49-51	I lartë	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 329 subjekte debitorë me vlerë 32,646,254 lekë. Gjithashtu nga strukturat e Bashkisë Pogradec të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Zyra Vendore Pogradec për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
14	Detyrimi i familjeve për tarifat e pastrimit gjelbërimit dhe ndriçimit për vitin 2019 është 14,659,273 lekë për 5604 familje, ndërsa për vitin 2020 është 22,516, 658 lekë për 7622 familje. Në total për vitet 2019-2020 shuma e detyrimit është **37,175,931 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec**.	54-55	I lartë	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të intensifikojë punën dhe të marrë masa konkrete për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të familjeve për tarifat e pastrim-gjelbërim-ndriçimit në vlerën 37,175,931 lekë.
15	Për periudhën objekt auditimi 2019-2020, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ka vendosur 45 gjoba me vlerë totale 9,160,000 lekë. IMT në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, nuk ka kërkuar në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes, në titull ekzekutiv në përputhje me	56-58	I lartë	Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, të kërkojnë në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me

[2] Detyrimi për legalizimet në vetvete përbëhet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë 0.5% e vlerës së investimit dhe tarifa e planit të detajuar vendor 1%.

	nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò. Për periudhën 2019-2020 **të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMT janë në vlerën **13,136,000 lekë.**			nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe të marrë masa për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitet 2019-2020 në vlerën 13,136,000 lekë. Gjithashtu, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.
16	Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Pogradec, KLSH ka njoftuar Bashkinë Pogradec me shkresën 390/60, datë 22.10.2019. Bashkia Pogradec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu nuk është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në shkelje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò. Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se: Nga 9 masa organizative, janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa. Nga 3 masa shpërblim dëmi për vlerën **562,463 lekë**,	132	I lartë	Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën 360/60, datë 22.10.2019 ñ*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pogradec*ò, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

	është zbatuar plotësisht 1 masa në vlerën **56,890 lekë**, janë nisur njoftimet për 2 rekomandime në vlerën **505,573 lekë,** por ende nuk kanë filluar arkëtimet ose proceset gjyqësore. Nga 4 masa administrative për vlerën **650,000,** është zbatuar 1 masë për vlerën **50,000 lekë,** dhe janë në proces zbatimi 3 masa për vlerën **600,000 lekë.**			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

a. Nga auditimi mbi pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

"Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet (ISSAI 1700) , ISSAI 1705 dhe (ISSAI 1200) shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Pogradec duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2019".

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Pogradec, të vitit ushtrimor 2019, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Formati nr. 2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Formati nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash floë), Formati nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formati nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore, Formati nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formati nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formati nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1.5 % (*vlerën 13,592,445 lekë për shpenzimet*) për tâu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Përshkrimi i çështjeve:

*****Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve afat gjata materiale i llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm si dhe është ngritur komisioni për nxjerrjen jashteperdorimi të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata ne Bashki dhe Njesite Administrative.

*Nga Bashkia Pogradec janë hartuar Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2019, pa u kryer inventari fizik i mallrave, materialeve dhe aktiveve afatgjata të qëndrueshme.
* *Gjendja e llog. 17 "Huamarrje e huaj"* për vlerën pjesore prej **4,119,667** lekë e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve.
* Nga analiza e llogarisë 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò ku janë kontabilizuar detyrimet sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë për vlerën kontabël **318,405,388** lekë, konstatohet diferencë e madhe në kohë në disa raste mbi 5 vite, midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhërit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit. Kjo gjë ka sjellë mos evidentimin në kohë të detyrimeve sipas vendimeve gjyqësore si dhe mos marjen e masave për uljen e borxhit financiar ndaj të tretëve, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabëlò, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme, UMF nr. 1, datë 4.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit te detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesaritò pikat 2, 3, 4, 6, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 ñPër procedurat standart të zbatimit të buxhetitò Kap. II, pika 102 dhe UMF nr. 8, datë 13.01.2017 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2017ò pikat 81, 84.
*Në nëntë raste u konstatuan të ardhura të munguara në vlerën totale **168,171 mijë lekë** për shkak të mos zbatimit të procedurave për: shkak të mos planifikimit të saktë së taksës së tokës bujqësore; taksën e ndikimit në infrastrukturë; tarifat e pastrimit gjelbërimit dhe ndriçimit; mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMT; mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake; nga mos arkëtimi i detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, nga debitorë progresiv për subjektet fizike/jurik; nga mos paisja me autorizim të subjekteve në sektorin e hidrokarvureve; et,.

b-Nga auditimi mbi përputhshmërinë.

Opinion i kualifikuar për prokurimet publike.
Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Pogradec të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:
Në 14 raste për vitin 2019 fitues i cili nuk plotëson kriteret dhe specifikimet e vendosura në DST, për pasojë ka sjell paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale **224,926 mijë lekë pa TVSH**.
* Në 15 raste u konstatua se kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në 14 raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Pogradec.
Në 12 raste, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, si dhe nuk janë argumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim.

Në 6 raste janë konstatuar pagesa për volume punimesh të pasqyruar në situacion, por të pa kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,376,889 lekë pa TVSH**.
Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin ñ*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare"* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.
Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pogradec.
Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. HYRJA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

- Objekti i auditimit synon:
Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:
- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.
-Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

2. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.
Për fushën e prokurimeve qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në cfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuara personat përgjegjëstë ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes.

Identifikimi i çështjes:
A. Kontrolli i brendshëm
B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.
B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre, borxhi tatimor
C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare për vitin 2019 dhe 2020).
D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.
D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.
E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për Kontrollin e Brendshëm.
Nëpunësi autorizues z. I. Xh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësi zbatues znj. I. K., me detyrë përgjegjëse finance, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të

Bashkisë Pogradec. Bazuar në pikën 6 të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò: ñÇdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendoreò. Sipas neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3.
Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit. Neni 65; ñAdministrata e njësisë administrativeò, pika 1, ñNë njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratoriò. Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò; nr. 9936, datë 26.6.2008, ñPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Raport Auditimi.

5. Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar si dhe çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave të prokurimit me fonde publike dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.
Këto standarde kërkojnë që ne tã përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm, me qëllim programimin e procedurave të përshtatshme të auditimit. Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:
Parimin e integritetit
Parimin e pavarësisë
Parimin e objektivitetit
Parimin e shmangies së konfliktit të interesit

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik.

6. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:
-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 ñ*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
-Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò.
-Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes Vendore".*
-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò; i ndryshuar.
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar.
-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar.
-Ligji nr. 25/2018, datë 01.01.2019 ñ*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar.
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 ñ*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël***".**
- VKM nr. 717,datë 23.06.2009ò,për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetoreò i ndryshuar.
VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të palujtshme dhe të luajtshmeò, etj.
-UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar.
-Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 ñ*Për miratimin e manualit të MFK*ò.
-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ò*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò
- Udhëzimi MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e buxhetit vendorò,etj.
- UMFnr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò.
- Rregullore e brendshme ñMbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Pogradecò, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 ñ*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 ñ*Udhëzues të Auditimit Financiar*ò;
- ISSAI 1300 ñ*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*ò;
- INTOSAI GOV 9100 ñ*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"*si dhe INTOSAI GOV 9110 ñ*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*ò;
- ISSAI 400 ñ*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë"*që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me
kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,

INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".

- Standarded Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditit të Brendshëm, etj.

8. Metodat/procedurat e auditimit.

Teknikat audituese:

Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshmet cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Për arsye se në bazë të vlerësimi paraprak sistemi i Kontrollit të Brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e Kontrollit të Brendshëm.

Siguria e auditimit është marrë nga procedurat thelbësore.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për tësu nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñjashtë normalesò, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Metodat audituese:

-Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450,** i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tësu audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve**.**

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

-Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon[3].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 2 %, duke shtuar nivelin e procedurave analitike **(ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

-Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e *Raportit Përfundimtar* të Auditimit.

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e *Raportit Përfundimtar* të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Pogradec, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò *dhe* ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Pogradec etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pogradec.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Pogradec, bën pjesë në Qarkun e Korçës.

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Pogradecit shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë dhe bën pjesë në Krahinën Malore Qendrore të saj. Kufizohet në veri me Bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me Bashkinë e Pustecit, në jug me Bashkinë e Maliqit dhe në perëndim me Bashkinë ë Gramshit.

Popullsia: Popullsia është 90,726 banorë. Me një sipërfaqe prej 725 kilometrash katrorë.

Të dhëna të tjera: Në Bashkinë Pogradec janë 7 Njësi Administrative: Buçimas, Çërravë, Dardhas, Hudënisht, Trebinjë, Velcan dhe Proptisht.

Gjithashtu ndahet në disa Krahina kryesore gjeografike dhe etnografike: Krahina e Mokrës, Krahina e Gores, Krahina Paramalore e Malit të Thate dhe Fush-Gropa e Rrëzes.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit.
Përmbajtja e punës së kryer. Gjetjet dhe rekomandimet mbi Auditimin.

3. **Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm**.
U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të elektronike (back-up) për njësinë etj.

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 1</u>:** *Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk ka funksionuar në mënyrë efektive.*

Situata: Zbatimi i detyrimeve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin në Bashkinë Pogradec ka funksionuar por ka ende nevojë për përmirësime me qëllim përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, adresimin e risqeve dhe për të dhënë garanci të mjaftueshme që objektivat e njësisë publike do të arrihen duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.
Bashkia Pogradec, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 18, ka hartuar dhe ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1054 Prot, datë 27.02.2020 dhe shkresën nr. 04/4 Prot, datë 2.02.2021 Deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019-2020.
Grupi i Menaxhimit Strategjik
GMS-ja është një strukturë që duhet të ngrihet nga titullari i njësisë publike në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 8, pika 8\b. Në Bashkinë Pogradec për periudhën 2019 ï 2020 GMS është ngritur në bazë të Urdhrit nr. 671 datë 31.12.2018 dhe Urdhrit nr. 82, datë 31.12.2019 ñPër ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjikò. Nga shqyrtimi i minutave të takimit rezulton se GMS nuk është mbledhur rregullisht[4], si dhe nuk ka asnjë raport periodik të hartuar mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, progresin e bërë në arritjen e objektivave të bashkisë, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve, etj[5].
Mjedisi i kontrollit-Aftësitë profesionale të punonjësve
Për vitin 2019 nga Bashkia Pogradec janë trajnuar gjithsej 48 punonjës nga 202 që ka aparati i bashkisë.[6] Për vitin 2020 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk ka të dhëna se sa është numri i punonjësve të trajnuar në ASPA apo institucione të tjera.[7] Kjo mungesë të dhënash vjen si rezultat i zhvillimit të trajnimeve online për shkak të pandemisë Covid-19. Zhvillimi i trajnimeve online ka bërë që punonjësit e bashkisë të mos marrin pjesë në trajnime apo të marrin pjesë individualisht pa vënë në dijeni Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Drejtoria e

[4] Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 27 ñGMS duhet të zhvillojë takime periodike për të diskutuar çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollinò.
[5] Manuali Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, pika 2.2.6.
[6] Analiza Vjetore e punës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ï viti 2019.
[7] Analiza Vjetore e punës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ï viti 2020.

Burimeve Njerëzore nga ana e saj nuk ka marrë masa për të programuar pjesëmarrjen e punonjësve të saj në trajnimet e ASPA-s në varësi të temave të ofruara, detyrave funksionale dhe nevojave të punonjësve. Bashkia Pogradec nuk ka të hartuar dhe të miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve[8].

Menaxhimi i riskut

Në vitin 2019 kanë hartuar regjistrat e riskut 7 nga 26 struktura, njësi administrative dhe ndërmarrje varësie ndërsa në vitin 2020, 13 nga 24 struktura, njësi administrative dhe ndërmarrje varësie të Bashkisë Pogradec. Regjistrat e riskut nuk janë të konsoliduar në një regjistër të vetëm. Gjithashtu, rezulton se Bashkia Pogradec nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut[9].

Veprimtaritë e kontrollit

Ndarja e detyrave është e miratuar në strukturën organizative të bashkisë dhe më pas në rregulloren e brendshme janë të përshkruara procest e punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve sipas niveleve. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Drejtuesit e strukturave mbikëqyrin punën dhe udhëzojnë punonjësit për të minimizuar gabimet. Bashkia Pogradec nuk ka sisteme kompjuterike të licensuara për të menaxhuar aktivitetet e saj si për shembull taksat dhe tarifat vendore.

Informimi dhe komunikimi

Komunikimi i brendshëm në Bashkinë e Pogradecit realizohet me shkrim, me postë elektronike dhe në mënyrë verbale. Nga vlerësimi i bërë për komunikimin shkresor midis Kryetarit/Zëvendës Kryetarëve me Këshillin Bashkiak dhe anasjelltas për vitin 2019-2020 rezultoi se, korrespondenca Këshill Bashkiak - Kryetar Bashkie dhe anasjelltas për vitin 2019 përmban gjithsej 2 shkresa ndërsa për vitin 2020 përmban gjithsej 17 shkresa. Në vlerësimin e komunikimit shkresor Këshill Bashkiak-Kryetar dhe anasjelltas, u konstatua se ekzistonin Vendime të Këshillit Bashkiak me të njëjtin numër protokolli[10]. Lidhur me vlerësimin e komunikimit elektronik konstatohet se për periudhën 2019-2020 vetëm 82 nga 198 punonjës që kryejnë detyra administrative të Bashkisë Pogradec janë të pajisur me e-mail zyrtar me domain @bashkiapogradec.gov.al.

Monitorimi

Monitorimi i vazhdueshëm ndodh gjatë zhvillimit të aktiviteteve të çdo drejtorie apo njësie dhe përfshin procesin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes që ndodhin në përditshmërinë e kryerjes së detyrave. Monitorimi nëpërmjet Auditimit të Brendshëm ka funksionuar duke kryer 14 auditime për periudhën 2019-2020 nga 7 në secilin vit. Në programet e auditimit është përfshirë edhe vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në të 5 komponentët e tij. Ajo që rezulton nga raportet e auditimit të brendshëm është se rekomandimet e lëna nga Auditi i Brendshëm i Bashkisë Pogradec në vitin 2019 nuk janë zbatuar pasi në vitin 2020 janë dhënë përsëri të njëjtat rekomandime.

---

[8] Ligji nr. 152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, neni 38 ñNëpunësi civil ka të drejtën të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, donatorë të huaj apo të ardhurat vetjakeò.

[9] Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 21 ñPër të zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskutò.

[10] Vendim i KB nr. 79 datë 23.07.2020 nr. 3408/1 prot, ñPër një ndryshim në Vendimin nr. 47 datë 29.04.2020, për një ndryshim në Vendimin nr 115, datë 27.12.2019, për miratimin dhe detajimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Pogradec për vitin 2020ò dhe Vendim i KB nr. 80, datë 23.07.2020 nr. 3408/1 prot, ò Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 115, datë 27.12.2019, për miratimin dhe detajimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Pogradec për vitin 2020ò.

Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar Gjurmën e Auditimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit për MFK-në. Plani i veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për periudhën 2019-2020 nuk është i hartuar në përputhje me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli VI, aneksi 8, përkatësisht mungojnë aktivitetet e planifikuara që do të ndërmerren për të zbatuar gjetjet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjithashtu, Plani i Veprimit nuk është i nënshkruar nga titullari i institucionit.

Kriteret: - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 8, pika 8\b, neni 16 pika 2 dhe 3, neni 21, neni 23, neni 27; - Ligji nr. 152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, neni 38; - Rregullore nr. 1 datë 30.09.2018 ñPër përdorimin e postës elektronike në Administratën Publikeò, Kapitulli 3, pika e; - Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli VI, aneksi 8.

Ndikimi/Efekti:

Nuk janë identifikuar aktivitetet me risk të lartë si rezultat nuk janë marrë masat e duhura për minimizimin e risqve që ndikojnë në arritjen e objektivave të secilës strukturë. Sistemet e informacionit dhe komunikimit nuk sigurojnë një komunikim efektiv si dhe nuk sigurohet dokumentimi i të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë dhe monitorimin me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike.

Shkaku: Mosnjohje sa dhe si duhet i ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò nga niveli i lartë drejtues, si dhe mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandime: Titullari i Bashkisë Pogradec në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut të marrë masa për ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut si dhe të hartojë dhe miratojë strategjinë e menaxhimit të riskut me qëllim që të sigurojë përdorimin e fondeve publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet.

Titullari i Bashkisë Pogradec të miratojë gjurmën e auditimit të paktën për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Pogradec të bëjë vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve dhe bazuar në rezultatet të hartojë Planin e Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të nëpunësve rregullisht në trajnimet e ofruara nga ASPA si dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të trajnimeve brenda institucionit.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të bërë të mundur që të gjithë punonjësit të mund të përdorin postën elektronike të bashkisë për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

Personat që ngarkohen me përgjegjësi për zbatimin e kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollit janë:

z. I. Xh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pogradec;

z. B. Ç. me detyrë Koordinatori GMS-së;

znj. I. K. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar;

znj. I. C. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;

znj. E. P. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Administrative.

4. Auditimi mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm.

Njësia e auditimit te brendshëm është e organizuar në nivel sektori dhe fuksionon me tre punonjës në këtë njësi, ku 1 punonjës është i paisur me certifikatën e auditit të brendshëm. Nga njësia e auditimit te brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit ne zbatim te ligjit për auditimin e Brendshëm Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të miratuara. Për vitin 2019 janë planifikuar dhe realizuar 7 auditime, nga ku janë konstatuar 26 gjetje dhe janë lenë 26 rekomandime. Për vitin 2020 nga 7 auditime të planifikuara janë realizuar 7 auditime, nga ku janë konstatuar 20 gjetje dhe janë lenë 20 rekomandime.

► ***Titulli i gjetjes nr. 1:*** *Organizimi dhe struktura e Njësisë së Auditit të Brendshëm*

Situata: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se*, në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Pogradec, është bazuar në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 ñPër miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar. Sektori e Auditit të Brendshëm që nga periudha e krijimit ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec, i përbërë nga 2 (dy) specialist dhe 1 (një) përgjegjës, ku përgjegjës i NjAB është emëruar Znj. Ë. A. (**Trajtuar në Aneksi nr. 2.2 "Për Auditin e Brendshëm"; Tabela 2.1**).

Nga auditimi rezultoi se:

1) Karta e Auditimit, është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Pogradec me Urdhrin nr. 979, datë 24.02.2020, në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, ku përcaktohet që *"Karta e Auditimit" është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm*ò, si dhe në përputhje me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

2) Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2018 - 2020, me shkresën nr. 3598/1 prot., datë 16.10.2017, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe planifikimi vjetor për vitin 2018, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2

3) Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019 ï 2021, me shkresën nr. 6773/1 prot., datë 15.10.2018, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe plani vjetor për vitin 2019, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2. Planifikimi vjetor është ndryshuar dhe dërguar në DHAB në MF me shkresën nr. 7478 prot., datë 10.09.2019, duke specifikuar dhe arsyen e ndryshimit në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm.

4) Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2020 ï 2022, me shkresën nr. 6726/1 prot., datë 18.10.2019, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe planifikimi vjetor për vitin 2020.

5) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2019, dërguar në DHAB me shkresën nr. 147/1 prot, date 28.01.2020, dhe për vitin 2019,

bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.

5) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2020, dërguar në DHAB me shkresën nr. 246/1 prot, date 04.02.2021, dhe për vitin 2020, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6

6) Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2019 dhe 2020 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

7) Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur të plotësuara e administruar në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të MAB, me dokumentet e nevojshme, por në disa raste mungon Plani i Veprimit të subjekteve të audituara.

8) Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së AB, bashkia Pogradec, rezulton se:

a) Znj. Ë. A., me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën financë, me vendimin nr. 545, datë 17.10.2019, është emëruar në pozicionin ñPërgjegjëse Auditò në Njësinë e Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Pogradec.
b) Znj. K. V., me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Administrim Biznesi është emëruar në pozicionin ñAudi i brendshëmò në NJAB pranë bashkinë Pogradec me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 112, datë 07.04.2016 si dhe rezulton e pajisur me certifikatën e audituesit.
c) Z. E. B. me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, është emëruar në detyrën Specialist në bashkinë Pogradec me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 280, datë 31.10.2019, si dhe rezulton e pajisur me certifikatën e audituesit.

- Misioni i auditimit të brendshëm: Misioni i Njësisë së auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e bashkisë Pogradec në mënyrë të pavarur dhe objektive si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin, në mënyrë që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë funksionimin e Bashkisë Pogradec. Ai ndihmon Bashkinë të përmbushë objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proçeseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes.
- Organizimi i NJAB: Njësia e auditimit nga 17 tetori 2019 përbëhet nga tre punonjës: dy ekonomistë një përgjegjës dhe një specialist si dhe një juriste- audit i çertifikuar nga Ministria e Financave në shtator të 2017. Në strukturën (organigramën) e Bashkisë Pogradec Njësia e Auditimit është pozicionuar në linjë pas kabinetit të kryetarit.

Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

Sipas planit Strategjik të periudhës 2018-2020, 2019-2021, dhe 2020-2022 i nënshtrohen auditimit të plotë:

Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Vend të veçantë në programin dhe në procesin e auditimit ka zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Përgjithësisht referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

- Për vitin 2019: Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Njësia e Auditimit në Bashkinë Pogradec gjatë vitit 2019 ka realizuar 7 auditime sipas planit të miratuar nga Titullari i AK. Këto auditime janë realizuar si vijon (Drejtorinë e administrimit të çështjeve ekonomike-financiare përkatësisht vlerësimi i procedurave të detyrimeve të prapambetura; Qendrën Arsimore; Sektori i çështjeve juridike dhe prokurimeve publike;Policia bashkiake; Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore; Njësia Administrative Udënisht dhe Njësia Administrative Trebinjë).
Sipas planifikimit vjetor (i ndryshuar) janë parashikuar për tu kryer 7 auditime gjithsej, dhe janë realizuar 7 të planifikuara (në masën 100 % të auditimeve të planifikuara).
Gjatë vitit 2019 fushat me risk të lartë kanë qënë : (prokurimet publike; llogaritja e fondit limit, zhvillimi i proçedurave ligjore në kohë, pranimi i ofertës ekonomike më të ulët por edhe cilësore; administrimi i aseteve; realizimi i buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet), mbledhja e taksave dhe tarifave dhe evidentimi i detyrimeve në lidhje me to; detyrimet e prapambetura; mirëmbajtja e institucioneve shkollore dhe administrimi i tyre si asete; mirëmbajtja e infrastrukturës rurale: administrimi i aseteve.).
Gjetjet kryesore sipas sistemeve:
-**Në drejtorinë e financave**: Detyrimet e prapambetura të krijuara në vite.
-**Në qendrën arsimore** Administrimi jo korrekt i aseteve, vlerave materiale mos mbajtja e ditarit të plotë të bankës.
-Në sistemin e prokurimeve: Operatorët ekonomik nuk paraqesin oferta ekonomike të shoqëruara me lista e hollësishme e çmimeve (preventivi) në zbatim të nenit 17 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik)ò, *n*uk zbatohen plotësisht procedurat ligjore të prokurimit publik VKM 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò për hartimin e raporteve dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të prokurimeve, nuk bëhet e saktë llogaritja/rillogaritja e fondit limit duke qenë në përputhje me çmimet e tregut.
- Në drejtorinë e taksave dhe tarifave: Mungesa e dokumentacionin ligjor të pronësisë për të llogaritur drejt detyrimet në lidhje me sipërfaqen e truallit dhe ndërtesës sipas kateve.
Mos kundrim i diferencave sipas pasqyrës së të ardhurave me debitorët sipas zyrës së taksave. Mos verifikimi i hapësirave publike (lulishtet) të zëna nga subjektet tregtare (sidomos baret, hotelet dhe restorantet përgjatë lulishtes breg liqenore).
-Në njësitë administrative: Administrimi jo korrekt i aseteve. (**Rezultatet e NjAB për vitin 2019, paraqiten në Aneksin nr. 2.2; tabela 2**)
Vihet re se nga NjAB për auditimin e brendshëm për vitin 2019, nuk konstatohet asnjë gjetje me dëm ekonomik.
Nga NJAB, rekomandimet janë propozuar sipas gjetjeve të lartpërmendura ndër të cilat disa gjetje janë pranuar disa gjetje janë kundërshtuar.
Rezultatet nga auditimi i detyrimeve të prapambetura
Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2019 fondi për likuidimin e detyrimeve është **65,000,000 lekë** kurse realizimi si 11 mujor është **54,205,071 lekë**.
Në buxhetin e vitit 2019, miratuar me vendim nr. 2 datë 04.01.2019 të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar tek plani i shpenzimeve fonde për detyrimet e prapambetura.
Nga verifikimi të dhënave të dërguara me e-mail nga punonjësja e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar u konstatua se është bërë raportimi çdo muaj tek Dega e Thesarit Pogradec për detyrimet e prapambetura. Gjithashtu në bazë të shkresës nr.7004 prot, datë 09.10.2019 është dërguar në Ministrinë e Financave Tiranë, evidenca e detyrimeve të prapambetura për periudhën korrik-shtator 2019.
Nga NJAB janë dhënë rekomandimet përkatëse për vitin 2019, të cilat janë pasqyruar në **Aneksin nr. 1** (Auditim mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm) bashkëngjitur këtij akt konstatimi.

- Për vitin 2020: Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Njësia e Auditimit në Bashkinë Pogradec gjatë vitit 2020 ka realizuar 7 auditime sipas planit të miratuar nga titullari i AK. Këto auditime janë realizuar si vijon: (Drejtorinë ekonomike dhe menaxhimi financiar (vlerësimi i procedurave të detyrimeve të prapambetura); Qendrën Arsimore; Drejtoria juridike, prokurimeve publike dhe asetet; Drejtoria e Kontrollit, Mbrojtja e Territorit. (Sektori i Transportit, Supervizimit; Inspektoriati i Konsumatorit dhe Tregjeve); Drejtoria e Burimeve njerëzore (Sektori i arkiv-protokollit dhe marrëdhënies me publikun); rejtorinë e Shërbimeve Sociale(Sektori i mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale); Njësia Administrative Dardhas).

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre

Gjatë vitit 2020 është konsideruar me risk të lartë, funksionimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura dhe më konkretisht:.[-prokurimet publike: vendosja e kërkesave për kualifikim, llogaritja e fondit limit, zhvillimi I procedurave ligjore në kohë, pranimi i ofertës ekonomike më të ulët por edhe cilësore; -administrimi dhe regjistrimi i aseteve; -realizimi i buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet); -mbledhja e taksave dhe tarifave dhe evidentimi i detyrimeve në lidhje me to;
-sistemi i pagave, sistemi i pagesave; -mirëmbajtja e institucioneve shkollore dhe administrimi i tyre si asete; - mbikëqyrja e kontratës së shërbimit të pastrimit, transporti, mbrojtja e konsumatorit nga tregtimet e parregullta; -mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore dhe përfshirja sociale;
-marrëdhënia me publikun, protokollimi dhe arkivimi].

Gjetjet kryesore sipas sistemeve:

-Në drejtorinë e financave: Detyrimet e prapambetura të krijuara në vite; sistemi i pagave, sistemi i pagesave.
-Në qendrën arsimore: Administrimi jo korrekt i aseteve, vlerave materiale.
-Në sistemin e prokurimeve: Vendosja e kërkesave për kualifikim, mos sistemimi dhe arkivimi i dokumentacionit të prokurimeve, nuk bëhet e saktë llogaritja/rillogaritja e fondit limit duke qenë në përputhje me çmimet e tregut.
-Në sistemin e aseteve: inventarizimi, regjistrimi, ndjekja e kontratave të qirave dhe kontratave të investimeve.
-Në drejtorinë e kontrollit, mbrojtja e territorit: Transportit, Supervizimi i pastrimit; Inspektorati i Konsumatorit dhe Tregjeve);
- Në Drejtorinë e shërbimeve Sociale: mbrojtja e fëmijëve, grave të dhunuara, barazia gjinore dhe përfshirjes sociale.
-Sistemi i arkiv-protokollit dhe marrëdhënies me publikun
-Në njësitë administrative : Administrimi jo korrekt i aseteve, mbledhja e taksave dhe tarifave. (Rezultatet e NjAB për vitin 2020, paraqiten në Aneksin nr. 2; tabela 3)
Vihet re se nga NjAB për Auditimin e brendshëm për vitin 2020, nuk konstatohet asnjë gjetje me dëm ekonomik.
Nga NJAB, rekomandimet janë propozuar sipas gjetjeve të lartpërmendura ndër të cilat disa gjetje janë pranuar disa gjetje janë kundërshtuar.

Rezultatet nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2020

1-Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura. Klasifikimi i tyre sipas standardeve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo kategori.
Sga verifikimi i detyrimeve të prapambetura deri në 30.09.2020 u konstatua se ato janë që nga viti 2008 dhe janë të ndara në:

Përshkrimi	Gjendja me _31.12.2019_	Shtesat	Pakësimit	Gjendja me 30.09.2020
Detyrime të prapambetura për **Vendime Gjyqësore**	118.909.927	1.312.960	4.807.881	115.415.006
Detyrime të prapambetura për **Shërbime**	103.887.578	-	-	103.887.578
Detyrime të prapambetura për **Mirëmbajtje e Riparime**	601.529	-	-	601.529

Detyrime të prapambetura për **Investime**	82.016.486	-	-	82.016.486
Detyrime të prapambetura për **Të tjera**	11.000.782		1.345.340	9.655.442
TOTALI	**316.416.302**	**1.312.960**	**6.153.221**	**311.576.041**

2-Evidentimi dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhrat e gjykatës apo zyrave të përmbarimit gjyqësor për ekzaminimin e vendimeve të formës së prerë, të mbetura të papaguara 30 ditë pas datës së përcaktuar në kontratë apo në ligj .

Për sa i përket kontratave konstatohet se nuk ka gjurmë auditimi që në momentin e lidhjes së tyre deri në gjendjen e sotme likuiduese për këtë Dr.Ek.M.F. duhet të marrë masat përkatëse që të eliminojë këtë mangësi.

Nga auditimi i likuidimit të vendimeve gjyqësore**:** Vendimet e gjyqit nuk janë të shoqëruara me Pasqyrën e gjurmës së e auditimit ku të pasqyrohet detyrimi fillestar dhe likuidimet në vazhdimësi.

Pra konstatohet mungesa e gjurmës së auditimit për vendimet gjyqësore dhe detyrimet kontraktore**,** në mos zbatim të Ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò ndryshuar me ligjin nr.110/2015 dt.15.10.2015; Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr. 1, Datë 04.06.2014.

3-Verifikimi i regjistrit të prokurimeve për fonde publike ñmallra shërbime, punë publike të depozituara pranë Degës së Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimorò.

Regjistri i parashikimit është dërguar në Degën e Thesarit Pogradec me shkresë nr. 58 prot. datë 08.01.2020, ka parashikuar 2 procedura prokurimi blerje të vogla me fond limit më të vogël se 800.000 lek .

Regjistri i parashikimit i vitit 2020 është dërguar në Degën e Thesarit Pogradec me shkresë nr. 58/1 prot, datë 04.02.2020, ka parashikuar 38 procedura prokurimi. Ky regjistër ka pësuar disa ndryshime të cilat janë dërguar në Degën e Thesarit Pogradec me shkresë.

4-Auditimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme të investimeve apo shërbimeve në vitin ushtrimor dhe atyre që zgjasin në vitet në vazhdim, përpara se të filloj procedura e prokurimit publik ñ.

Sipas pasqyrave 15 dhe 16 të buxhetit është bërë detajimi i plan-buxhetit për thesarin. Plani i investimeve për 2020 është me vlerë 166,010,400 lekë. Për çdo prokurim është bërë relacion drejtuar degës së thesarit për disponibilitetin e fondeve.

***5*-Auditimi i regjistrimit, evidentimit në kontabilitet** si dhe në Sistemin Informatik Financiar të Degës së Thesari të detyrimeve të prapambetura dhe të shtesave të kontratave. Verifikimi I dokumentimit mbështetës dhe procedurave për përfshirjen e detyrimeve financiare në listën e shlyerjes së tyre .

Në lidhje me këtë pikë konstatohet se është bërë regjistrimi, evidentimi në kontabilitet dhe në Sistemin Informatik Financiar të degës së Thesarit të detyrimeve të prapambetura.

6-Verifikimi i respektimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për secilën kategori, sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimit financiar sipas sektorëve.

Nga NJAB janë dhënë rekomandimet përkatëse për vitin 2020, të cilat janë pasqyruar në Zbatimi i rekomandimeve është trajtuar më gjerësisht në **Aneksin nr. 2.2** (Auditim mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm).

Konkluzion mbi funksionimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura.

Në këndvështrim të dy auditimeve të fundit të këtij sistemi konkludojmë se ekzistenca e detyrimeve të prapambetura që nga viti 2008 është evidente dhe ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të tyre për shkak të mungesës së fondeve por edhe të mungesës së dokumentacionit mbështetës të tyre dhe mos zhvillimit të procedurave ligjore të plota në disa prej tyre .

Megjithëse këto mangësi, këto detyrime mbeten si të tilla dhe Drejtoria ekonomike dhe Menaxhimit Financiar/Sektori i financës dhe buxhetit, duhet të marrë masat për analizimin dhe likuidimin e atyre detyrimeve (nga më e vjetra tek më e reja) të cilat kanë dokumentacionin mbështetës dhe janë kryer me procedurë të drejtë ligjore, nëpërmjet një plani konkret të përvitshëm.

Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimet vjetore për vitet objekt auditimi, rezulton se NJAB pavarësisht se ka planifikuar auditimin e disa drejtorive me risk të lartë siç është Drejtoria e Financës apo Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në secilin rast, pavarësisht planifikimit vjetor, angazhimi është kryer mjaftueshëm, pasi janë audituar çështje me risk të ulët deri në të mesëm. Gjithashtu, nuk është planifikuar, auditimi i të gjitha Njësive Administrative.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, òManuali i Auditimit të Brendshëm (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt ج raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si projekt ï raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual.

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi i kanë zbatuar ato, në disa raste nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, veprime që bien në kundërshtim me ligjin 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, òEvidentimi dhe dokumentimi i punës auditueseò), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Vend të veçantë në program zë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

-Mangësi e konstatuar në dosjet e auditimit, rezulton mungesa e planifikimit të detajuar të angazhimit, veprim ky në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.1 ñPlanifikimi i një angazhimi auditimiò, i cili parashikon sipas *Standardit 2200 – Planifikimi i angazhimit se "Audituesit e brendshëm duhet të zhvillojnë dhe të dokumentojnë një plan për secilin angazhim, duke përfshirë objektivat, fushën, kohën, dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit*, si dhe *Standardin 2210 – Çështje të planifikimit.*

NjAB ka bërë mjaftueshëm punë mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duke bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

Organizimi i NJAB, Bashkia Pogradec, është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò

1. Është miratuar Karta e Auditit, janë hartuar planet strategjike, planifikimet vjetore, si dhe raportimet vjetore të aktivitetit të njësisë, dërguar në DHAB brenda afateve dhe standardeve ligjore të përcaktuara Manualin e Auditimit të Brendshëm.
2. Angazhimi i kryer nga NJAB për auditimet e ushtruara në përgjithësi është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò dhe të kapitullit VI ñEvidentimi dhe dokumentimi i punës audituesò të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.
3. Nga audituesit e brendshëm, nuk është hartuar planifikimi i detajuar i angazhimit, veprim ky në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.1 ñPlanifikimi i një angazhimi auditimiò.
4. NjAB ka audituar një numër të vogël auditimesh të Njësive Administrative, përkatësisht 2 auditime në vitin 2019 (Udënisht dheTrebinjë) dhe 1 auditim në vitin 2020 (Dardhas).
5. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Njësia e Audit të Brendshëm nuk ka zhvilluar trajnime.
6. NjAB, gjatë ushtrimit të aktivitetit për periudhën e auditimit 2019-2020 nuk është angazhuar në auditime me rist të lartë në Bashkinë Pogradec.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Kreu I, neni 2, Kreu II, neni 5, neni 6, neni 16, ñManuali i Auditimit të Brendshëm (MAB), Kap II, pika 2.1, pika 2.6.2, neni 27 ï neni 29 i Rregullores së Bashkisë Pogradec, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò

Përsa më sipër, n*garkohet me përgjegjësi*: anëtarët e NJAB; Znj. Ë. A., Znj. K. (Sh.) V.; Z. E. B..

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i problematikave dhe risqeve të mundshëme në sektorët më me risk dhe prioritar të Bashkisë Pogradec

Shkaku: Mosnjohje e kërkesave të ligjit Për Auditin e Brendëshëm..

Rëndësia: I Mesëm

Rekomandime: a) Njësia e Auditimit të Brendshëm në , të marrë masa për forcimin e procesit të auditimit të brendshëm duke planifikuar auditime nxsektorë me rrisk të lartë dhe të rrisë numrin e auditimeve në Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.

b) Titullari i Bashkisë të marrës masa, për trajnim stafit të NjAB dhe bazuar në rezultatet të hartojë Planin e Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të nëpunësve rregullisht në trajnimet e ofruara nga Ministria e Financës (Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) apo ASPA si dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të trajnimeve brenda institucionit.

5. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit"të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit .

(Programimi i PBA dhe i buxhetit vjetor 2019-2020; Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative; Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit; Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre).

- për vitin 2019 planifikimi shpenzimeve ka qenë në vlerën 1,604,430 mijë lekë, realizimi në vlerën 1,382,736,264 lekë, ose në masën 86%.
- për vitin 2020 planifikimi shpenzimeve ka qenë në vlerën 1,969,114 mijë lekë, realizimi në vlerën 1,655,983 mijë lekë, ose në masën 84%. Në mënyrë tabelore të dhënat për planifikimin dhe realizimin e buxhetit për secilin zë, për periudhën 2019-2020 jepen në aneksin nr. 5/1 në fund të raportit të auditimit.

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 1</u>: Mos likuidim i faturave të prapambetura sipas afateve për mungesë fondesh nga bashkia Pogradec.**

Situata: Nga verifikimi i faturave te palikujduara për vitin 2019 rezultoi që llogaria 486 ñshpenzime të periudhave të ardheshme ò është në shumën 316,383,902 lekë, ku detyrime të prapambetura për <u>vendime gjyqësore</u> janë në shumën 118,877,527 leke ose 37.5 % e gjithë detyrimeve te prapambetura. Detyrime të prapambetura për <u>shërbime</u> janë në shumën 103,887,578 leke ose 32.8 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për <u>mirembajtje</u> janë në shumën 601,529 lekë ose 0.1 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për <u>blerje</u> janë në shumen 11,000,782 lekë ose 3.4 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për <u>investime</u> janë në shumen 82,016,486 leke ose 25.9 % e gjithë detyrimeve.

- Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2019 fondi për likuidimin e detyrimeve është 65,000,000 lekë ndërkohë që realizimi i likuidimeve paraqitet në shumën 22,518,565 lekë. Sa më sipër trajtuar vihet re moslikuidim i detyrimeve të prapambetura duke mos zbatuar radhën e likuidimit të detyrimeve të prapambetura. Nga verifikimet e proceseve të likuidimit të vitit 2019 nga situacioni i thesarit u konstatua se janë kryer likuidimit të periudhës të viti 2019 dhe nuk janë likuidur detyrimet e prapambetura.
- Në lidhje për detyrimet e mbetura për sherbime duke qenë që nga vlera 103,887.578 lekë shoqëria ñP.ò SHPK zë vleren prej 95,079,867 lekë dhe duke qenë që kjo vlerë përben 92 % të vlerës së detyrimeve u kërkua informacion bashkisë në lidhje me moslikujdimin e kësaj shoqërie dhe rezultoi që kjo shoqëri është në proces gjyqësor me Bashkinë Pogradec për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale proces të cilin shoqëria ñP.ò SHPK e ka fituar procesin gjyqesor në Gjykaten administrative të shkallës së parë Korçë sipas Vendimit Nr. 92 datë 09.03.2016. Ky vendim është ankimuar nga ana e Bashkisë dhe me vendimin Nr. 4912 datë 22.11.2017 të gjykates së Apelit Tiranë shoqëria Paster ka fituar procesin gjyqësor. Bashkia Pogradec ka bere Kërkesë për Pezullim civile në Gjykatë të Lartë. I vetmi dokumentacion i paraqitur nga Bashkia Pogradec është fotokopje e printuar nga faqja e web e Gjykatës së Lartë në seksionin *"Lista e kerkesave për pezullim civile*ò e datës 28.03.2018 sipas së cilës është pranuar kërkesa e Bashkise Pogradec për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit të Gjykates.

Bashkia Pogradec nuk dispononte vendimin e arsyetuar të Gjykates së Lartë.

Gjate vitit 2020 Bashkia ka likuiduar 3 fatura te prapamebetura per kete shoqeri si me poshte:

Nr	UXH	date likuidimi	vlera e likuidimit	Shoqeria	NIPTI	Data e fatures	Vlera e fatures
1	980	18.12.2020	3,654,810	P.	J64103678G	30.09.2012	3,654,810
2	981	18.12.2020	3,368,538	P.	J64103678G	31.10.2012	3,368,538
3	982	18.12.2020	2,801,206	P.	J64103678G	31.11.2012	2,801,206

Sa më sipër konstatohet se, pavarësisht faktit se në datën 31.12.2019 bashkia edhe pse ka pasur fonde në dispozicion (Bilanci Bashki total ndërmarrje) në shumen 183,475,387 leke, shumë e cila është programuar në thesar për destinacion të prokurimeve të vitit 2020, nuk i ka përdor këto fonde për shlyrje detyrimesh por i ka përdorur për likuidimin e faturave të investimeve të vitit 2020.

- Nga verifikimi i faturave të palikujduara për vitin 2020, rezulton se janë në shumën 292,389,248 lekë, ku detyrime të prapambetura për vendime gjyqesore janë në shumën 112,784,997 lekë ose 38.5% e gjithë detyrimeve të prapambetura. Detyrime të prapambetura për shërbime janë në shumën 94,063,024 lekë ose 32% e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për mirëmbajtje janë në shumën 601,529 lekë ose 0.1 % e gjithe detyrimeve. Detyrime të prapambetura për blerje janë në shumën 9,393,842 lekë ose 3.2 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për investime janë në shumen 75,545,856 leke ose 25.8 % e gjithë detyrimeve.

Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2020 fondi për likuidimin e detyrimeve është **37,850,000 lekë** kurse realizimi si 12 mujor është **24,902,903 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Drejtoria e Financës *Znj. I. K.* dhe është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, nenit 52 ñKryerja e shpenzimeveò ku thekson:

...Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës"

Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për periudhën 2019 - 2020, *u konstatua se*:

a. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme të buxhetit, konkretisht *për vitin 2019* kanë pësuar ndryshime të brendshme parashikimet e fondeve buxhetore për shpenzime në shumen 28,300,000 leke, duke i diversifikuar nga një zë shpenzimi në një riklasifikim zëri shpenzimi tjetër pa pësuar rritje apo pakësim të shpenzimeve buxhetore në total.

Për vitin 2020, ndryshimet në buxhet kanë ndodhur: Pakësohet shpenzimet për kodin e artikullit 602 në shumën 680,019 lekë. Shtohet kodi i artikullit 1,661,300 në shumën 17,600 lekë dhe kodi 6,511,300 në vlerë 662,419 lekëò. Të pakësohet zëri ñProjektimi dhe Restaurimi dhe Rikualifikimin Urban të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të Pogradecitò kodi 230 në vlere 4,000,000 leke, të shtohet me 3,000,000 lekë diferenca në zbritje 1,000,000 lekë. Pakësohet zëri 602 shpenzime COVID 19 në shumen 7,500,000 lekë, të shtohet i njëjti zë për vlerën 7,500,000 lekë efekti në ndryshim nuk ndryshon. Të shtojë në buxhet zërin llogaria 604 shumën 3,000,000 lekë. Të shtohet zëri Projektime artikulli 230 në Shumen 3,000,000 lekë. Të miratojë shtesën e buxhetit të Bashkisë Pogradec në vlerën 8,526,255 lekë në bazë të shkresës së ministrisë. Të shtohet zëri ñShpenzime për COVID 19ò artikulli 602 në shumën 6,500,000 lekë. Të pakësohet zëri ñ sistemimi i bllokut në krah rrugës ñAvdyl Frashëriò me kod 231 në vlerën 2,800,000 lekë. Të shtohet zëri mbikëqyrje rikonstruksion te banesave për familjet e varfëra në bashkinë Pogradec në shumën 400,000 lekë. Të shtohet zëri ñMbikëqyrje Pritat e Lumenjveò kodi

231 në shumën 150,000 lekë. Të shtohet zëri projektime me kod 230 në shumen 2,000,000 lekë. Të pakësohet zëri ñmirëmbajtje ndërtesash +dezinfektimò kodi 602 në shumen 9,767,100 lekë. Të pakësohet zëri përmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradec, si më poshtë : kodi 231 në shumën 14,000,000 lekë, të bëhet zëri përmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradec, si më poshtë: kodi 231 në shumen 6,000,000 lekë. Shtohet në zërin e investimeve bashkëfinancimi për vitin 2020 me objekt ñPërmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëri dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradecò, si me poshtë : kodi 231 në shumën 20,000,000 lekë. Argument ka ne lidhje me vitin Covid dhe ndihmes se familjeve ne nevoje u jep kuptim ndryshimeve te buxhetit .

Veprimet e mësipërme tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet real, të qëndrueshëm dhe efektiv.

b. Nga auditimi i programimit i PBA për periudhën e auditimit tavani i buxhetit të bashkisë për vitin 2019 është 890,596 mijë lekë dhe planifikimi i buxhetit është 1,059,402 mijë lekë, pra konstatohet që nga bashkia Pogradec nuk është bërë një parashikim i saktë në lidhje me programimin e PBA.

c. Nga auditimi i programimit i PBA për periudhën e auditimit tavani i buxhetit të bashkisë për vitin 2020 është 905,890 mijë lekë dhe planifikimi i buxhetit është 1,007,164 mijë lekë, pra konstatohet që nga bashkia Pogradec nuk është bërë një parashikim i saktë në lidhje me programimin e PBA.

d. Realizimi i buxheteve për periudhën objekt auditimi paraqitet: *për vitin 2019* nga **1,467,129** mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën **1,326,697** mijë lekë ose në masën 90.42 %, *për vitin 2020* nga **1,597,292** mijë lekë të planifikuara janë realizuar **1,612,951** lekë ose në masën **100.5** %. Peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë transferta të buxhetit familjarë dhe individ, të cilat për *vitin 2019* zënë në vlerën 763,305 mijë lekë ose 57.5 % dhe për *vitin 2020* në vlerën 936,895 mijë lekë zënë ose 60 % të shpenzimeve totale *(me shpenzimet e transfertave të ndihmave ekonomike dhe invalid)*.

d. Për vitet 2019 dhe 2020, rezulton se nga bashkia Pogradec nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për çdo zë të tij sipas programeve të hartuara në bazë të funksioneve të kësaj njësie vendore për tû paraqitur në Këshillin e Bashkisë, duke mos evidentuar në çûmasë janë arritur objektivat, shkaqet e mosrealizimeve të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, me qëllim përmirësimin e planifikimit të kërkesave të programit në periudhat e ardhshme si dhe përcaktimin e masave që duhet të merren për përdorimin e fondeve me efektivitet.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, nenit 52; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò i ndryshuar, pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò neni 40, 48.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është planifikuar jo i sakte dhe jo i drejtë buxheti për vitet 2019 dhe 2020.

Shkaku: planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. I. K., me detyrë Drejtore e Financës.*

Rëndësia : *E mesëm*

Rekomandime:

1.1. <u>Rekomandim</u>: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.
1.2. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi planifikim dhe zbatimin e buxhetit, u konstatua si vijon:
1.Programimi i PBA 2017-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2019 dhe 2020. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative.
Programimi i PBA 2017-2020 ndodhet sipas Aneksit nr.1 bashkëngjitur.
Bashkia Pogradec ka hartuar programet buxhetore për periudhen 2017-2020 sipas së cilës përcaktohen tavanet e institucionit si më poshte.
Tavanet e institucionit

Emertimi i artikullit	Nr.Artikullit	Buxheti 2017	2018	2019	2020
Paga	600-601	373,837	384,516	394,952	405,400
Korente te tjera	602-606	334,935	346,810	355,973	355,610
Kapitale	230-231	236,447	142,614	139,671	144,880
Jashte-buxhetore					
TOTALI		**945,219**	**873,940**	**890,596**	**905,890**

Në buxhetin e vitit 2019 janë planifikuar shpenzime 1,059,402 lekë kurse për vitin 2020 janë planifikuar shpenzime 1,007,164 lekë, kjo tregon që buxheti për vitin 2019 dhe 2020 i ka tejkaluar tavanet e parashikuara në PBA për periudhën e auditimit.
Kjo do të thotë që nuk është bërë një parashikim i saktë në lidhje me programimin e PBA
Zërat e parashikimeve sipas PBA jane:

1	Administrata	9	Kujdesi Social
2	Likujdim detyrime te prapambetura	10	Arsimi administrata
3	Pastrimi	11	Arsimi(çerdhe)
4	Gjelbrimi	12	Arsimi (parashkollor kopeshte)
5	Arti,kultura e turizmi	13	Menaxhimi I ujit (ujitje e kullim)
6	Ndriçimi publik	14	Emergjenca civile
7	Mbrojtja e mjedisit e menaxh i pyjeve	15	Sherbime te tjera publike
8	Zhvillimi I sportit		
Funksione të financuara me transferte specifike			
1	Arsimi parashkollor '09120	5	Administrimi i pyjeve
2	Arsimi parauniversitar ('09230)	6	Rruget Rurale
3	Ujitja dhe kullimi	7	Drejtoria e bujqesise
4	Sherbimi zjarrfikes		

Buxheti i vitit 2019 është miratuar me VKB nr. 2 datë 04.01.2019 konfirmuar nga Prefekti i qarkut me Nr.193.prot., date 10.01.2019
Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2019 janë planifikuar të balancuara në vlerën 1,059,402 mijë lekë, janë paraqitur në **Aneksin V. 2.3 tabela nr. 1**

Buxheti fillestar për vitin 2019 i është nënshtruar 2 herë ndryshimeve, të cilat janë të miratuara sipas VKB të mëposhtme:

Nr	VKB	KONFIRMIM PREFEKTURE
1	nr 89 d 24.09.2019	nr 1299/1 dt 02.10.2019
2	nr 102 dt 21.10.2019	nr 1397/1 dt 04.11.2019

Ndryshimet në buxhet teë vitit 2019 kanë ndodhur sipas Vendimit Nr.89 datë 24.09.2019 shkrese Nr. 6661 prot., datë 26..09.2019 të Keshillit Bashkiak me temë ñRishperndarja e fondeve në vendim Nr. 33 datë 28.03.2019 ñPër një ndryshim në VKB Nr. 02 date 04.01.2019 për miratimin dhe detajimin e buxhetit shtesë në Bashkinë Pogradec për vitin 2019, miratuar nga prefekti i qarkut Korçë me shkresen Nr. 1299/1 prot., datë 02.10.2019.

Kanë pesuar ndryshime të brendshme parashikimet e fondeve buxhetore për shpenzime në shumën 28,300,000 lekë duke i diversifikuar nga një zë shpenzimi në një riklasifikim zëri shpenzimi tjeter pa pësuar rritje apo pakësim të shpenzimeve buxhetore ne total.

Ndryshimet në buxhet të vitit 2019 kanë ndodhur sipas Vendimit Nr.102 datë 24.10.2019, shkreseë Nr. 7432 prot., date 24.10.2019 të Keshilit Bashkiak me temë ñNjë saktësim dhe rishperndarje në V.K.B Nr. 89 date 24.09.2019 ñPër rishperndarjen e fondeve në Vendimin Nr. 33, datë 28.03.2019. Për një ndryshim në V.K.B Nr. 02 datë 04.01.2019, për miratimin dhe detjaimin e Buxhetit shtesë të Bashkisë Pogradec per vitin 2019ò

1. Të pakësohet fondi për investime dhe shpenzime të tjera të bashkia pogradec në shumën 151,175 lekë ñMbikqyrje tëe ujësjellësit Rrodokol Golikò.

2. Të pakesoje dhe të shtojë në të njëjten vlerë 52424 lekë zera shpenzim mbikqyrje blerje mallra .

U krye kontrolli i veprimeve te bankes per vitin 2019 dhe vitin 2020 në lidhje me rakordimin e situacioneve të shpenzimeve dhe të ardhurave të rakorduara me degen e thesarit për bashkinë QKB, Zjarrfikese dhe Gjendja civile dhe rezultoi si më poshte:

Në planifikimin e situacioneve janë perfshire në kontroll financimet e Ministrise së financave për Bashkine Pogradec

Situacion për rakordimin e shpenzimeve nga të ardhurat për vitin 2019

Kodi i shpenzimt	Vlera e shpenzimit	Raporti në perqindje	Emertimi i shpenzimt
166	1,458,638	0.78	Shpenzime per principalin
231	69,364,392	37.20	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	52,189,414	27.99	Paga,shperblime dhe te tjera
601	12,323,191	6.61	Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	41,047,735	22.02	Mallra dhe sherbime te tjera
604	7,837,421	4.20	Sposorizime transferime
606	2,159,813	1.16	Transferta per buxhetet familjare dhe individ
651	71,408	0.04	Shpenzime per interesin e kredise
Totali	186,452,012.0	100.00	

Ujësjellës SHA, është i ndarë nga Bashkia me bilanc më vete. Kredia është një vlerë kredie e vogël e Bashkisë.

Sikurse verehet në tabelen e mësiperme nga të ardhurat e Bashkise për vitin 2019 janë përdorur për shpenzime për pricipalin në shumën 1,458,638 lekë, për Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 69,364,392 lekë, shpenzime për paga 52,189,414 lekë, Kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore 12,323,191 lekë, mallra dhe sherbime të tjera 41,047,735 lekë, sposorizime 7,837,421 lekë Transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 2,159,813 lekë dhe shpezime për interesat e kredisë 71,408 lekë.

Situacion për rakordimin e shpenzimeve nga transfertat e pakushtezuara për vitin 2019

Kodi i shpenzimt	Vlera e shpenzimit	Raporti ne perqindje	Emertimi i shpenzimt
166	2,661,029.00	0.83	Shpenzime per principalin
231	193,500,853.00	60.61	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupezuara
600	64,729,834.00	20.28	Paga,shperblime dhe te tjera
601	6,848,051.00	2.15	Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	51,224,420.00	16.05	Mallra dhe sherbime të tjera
606	62,902.00	0.02	Transferta për buxhetet familjare dhe individ
651	224,231.00	0.07	Shpenzime për imteresin e kredise
Totali	**319,251,320.00**	100.00	

Sikurse verehet në tabelen e mësiperme nga nga transfertat e pakushtezuara për vitin 2019 janë përdorur për shpenzime për pricipalin në shumën 2,661,029 lekë ,shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupezuara 193,500,853 leke,shpenzime per paga 64,729,834 leke, kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore 6,848,051 leke ,mallra dhe sherbime te tjera 51,224,420 leke,transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 62,902 lekë dhe shpezime për interesat e kredisë 224,231 lekë.

Situacion per rakordimin e shpenzimeve nga transfertat e kushtezuara per vitin 2019

Kodi i shpenzimt	Vlera e shpenzimit	Raporti në perqindje	Emertimi i shpenzimt
231	103,918,003	11.85	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara
600	10,092,506	1.15	Paga,shperblime dhe të tjera
601	1,291,919	0.15	Kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	624,600	0.07	Mallra dhe sherbime të tjera
606	761,105,905	86.78	Transferta për buxhetet familjare dhe individ
Totali	**877,032,933**	**100.00**	

Sikurse verehet në tabelen e mesiperme nga transfertat e kushtezuara për vitin 2019 janë përdorur, shpënzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupezuara 103,918,003 lekë, shpenzime për paga 10,092,506 lekë, kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore 1,291,919 lekë, mallra dhe shërbime të tjera 624,600 lekë, transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 761,105,905 lekë.

Rakordimi i të gjitha shpenzimeve nga të ardhurat nga transferta të kushtezuara dhe transferta të pakushtezuara për vitin 2019 , tabela përmbledhëse.

Kodi i shpenzimt	Vlera e shpenzimit	Raporti ne perqindje	Emertimi i shpenzimit
166	4,119,667.00	0.30	Shpenzime per principalin
231	366,783,248.00	26.53	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	127,011,754.00	9.19	Paga,shperblime dhe te tjera
601	20,463,161.00	1.48	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	92,896,755.00	6.72	mallra dhe sherbime te tjera
604	7,837,421	0.57	sposorizime transferime
606	763,328,620.00	55.20	Transferta per buxhetet familjare dhe individ
651	295,639.00	0.02	shpenzime per imteresin e kredise
Totali 2019	1,382,736,729	100.00	

Sikurse vërehet në tabelen e mesipërme nga rakordimi i të gjitha shpenzimeve nga të ardhurat nga transferta të kushtezuara dhe transferta të pakushtezuara për vitin 2019 janë perdorur, shpenzime për principalin e kredise 4,119,667 lekë për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 366,783,248 lekë, shpenzime për paga 127,011,754 lekë, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 20,463,161 lekë, mallra dhe shërbime të tjera 92,896,755 lekë, transferta për buxhetet familjare dhe individ neshumen 763,328,620 lekë, shpenzime për interesin e kredisë 295,639 lekë.

Tabela e realizimit plan fakt i buxhetit të Bashkise QKB, Zjarrfikëse dhe Gjendja civile së bashku me financimet e Ministrise së Financave.

Llog	Plani sipas situacionit	Fakti i shpenzimit	Raporti ne perqindje	Emertimi i shpenzimit
166	4,119,668	4,119,667.00	100%	shpenzime per principalin
231	414,558,700	366,783,248.00	88%	Shpenzime per rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupezuara
600	157,701,441	127,011,754.00	81%	Paga,shperblime dhe te tjera
601	34,022,343	20,463,161.00	60%	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	226,593,822	92,896,755.00	41%	mallra dhe sherbime të tjera
604	1,000,000	7,837,421	784%	sponsorizime transferime
606	765,748,123	763,328,620.00	100%	Transferta për buxhetet familjare dhe individ
651	686,092.00	295,639.00	43%	shpenzime për interesin e kredise
TOTALI 2019	**1,604,430,189**	**1,382,736,265.00**		

Sikurse vërehet në tabelen e mësiperme nga planifikimi sipas situacionit të buxhetit u verejt që, shpenzime për principalin e kredise 4,119,667 lekë është realizuar në masen 100% të planifikimit për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupëzuara 366,783,248 lekë në masën 88% të planifikimit, shpenzime për paga 127,011,754 lekë ose 81% e planifikimit, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetesore 20,463,161 lekë ose 60% e planifikimit, mallra dhe shërbime të tjera 92,896,755 lekë ose 41% e planifikimit, transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 763,328,620 leke ose 100% e planifikimit, shpenzime për interesin e kredisë 295,639 lekë ose 43% e planifikimit..

Mbi auditimin e llogarise 231 investimet është trajtuar në Aneksein V , pika 2.3, tabela nr. 2.**Buxheti i vitit 2020** është miratuar me vendim nr.115 datë 27.12.2019, konfirmuar nga keshilli i qarkut me Nr. 8659/1 date 27.12.2019.

Gjatë vitit 2019 buxheti i Bashkisë Pogradec dhe i është nënshtruar 10 herë ndryshimeve të cilat janë të miratuara sipas VKB të mëposhtme:

Nr	VKB	KONFIRMIM PREFEKTURE
1	nr 49 dt 29.04.2020	nr 408/1 dt 06.05.2020
2	nr 54 dt 13.05.2020	nr 455 dt 15.05.2020
3	nr 56 dt 01.06.2020	nr 541 dt 08.06.2020
4	nr 79 dt 23.07.2020	nr 710 dt 30.07.2020
5	nr 80 dt 23.07.2020	nr 710 dt 30.07.2020
6	nr 84 dt 27.08.2020	nr 813 dt 09.09.2020
7	nr 83 dt 27.08.2020	nr 813 dt 09.09.2020
8	nr 105 dt 23.09.2020	nr 894 dt 05.10.2020
9	nr 127 dt 06.11.2020	nr 993 dt 10.11.2020
10	nr 131 dt 20.11.2020	dt 27.11.2020

Rakordimi shpenzimeve te vitit 2020 nga te ardhurat sipas situacionit

Kodi shpenzimt	Vlera e shpenzimit	Raporti ne perqindje	Emertimi i shpenzimt
231	34,122,593	18.63	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	84,460,602	46.11	Paga,shperblime dhe te tjera
601	735,524	0.40	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	34,709,486	18.95	mallra dhe sherbime te tjera
603	2,145,729	1.17	Subvencione
604	22,377,341	12.22	sponsorizime
606	3,810,530	2.08	transferta per buxhetet familjar dhe individ
651	7,398	0.00	shpenzime principali kredie
231	791,396	0.43	çelje shpenzime per rritjen e AQT
TOTALI	**183,160,599.00**	**100.00**	

Sikurse vërehet në tabelen e mësiperme nga të ardhurat e Bashkise për vitin 2020 janë përdorur për Shpenzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupëzuara 34,122,593 lekë, shpenzime për paga 84,460,602 lekë, Kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore 735,524 lekë, mallra dhe sherbime të tjera 34,709,486 lekë, sposorizime 22,377,341 lekë. Transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 3,810,530 lekë dhe shpezime për interesat e kredisë 7,398 lekë, çelje shpenzime për rritjen e AQT në vlerën 791,396 lekë.

Rakordimi shpenzimeve te situacionit te vitit 2020 nga transfertat e kushtezuar

kodi I shpenzimt	Vlera e shpenzimit	% e shpenzimit me totalin	Emertimi I shpenzimit
231	186,293,128.00	16.29	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	7,762,240.00	0.68	Paga,shperblime dhe te tjera
601	1,292,695.00	0.11	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	12,546,544.00	1.10	mallra dhe sherbime te tjera
604	1,409,440.00	0.12	ndihma financiare
606	934,318,990.00	81.70	Transferta per buxhetet familjare dhe individ
TOTALI	**1,143,623,037.00**	100.00	

Sikurse verehet në tabelen e mësiperme nga transferte e kushtezuar për vitin 2020 janë përdorur për Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupezuara 186,293,128 lekë, shpenzime për paga 7,762,240 lekë. Kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore 1,292,695 lekë, mallra dhe sherbime të tjera 12,546,544 lekë, ndihma financiare 1,409,440 lekë. Transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 934,318,990 lekë.

Rakordimi i shpenzimeve 2020 nga transfert e pakushtëzuar

Kodi i shpenzimt	Vlera e shpenzimit	% e shpenzimit me totalin	Emertimi i shpenzimit
166	5,108,041.00	1.55	shpenzime principal kredie
231	57,072,882.00	17.34	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	78,988,459.00	24.00	Paga,shperblime dhe te tjera
601	25,788,628.00	7.84	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	154,475,714.00	46.94	mallra dhe sherbime te tjera
603	1,644,000.00	0.50	Subvencione
604	4,800,000.00	1.46	sponsorizime

606	1,142,321.00	0.35	transferta per buxhetet familjar dhe individ
651	86,818.00	0.03	shpenzime interes kredie
TOTALI	**329,106,863.00**	**100.00**	

Sikurse verehet në tabelen e më sipërme nga transferte e pakushtëzuar për vitin 2020 janë përdorur për shpenzime për shpënzime principal kredie 5,108,041 shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 57,072,882 lekë, shpenzime për paga 78,988,459 lekë, Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetesore 25,788,628 lekë, mallra dhe sherbime të tjera 154,475,714 lekë, ndihma financiare 1,644,000 lekë. Transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 1,142,321 lekë. shpenzime për interesa kredie 86,818 lekë.

Tabela e realizimit plan fakt i buxhetit te Bashkise QKB, Zjarrfikese dhe Gjendja civile sipas situacionit te thesarit se bashku me financimet e Ministrise se Financave.

kodi i shpenzimt	Plani	Vlera e shpenzimit	Raporti në perqindje	Emertimi i shpenzimt
166	5,129,000	5,108,041.00	100%	shpenzime principal kredie
230-231	510,961,134	278,373,115.00	54%	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara
600	182,213,360	171,211,301.00	94%	Paga,shperblime dhe te tjera
601	30,195,374	27,816,847.00	92%	kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
602	261,930,410	201,731,744.00	77%	mallra dhe sherbime te tjera
603	3,789,729	3,789,729.00	100%	Subvencione
604	34,399,911	28,586,781.00	83%	ndihma financiare
606	940,347,966	939,271,841.00	100%	Transferta per buxhetet familjare dhe individ
651	147,600	94,216.00	64%	shpenzime interes kredie (Eshte pagesa e interesave te kredise qe nuk jane realizuar brenda vitit)
	1 ,969,114,484	**1 ,655,983,615.00**	84%	

Sikurse verehet në tabelen e mesiperme nga planifikimi sipas situacionit te buxhetit u verejt që, shpenzime për principalin e kredisë 5,108,041 lekë është realizuar në masen 100% të planifikimit për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 278,373,115 lekë në masen 54 % të planifikimit, shpenzime për paga 171,211,301 lekë ose 94 % e planifikimit, kontribute për sigurimet shoqerore dhe shendetesore 27,816,847 lekë ose 92 % e planifikimit, mallra dhe shërbime të tjera 201,731,744 lekë ose 77 % e planifikimit, subvencione 3,789,729 lekë ose 100% e planifikimit, ndihma financiare 28,586,781 lekë ose 83% e planifikimit, transferta për buxhetet familjare dhe individ në shumën 939,271,841 lekë ose 100% e planifikimit, shpenzime për interesin e kredisë 94,216 lekë ose 64% e planifikimit.

Vleresimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Nga verifikimi përkatës u konstatua se është bërë regjistrimi, evidentimi në kontabilitet dhe në Sistemin Informatik Financiar të degës së Thesarit të detyrimeve të prapambetura.

Likuidimi i detyrimeve të prapambetura nuk është bere sipas radhës kohore.

Meqenëse detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore janë detyrime të cilat rriten nga interesat, perbejne risk ne realizimin e bushetit .

Në buxhetin e vitit 2019, miratuar me vendim nr. 2, datë 04.01.2019 të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar tek plani i shpenzimeve fonde për detyrimet e prapambetura.

Nga verifikimi të dhënave të dërguara me e-mail nga punonjësja e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar u konstatua se është bërë raportimi çdo muaj tek Dega e Thesarit Pogradec për detyrimet e prapambetura.

Nga verifikimi i faturave të palikujduara për vitin 2019 rezulton që llogaria 486 ñshpenzime të periudhave të ardheshmeò është në shumën 316,383,902 lekë, ku detyrime të prapambetura për vendime gjyqesore janë në shumën 118,877,527 lekë ose 37.5% e gjithë detyrimeve të prapambetura. Detyrime të prapambetura për sherbime janë në shumën 103,887,578 lekë ose 32.8% e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për mirembajtje janë në shumën 601,529 lekë ose 0.1% e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për blerje janë në shumën 11,000,782 lekë ose 3.4 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për investime janë në shumën 82,016,486 lekë ose 25.9 % e gjithë detyrimeve.

	Detyrimet	**Shtesa**	Vlera V.2019	Raporti ne %
1	Detyrime te prapambetura per Vendime Gjyqesore	908,249	118,877,527	37.50%
2	Detyrime te prapambetura per sherbime		103,887,578	32.80%
3	Detyrime te prapambetura per mirembajtje		601,529	0.1.%
4	Detyrime te prapambetura per Blerje		11,000,782	3.40%
5	Detyrime te prapambetura per Investime		82,016,486	25.90%
	Totali	908,249	**316,383,903**	

Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2019 fondi për likuidimin e detyrimeve është **65,000,000 lekë** kurse realizimi si **22,518,565** lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 52 ñKryerja e shpenzimeveò, të ku thuhet: ñ*Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës*ò.

Në lidhje për detyrimet e mbetura për sherbime duke qënë që nga vlera 103,887.578 lekë shoqëria PASTER zë vleren prej 95,079,867 lekë dhe duke qëne që kjo vlerë përben 92% të vlerës së detyrimeve u kërkua informacion bashkisë në lidhje me moslikujdimin e kësaj shoqerie dhe rezultoi që kjo shoqëri është në proces gjyqësor me bashkine Pogradec për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale proces të cilin shoqeria Paster e ka fituar procesin gjyqesor në Gjykatën administrative e shkalles së parë Korçe sipas Vendimit Nr. 92, datë 09.03.2016 . Ky vendim është ankimuar nga ana e Bashkisë dhe me vendimin Nr. 4912, datë 22.11.2017 të gjykates së Apelit Tirane shoqeria ñP.ò SHPK ka fituar procesin gjyqesor. Bashkia Pogradec ka bërë kërkesë për pezullim civile në Gjykate të Larte. I vetmi dokumentacion i paraqitur nga Bashkia Pogradec është fotokopje e printuar nga faqja e web e Gjykates së Larte në seksionin *"Lista e kerkesave për pezullim civile*ò e datës 28.03.2018 sipas së ciles është pranuar kërkesa e Bashkisë Pogradec për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit të Gjykatës.

Bashkia Pogradec nuk dispononte vendimin e arsyetuar të Gjykates së Lartë. Gjate vitit 2020

Siç jemi shprehur më sipër kontrolli është ushtruar mbi dokumentacionin e paraqitur nga ana e Bashkisë dhe pranimi i rekursit në gjykatë të lartë është gjykuar si çeshtje në proces e siper për të cilen nuk mund të shprehim opinion.

Bashkia ka likuiduar 3 fatura të prapamebetura për këtë shoqëri si më poshtë:

Nr	UXH	date likuidimi	vlera e likuidimit	Shoqeria	NIPTI	Data e fatures	Vlera e fatures
1	980	18.12.2020	3,654,810	P.	J64103678G	30.09.2012	3,654,810
2	981	18.12.2020	3,368,538	P.	J64103678G	31.10.2012	3,368,538
3	982	18.12.2020	2,801,206	P.	J64103678G	31.11.2012	2,801,206

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht faktit se në datën 31.12.2019 bashkia ka ka pasur fonde në dispozicion (Bilanci Bashki total ndermarrje) ne shumen 183,475,387 lekë, shumë e cila është

programuar në thesar për destinacion të prokurimeve të vitit, nuk i ka krijuar mundësi Bashkisë likuidimin e faturave të pa likuiduara, fatura të investimeve të periudhave të hershme, që i përkasin viteve 2010,2011,2012).

- Nga verifikimi i faturave të palikujduara për vitin 2020 rezulton se janë në shumen 292,389,248 lekë, ku detyrime të prapambetura për vendime gjyqesore janë në shumën 112,784,997 lekë ose 38.5% e gjithë detyrimeve të prapambetura. Detyrime të prapambetura për shërbime janë në shumën 94,063,024 lekë ose 32% e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për mirëmbajtje janë në shumën 601,529 lekë ose 0.1 % e gjithë detyrimeve. Detyrime të prapambetura për blerje janë në shumën 9,393,842 lekë ose 3.2 % e gjithe detyrimeve. Detyrime të prapambetura për investime janë në shumën 75,545,856 lekë ose 25.8 % e gjithë detyrimeve.

Nr.	Detyrimet	Likujduar për vitin 2020	Viti 2020	Raporti në %
1	Detyrime te prapambetura per Vendime Gjyqesore	7,000,779	112,784,997	38.50%
2	Detyrime te prapambetura per sherbime	9,824,554	94,063,024	32%
3	Detyrime te prapambetura per mirembajtje	-	601,529	0.1%
4	Detyrime te prapambetura per Blerje	1,606,940	9,393,842	3,2%
5	Detyrime te prapambetura per Investime	6,470,630	75,545,856	25.80%
	Totali	**24,902,903**	**292,389,248**	

Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2020 fondi për likuidimin e detyrimeve është **37.850,000 lekë** kurse realizimi si 12 mujor është **24,902,903 lekë**.

Veprimet e mësipërme jan në kundërshtim me kërkesat e nenit nr. 52 ñKryerja e shpenzimeveò, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, ku thuhet: ñ...*Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës".*

6. AUDITIMI MBI REALIZIMIN E TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMI I TYRE.

(Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre**;** Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor)

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave, rezultoi:

1. Të dhënat mbi numrin e punonjësve

Për vitin 2019, bazuar në Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Pogradec[11], Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka funksionuar me 21 punonjës në total, (9 punonjës në bashki dhe 12 në Njësitë Administrative) deri më 17.09.2019 dhe 24 punonjës në total (12 punonjës në bashki dhe 12 në Njësitë Administrative) me ndryshimin e strukturës më datë 17.09.2019. Për vitin 2020 struktura e DTTV ka pasur 26 punonjës në total, (14 punonjës në bashki dhe 12 në Njësitë Administrative).

Për realizimin e kësaj pike programi (*mbledhja dhe përdorimi i të ardhurave),* grupi i auditimit shqyrtoi dhe analizoi evidencat si vijon: Akt akordimet me Degën e Thesarit Pogradec për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për subjektet fizik/juridik dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, administrimi i aseteve për kontratat e qirave, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale 2019-2020.

Për vitin 2019, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Pogradec është miratuar me VKB-në nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Për vitin 2020 paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Pogradec është miratuar me VKB-në nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19[12].

2. Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Referuar Vendimeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Pogradec ka miratuar treguesit e planit të ardhurave, për vitet 2019-2020 të cilët paraqiten të detajuar në formë tabelore në Aneksin 4/1

Nga analiza e të dhënave të Aneksit 4/1 rezulton se:

Për vitin 2019 të ardhurat e parashikuara nga taksat dhe tarifat vendore janë **405,269 mijë lekë**. Këto të ardhura janë realizuar në vlerën **290,960 mijë lekë** ose në masën **72%**, diferenca paraqitet në vlerën **114,309 mijë lekë** deficit.

Sipas zërave fiskal, niveli mesatar i realizmit të të ardhurave varion nga 17% që është taksa e ndikimit në infrastrukturë deri në 100% që është taksa e reklamës.

Për vitin 2020 të ardhurat e parashikuara nga taksat dhe tarifat vendore janë **460,086 mijë lekë**. Këto të ardhura janë realizuar në vlerën **307,180 mijë lekë** ose në masën **67%**, diferenca paraqitet në vlerën **152,906 mijë lekë** deficit.

---

[11] Vendim nr. 26, datë 31.01.2019 ñPër miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2019ò, i ndryshuar me Vendimin nr. 247, datë 17.09.2019. Vendim nr. 51, datë 14.02.2020 ñPër miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2020ò i ndryshuar me Vendimin nr. 141, datë 17.07.2020.

[12] VKB nr. 46, datë 07.04.2020 ñPër krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò, VKB nr. 55, datë 13.05.2020, VKB nr. 90, datë 27.08.2020, VKB nr. 102, datë 23.09.2020.

Sipas zërave fiskal, niveli mesatar i realizmit të të ardhurave varion nga 15% që është taksa e ndikimit në infrastrukturë deri në 117% që është taksa e tabelës.

Tabela nr. 6/1: Përmbledhje mbi parashikimin-realizimin e taksave dhe tarifave vendore 2019-2020

Periudha	Parashikimi	Realizimi	%
2019	405,269	290,960	72%
2020	460,086	307,180	67%
Totali	**865,355**	**598,140**	**69.5%**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec

Sikurse mund të vërehet nga tabela e mësipërme kemi rënie në realizimin e të ardhurave nga 72% në vitin 2019 në 67% në vitin 2020. Kjo rënie ka ardhur kryesisht për shkak të lehtësirave që janë miratuar nga KB në pagesat e taksave dhe tarifave vendore për bizneset si rezultat i pandemisë Covid-2019 dhe që do të trajtohet në vijim.

►**Titulli i gjetjes nr. 1:** *Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore.*

Situata: Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 23[13] të VKB-ve për vitin 2019-2020[14] dhe është e ndarë në 10 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit.

Tabela nr. 6/2: Taksa e tokës sipas kategorive

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)	Tokë bujqësore gjithsej sipas kategorisë
I	2,800	.....
II	2,100	.....
III	1,400	.....
IV	1,350	452
V	1,150	.....
VI	1,100	176
VII-X	1,000	1,661
Gjithsej		***2,289***

Burimi: DTTV Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Pritshmëria e arkëtimit të taksës së tokës bazuar në sipërfaqen në ha që zotërojnë familjet dhe në VKB-të për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2019 dhe 2020 është **2,464,800 lekë** dhe më e detajuar jepet në tabelën në vijim.

Tabela nr.6/3: Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitet 2019-2020

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve që taksohen	Tokë bujqësore gjithsej ha	Çmimi sipas paketës fiskale lekë/ha	Detyrim vjetor/lekë
1	Bucimas	5500	207	1,350	279,450
2	Udënisht	2500	245	1,350	330,750
3	Çërravë	2500	176	1,100	193,600
4	Dardhas	900	428	1,000	428,000
5	Proptisht	1200	712	1,000	712,000
6	Trebinjë	700	241	1,000	241,000
7	Velçan	700	280	1,000	280,000
Shuma		***14,000***	***2,289***		***2,464,800***

Burimi: DTTV Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

[13] Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 23, pika 1, ankesi 2.

[14] Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

Sikurse paraqitet në tabelën e mësipërme, bazuar në të dhënat që administron DTTV për të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Pogradec, sipërfaqja e tokës e cila tatohet për detyrimin e taksës së tokës është **2,289 ha** dhe detyrimi vjetor që duhet të paguhet është **2,464,800 lekë**. Grupi i auditimit mori të dhëna edhe nga Drejtoria e Mbrojtjes së Tokës dhe Koordinimit me Nj.A lidhur me sipërfaqen në ha që familjet disponojnë me AMTP. Në mënyrë të përmbledhur këto të dhëna paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela nr.6/4:Inventari tokës bujqësore që disponon Bashkia Pogradec, dhe ndarja e saj sipas familjeve

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve gjithsej që kanë tokë me AMTP	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Sipërfaqe në pronësi të bashkisë (ha)	Çmimi sipas paketës fiskale lekë/ha	Detyrim vjetor/lekë
1	Bucimas	6096	1382	1088	1,350	1,865,700
2	Udënisht	2503	463	511	1,350	625,050
3	Çërravë	3186	1013	1645	1,100	1,114,300
4	Dardhas	1215	682	172	1,000	682,000
5	Proptisht	1997	1246	1459	1,000	1,246,000
6	Trebinjë	1075	1554	1973	1,000	1,554,000
7	Velçan	1076	617	908	1,000	617,000
Shuma		***17,148***	***6,957***	***7,756***		***7,704,050***

Burimi: DMT, Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Nga analizimi dhe krahasimi i të dhënave në tabelat nr. 4/3 dhe nr. 4/4 (të dhënave nga DTTV dhe DMT) rezulton së ka mospërputhje në sipërfaqen e tokës së marrë nga familjet me AMTP. Përkatësisht, sipërfaqja totale mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore nga DTTV është **2,289 ha** me detyrim vjetor për tû arkëtuar **2,464,800 lekë**, ndërsa nga të dhënat e DMT sipërfaqja e tokës që familjet kanë me AMTP është **6,957 ha,** sipërfaqe e cila duhet të tatohet për detyrimin e taksës së tokës, me vlerë detyrimi vjetor **7,704,050 lekë**.

Duke u mbështetur në të dhënat e paraqitura më sipër nuk është e qartë se si DTTV e bën planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Për vitin 2020 planifikimi i kësaj takse është **5,171,000 lekë**, ndërsa pritshmëritë e taksës së tokës të paraqitura në tabelën nr. 4/3 janë **2,464,800** lekë. Lidhur me diferencën prej **2,706,200 lekë** midis planifikimit dhe pritshmërisë DTTV shprehet se ka llogaritur edhe arkëtimet e mundshme të familjeve që rezultojnë debitorë nga viti paraardhës.

Ndërsa referuar të dhënave nga DMT të paraqitura në tabelën nr. 4/4 pritshmëria për taksën e tokës është 7,704,050 lekë. Bazuar në të dhënat e DMT, DTTV duhet të kishte planifikuar të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore në shumën 7,704,050 lekë, diferenca në planifikim është **2,533,050 lekë** për vitin 2020 dhe **2,543,050 lekë** për vitin 2019, duke sjellë të ardhura të planifikuara më pak në buxhetin e bashkisë për të dy vitet në shumën **5,076,100 lekë**.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 23, pika 1[15], aneksi 2. Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti

Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

[15] ñBaza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetë deklarimet të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet tokaò.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit efektiv midis Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën **2,533,050 lekë.**
Për pasaktësitë në llogaritjen e planifikimit të taksës së tokës bujqësore ngarkohen me përgjegjësi:
Z. V. M., Drejtor i DTTV - N/C;
Znj. A. P., Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit N/C.

► **Titulli i gjetjes nr. 2:** *Mos vjelje e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore.*

Situata:

Tabela nr. 6/5: Familjet debitorë për taksën e tokës 2019-2020

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve debitorë 2019	Shuma e detyrimit 2019 në lekë	Nr. i familjeve debitorë 2020	Shuma e detyrimit 2020 në lekë
1	Bucimas	707	230,160	1686	414,307
2	Udënisht	386	106,270	583	208,925
3	Çërravë	1040	1,275,168	1414	1,110,081
4	Dardhas	278	170,371	233	198,336
5	Proptisht	558	393,760	558	393,760
6	Trebinjë	253	111,222	287	128,852
7	Velçan	551	255,268	550	255,268
Totali		**3773**	**2,542,219**	**5311**	**2,709,529**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër konstatohet se për vitin 2019 janë debitorë për taksën e tokës bujqësore 3773 familje me vlerë 2,542,219 lekë dhe për vitin 2020 janë debitorë 5311 familje me vlerë 2,709,529 lekë, në total për vitet 2019-2020 detyrimet e pa arkëtuara për taksën e tokës janë në shumën 5,251,748 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, nenet 9, 23.
Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mos arkëtimi i vlerës prej **5,251,748 lekë** për taksën e tokës bujqësore.
Shkaku: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka qenë efektive në punën e saj për të bërë të mundur mbledhjen e taksës së tokës bujqësore.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të angazhohet në marrjen e masave dhe identifikimin e mekanizmave për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet që nuk e paguajnë atë nëpërmjet agjentit tatimor ñUKò Pogradec, por dhe ato familje që paguajnë në faturën e ujit të pijshëm, me qëllim rritjen e arkëtimeve për taksën e tokës nga familjet debitorë në vlerën **5,251,748 lekë.**
Për mos arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës ngarkohen me përgjegjësi:
Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;
Z. E. M. - Shef i Menaxhimit të Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P; Specialistët për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore në njësitë administrative, K/P:

z. I. H., z. M. P., z. G. B., z. T. P., z. K. B., z. T. E ., z. E. F., znj. S. K., znj. K. L., z. R. Ç., znj. A. Q., znj. A. Gj.. Ish punonjësit me detyrë specialistë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, z. S. O., z. B. M., z. M. D., z. A. M., z. E. S., znj. E. D., z. A. G., z. B. L., z. E. B., z. H.H., z. B. M..

► **Titulli i gjetjes nr. 3:** *Metodologjia e përdorur nga DTTV për llogaritjen e taksës së pasurisë ndërtesë.*

Situata: Taksa e pasurisë, ndërtesë për vitin *2019* është realizuar në masën 91%, nga 56,131,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 51,324,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 4,807,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 83%, nga 67,668,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 55,924,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 11,744,000 lekë.
Taksa e truallit për vitin *2019* është realizuar në masën 91%, nga 3,862,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 3,498,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 364,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 77%, nga 4,238,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 3,255,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 983,000 lekë. Për planifikimin e këtyre dy taksave DTTV duhet të marrë informacion periodik nga ASHK-ja Pogradec bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 24[16]. DTTV me anë të shkresës nr. 6536 Prot, datë 20.09.2019 dhe shkresës nr. 3320 Prot, datë 14.07.2020 i është drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Pogradec, duke i kërkuar informacion dhe të dhëna mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës në zbatim të detyrimeve të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 ñPër metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ñndërtesaò neni 2, neni 4, dhe Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò neni 24. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, nuk ka kthyer përgjigje asnjërës nga shkresat e DTTV si në vitin 2019 ashtu edhe në vitin 2020. ASHK nuk ka dërguar informacion periodik në Bashkinë Pogradec lidhur me regjistrimet e reja dhe ndryshimet e gjendjes së pronave, në kundërshtim me detyrimet ligjore. Gjithashtu, nga auditimi rezulton që nga ana e DTTV janë bërë verifikime në terren për të saktësuar regjistrin e bazës së të dhënave mbi të cilin llogaritet taksa e pasurisë, ndërtesë vetëm për Njësitë Administrative Velçan dhe Proptisht. Në kushtet e mos marrjes së informacionit nga ASHK, dhe mos realizimit të verifikimeve në terren për të gjitha njësitë, DTTV e kryen planifikim e kësaj takse bazuar në regjistrat e pasurive të njësive administrative për ndarjen e tokës bujqësore dhe të dhënat e ndërtesave dhe truallit. Llogaritja e taksës së pasurisë ndërtesë në këtë`mënyrë nuk është plotësisht e saktë pasi regjistrat e njësive administrative nuk janë të përditësuar.
Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 24. VKM nr. 132, datë 07.03.2018 ñPër metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ñndërtesaò, neni 2, pika 2[17], neni 4.
Ndikimi/Efekti: Mos llogaritje e saktë e taksës së pasurisë ndërtesë me ndikim në sasinë e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: ASHK nuk ka dërguar informacion periodik në Bashkinë Pogradec lidhur me regjistrimet e reja dhe ndryshimet e gjendjes së pronave si dhe DTTV nuk ka bërë verifikime në

[16] ñPër efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të komunës njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë për regjistrimet e reja të kryera dhe për ndryshimet e gjendjes së pronaveò.
[17] ñNjësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësoreò.

terren për të saktësuar regjistrin e bazës së të dhënave mbi të cilin llogaritet taksa e pasurisë, ndërtesë.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në mungesë të informacionit periodik nga ASHK mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë saj, të angazhohet në kryerjen e verifikimeve periodike në terren për të përditësuar dhe saktësuar informacion dhe të dhënat mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës. Gjithashtu, DTTV nga ana e saj, të vazhdojë përpjekjet për të marrë informacionin periodik nga ASHK në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 ñPër metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ñndërtesaò.

► **Titulli i gjetjes nr. 4:** *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

Situata: Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë **329** subjekte të legalizuara me vlerë **11,442,106 lekë**, si dhe detyrimin e tarifës së planit të detajuar vendor **329** subjekte të legalizuara me vlerë **21,204,148 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. Në total të ardhurat e munguara nga mos arkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës së planit të detajuar vendor (taksa për legalizimet) janë **32,646,254 lekë**. Taksa që paguhet për ndërtimet e reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve) përbëhet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e planit të detajuar vendor. Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vetvete zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisje me leje ndërtimi dhe llogaritet bazuar në VKB-të për vitin 2019-2020 për miratimin e tarifave dhe taksave vendore në Bashkinë Pogradec. Duke analizuar të dhënat e paraqitura në Aneksin 2.4/1 për nivelet e realizimit të kësaj takse rezulton se, për vitin *2019,* është realizuar në masën 17 %, nga 43,736,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 7,652,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 36,084,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 15 %, nga 47,885,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 7,284,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 40,601,000 lekë. Realizimi i kësaj takse varet nga lejet e zhvillimit/ndërtimit që jepen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe nga taksa e legalizimeve. Nga analizimi i të dhëna rezulton se për vitin 2019 janë dhënë 18 leje ndërtimi dhe shuma e arkëtuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 1,346,686 lekë, për vitin 2020 janë dhënë 23 leje ndërtimi dhe shuma e arkëtuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 4,957,810 lekë.
Detyrimi për legalizimet në vetvete përbëhet nga:

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 0.5% [18] e vlerës së investimit;
2. Tarifa e planit të detajuar vendor 1 %[19].

Tabela nr.6/6: Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2019-2020

Viti	Numri total i legalizimeve	Detyrimi financiar në lekë	Numri i faturave të paguara	Vlera në lekë	Numri i faturave të pa paguara	Vlera në lekë
2019	326	9,716,854	157	3,642,771	169	**6,074,083**

[18] Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c ñpër ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesiò.
[19] Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

2020	247	7,682,942	87	2,314,919	160	**5,368,023**
SHUMA	**573**	**17,399,796**	**244**	**5,957,690**	**329**	**11,442,106**

Burimi: Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Pogradec, për vitin *2019* janë legalizuar gjithsej 326 objekte për të cilat DPKZHT ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 9,716,854 lekë. Kanë paguar detyrimin 157 qytetarë në shumën 3,642,771 lekë. Janë **debitorë 169 qytetarë në shumën 6,074,083 lekë** (për më shumë informacion shiko Aneksin 4/2). Për vitin *2020* janë legalizuar 247 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë 7,682,942 lekë. Kanë paguar detyrimin 87 qytetarë në shumën 2,314,919 lekë. Janë **debitorë 160 qytetarë në shumën 5,368,023 lekë** (për më shumë informacion shiko Aneksin 4/3).

Tabela nr.6/7: Pagesa e tarifës së planit të detajuar vendor për vitin 2019-2020

Viti	Numri total i legalizimeve	Detyrimi financiar në lekë	Numri i faturave të paguara	Vlera në lekë	Numri i faturave të pa paguara	Vlera në lekë
2019	326	18,273,745	157	7,104,076	169	**11,196,669**
2020	247	14,637,306	87	4,629,827	160	**10,007,479**
SHUMA	**573**	**32,911,051**	**244**	**11,733,903**	**329**	**21,204,148**

Burimi: Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Për vitin *2019* janë legalizuar gjithsej 326 objekte për të cilat DPKZHT ka llogaritur detyrimin për tarifën e planit të detajuar vendor në shumën 18,273,745 lekë. Kanë paguar tarifën 157 qytetarë në shumën 7,104,076 lekë. Janë **debitorë 169 qytetarë në vlerën 11,196,669 lekë**. Për vitin *2020* janë legalizuar 247 objekte me detyrim për tarifën e planit të detajuar vendor 14,637,306 lekë. Kanë paguar 87 qytetarë në vlerën 4,629,827 lekë. Janë **debitorë 160 qytetarë në vlerën 10,007,479 lekë**.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 4/6 rezulton se, **për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 329 subjekte të legalizuara me vlerë 11,442,106 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 4/7 rezulton se, **për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin e tarifës së planit të detajuar vendor 329 subjekte të legalizuara me vlerë 21,204,148 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

Në zbatim të detyrimeve të ligjit 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar[20] deri në muajin gusht 2020 individët që kishin përfituar lejen e legalizimit nuk mund ta merrnin atë pa vërtetuar pagesën e taksave pranë bashkisë. Ky detyrim ligjor është shfuqizuar me Ligjin nr. 98/2020 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, dhe nga muaji gusht 2020, ASHK mund të lëshojë lejen e legalizimit edhe pa paguar taksat vendore. Edhe pse ky ndryshim i ligjit e bën më të vështirë situatën për strukturat e bashkisë në arkëtimin e kësaj takse, ajo që vërehet është se, për periudhën janar 2019-gusht 2020 nga ana e strukturave të Bashkisë Pogradec nuk janë bërë përpjekje për të rritur

[20]Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c ñPër ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesiò. Ligji nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò, fjalia e dytë shfuqizohetò.

nivelet e arkëtimit. DPKZHT pret që qytetarët të paraqiten vetë pranë bashkisë për të paguar apo për shërbime të tjera të cilat nuk u ofrohen deri në likuidimin e taksës së legalizimit. Grupi auditimit konstatoi se DPKZHT nuk e koordinon punën me DTTV duke sjellë që kjo e fundit të mos ketë informacion mbi realizimin e kësaj takse dhe të mos bëjë regjistrimin e detyrimeve që subjektet e legalizuara kanë ndaj bashkisë. Nga asnjë strukturë e Bashkisë Pogradec nuk janë dërguar shkresa për verifikimin e subjekteve të cilët nuk kanë paguar detyrimet dhe nëse ato janë pajisur ose jo me lejen e legalizimit.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c[21].

Ligji nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò[22].

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò pika 5[23].

Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar. VBK nr. 124 Prot, datë 21.10.2020 ñpër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradecò, pika III. 1

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mos arkëtimi i vlerës prej **32,646,254 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e asnjë mase nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për të bërë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve nga subjektet/familjet që kanë përfituar certifikatën e pronësisë, si dhe mos bashkëpunim me DTTV dhe ASHK-në.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 329 subjekte debitorë me vlerë **32,646,254 lekë**. Gjithashtu nga strukturat e Bashkisë Pogradec të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Personat përgjegjës për mungesën e bashkëpunimit midis dy drejtorive brenda Bashkisë Pogradec dhe mos koordimimin e punës për arkëtimin e taksës për legalizimet janë:

Znj. B. N.[24] - Drejtore e DPKZHT për periudhën 01.01.2019-30.09.2019, N/C;

Z. P. Z.[25] - Nënkryetar i Bashkisë Pogradec por që nga data 01.10.2019 kryen edhe funksionet e Drejtorit të DPKZHT;

---

[21] ñPër ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesiò.

[22] Ligji nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò, fjalia e dytë shfuqizohetò.

[23] ñTaksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, të ndryshuarò.

[24] Vendim nr. 546, datë 02.11.2016, Vendin nr. 250, datë 29.05.2017 dhe Vendim nr. 257, datë 23.09.2019.

[25] Urdhër nr. 405, datë 30.09.2019.

Znj. F. Z.[26] - Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nga data 15.05.2020, N/C;
Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;
Znj. A. P. - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit, N/C.

► **Titulli i gjetjes nr. 5:** *Planifikim jo i saktë i taksës së fjetjes në hotel.*

Situata: Taksa e fjetjes në hotel për vitin *2019* është realizuar në masën 79%, nga 8,781,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 6,896,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,885,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 16%, nga 9,525,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 1,511,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 8,014,000 lekë.
Realizimi i kësaj takse është ndikuar ndjeshëm nga masat e marra nga qeveria me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19. Referuar të dhënave të paraqitura grupit të auditimit, në vitin 2019 numri total i shtretërve të shfrytëzuar ka qenë 109,755 e përkthyer kjo në vlerë monetare 7,682,862 lekë, ndërsa në vitin 2020 numri total i shtretërve të shfrytëzuar ka qenë 27,134 e përkthyer kjo në vlerë monetare 1,899,380 lekë. Diferenca llogaritet në minus 82,979 shtretër të shfrytëzuar më pak me ndikim financiar 5,783,482 lekë mungesë në të ardhurat e bashkisë.
Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të kësaj takse rezulton se DTTV ka të regjistruar vetëm 30 hotele, nga të cilët 3 janë mbyllur në vitin 2020. Për periudhën objekt auditimi specialistët e DTTV nuk kanë kryer verifikime në terren për të identifikuar dhe më pas regjistruar njësi të tjera akomoduese. Gjithashtu, nga ana e DTTV nuk janë bërë përpjekje as për të verifikuar nëpërmjet faqeve të internetit për rezervime online të hoteleve si një mënyrë për të kontrolluar nëse ka hotele apo njësi të tjera akomoduese që japin dhoma me qira dhe nuk janë të regjistruara për të paguar bashkisë taksën e fjetjes në hotel sipas përcaktimeve të VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore. Vetëm nga një kërkim i thjeshtë në internet i bërë nga grupi i auditimit për ñ*akomodim në Pogradec*ò, rezulton që të jenë mbi 100 vende për akomodim ku përfshihen hotelet, bujtinat dhe njësi të tjera akomoduese, ndërsa DTTV ka të regjistruar vetëm 30 subjekte/hotele për detyrimin e taksës së fjetjes në hotel.
Për të ilustruar identifikimin e subjekteve që nuk janë të regjistruar nga DTTV për pagesën e taksës së fjetjes mund të përmendim rastet e disa subjekteve akomoduese që janë marrë nga interneti si:

- Vila ñI.ò ushtron aktivitet që nga muaji qershor i vitit 2018, është e regjistruar në QKB vetëm si bar-restorant[27];
- Vila ñT.ò ushtron aktivitet që nga muaji qershor i vitit 2018[28];
- Hotel ñF.ò ushtron aktivitet që nga muaji dhjetor i vitit 2018 është regjistrua në QKB më datë 16.09.2020[29];
- Vila ñB.ò ushtron aktivitet që nga muaji gusht i vitit 2018[30];
- Hotel Restorant ñJ.ò ushtron aktivitet që nga muaji gusht i vitit 2019[31];
- Vila ñG.ò ushtron aktivitet që nga muaji qershor i vitit 2020, është e regjistruar në QKB vetëm si bar-restorant[32];

[26] Vendin nr. 123, datë 15.05.2020.
[27] https://www.booking.com/hotel/al/vila-ilo.html
[28] https://www.booking.com/hotel/al/vila-topciu.html
[29] https://www.booking.com/hotel/al/dea-pogradec12345.html
[30] https://www.booking.com/hotel/al/villa-braho1.html?aid=318615;label=New_English_EN_AL_27034602145-
[31] https://www.booking.com/hotel/al/jonirestaurant.html?aid=318615;label=New_English_EN_AL_2703460214
[32] https://www.booking.com/hotel/al/vila-genton.html?aid=318615;label=New_English_EN_AL_27034602145-

- ñN. R. H.ò ushtron aktivitet që nga muaji gusht i vitit 2020[33].

Këto struktura akomoduese që ushtrojnë veprimtari duke mos përmbushur detyrimet ligjore për pagesën e taksës së fjetjes në hotel gjenden fare lehtë nga një kërkim i thjeshtë në internet. Duke mos pasur informacion rreth sipërfaqes (numrit të dhomave, numrit të shtretërve) që këto subjekte ofrojnë për akomodim është e pamundur të llogariten detyrimet financiare të munguara ndaj Bashkisë Pogradec.

Kriteret: Ligji nr. 93/45 ñPër Turizminò, i ndryshuar, neni 45 - klasifikimi i strukturave akomoduese. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, neni 26. VKB-të nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò, VKB nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Shkaku: DTTV nuk është angazhuar në kryerjen e verifikimeve në terren por edhe hulumtimeve në faqet e internetit që ofrojnë akomodim për të identifikuar njësi të tjera akomoduese në Bashkinë Pogradec.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

DTTV të kryejë verifikime në terren si dhe në faqet e internetit që ofrojnë rezervime për akomodim në territorin e Bashkisë Pogradec, për të identifikuar njësitë akomoduese që ushtrojnë aktivitet të pa regjistrua duke iu shmangur pagesës së taksës së fjetjes.

Për mos kryerjen e verifikimeve në terren apo mos marrjen e asnjë nisme për të verifikuar subjektet që ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar për detyrimin e taksës së fjetjes në hotel ngarkohen me përgjegjësi:

Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;

Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P;

Punonjësit e terrenit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, K/P:

z. E. D., z. E. C., z. A. K., z. M. P., z. G. B., z. T. P., z. I. H., z. K. B., z. T. E ., z. E. F., znj. S. K., znj. K. L., z. R. Ç., znj. A. Q., znj. A. Gj..

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 6</u>:** *Planifikim jo i saktë i taksës së parkimit.*

Situata: Taksa e parkimit për vitin *2019* është realizuar në masën 64%, nga 4,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,568,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,432,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 61%, nga 4,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,422,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,578,000 lekë.

Nga shqyrtimi i materialeve të vëna në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se, për vitin 2019 janë 5 subjekte që kanë autorizim nga Bashkia Pogradec për parkim të rezervuar, shuma që ato kanë paguar është në vlerën 63,600 lekë. Për vitin 2020 janë pajisur me autorizim 7 subjekte, shuma e paguar është në vlerën 99,000 lekë. Theksojmë se kjo shumë paguhet paraprakisht për periudhën e kërkuar dhe më pas bëhet pajisja me autorizimin përkatës nga bashkia. Nga shqyrtimi i të gjitha praktikave të lejeve për autorizimin e subjekteve për parkim të rezervuar rezultoi që të gjitha e kishin dokumentacionin në rregull. Llogaritja e taksës së parkimit është detyrë e Sektorit

[33] https://www.booking.com/hotel/al/nesti-relax-home-pogradec-lin.html?aid=356980;label=gog235jc-

të Transportit në Bashkinë Pogradec dhe vjelja bëhet nga DTTV[34]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me taksën e parkimit rezulton se Bashkia Pogradec nuk ka të miratuar me VKB sipërfaqe për parkimin e mjeteve me pagesë. Gjithashtu, nuk është e qartë si bëhet llogaritja e kësaj takse nga Sektori i Transportit kur nuk janë miratuar m^2 që janë të disponueshme për parkim.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, neni 32.

Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò.

Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e parkimit, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Shkaku: Mungesa e një Vendimi të KB për përcaktimin e sipërfaqes së disponueshme për parkimin e automjeteve me pagesë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime

Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit (Sektorin e Transporteve dhe Supervizimit të Shërbimeve) në bashkëpunim me strukturat e tjera në Bashkinë Pogradec të identifikojnë sipërfaqen që është në dispozicion për parkim me pagesë dhe të nxjerrin aktet e nevojshme për miratimin e kësaj sipërfaqe si të disponueshme për parkim. Sipërfaqe kjo që duhet të jetë baza për llogaritjen e taksës së parkimit.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për llogaritjen e kësaj takse janë:

Z. D. T. - Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit që ka në varësi Sektorin e Transporteve dhe Supervizimit të Shërbimeve, K/P;

z. N. SH. - Specialisti për transportin, N/C.

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 7</u>:** *Mos arkëtim i të ardhurave nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.*

Situata: Për vitin 2019 këto tarifa janë realizuar në masën 78% ose mos arkëtim në vlerën 21,591,000 lekë, 77% ose mos arkëtim në vlerën 10,917,000 lekë dhe 70% ose mos arkëtim në vlerën 7,231,000 lekë ndërsa në vitin 2020 janë realizuar në vlerat 65%, ose mos arkëtim në vlerën 42,777,000 lekë, 63% ose mos arkëtim në vlerën 21,577,000 lekë dhe 63% ose mos arkëtim në vlerën 10,484,000 lekë. Planifikimi për realizimin e këtyre tarifave bëhet bazuar në numrin e bizneseve të ndara sipas llojit të aktivitetit që ato ushtrojnë dhe të familjeve që paguajnë këto tarifa sipas VKB-ve. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit janë në grupin e tarifave që kanë pësuar lehtësira në vitin 2020 nisur nga situata që është krijuar nga pandemia e Covid-19. Më saktësisht, VKB nr. 55, datë 13.05.2020 ñPër disa ndryshime në paketën fiskale 2020 në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò **përjashton nga pagesat e tarifave vendore të *pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit* subjektet të cilat kanë mbyllur aktivitetin** bazuar në Urdhrin nr. 164, datë 12.03.2020 ñPër mbylljen e bareve, restoranteve, lokaleve, fastfood dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientëtò.

VKB nr. 90, datë 27.08.2020 ñPër disa ndryshime në paketën fiskale 2020 në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò **përjashton nga pagesat e tarifave vendore të**

[34] Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.

pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit **subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin e transportit të udhëtarëve** bazuar në Urdhrin nr. 168, datë 12.03.2020 ñPër ndalimin/kufizimin e lëvizjeve me mjetet e transportit. Këto dy vendime kanë ndikuar në uljen e arkëtimeve nga këto tarifa sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.6/8: Diferenca në arkëtimin e tarifave të pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit në vitin 2020 si rezultat i lehtësirave fiskale

Nr.	Taksa	Njësitë Administrative								Total në lekë
		Pogradec	Buçimas	Çërravë	Proptisht	Velçan	Trebinjë	Dardhas	Udënisht	
1	Pastrim	1,308,427	465,240	38,917	3,900	1,217	267	300	190,682	**2,008,950**
2	Gjelbërim	654,212	232,621	19,458	1,950	608	133	150	95,342	**1,004,474**
3	Ndriçim	258,033	69,517	5,583	1,450	450	100	144	142,726	**478,003**
Total		**2,220,672**	**767,378**	**63,958**	**7,300**	**2,275**	**500**	**594**	**428,750**	**3,491,427**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec

Tabela nr.6/9: Detyrimi i familjeve për tarifat e pastrim-gjelbërim-ndriçimit 2019-2020

Nr.	Njësia Administrative	Nr. i familjeve debitore 2019	Shuma e detyrimit 2019 në lekë			Nr. i familjeve debitore 2020	Shuma e detyrimit 2020 në lekë		
			Pastrim	Gjelbërim	Ndriçim		Pastrim	Gjelbërim	Ndriçim
1	Pogradec	905	1,925,597	938,111	592,491	1605	3,612,240	1,759,809	1,111,459
2	Buçimas	707	1,496,038	728,839	460,319	1686	2,692,999	1,311,974	828,615
3	Udënisht	386	690,756	336,522	212,540	583	1,358,012	661,595	417,850
4	Çërravë	1772	3,201,119	1,597,274	1,060,467	1816	3,945,552	1,968,306	1,008,247
5	Dardhas	419*	203,400		83,800	490	300,000		98,000
6	Proptisht	560	336,000		112,000	560	448,000		112,000
7	Trebinjë	260	156,000		52,000	287	229,600		57,400
8	Velçan	595	357,000		119,000	595	476,000		119,000
Totali		**5604**	**8,365,910**	**3,600,746**	**2,692,617**	**7622**	**13,062,403**	**5,701,684**	**3,752,571**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

**Për tarifën e pastrimit në Njësinë Administrative Dardhas janë debitorë 339 familje pasi disa fshatra nuk kanë detyrim për këtë tarifë - ky shërbim nuk ofrohet nga Bashkia Pogradec*

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mos arkëtimi i vlerës prej **37,175,931 lekë** për tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

Shkaku: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka qenë efektive në mbledhjen e tarifave të pastrimit-gjelbërimit-ndriçimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të intensifikojë punën dhe të marrë masa konkrete për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të familjeve për tarifat e pastrim-gjelbërim-ndriçimit në vlerën **37,175,931 lekë.**

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për mos arkëtimin e detyrimeve për tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit janë:

Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;

Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P;

Punonjësit e terrenit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, K/P:

z. E. D., z. E. C., z. A. K., z. M. P., z. G. B., z. T. P., z. I. H., z. K. B., z. T. E ., z. E. F., znj. S. K., znj. K. L., z. R. Ç., znj. A. Q., znj. A. Gj.. Ish punonjësit me detyrë specialistë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, z. S. O., z.B. M., z.M. D., z. A. M., z. E. S., znj. E. D., z.A. G., z. B. L., z. E. B., z. H.H., z.B. M..

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 8</u>:** *Mos arkëtim i gjobave të vendosura nga strukturat e Policisë Bashkiake dhe Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit, Bashkia Pogradec.*

Situata: Të ardhurat nga gjobat Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore i planifikon duke u bazuar në vitet paraardhëse, dhe për tre vitet e fundit 2018-2019-2020 shuma e planifikuar është 3,000,000 lekë por arkëtimi i gjobave ka ardhur me rënie nga 72% në vitin 2018, në 52 % në vitin 2019 dhe në 21 % në vitin 2020.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Pogradec funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò i ndryshuar, neni 3,4,5, ligjit nr. 183/2014 datë 24.02.2014 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, neni 4,5,6. Në zbatim të detyrimeve ligjore IMT vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.[35]

Për vitin 2019, IMT ka vendosur 25 gjoba me vlerë totale 4,410,000 lekë, për vitin 2020 janë vendosur 20 gjoba me vlerë totale 4,750,000 lekë.

Për gjobat e vendosura në vitin 2019 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMT në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 22, pika 1[36], e ka vazhduar procedurën për arkëtimin e tyre duke e dërguar vendimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë për të bërë të mundur lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për secilën gjobë. Rezulton se 4 kundërvajtës e kanë ankimuar vendimin e IMT-së për vendosjen e gjobës në GJASHPK, për 3 kundërvajtës kërkesa është rrëzuar (kundërvajtësi M. M. -vlera e gjobës 100,000 lekë[37], kundërvajtësi E.M.-vlera e gjobës 500,000 mijë lekë[38] dhe kundërvajtësi F.H.-vlera e gjobës 500,000 lekë[39]) dhe për 1 kundravajtës kërkesa është pranuar (kundërvajtësi E. B.-vlera e gjobës 500,000[40]. Për kundërvajtësin E.B. IMT e ka ankimuar vendimin e gjykatës më datë 30.2.2019[41].

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se gjobat e vendosura nga IMT në vitin 2019 janë kontabilizuar si detyrime, ndërsa gjobat e vendosura në vitin 2020 nuk janë kontabilizuar si detyrime sepse IMT nuk ka përcjellë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrim kontabël pas vendosjes së gjobës si dhe në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1[42], pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të ontabilitetitò.

Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë[43].

---

[35] Ligjit nr. 183/2014 datë 24.02.2014 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, neni 6.

[36] Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 22, pika 1,Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv ñVendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligjiò.

[37] Vendim nr. 1739-545, datë 19.11.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë.

[38] Vendim nr. 608, datë 26.12.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë.

[39] Vendim nr. 694-01470, datë 17.12.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë.

[40] Vendim nr. 1656-529, datë 06.11.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë.

[41] Shkresa nr. 5090/10 Prot, datë 30.12.2019.

[42] ..... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për tôu paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

[43] Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeòneni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve pika 1,ñGjoba dhe shumat, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje

Për gjobat e vendosura gjatë vitit 2019 pas nxjerrjes së Urdhrit të Ekzekutimit nga ana e IMT-së nuk janë marrë masa për arkëtimin me forcë të gjobave, nëpërmjet shërbimit të përmbarimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë.[44] Gjatë kryerjes së auditimit grupit të auditimit iu paraqitën shkresat nr. 1459 Prot, nr. 1460 Prot, dhe nr. 1461 Prot, datë 31.03.2020 me objekt ekzekutimin e Vendimeve të GJASHPK nr. 7, nr. 9 dhe nr. 10, datë 19.06.2019 drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Për gjobat e vendosura gjatë vitit 2020, IMT nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të bërë të mundur arkëtimin e tyre, duke mos dërguar në gjykatë asnjë nga gjobat e papaguara në afatin ligjor (brenda 10 ditëve) për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.[45]

Për sa më sipër rezulton se, për vitin 2019 nuk janë arkëtuar 17 gjoba me vlerë 3,710,000 lekë plus kamatë vonesat me vlerë 2,226,000 lekë, vlera totale e detyrimeve ndaj bashkisë është **5,936,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

Për vitin 2020 janë paguar gjithsej 3 gjoba në vlerën 250,000 lekë dhe mbeten ende pa u paguar 17 gjoba në vlerë 4,500,000 lekë, plus kamatë vonesat me vlerë 2,700,000 lekë, **në total vlera e gjobave të papaguara është 7,200,000 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec**. **Për vitin 2019-2020 kemi gjoba të papaguara në vlerën totale 13,136,000 lekë.**

Policia Bashkiake

Menaxhimi i gjobave nga Policia Bashkiake Pogradec bëhet në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës", i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative".

Tabela nr.6/10: Gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake 2019-2020

Viti	Gjoba të vendosura	Gjoba të arkëtuara	Vlera në lekë e gjobave të arkëtuara	Gjoba të pa arkëtuara	Vlera në lekë e gjobave të pa arkëtuara
2019	83	58	101,500	25	52,500
2020	103	57	96,000	46	88,500
Totali	**186**	**115**	**197,500**	**71**	**141,000**

Burimi: Policia Bashkiake, Bashkia Pogradec

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme për vitet 2019-2020 Policia Bashkiake ka vendosur 186 gjoba me vlerë 338,500 lekë. Janë paguar 115 gjoba me vlerë 197,500 lekë dhe janë ende pa u paguar **71 gjoba me vlerë 141,000 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e

me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur.....pika 3 ñPas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesatò.

[44] Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò, neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative ñVendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligjiò, neni 22, pika 1, ñVendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligjiò, neni 3, pika 5 ñKur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerëò.

[45] Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 22, pika 1 Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv.

Bashkisë Pogradec. Bashkia Pogradec nuk ka një sistem për menaxhimin e gjobave që vendos Policia Bashkiake gjë që sjell ulje të eficiencës së procesit të menaxhimit me ndikim direkt në arkëtimin e tyre. Vjelja e gjobave për individët që nuk i paguajnë ato dhe kanë kontratë me UK Pogradec bëhet nëpërmjet faturës së Ujësjellësit bazuar në Vendimin nr. 37 datë 05.03.2020 ñPër disa ndryshime në Akt-Marrëveshjen nr. 18, datë 31.01.2012, ñPër vendosjen e taksave dhe tarifave vendore tek Ndërmarrja e UK Sh.Aò. Ndërsa për individët të cilët nuk kanë një kontratë me UK Pogradec vjelja e gjobave të Policisë Bashkiake bëhet e vështirë për të mos thënë e pa mundur. Në këto raste ajo që aplikohet nga strukturat e bashkisë, është që këtyre qytetarëve nuk iu ofrohen shërbime bashkiake deri në pagesën e vlerës së gjobës. Nga ana tjetër, Vendimi nr. 37, datë 05.03.2020 për vjeljen e gjobave të Policisë Bashkiake nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm nga Prefekti i Qarkut Korçë është klasifikuar si i pa bazuar në legjislacion.[46] Fatura e ujit të pijshëm përbën titull ekzekutiv[47], ndërsa vendosja dhe vjelja e kundërvajtjeve administrative të bashkisë ndaj të tretëve bazohet në akte të tjera ligjore dhe parashikon afate ankimi administrativ apo dhe ankimim në gjykatë.[48]

Gjithashtu, për vitin 2019-2020, struktura e Policisë Bashkiake nuk ka dërguar pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrimin kontabël të gjobave si dhe nuk ka bërë akordimin në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1[49], pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.

Kriteret: Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò i ndryshuar, neni 3,4,5.

Ligji nr. 183/2014 datë 24.02.2014 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, neni 4,5,6.

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 22, pika 1[50]

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1[51], pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.

Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës", i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMT dhe Policia Bashkiake.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit nga strukturat që kanë përgjegjësinë për ndjekjen e hapave ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

---

[46] Shkresa e Prefektit të Qarkut Korçë, nr. 345/1 Prot. datë 02.04.2020.

[47] Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 ñPër trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutivò, i ndryshuar.

[48] Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 7 dhe neni 9.

[49] ..... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për tôu paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

[50] Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 22, pika 1,Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv ñVendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligjiò.

[51] ..... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për tôu paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, të kërkojnë në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe të marrë masa për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitet 2019-2020 në vlerën 13,136,000 lekë. Gjithashtu, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.
Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër janë:
Z. E. Ç. - Kryeinspektor i IMT-së për periudhën 01.01.2019-31.10.2019[52]*, K/P;*
Z. N. Ç. - Kryeinspektor i IMT-së për periudhën 01.11.2019 e në vazhdim[53] *K/P;*
Z. K. Ç. - Inspektor i Policisë Bashkiake[54]*.*

Taksa dhe tarifa të tjera vendore
Taksë vendore për biznesin e vogël/Tatim i thjeshtuar mbi fitimin
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin për vitin *2019* është realizuar në masën 62%, nga 4,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,477,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,523,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 59%, nga 4,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,355,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,645,000 lekë. Mbledhja e taksës tatim i thjeshtuar mbi fitimin bëhet nga agjenti tatimor Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë[55] e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe arkëtimin e kësaj takse referuar të dhënave që subjektet deklarojnë në fund të periudhave për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.
Taksa mbi të ardhurat personale
Bazuar në të dhënat e paraqitura nga DTTV rezulton së për vitin 2019 taksa mbi të ardhurat personale është planifikuar në shumën 4,643,000 lekë dhe nuk është realizuar. Për vitin 2020 është planifikuar në shumën 4,643,000 lekë dhe është realizuar në shumën 12,789,000 lekë, realizimi në masën 275%. Për realizimin e kësaj takse u shqyrtuan shkresat që administronte Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Pogradec ku rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shumën e TAP prej 8,526,000 lekë që është realizuar në juridiksionin e tyre për vitin 2019 e ka kaluar në datë 09.09.2020[56] dhe shumën prej 4,263,000 lekë që është realizuar për vitin 2020 e ka kaluar më datë 23.12.2020[57].
Taksa mbi rentën minerale
Për vitin *2019* taksa mbi rentën minerare është realizuar në masën 92%, nga 200,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 183,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 17,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 223 %, nga 200,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 446,000 lekë, arkëtim mbi parashikimin në vlerën 246,000 lekë. Kjo taksë kalon për llogari të bashkisë nga DPT&DPD.

[52] Urdhër nr. 628, datë 31.10.2019.
[53] Urdhër nr. 630, datë 31.10.2019.
[54] Urdhër nr. 128, datë 17.05.2018.
[55] Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 04.01.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2019ò. Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 108, datë 22.11.2019 ñPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Pogradec për vitin 2020ò, i ndryshuar.
[56] Shkresa nr. 16572 prot, datë 09.09.2020 e DPT.
[57] Shkresa nr. 23951 prot, datë 23.12.2020 e DPT.

Taksa e kalimit të pronësisë
Taksa e kalimit të pronësisë për vitin *2019* është realizuar në masën 93%, nga 6,200,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 5,767,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 433,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 43%, nga 6,200,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,697,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 3,503,000 lekë. Planifikimi kësaj takse bëhet bazuar në realizimin e vitit para ardhës dhe realizimi i saj varet drejtpërdrejtë nga shitjet e ndërtesave. Sikurse rezulton, për vitin 2020 kjo taksë ka një rënie në realizim nga vitin 2019 me 50%.
Taksë për hapësira publike
Taksë për hapësira publike për vitin *2019* është realizuar në masën 64%, nga 3,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 1,930,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 1,070,000 lekë. Për vitin *2020* është realizuar në masën 47%, nga 5,500,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 2,563,000 lekë, mos arkëtim në vlerën 2,937,000 lekë. Taksa për hapësirën publike është në grupin e taksave dhe tarifave që kanë pësuar lehtësira në vitin 2020 nisur nga situata që është krijuar nga pandemia e Covid-19. Më saktësisht,VKB nr. 102, datë 23.09.2020 ñPër krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò bazuar në Urdhrin nr. 320, datë 15.5.2020 ñPër disa kufizime në ofrimin e shërbimeve në bare, restorante dhe lokale, fastfood*”* **ka përjashtuar nga pagesa e taksës vendore për hapësirën publike për periudhën shtator-dhjetor 2020** subjektet që i nënshtrohen zbatimit të urdhrit të sipërcituar. Ndikimi financiar i zbatimit të këtij urdhri sipas përllogaritjeve të DTTV është 1,488,000 lekë.

3. Menaxhimi i borxhit tatimor

► **Titulli i gjetjes nr. 9:** *Debitorët për taksat dhe tarifat vendore 2019-2020 dhe masat e marra për të arkëtuar detyrimet.*
Situata: DTTV në Bashkinë Pogradec ka pjesë të saj edhe strukturën e menaxhimit të borxhit[58]. Sipas listës së punonjësve të kësaj drejtorie janë 2 punonjës që kanë përgjegjësi për menaxhimin e borxhit. Nga auditimi i dokumentacionit të DTTV u konstatua se, subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit.

Tabela nr.6/11: Bizneset Debitorë 2019-2020

Bashkia Pogradec	2019		2020	
	Nr. Debitorëve	Shuma	Nr. Debitorëve	Shuma
NJA Pogradec	101	8,451,514	112	4,181,944
NJA Buçimas	52	3,218,925	63	3,978,688
NJA Çërravë	34	1,226,801	23	265,138
NJA Dardhas	2	26,843	1	19,463
NJA Udënisht	32	2,805,905	50	3,994,271
NJA Proptisht	25	913,605	28	313,844
NJA Trebinjë	10	169,936	3	124,240
NJA Velçan	6	115,066	3	65,048
Totali	**262**	**16,928,595**	**283**	**12,942,636**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr.6/12: Familjet Debitorë 2019-2020

Bashkia Pogradec	Nr. Familjeve 2019	Nr. Familjeve debitorë	Nr. Familjeve debitorë %	Shuma në lekë
NJA Pogradec	13,576	905	6.67	4,937,427
NJA Buçimas	5,832	707	12.12	3,835,994
NJA Çërravë	3,174	1772	55.83	12,751,665
NJA Dardhas	1,231	419	34	770,185
NJA Udënisht	2,647	386	14.58	1,771,170
NJA Proptisht	1,992	560	28.11	1,346,779

[58] Vendim nr. 245, datë 17.09.2019.

NJA Trebinjë	1,116	260	23.29	526,826
NJA Velçan	1,086	595	54.79	1,394,795
Totali	**30,654**	**5185**	**16.9**	**27,334,841**
Bashkia Pogradec	**Nr. Familjeve 2020**	**Nr. Familjeve debitorë**	**Nr. Familjeve debitorë %**	**Shuma në lekë**
NJA Pogradec	13,630	1605	11.78	9,262,155
NJA Buçimas	5,868	1686	28.73	6,905,125
NJA Çërravë	3,184	1816	57.04	11,579,628
NJA Dardhas	1,236	490	39.64	1,104,827
NJA Udënisht	2,660	583	21.92	3,482,081
NJA Proptisht	1,997	560	28.04	1,626,629
NJA Trebinjë	1,113	287	25.79	732,228
NJA Velçan	1,080	595	55.09	1,693,295
Totali	**30,768**	**7622**	**24.77**	**36,385,968**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Vlera totale e debisë (borxhit tatimor) që menaxhohet nga DTTV paraqitet:

- *Viti 2019*

Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 27,334,841 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 16,928,595 lekë;

- *Viti 2020*

Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 36,385,968 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 12,942,636 lekë;

Referuar informacionit të paraqitur nga DTTV Bashkia Pogradec, u konstatua se në fund të vitit 2020 gjendja e debitorëve vetëm për subjektet fizik/juridik është **44,428,186 lekë për 370 subjekte**.

Në mënyrë analitike nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 4/11 rezulton se, shuma që bizneset i detyrohen bashkisë për vitin 2019 është 16,928,595 lekë dhe për vitin 2020 është 12,942,636 lekë, pra ka një rënie prej 3,985,959 lekë. Por edhe pse kemi një ulje të vlerës së detyrimit total, numri i bizneseve debitorë nga viti 2019 në vitin 2020 është rritur nga 262 në 283, kemi 21 biznese më shumë që i janë shtuar listës së debitorëve. Ky numër është rritur kryesisht në njësitë administrative Udënisht, Buçimas dhe Pogradec.

Nga analizimi i të dhënave të tabelës nr. 4/12 rezulton se, numri i familjeve debitorë në Bashkinë Pogradec për vitin 2019 është 5185 ose 16.9% e familjeve janë debitorë, ndërsa në vitin 2020 është 7622 ose 24.77% e familjeve janë debitorë, kemi një rritje të numrit të familjeve debitorë me 2,697 familje. Për vitin 2019 nga detyrimi i familjeve për taksat dhe tarifat vendore nuk është mbledhur shuma 27,334,841 lekë dhe për vitin 2020 nuk është mbledhur shuma prej 36,385,968 lekë. Numri më i madh i familjeve debitorë për vitin 2019 rezulton në njësitë administrative Çërravë ï 55.8% e familjeve janë debitorë, Velçan ï 54.7% e familjeve janë debitorë, Proptisht ï 28% e familjeve janë debitorë, Trebinjë ï 23% e familjeve debitorë e kështu me radhë. Për vitin 2020 numri më i madh i familjeve debitore rezulton në njësitë administrative Çërravë ï 57% e familjeve janë debitorë, Velçan ï 55% e familjeve janë debitorë, Dardhas ï 39% e familjeve janë debitorë, Proptisht dhe Buçimasï 28% e familjeve janë debitorë, e kështu me radhë.

Gjithashtu, DTTV nga ana e saj ka dërguar në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar listën e debitorëve për vitin 2019[59] por nga ana e DEMF nuk janë marrë masa për të kontabilizuar debitorët.

Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave pjesë e DTTV paraqet probleme në menaxhimin e dokumentacionit të debitorëve. Përkatësisht kjo njësi nuk disponon listat e debitorëve progresiv të konsoliduara për periudhën objekt auditimi. Grupit të auditimit iu vunë në

[59] Shkresa nr. 08 Prot. datë 14.01.2020 ñPër subjektet debitorë për taksat dhe tarifat vendore 2019ò.

dispozicion listat e debitorëve nga Sektori i Vlerësimit dhe Regjistrimit në DTTV, i cili gjithashtu nuk dispononte një listë të konsoliduar të debitorëve progresiv por lista specifike të grupuara sipas njësive administrative, sipas llojeve të bizneseve, sipas mënyrës së pagesës (në faturën e ujit të pijshëm ose jo). Mos hartimi i një liste përmbledhëse për të gjithë debitorët progresiv bëhet shkas për pasaktësi në llogaritjen e tyre.

Masat e marra nga DTTV për arkëtimin e detyrimeve

Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Pogradec është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:[60]

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DTTV lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, DTTV ka njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2019 dhe 2020.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2019, DTTV ka nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar. Përkatësisht:

- Urdhër nr. 248, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 814, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekare, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò ka urdhëruar vendosjen e masës siguruese apo barrës hipotekare ndaj pasurive të personave që rezultojnë debitorë ndaj bashkisë. Për zbatimin e këtyre urdhrave DTTV i ka dërguar shkresa Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec (shkresa nr. 1501/1 Prot, datë 07.04.2020 dhe shkresën nr. 4982/1 Prot, datë 13.10.2020) për bllokimin e pasurive të paluajtshme të subjekteve debitorë të biznesit për vitin 2019.
- Urdhër nr. 250, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 813, datë 13.10.2020 ñPër bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorëò ka urdhëruar bllokimin e llogarive bankare për subjektet që rezultojnë debitorë ndaj Bashkisë Pogradec. Për zbatimin e këtyre urdhrave DTTV i ka dërguar shkresa zyrtare 13 bankave të nivelit të dytë (shkresa nr. 1503/1 Prot, datë 07.04.2020 dhe shkresën nr. 4981/1 Prot, datë 13.10.2020) për bllokimin e llogarive të subjekteve debitorë të biznesit për vitin 2019.
- Urdhër nr. 249, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 815, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekare, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò ka urdhëruar vendosjen e masës siguruese apo barrës hipotekare ndaj pasurive të subjekteve që rezultojnë debitorë ndaj Bashkisë Pogradec për taksat dhe tarifat vendore. Për zbatimin e këtyre urdhrave DTTV i ka dërguar shkresa zyrtare Drejtorisë Rajonale të Transporteve Korçë (shkresa nr. 1502/1 Prot, datë 07.04.2020 dhe shkresën nr. 4983/1 Prot, datë 13.10.2020) për vendosjen e masës së sigurisë ndaj subjekteve debitorë të biznesit për vitin 2019.

[60] Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

- Nga shqyrtimi i shkresave nr. 3941 Prot, nr. 3941/1 Prot, dhe nr. 3941/2 Prot, datë 19.08.2020 që njoftojnë subjektet debitorë për detyrimet tatimore për taksat dhe tarifat vendore, ñA. O.ò, ñHotel E. K.ò dhe A. Ç. konstatohet se këto subjekte janë debitorë:[61]
  - Subjekti ñA. O.ò, që nga viti 2015 në shumën 521,812 lekë;
  - Subjekti Hotel ñE. K.ò, që nga viti 2014 në shumën 6,187,701 lekë;
  - Subjekti ñA. Ç.ò, që nga viti 2017 në shumën 120,591 lekë.

Nëpërmjet shkresave të sipërcituara subjektet njoftohen që ndaj tyre në zbatim të dispozitave ligjore do të aplikohet masa ñ*konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor*ò[62]. Për zbatimin e kësaj mase është ngritur grupi i punës me Urdhër-Pune nr. 676, datë 02.09.2020 ñPër të verifikuar, monitoruar në vend subjektet debitorë për taksat dhe tarifat vendoreò. Nëpërmjet këtij urdhri inspektorët e grupit të punës duhet të verifikojnë dhe monitorojnë në vend subjektet debitorë për taksat dhe tarifat vendore me qëllim konfiskimin në fund të ditës të 50% të qarkullimit të realizuar. Nga zbatimi i këtij urdhri rezulton që nga subjekti E. K. (A. K.) janë arkëtuar gjithsej 40,000 lekë dhe nga subjekti A. Ç. janë paguar gjithsej 50,000 lekë.

Urdhrat e cituar më sipër përfshijnë një listë prej **257 biznesesh debitorë për vitin 2019 të cilët janë dërguar për t'u bllokuar, me shumë totale të detyrimeve 16,928,595 lekë** (për më shumë informacion shiko Aneksin 4/4).

Për debitorët të cilët paguajnë detyrimit nëpërmjet agjentit Ujësjellës Kanalizime, DTTV ka kryer kontroll të vazhdueshëm për pagesat e faturave të ujit dhe i është dërguar informacion Ndërmarrjes së UK Pogradec për marrjen e masave që konsistojnë në ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të debitorëve.[63]

Pas marrjes së masave të mësipërme rezulton se nga 257 biznese të cilët janë dërguar për bllokim sipas urdhrave sipërcituar, vetëm 43 prej tyre kanë paguar detyrimet totale apo të pjesshme që kanë ndaj bashkisë për vitin 2019. Më saktësisht, detyrimet e këtyre 43 bizneseve janë në shumën 3,811,020 lekë, nga e cila **janë paguar 3,643,364 lekë dhe kanë mbetur për t'u paguar 167,656 lekë** (për më shumë informacion shiko Aneksin 4/5).

Nga dokumentet e analizuara nuk rezulton që për periudhën objekt auditimi Bashkia Pogradec të ketë aplikuar masën ñSekuestrim i pasurisëò për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet ndaj bashkisë. Për arkëtimin e detyrimeve të vitit 2020 rezulton se DTTV ende nuk ka filluar marrjen e masave për subjektet debitorë. Gjithashtu, në shkresat e cituara më sipër rezultojnë biznese të cilët kryejnë aktivitet duke pasur detyrime të konsiderueshme ndër vite ndaj bashkisë ndaj të cilëve nuk janë marrë masat e sekuestrimit të pasurisë[64] apo të kërkohet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të RSH[65].

Kriteret: Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

---

[61] Detyrimet e këtyre subjekteve nuk janë të njëjta me shumën e detyrimeve në listën e debitorëve që janë dërguar për tôu bllokuar sepse në atë listë janë llogaritur detyrimet vetëm për vitin 2019.

[62] Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, neni 89 pika 2, i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuarò.

[63] Viti 2019- shkresa nr. 2048 Prot. datë 06.03.2019, shkresa nr. 6313 Prot. datë 11.09.2019, shkresa nr. 8354 Prot. datë 05.12.2019. Viti 2020- shkresa nr. 10 Prot. datë 21.01.2020, shkresa nr. 4521 Prot. datë 23.09.2020, shkresa nr. 6449 Prot. datë 17.12.2020.

[64] Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 93.

[65] Kodi Penal e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar Seksioni VI, Veprat Penale në lidhje me taksat dhe tatimet, neni 181, Mospagimi i taksave dhe tatimeve ñMospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjetôò.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e vitit 2019 të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekare, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò dhe ñPër bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorëò.[66]
Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 apo rezultojnë debitorë ndër vite në vlerën **44,428,186 lekë**, të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisëò.
Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisë.

Për problemet e sipër cituara ngarkohen me përgjegjësi:
Z. V. M. - Drejtor i DTTV,N/C;
Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P;
Z. V. Ll. - Specialist për borxhin, K/P;
Specialistët për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore në njësitë administrative, K/P:
z. I. H., z. M. P., z. G. B., z. T. P., z. K. B., z. T. E ., z. E. F., znj. S. K., znj. K. L., z. R. Ç., znj. A. Q., znj. A. Gj.;
Për mos regjistrimin në regjistrat kontabël të debitorëve ngarkohet me përgjegjësi znj. I. K. - Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, N/C.

4. *Zbatimi i akt marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve me këste*

► **Titulli i gjetjes nr. 10:** *Mos zbatimi i kushteve të akt marrëveshjeve për të paguar me këste detyrimet për taksat dhe tarifat vendore.*

Situata: Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, DTTV në Bashkinë Pogradec ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara në vijim.
Tabela nr.6/13: Marrëveshjet e lidhura për vitin 2019

Nr.	Data e Akt-marrëveshjes	Subjekti	Detyrimi në lekë	Shuma e Paguar në lekë	Shuma e Mbetur në lekë
1	Nr. 33 Prot,datë 12.04.2019	M.04	928,327	528,327	400,000
2	Nr. 122 Prot,datë 25.06.2019	B.P,M.Mj,E.S	177,959	177,959	0
3	Nr. 275 Prot,datë 18.09.2019	G.C	768,005	605,394	162,611
4	Nr. 60 Prot,datë 14.06.2019	Ko. BR	217,139	217,139	0
5	Nr. 59 Prot,datë 13.06.2019	K shpk	531,497	408,320	123,177

[66] Urdhër nr. 248, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 814, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò, Urdhër nr. 250, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 813, datë 13.10.2020 ñPër bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorëò, Urdhër nr. 249, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 815, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò

6	Nr. 56 Prot,datë 12.06.2019	NPV I	378,604	378,604	0
7	Nr. 30 Prot,datë 05.04.2019	Ch. A	1,062,914	53,146	1,009,768
8	Nr. 50 Prot,datë 29.05.2019	D. M	34,526	8,632	25,894
9	Nr. 306 Prot,datë 18.10.2019	A. B	91,550	18,000	73,550
10	Nr. 44 Prot,datë 13.05.2019	AN-IR-IS	461,042	25,613	435,429
11	Nr. 167 Prot, datë 31.07.2019	J. 06	1,012,140	1,012,140	0
12	Nr. 125 Prot, datë 02.07.2019	H.E	2.526,084	730,676	1,795,408[67]
13	Nr. 126 Prot, datë 02.07.2019	P.E	2,241,701	949,078	1,292,623[68]
Totali			**10,431,448**	**5,113,028**	**5,318,460**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec

- Akt marrëveshja nr. 33 Prot, datë 12.04.2019 do të likuidohej në dy këste, kësti i parë më datë 12.04.2019 dhe kësti i dytë në prill 2020. **Rezulton që akt marrëveshja nuk është zbatuar, është paguar kësti i parë dhe nuk është paguar kësti i dytë**.
- Akt marrëveshja nr. 275 Prot, datë 18.09.2019 duhet të likuidohej me 18 këste mujore prej 42,667 lekë deri në muajin shkurt të vitit 2021, **rezulton që janë ende të pa paguara 4 muaj.**
- Akt marrëveshja nr. 59 Prot, datë 13.06.2019 duhet të likuidohej me 6 këste, 5 këste në shumën 100,000 lekë dhe kësti i fundit në shumën 31,497 lekë duhej të likuidohej në nëntor 2019. **Rezulton se nuk janë paguar ende dy kështet e fundit**.
- Akt marrëveshja nr. 30 Prot, datë 05.04.2019 duhej të likuidohej me 20 këste mujore, deri në tetor 2020. Subjekti debitor **ka paguar vetëm 1 muaj detyrimin dhe nuk ka kryer më pagesat sipas akt marrëveshjes.**
- Akt marrëveshja nr. 50 Prot, datë 29.05.2019 parashikon se detyrimet duhej të likuidoheshin në 4 këste deri në muajin nëntor 2019. Subjekti debitor **ka paguar vetëm një këst dhe vijon të jetë debitor duke mos respektuar akt marrëveshjen.**
- Akt marrëveshja nr. 306 Prot, datë 18.10.2019 parashikon që detyrimet do të likuidohen me 10 këste deri në muajin korrik 2020. Subjekti **ka paguar vetëm këstin e parë në momentin e nënshkrimit të akt marrëveshjes dhe nuk ka paguar 9 kështet e tjera duke mos respektuar kushtet e akt marrëveshjes**.
- Akt marrëveshja nr. 44 Prot, datë 13.05.2019 duhet të likuidohet me 18 këste mujore deri në muajin tetor 2020. Rezulton se **është paguar vetëm kësti i parë dhe subjekti vazhdon të jetë debitor duke mos respektuar kushtet e akt marrëveshjes.**
- Akt marrëveshja nr. 125 Prot, datë 02.07.2019 duhet të likuidohet me 18 këste mujore, deri në dhjetor 2020. Subjekti **ka paguar 8 këste dhe është debitor për 10 kështet e tjera në shkelje të kushteve të akt marrëveshjes.**
- Akt marrëveshja nr. 126 Prot, datë 02.07.2019 duhet të likuidohet me 18 këste mujore, deri në dhjetor 2020. Subjekti **ka paguar 11 këste dhe është debitor për 7 kështet e tjera në shkelje të kushteve të akt marrëveshjes.**

Tabela nr.6/14: Marrëveshjet e lidhura për vitin 2020

Nr.	Data e Akt-marrëveshjes	Subjekti	Detyrimi në lekë	Shuma e Paguar në lekë	Shuma e Mbetur në lekë
1	Nr. 205 Prot,datë 29.09.2020	Dh. A.	51,308	51,308	0
2	Nr. 154 Prot,datë 02.07.2020	A. M.	91,584	46,299	45,000
3	Nr. 114 Prot,datë 01.06.2020	B. T.	86,507	13,404	73,103
4	Nr. 46 Prot,datë 11.02.2020	D. P.e	273,123	273,123	0
5	Nr. 284 Prot,datë 17.12.2020	J. Tr. & Al. Comp.	274,343	105,000	169,343

[67] Është bërë llogaritja nga të dhënat e paraqitura në akt marrëveshjen nr. 254 Prot. datë 13.11.2020 detyrimet e mbartura nga akt marrëveshja nr. 125 Prot, date 02.07.2019.

[68] Është bërë llogaritja nga të dhënat e paraqitura në akt marrëveshjen nr. 253 Prot. datë 13.11.2020 detyrimet e mbartura nga akt marrëveshja nr. 126 Prot, date 02.07.2019.

6	Nr. 176 Prot,datë 07.08.2020	M. N	322,121	66,120	256,001
7	Nr. 278 Prot,datë 11.12.2020	A. K.	159,590	39,168	120,422
8	Nr. 115 Prot,datë 03.06.2020	E. L. S.	35,009	17,997	17,012
9	Nr. 252 Prot,datë 11.11.2020	M.	859,537	30,000	729,537
10	Nr. 233 Prot,datë 20.10.2020	M.Pr. nef co	1,167,456	778,306	389,150
11	Nr. 215 Prot,datë 07.10.2020	K. BR	422,520	120,000	302,520
12	Nr. 94 Prot, datë 06.05.2020	Re. Mi.	230,005	230,005	0
13	Nr. 86 Prot,datë 21.04.2020	Jo. 2008	1,138,881	460,000	678,881
14	Nr. 150 Prot,datë 30.06.2020	J. 06	1,115,160	360,000	755,160
15	Nr. 146 Prot, datë 25.06.2020	R. M.	75,694	30,348	45,346
16	Nr. 254 Prot, datë 13.11.2020	H. El.	3,137,277	400,000	2,737,277
17	Nr. 253 Prot, datë 13.11.2020	P.r El.	2,865,552	470,000	2,395,552
Totali			**12,205,382**	**3,491,078**	**8,714,304**

Burimi: DTTV, Bashkia Pogradec

- Akt marrëveshja nr. 154 Prot, datë 02.07.2020 do të likuidohet në 18 këste mujore deri në muajin dhjetor 2021. Janë paguar rregullisht këstet mujore sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 114 Prot, datë 01.06.2020 do të likuidohet në 18 këste mujore deri në muajin dhjetor 2021. Rezulton se **ka paguar 3 këste për vitin 2020 nga 6 këste që duhet të kishte paguar sipas kushteve të akt marrëveshjes**.
- Akt marrëveshja nr. 284 Prot, datë 17.12.2020 do të likuidohet në 13 këste mujore deri në muajin dhjetor 2021. Janë paguar rregullisht këstet mujore sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 176 Prot, datë 07.08.2020 do të likuidohet në 31 këste mujore. Janë paguar rregullisht këstet mujore sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 278 Prot, datë 11.12.2020 do të likuidohet në 18 këste mujore. Rezulton se ka paguar këstin e parë sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 115 Prot, datë 03.06.2020 do të likuidohet në 3 këste mujore qershor-korrik-gusht 2020. Rezulton se **ka paguar vetëm këstin e parë dhe nuk ka paguar dy këstet e tjera duke shkelur kushtet e akt marrëveshjes**.
- Akt marrëveshja nr. 252 Prot, datë 11.11.2020 do të likuidohet në 7 këste deri në muajin maj 2021. Rezulton se **ka paguar vetëm këstin e parë dhe nuk ka paguar këstet e tjera sipas afateve të përcaktuara duke shkelur kushtet e akt marrëveshjes**.
- Akt marrëveshja nr. 233 Prot, datë 20.10.2020 do të likuidohet në 15 këste deri në muajin dhjetor 2021. Rezulton se ka për të paguar edhe 5 këste.
- Akt marrëveshja nr. 215 Prot, datë 07.10.2020 do të likuidohet në 14 këste mujore. Rezulton se ka paguar rregullisht këstet mujore sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 86 Prot, datë 21.04.2020 do të likuidohet në 18 këste mujore. Rezulton **se ka paguar 7 këste për vitin 2020 nga 9 këste që duhet të kishte paguar** sipas kushteve të akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 150 Prot, datë 30.06.2020 do të likuidohet në 13 këste mujore deri në muajin korrik 2021. Rezulton se **ka paguar 4 këste për vitin 2020 nga 6 këste që duhet të kishte paguar** sipas kushteve të akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 146 Prot, datë 25.06.2020 do të likuidohet në 12 këste mujore. Janë paguar rregullisht këstet mujore sipas akt marrëveshjes.
- Akt marrëveshja nr. 254 Prot, datë 13.11.2020 duhet të likuidohet me 8 këste mujore. Rezulton se **ka paguar vetëm këstin e parë duke mos respektuar kushtet e akt marrëveshjes**. Gjithashtu, akt marrëveshja nuk është e firmosur nga ana e administratorit të subjektit debitor Hidropower Elektrik.
- Akt marrëveshja nr. 253 Prot, datë 13.11.2020 duhet të likuidohet me 6 këste mujore. Rezulton se **ka paguar vetëm këstin e parë duke mos respektuar kushtet e akt**

marrëveshjes. Gjithashtu, akt marrëveshja nuk është e firmosur nga ana e administratorit të subjektit debitor Po. El.

Për vitin 2019, nga 13 akt marrëveshje që DTTV ka lidhur për të ndihmuar subjektet debitorë në likuidimin e detyrimeve me këste, vetëm 4 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa 9 subjektet e tjera nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes. Nga subjektet që nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjeve, 5 janë dërguar për bllokim sipas shkresave të cituara në rubrikën ñ*Masat e marra për arkëtimin e detyrimeve*ò, me 2 të tjera janë nënshkruar aktmarrëveshje në vitin 2020 duke mbartur edhe detyrimet e mbetura nga akt marrëveshja e vitit 2019, ndërsa për 2 subjektet e tjera (Marsi 04 dhe G. C.) nuk rezulton që nga ana e DTTV të jenë marrë masa për vjeljen e detyrimeve në zbatim të dispozitave ligjore për debitorët[69].

Për vitin 2020, nga 17 akt marrëveshje që DTTV ka lidhur për likuidimin e detyrimeve me këste, 3 subjekte i kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë, 7 subjekte kanë paguar rregullisht detyrimet në zbatim të kushteve të akt marrëveshjes, ndërsa 7 subjekte nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes. Nga analizimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se kemi mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Në asnjë rast nuk kemi kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste;
- Dy marrëveshje (me subjektet Hi. El. dhe Po. El.) janë të pa firmosura nga ana e tatimpaguesit;
- Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste;
- Në lidhjen e 3 akt marrëveshjeve nuk janë respektuar kërkesat ligjore për kohëzgjatjen e tyre (akt marrëveshja nr. 275 Prot, datë 18.09.2019, lidhur 3 muaj më shumë se afati i lejuar, akt marrëveshja nr. 176 Prot, datë 07.08.2020, lidhur për 14 muaj më shumë se afati i lejuar dhe akt marrëveshja nr. 278 Prot, datë 11.12.2020, lidhur për 5 muaj më shumë se afati i lejuar);
- Në pjesën më të madhe të akt marrëveshjeve të nënshkruara (në 21akt marrëveshje nga 30) detyrimet e periudhës/vitit janë bërë pjesë e aktmarrëveshjes.

Nga ana e DTTV për subjektet që nuk kanë respektuar kushtet e akt marrëveshjes nuk është bërë zgjidhja e saj sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 78[70] por subjektet janë dërguar për bllokim për detyrimet e vitit 2019.

Kriteret: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 2,3,4,5

Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.4

Akt marrëveshjet përkatëse të nënshkruara me subjektet debitorë.

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtim i detyrimeve ï mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Shkaku: Mos zbatim i detyrimeve të akt marrëveshjeve nga subjektet debitorë dhe mbikëqyrje jo efektive nga ana e DTTV.

---

[69] Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 89,90,91,93.

[70] Neni 78-Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste, Marrëveshja e pagesës me këste zgjidhet nga administrata tatimore kur:

a) tatimpaguesi nuk i bën pagesat në përputhje me marrëveshjen;

b) tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja.

Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të zbatojë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 2,3,4,5 si dhe ti referohet Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.4 gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë si dhe të monitorojë me shumë përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve.
Punonjësit që ngarkohen më përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë:
Z. V. M. - Drejtor i DTTV,N/C;
Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P;
Znj. A. P. - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit,N/C;
Z. V. Ll. - Specialist për borxhin, K/P;

5. *Agjentët tatimorë*

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 11</u>:** *Vjelja e taksave dhe tarifave vendore nga Agjentët Tatimorë.*

Situata: Agjentët tatimore me të cilët bashkëpunon Bashkia Pogradec për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore janë UK Pogradec, ASHK, DRT, DTK, DPT dhe DPD, të cilët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr.6/15: Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Pogradec për vitin 2019-2020 (000 lekë)

Nr.	Agjenti tatimor	Lloji i taksës	Viti 2019	Viti 2020
1	UK Pogradec	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	51,324	55,924
		Taksa mbi tokën bujqësore	2,245	3,048
		Taksa e truallit	3,498	3,255
		Taksë tabele	1,565	1,936
		Taksë hoteli	6,896	1,511
		Taksë reklame	3,491	4,329
		Tarifë ndriçimi rrugor	16,939	17,575
		Tarifë mirëmbajtje varreze	4,908	7,352
		Tarifë pastrimi	74,919	77,761
		Tarifë gjelbërimi	36,125	37,479
2	Drej Rajonale e Tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	2,477	2,355
3	ASHK	Taksa e kalimit të pronësisë	5,767	2,697
4	DPT&DPD	Renta minerare	183	446
5	Drejt e Transportit Korçë	Taksë mbi rregj e automjeteve	16,400	19,315
6	DPT Korçë	Taksa mbi të Ardhurat personale		12,789
Totali			**226,737**	**247,772**

Burimi: Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i planifikimit të të ardhurave që vilen nga agjentët tatimorë u konstatua se realizimi varion në nivele të ndryshme për taksa dhe tarifa që vilen nga agjentë të ndryshëm. Rezulton se UK është agjenti tatimor më i rëndësishëm i Bashkisë Pogradec i cili vjel për llogari të bashkisë 10 taksa dhe tarifa vendore (tabela nr. 4/15).
Nga auditimi i dokumentacionit mbi xhirimet që UK Pogradec ka bërë për bashkinë rezulton se në janar të vitit 2019 (detyrimi i vitit 2018) shuma që UK nuk ka kaluar në llogari të bashkisë është 31,303,063 lekë, në janar të vitit 2020 shuma e pa kaluar është 23,303,266 lekë, në dhjetor të vitit 2020 shuma e pa kaluar është 13,624,890 lekë. DTTV nga ana e saj është përpjekur që të rrisë

bashkëpunimin me Ujësjellësin me qëllim derdhjen e shumës së arkëtuar në llogari të bashkisë. Me shkresat nr. 15/1 Prot, datë 15.02.2019 dhe nr. 46/2 Prot, datë 14.02.2020, DTTV i drejtohet UK Pogradec ku i kërkon kalimin e arkëtimeve të taksave dhe tarifave vendore. Nga akt akordimet vërehet se nga shkurti i vitit 2019 dhe në vazhdim paraqitet përmirësim në kalimin e taksave dhe tarifave të mbledhura për llogari të bashkisë. Në përgjithësi mund të thuhet se përveç problematikës me UK që tashmë është drejt zgjidhjes agjentët e tjerë tatimorë janë korrekt në kalimin e arkëtimeve Bashkisë Pogradec diferencat që mund të ketë nga planifikimi në realizim vijnë si rezultat i planifikimeve jo plotësisht të sakta që bën DTTV pasi planifikimet varen nga faktorë të tjerë si për shembull taksa e kalimit të pronësisë që varet nga shitjet e pronave, etj.
Kriteret: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Mos zbatim i detyrimeve që ka UK Pogradec ndaj bashkisë si Agjent Tatimor.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të rrisë bashkëpunimin me Agjentin Tatimor UK Pogradec për arkëtimin e të ardhura të mbledhura për llogari të bashkisë duke bërë të mundur arkëtimin e vlerës 13,624,890 lekë, dhe në rast të lindjes së problemeve të zbatojë procedurat ligjore për penalizmin e Agjentit Tatimorë sipas ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 117.

Personat që ngarkohen me përgjegjësi për problematikën e cituar më sipër (për kalimin e plotë të arkëtimeve për taksat dhe tarifat vendore nga UK Pogradec në llogari të bashkisë) janë:
Z. J. S. - Administrator i UK Pogradec nga data 23.08.2019 e në vijim[71],
Z. V. M. - Drejtor i DTT;
Z. M. I. - Administrator i UK Pogradec për periudhën 01.01.2019-23.08.2019[72].

6. Administrimi i taksave dhe Tarifave Vendore

► **Titulli i gjetjes nr. 12:** *Menaxhimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec paraqet disa probleme në mënyrën e mbajtjes, përpunimit dhe saktësisë së të dhënave.*

Situata: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Pogradec kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Pogradec i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.
Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Për shembull, sikurse është trajtuar e detajuar në vijim në rastin e subjekteve që tregtojnë karburante grupi i auditimit ka konstatuar që nga përfundimi i afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit deri në pajisjen me autorizimet e reja ka një diferencë disa mujore në disa raste dhe vjetore. Kjo periudhë kohore ka sjellë efekte negative financiare në të ardhurat e Bashkisë Pogradec dhe pa dyshim që menaxhimi i taksave dhe tarifave nëpërmjet një sistemi të mirëfilltë do të zvogëlonte apo eliminonte pasaktësi të tilla. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë

[71] Vendin nr. 55, datë 23.08.2019, nr. 296 Prot.
[72] Vendim nr. 2, datë 15.02.2016, nr. 2 Prot, Vendim nr. 54, datë 23.08.2019, nr. 295 Prot.

edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; Neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7[73].

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Pogradec:

Tabela nr.6/16: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Pogradec, 2019-2020

Lloji i biznesit	Numri në fillim të vitit		Regjistrime të reja		Mbyllur aktivitetin gjatë vitit		Numri në fund të vitit	
	2019	**2020**	**2019**	**2020**	**2019**	**2020**	**2019**	**2020**
Biznes i vogël	1410	1515	266	269	161	155	1515	1629
Biznes i madh	365	364	2	4	3	5	364	363
Totali	**1775**	**1879**	**268**	**273**	**164**	**200**	**1879**	**1992**

Burimi: Bashkia Pogradec

Gjatë vitit 2019-2020 nga inspektimet në terren të inspektorëve të DTTV rezulton se, për vitin 2019 janë konstatuar **44** biznese dhe për vitin 2020, **56** biznese që ushtronin aktivitetin pa qenë të regjistruar në QKB, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 40, pika 1[74].

DTTV, pas konstatimit të këtyre bizneseve i ka dërguar listat emërore të tyre Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë përkatësisht me shkresat nr. 7374 Prot, datë 23.10.2019, nr. 7374/1 Prot, datë 04.11.2019, nr. 3008 Prot, datë 26.06.2020 dhe nr. 3008/1 Prot, datë 20.08.2020. Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga DTV rezulton se për vitin 2019, 10 subjekte nga 44 të identifikuar janë ende debitorë ndaj bashkisë në shumën totale prej **126,353** lekë dhe në vitin 2020 rezultojnë debitorë 30 subjekte nga 56, në shumën totale prej **347,970** lekë, (për më shumë informacion shiko Aneksin 4/6). Në total për të dy vitet 2019-2020 kemi shumën e detyrimit **474,323 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

Gjithashtu, për një menaxhim sa më eficient të taksave dhe tarifave vendore, DTTV i ka dërguar shkresë Njësisë së Prokurimit të Bashkisë Pogradec për të njoftuar këtë të fundit mbi kontratat që lidhen pas përfundimit të procedurës së prokurimit sepse gjatë inspektimeve në terren ka konstatuar subjekte të cilat kanë lidhur kontrata për shërbime me bashkinë dhe nuk kanë regjistruar adresë sekondare në QKB[75]. Rezulton që shkresa nuk është e shoqëruar me një listë specifike se cilat janë këto subjekte që DTTV ka konstatuar dhe që nuk janë të regjistruar me adresë dytësore edhe pse ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Pogradec. Nga ana e Njësisë së Prokurimit në Bashkinë nuk rezulton që shkresa e sipërcituar të ketë përgjigje por komunikimi me DTTV është kryer në rrugë elektronike. Përkatësisht, për vitin 2020 rezulton që Njësia e Prokurimit tõ ketë dërguar DTTV më datë 23.11.2020 listën e subjekteve që kanë lidhur kontrata deri në ato momente. Nuk kemi komunikim të dokumentuar rast pas rasti. Në kuadër të analizimit të mëtejshëm të kësaj problematike rezulton se, DTTV ka konstatuar gjithsej 6 subjekte (N. Shpk, Sh. Shpk, E. 2008, N.O.A. Shpk, M. Shpk, B-X Shpk) që ofrojnë shërbime në Bashkinë Pogradec

[73] ñPranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuarò.

[74] Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, neni 40, pika 1, ñPersonat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

[75] Shkresa nr. 7918 Prot. datë 12.11.2019.

dhe nuk kanë regjistruar vendndodhjen në këtë bashki, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, neni 12, pika 6[76].
Në mënyrë më të detajuar kemi:

- Subjekti ñ*N.” Shpk* ka fituar tre kontrata shërbimi në territorin e Bashkisë Pogradec me UK Pogradec për ofrimin e shërbimit të sigurisë[77]. DTTV e ka ngarkuar me detyrime për të paguar taksat dhe tarifat vendore që në vitin 2018 bazuar në kontratat përkatëse të shërbimit. Për vitet 2018-2020 subjekti ka detyrime ndaj bashkisë në shumën 299,500 lekë, plus kamatëvonesa në shumën 40,951 lekë, **në total shuma e detyrimit është 340,451 lekë.** Subjekti ñN.ò Shpk nuk rezulton të jetë regjistruar për të paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore edhe pse ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Pogradec që nga dhjetori i vitit 2017.
- Subjektet e tjera ñ*Sh.” Shpk, “E- 2008” Shpk, “N.O.A.” Shpk, “M.” Shpk, “B-X” Shpk*, janë ngakuar për pagesën e taksave dhe detyrimeve vendore për periudhat përkatëse që kanë lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në territorin e Bashkisë Pogradec dhe kanë paguar detyrimet përkatëse të llogaritura nga DTTV.

Subjekti ñN.ò Shpk nuk ka paguar detyrimet vendore, shuma totale e detyrimeve për periudhën 2018-2020 përfshirë edhe kamatëvonesat është 340,451 lekë, **por për periudhën objekt auditimi 2019-2020 detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë 221,598 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.** DTTV ende nuk ka ndërmarrë hapat e duhur ligjor në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, nenet 89,90,91,93 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, Kreu XI ñMbledhja me forcë e detyrimit tatimorò me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara nga ana e subjektit debitor, pasi subjekti ka paraqitur pranë DTTV ankimin administrativ.
Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; Neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7, neni 12, pika 6.
Ndikimi/Efekti: Mos administrimi i taksave dhe tarifave vendore nëpërmjet një sistemi të mirëfilltë çon në gabime me efekt financiar në buxhetin e Bashkisë Pogradec sikurse mund të jetë llogaritja e saktë e taksave dhe tarifave, llogaritja e kamatë vonesave apo mos identifikimi në kohë i afateve për likuidimin e detyrimeve ndaj bashkisë. Administrimi i taksave dhe tarifave vetëm në programin Excel duke mos pasur një sistem dhe duke mos i regjistruar të dhënat në regjistra fizik është tepër i riskuar ndaj defekteve të pajisjeve elektronike.
Shkaku: Bashkia Pogradec nuk ka marrë masa për të ndërtuar një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vijojë ndjekjen e procedurave ligjore kundrejt subjektit ñN.ò Shpk deri në përfundim të ankimimit dhe të marrë masat e duhura shtrënguese për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit që subjekti ka ndaj bashkisë në vlerën totale 340,451 lekë.

Për mos marrjen e masave ngarkohen me përgjegjësi:
Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;
Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, K/P.

7. *Përdorimi i të ardhurave*

[76] ñTaksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhjeò.
[77] Kontrata nr. 753 Prot ,datë 05.12.2017, Kontrata nr. 230/26 Prot, datë 22.11.2018 dhe Kontrata nr. 495 Prot, datë 06.12.2019.

Të ardhurat totale të Bashkisë Pogradec përbëhen nga të ardhurat vjetore nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat nga grantet. Të ardhurat janë paraqitur në mënyrë tabelore në vijim.

Tabela nr.6/17: Të ardhurat totale të Bashkisë Pogradec vitet 2019-2020 (000 lekë)

Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020
Të ardhurat	298, 532	307,180
Të ardhura të trashëguara	59,798	65,399
Të ardhura nga grantet	529,701	547,080
Të ardhura nga garancitë	17,875	13,820
Total	**607,374**	**933,479**

Burimi: Bashkia Pogradec

Referuar vendimeve të KB të ardhurat e cituara në tabelën nr. 4/16 janë shpenzuar si vijon:

Tabela nr. 6/18: Shpenzimi i të ardhurave në Bashkinë Pogradec vitet 2019-2020

000 lekë

Nr.	Të ardhurat	Shuma	Shpenzimet	Shuma	%
			Viti 2019		
1	Të ardhurat e trashëguara	59,798	Paga	50,854	14.5
2	Të ardhurat e vitit	298,532	Sigurime Shoq. Shënd.	12,101	3.4
	Shuma	**350,758**	Shpenzime operative	41,868	11.9
			Transf. korrente te brendshme	7,837	2.2
			Transf. të buxhetit familjar	2,159	0.6
			Investime	59,547	17
			Shuma	**174,366**	**50 %**
			Viti 2020		
1	Të ardhurat e trashëguara	65,399	Paga	84,460	22.7
2	Të ardhurat e vitit	307,180	Sigurime Shoq. Shënd.	735	0.2
	Shuma	**372,579**	Shpenzime operative	36,861	9.9
			Transf. korrente te brendshme	22,377	6
			Transf. të buxhetit familjar	3,810	1
			Investime	30,602	8.2
			Shuma	**178,845**	**48%**

Burimi: Bashkia Pogradec

8. *Subjektet që tregtojnë karburante*

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 13</u>:** *Ushtrimi i aktivitetit në shkelje të dispozitave ligjore nga subjektet që tregtojnë lëndëve djegëse.*

Situata: Në Bashkinë Pogradec për periudhën objekt auditimi ushtrojnë aktivitetin e shitjes së lëndëve djegëse 16 subjekte. Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa të dokumenteve në dosje si:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Pogradec për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Dokumentet që mungonin në dosje dhe që strukturat e bashkisë i dispononinin u paraqitën pas kërkesës së grupit të auditimit. Më e detajuar problematika e dosjeve dhe dokumentacionit të subjekteve që tregtojnë karburante rezulton:

1. ***Subjekti "S-G" shpk*** ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Pogradec për një periudhë 5 vjeçare me autorizimin 16.04.2015-16.04.2020. Pajisja me autorizimin e radhës për vijueshmërinë e ushtrimit të aktivitetit është bërë më datë 26.11.2020. Rezulton që për periudhën 16.04.2020-26.11.2020 ky subjekt ka ushtruar aktivitet i pa pajisur me autorizim, pra për 7 muaj. Shuma që është detyrim për tâı paguar për 5 vjet ushtrim aktiviteti është 1,000,000 lekë, e llogaritur

për muaj është 16,666 lekë/muaj. **Për 7 muaj x 16,666 = 116,662 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec**[78].

2. ***Subjekti "G. C."*** ka tre pika të tregtimit të karburanteve në territorin e Bashkisë Pogradec (Rruga Sul Starovari, Rruga e Korçës-rruga nacionale Pogradec-Korçë, Udënisht-Aksi Qafthanë-Pogradec). Nga auditimi i dosjes për të tri pikat rezulton se:

a. ñG. C.ò -Udënisht ka ushtruar aktivitet për periudhën 5 vjeçare 19.11.2013-19.11.2018. Është pajisur me autorizim për vijimësinë e aktivitetit më datë 19.11.2020. Rezulton që për 2 vite, periudha nga 19.11.2018-19.11.2020 ka ushtruar aktivitet i pa pajisur me autorizim, **2 vite x 200,000 = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec;**

b. ñG. C.ò -Pogradec ka ushtruar aktivitet për periudhën 5 vjeçare 07.09.2015-07.09.2020. Është pajisur me autorizim për vijimësinë e aktivitetit më datë 19.11.2020. Rezulton që për 2 muaj, periudha nga 07.09.2020-19.11.2020 ka ushtruar aktivitet i pa pajisur me autorizim, **2 muaj x 16,666 = 33,332 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec;**

c. ñG. C.ò - Rruga e Korçës është hapur më datë 01.07.2019[79] është pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit më datë 19.11.2020. Për periudhën 16 mujore, 01.07.2019-19.11.2020 ka ushtruar aktivitet e pa pajisur me autorizim, **16 muaj x 16,666 = 266,656 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

3. ***Subjekti "E." Shpk*** ka ushtruar aktivitet i pajisur me autorizim 5 vjeçar për periudhën 15.05.2014-15.05.2019, është pajisur përsëri me autorizim 1 vjeçar[80] për vijimësinë e aktivitetit më datë 19.11.2020 por pagesën e autorizimit e ka bërë më datë 11.09.2020 (dy muaj para datës së autorizimit). Periudha nga 15.05.2019-11.09.2020 rezulton e pa pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit. Për periudhën prej 15 muajsh që subjekti ka ushtruar aktivitetin pa autorizim kemi **15 muaj x 16,666 = 249,990 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

4. ***Subjekti "AZ D."*** ka ushtruar aktivitet me autorizim 5 vjeçar për periudhën 05.05.2015-05.05.2020, është pajisur me autorizim 1 vjeçar për vijimësinë e aktivitetit më datë 26.11.2020. Rezulton që periudha e pa mbuluar me autorizim për ushtrimin e aktivitetit është 6 muaj me efekt financiar, **6 muaj x 16,666 = 99,996 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec**.

5. ***Subjekti "H."*** në dosje nuk ka asnjë autorizim për të verifikuar kur i ka përfunduar afati. Rezulton se më datë 31.08.2020 është njoftuar nga DTTV për pajisje me autorizim. Në mungesë të autorizimit të I-rë dhe mos pajisjes ende me autorizim ajo që mund të llogaritet është se nga muaji shtator 2020 ushtron aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Efekti financiar që grupi i auditimit mund të llogarisë për vitin 2020 është, **4 muaj x 16,666 lekë në muaj = 66,664 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

6. ***Subjekti "G." Shpk*** ka dy pika të tregtimit të karburantit brenda territorit të Bashkisë Pogradec:

   a. ñGò Shpk Qafë-Plloçë, ka ushtruar aktivitet për 5 vite përkatësisht për periudhën 10.03.2015-10.03.2020, është pajisur me autorizim 5 vjeçar më 25.06.2020. Periudha 3 mujore nga 10.03.2020-25.06.2020 rezulton ushtrim aktiviteti pa autorizim me efekt

[78] Theksojmë që pagesa duhet të bëhet e gjitha në fillim të periudhës së pajisjes me autorizim për ushtrimin e aktivitetit dhe jo vjetore apo mujore, por llogaritja e një pagese mesatare mujore është bërë vetëm për efekt të llogaritjes së efektit financiar të mos pajisjes me autorizim për ushtrimin e aktivitetit.

[79] Ekstrakti i QKB-së, numri i çështjes CN-245379-06-19.

[80] Vendimi i KB nr. 123, datë 23.10.2020 ñPër lehtësimin në pagesën e autorizimit të karburanteve, në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò

financiar, **3 muaj x 16,666 = 49,998 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

b. ñG.ò Shpk Buçimas, ka ushtruar aktivitet për 5 vite përkatësisht për periudhën 05.05.2015-05.05.2020. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e këtij subjekti për pikën në Buçimas rezulton që vazhdon ushtrimin e aktivitetit që nga data 05.05.2020 e pa pajisur me autorizim. Për periudhën 7 mujore që ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2020 efekti financiar është, **7 muaj x 16,666 = 116,662 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2020.**

7. ***Subjekti "B." Shpk***, ka dy pika të tregtimit të karburantit brenda territorit të Bashkisë Pogradec, Udënisht dhe Grabovicë:

a. Bregu Shpk Grabovicë, ka ushtruar aktivitet për 5 vite i pajisur me autorizim 22.01.2015-22.01.2020, është pajisur me autorizim 1 vjeçar për vijimësinë e aktivitetit më datë 11.12.2020. Periudha 11 mujore nga 22.01.2020-11.12.2020 është periudhë që ka ushtruar aktivitet e pa pajisur me autorizim me efekt financiar, **11 muaj x 16,666 = 183,326 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

b. ñB.ò Shpk Udënisht, është pajisur me autorizim 5 vjeçar për periudhën 26.04.2015-26.04.2020 është pajisur me autorizim 5 vjeçar për vijimësinë e aktivitetit më datë 04.08.2020. Periudha 3 mujore nga 26.04.2020 -04.08.2020 rezulton ushtrim aktiviteti pa autorizim me efekt financiar**, 3 muaj x 16,666 = 49,998 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

8. ***Subjekti "A. P." Shpk*** ka ushtruar aktivitet me autorizim 5 vjeçar për periudhën 21.01.2014-21.01.2019, është pajisur me autorizim 5 vjeçar për vijimësinë e aktivitetit më datë 21.09.2020. Rezulton që periudha e pa mbuluar me autorizim për ushtrimin e aktivitetit është 20 muaj, 21.01.2019-21.09.2020 me efekt financiar, **20 muaj x 16,666 = 333,320 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

9. ***Subjekti "A. O."*** ka pezulluar aktivitetin pa afat[81] më datë 21.08.2019. Ka ushtruar aktivitet me autorizim 5 vjeçar për periudhën 24.01.2014-24.01.2019 dhe ka paguar detyrimin për ushtrimin e aktivitetit. Në dosje nuk ka gjurmë shkresore që të tregojnë se DTTV ka konstatuar përfundimin e afatit të autorizimit të këtij subjekti. Për vitin 2019 DTTV i ka dërguar dy shkresa për të kryer pagesën e detyrimeve vendore[82], ndërkohë që subjekti ka bërë pezullimin e përkohshëm të aktivitetit në QKB më datë 21.08.2019. Rezulton që për periudhën 24.01.2019-21.08.2019 ka ushtruar aktivitet i pa pajisur me autorizimin përkatës. Efekti financiar është, **7 muaj x 16,666 = 116,662 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.** Gjithashtu bazuar në njoftimin e DTV nr. 274/4 Prot, datë 16.09.2019 nuk ka paguar detyrimin për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 në shumën 61,191 lekë.

Për të zgjidhur problematikën e sipër cituar DTTV ka dërguar 9 shkresa subjekteve që ju ka mbaruar afati i autorizimit për ushtrimin e aktivitetit.[83]

Sqarojmë se, në vitin 2020 me qëllim lehtësimin e subjekteve si rezultat i pandemisë Covid-16 Këshilli Bashkiak ka vendosur që subjektet që aplikojnë për pajisje me autorizim apo rinovim të

[81] Ekstrakt Historik QKB.

[82] Shkresa e datës 22.02.2019 pa numër protokolli por e firmosur dhe e vulosur nga Nënkryetari i Bashkisë Pogradec, Shkresa nr. 274/4 Prot. datë 16.09.2019.

[83] Shkresa nr. 4075 prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñG. C.ò; Shkresa nr. 4075/1 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñA.P.ò; Shkresa nr. 4075/2 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñG.ò; Shkresa nr. 4075/3 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñA. O.ò; Shkresa nr. 4075/4 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñS.-Gò; Shkresa nr. 4075/5 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñB. SHPKò; Shkresa nr. 4075/6 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñO. SHPKò; Shkresa nr. 4075/7 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñH.ò; Shkresa nr. 4075/8 Prot, datë 31.08.2020 ï subjekti ñE.ò.

autorizimit aktual për tregtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante të gazit të lëngshëm për ngrohje, etj, autorizimi të jepet për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritje sipas kërkesës së subjektit dhe pagesa për pajisjen me autorizim mund të kryhet me këste vjetore në shumën 200,000 lekë.[84]

Pas njoftimeve të dërguara nga DTTV rezulton se:

1. Subjekti ñS-Gò është pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit më datë 26.11.2020;
2. Subjekti ñE.ò është pajisur me autorizim më datë 19.11.2020. Autorizimi i parë i ka mbaruar më datë 15.05.2019 dhe DTV e ka njoftuar për rinovimin e tij më datë 31.08.2020, pas 15 muajsh;
3. Subjekti ñH.ò edhe pse ka marrë njoftim nga DTTV më datë 31.08.2020 **nuk rezulton të jetë pajisur ende me autorizim për ushtrimin e aktivitetit**;
4. Subjekti ñO. SHPKò është pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit më datë 19.11.2020;
5. Subjekti ñA. P.ò është pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit më datë 21.09.2020;
6. Subjekti ñG.ò **nuk rezulton të jetë pajisur ende me autorizim për adresën në Buçimas edhe pas marrjes së njoftimit nga DTTV;**
7. Subjekti ñB.ò Shpk është pajisur me autorizim për adresën në Grabovicë më datë 11.12.2020 dhe për adresën në Udënisht më datë 04.08.2020;
8. Subjekti ñG. C.ò është pajisur me autorizim për të tre adresat më datë 19.11.2020.

E gjithë problematika e konstatuar nga auditimi i dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve është paraqitur e përmbledhur edhe në formë tabelore në Aneksin 4/7.

Sikurse është trajtuar më sipër rezulton se problematika kryesore e konstatuar në auditimin e dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e hidrokarbureve të jetë në pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit sipas kërkesave ligjore në fuqi, përkatësisht ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4 ñ Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe *autorizimet përkatëse*, sipas përcaktimeve të këtij ligji. *Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*ò. Neni 20-Autorizimet pika 2. ñAutorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11[85], jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeò.

Rezulton se janë 9 subjekte që ushtrojnë aktivitet në 13 adresa që nuk janë pajisur me autorizimin përkatës brenda afateve ligjore të sipër cituara. **Ushtrimi i aktivitetit nga ana e këtyre subjekteve të pa pajisur me autorizim për periudhën 2019-2020 ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën 2,083,266 lekë.**

Gjithashtu, 2 subjekte (ñH.ò dhe ñG.ò për adresën në Buçimas) janë ende të pa pajisura me autorizimin për ushtrimin e aktivitetit edhe pse janë njoftuar nga DTTV që më datë 31.08.2020.

[84] Vendimi i KB nr. 123, datë 23.10.2020 ñPër lehtësimin në pagesën e autorizimit të karburanteve, në kuadër të situatës të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19ò.

[85] Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorëò.

Për këto dy subjekte nuk rezulton që nga DTTV të jenë marrë masa konform legjislacionit përkatës.
Kriteret: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.
VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9.
Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec në vlerën 2,083,266 lekë.
Shkaku: Puna jo efektive e drejtuesit dhe specialistëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim edhe pse janë njoftuar nga DTTV.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet ñHobeliò dhe ññGòò për adresën në Buçimas, të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9. Periudha e fillimit të autorizimit duhet të përkojë me afatin kur ka përfunduar autorizimi i fundit me qëllim që të bëhet e mundur edhe arkëtimi i vlerës prej **2,083,266 lekë** që përfaqëson detyrimin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit pa autorizimò.

Personat që ngarkohen me përgjegjësi për problematikën e trajtuar më sipër lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve pa autorizimin përkatës janë:
Z. V. M. - Drejtor i DTTV, N/C;
Z. E. M. - Shef i Njësisë për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave,K/P;
Znj. A. P. - Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit, N/C.

1. *Administrimi i aseteve të dhëna me qira*

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 14:</u>** *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve*

Situata: Bashkia Pogradec në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi[86] për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 44 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 5 vjet deri në 99 vjet. Kontratat janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për ndërtimin e HEC-ve, për aktivitet bujqësor apo për mbjellje arrorësh, etj. Grupi i auditimit me përzgjedhje auditoi 26 kontrata (59 %) ose 21 subjekte qiramarrëse dhe në mënyrë më të detajuar kemi si më poshtë vijon:

1. ***Hi. El.*** ï Kontrata nr. 90 Prot, datë 04.08.2010 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik ñHi. El.ò shpk, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqe ï 1.24 ha me afat 35 vjeçar dhe me vlerë vjetore 120,800 lekë.

[86] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 , ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

Kontrata nr. 3965 Prot, datë 08.11.2017 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik ñHi. El.ò, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqe ï 11.618 ha dhe 0.24 km me afat 8 vjeçar dhe me vlerë 248,650 lekë në vit. Procesverbali datë 21.02.2019 për rivlerësim tekniko-financiar e vlerëson shumën e detyrimit 617, 420 lekë në vit. Marrëveshje për ndryshim kontrate nr. 345 Rep, nr. 281/2 Kol, datë 28.05.2019 konsiston në ndryshimin e vlerës së detyrimit vjetor të kontratës pas rivlerësimit dhe kohëzgjatjes së saj. Vlera bëhet 617, 420 lekë në vit dhe afati 10 vjeçar. Nga auditimi rezulton se subjekti Hidropower Elektrik ka paguar detyrimet e kontratës së qerasë për vitin 2019 **ndërsa për vitin 2020 rezulton debitor në shumën 117, 420 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

2. ***Po. El.*** ï Kontrata nr. 56 Prot, datë 13.05.2009 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik ñPo. El.ò, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqe ï 0.59 ha me afat 35 vjeçar, me vlerë 73,400 lekë në vit. Kontrata nr. 1157 Rep, nr. 559 Kol, datë 26.05.2015 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik Power Elektrik, për kalimin e infrastrukturës së ndërtimit të HEC-it, me sipërfaqe ï 27.497 ha me afat 30 vjeçar me vlerë 682,000 lekë në vit. Procesverbali datë 21.02.2019 për rivlerësim tekniko-financiar e vlerëson shumën e detyrimit 1,157,415 lekë në vit. Si rezultat i procesverbalit ka ndryshuar edhe kontrata e vitit 2015 duke e rritur vlerën e saj në 1,157,415 lekë në vit. Nga auditimi rezulton se subjekti Power Elektrik ka paguar detyrimet e kontratave të qerasë për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, është debitor në shumën 895,752 lekë (plus kamatë vonesat në shumën 1% për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë por jo më shumë 10 % të vlerës së kontratës 89,575 lekë) **në total 985,327 lekë ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec**.
3. ***Mi.*** ï Kontrata e lidhur më datë 03.01.2013 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik ñMi.ò për një periudhë 25 vjeçare, me sipërfaqe 1ha dhe vlerë vjetore të qerasë 78,000 lekë. Nga auditimi rezulton se, qiramarrësi për vitin 2019 ka paguar vetëm 30,000 lekë dhe është debitor në shumën 48,000 lekë ndërsa për vitin 2020 është debitor në shumën 78,000 lekë. Në total për të dy vitet rezulton debitor në shumën 126,000 lekë plus kamatëvonesat në shumën 12,600 lekë (0.01% por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës) **në total 138,600 lekë që përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**
4. ***"J-06" Shpk*** ï Kontrata nr. 9093 Prot, datë 14.12.2018, për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në administrim të bashkisë, personit juridik ñJ-06ò Shpk për kalimin në sipërfaqen e marrë në përdorim, me gjatësi 0.95 km me afat 5 vjeçar, me vlerë vjetore të qerasë 644,800 lekë në vit. Nga auditimi rezulton se për vitin 2019 qiramarrësi ka paguar detyrimet e kontratës së qerasë ndërsa për vitin 2020 ka paguar shumën 360,000 lekë dhe **është debitor në shumën 284,800 lekë që përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**
5. ***"Pl. Ne." Shpk*** ï Kontrata nr. 5393 Prot, datë 24.07.2018 për dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme në pronësi të bashkisë personit juridik ñPl. Ne.ò shpk për instalim të kullës së antenave dhe aksesorët e tyre. Sipërfaqja e dhënë me qira është 0.018 ha, me afat 9 vjeçar dhe me vlerë vjetore 144,100 lekë. Qiraja duhet të paguhet çdo tre mujor paradhënie. Nga auditimi rezulton se për vitin 2019 ka paguar 4 këstet e pagesave ndërsa **për vitin 2020 ka paguar vetëm 3 këse duke rezultuar debitor në shumën 36,025 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec**. Kontrata nuk parashikon detyrime për vonesat në pagesa.
6. ***"Pr." Shpk*** ï Kontrata nr. 988 Rep, nr. 741 Kol, datë 27.05.2019 për dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme në pronësi të bashkisë personit juridik ñPr.ò Shpk për instalim të kullës së antenave dhe aksesorët e tyre. Sipërfaqja e dhënë me qira është 0.00105 ha, me afat

9 vjeçar dhe me vlerë vjetore 17,220 lekë. Qiraja duhet të paguhet çdo tre mujor paradhënie. Nga auditimi rezulton se qiramarrësi **nuk ka paguar detyrimet e qirasë për vitet 2019-2020 në vlerën 34,440 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.** Kontrata nuk parashikon detyrime për vonesat në pagesa.

7. ***Pl. Alb*** ï Kontrata e lidhur më datë 08.10.2013 për dhënie me qira të fondit pyjor kullosor në administrim nga bashkia për një periudhë 10 vjeçare. Detyrimi vjetor i qirasë është 219,780 lekë. Nga auditimi rezulton se ka paguar detyrimin për vitin 2019 dhe është debitor për vitin 2020 në vlerën 219,780 lekë, plus kamatë vonesat në vlerën (0.01%x219,780x83=1824 lekë) **vlera totale 221,604 lekë që përbën të ardhur të munguar në arkën e Bashkisë Pogradec.**
8. ***Me. He. & Sp.*** ï Kontrata nr. 235 Rep, nr. 134 Kol, datë 26.01.2017, amenduar me kontratën nr. 1565 Rep, nr. 1191 Kol, datë 07.08.2019 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të bashkisë. Sipërfaqja e dhënë me qira është 329.6 ha dhe vlera e detyrimit vjetor duke filluar nga data 26.01.2019 është 2,142,400 lekë. Nga auditimi rezulton se qiramarrësi Mediterranean Herbs &Spices nuk ka paguar detyrimin e qerasë për vitet 2019-2020. Shuma totale e detyrimit për të dy vitet është 4,284,800 lekë (plus kamatë vonesat në shumën 1% për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës 428,480 lekë), **në total shuma e detyrimeve është 4,713,280 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec**.
9. ***Bl-alb-Shpk*** ï Kontrata nr. 22 Rep, datë 30.03.2004 për dhënie me qira sipërfaqe prej 150 m^2 për montim furre, me detyrim vjetor në shumën 270,000 lekë. Nga auditimi rezulton se për vitin 2019 qiramarrësi ka paguar detyrimet e kontratës së qerasë ndërsa **për vitin 2020 është debitor në shumën 67,500 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.**
10. Nga auditimi rezulton se subjektet e listuar më poshtë kanë paguar detyrimet e kontratave të qirave konform kontratës:

a. Te. Al. Sh.a ka lidhur 5 kontrata (Kontrata nr. 1907 Rep, nr. 659 Kol, datë 24.04.2018, Kontrata nr. 1908 Rep, nr. 660/1 Kol, datë 24.04.2018, Kontrata nr. 4393 prot, datë 28.12.2016, Kontrata nr. 1386 Rep, nr. 498/1 Kol, datë 18.03.2019, Kontrata e lidhur më datë 01.02.2019);
b. Vo. Al. Sh.a ï Kontrata nr. 578 Rep, nr. 198 Kol, datë 10.05.2002;
c. Al. Sh.a ï ka lidhur 2 kontrata (Kontrata nr. 671 Rep, nr. 515 Kol, datë 10.04.2019, Kontrata nr. 672 Rep, nr. 516 Kol, datë 10.04.2019);
d. F. P. ï Kontrata e lidhur më datë 25.02.2010;
e. G. S. ï Kontrata nr. 271 Rep, nr. 202 Kol, datë 11.12.2019;
f. V. A. ï Kontrata nr. 469 Rep, nr. 387 Kol, datë 05.08.2019;
g. A. M. ï Kontrata nr. 669 Rep, nr. 513 Kol, datë 10.04.2019;
h. MP-H. Shpk ï Kontata nr. 4051 prot, datë 15.11.2017;
i. L. En. ï Kontrata nr. 2152 Rep, nr. 1937 Kol datë 15.06.2015;
j. Hi. In. ï Kontrata nr. 1273 prot, datë 08.02.2019;
k. Hec B. ï Kontrata nr. 966 Rep, nr. 456/2 Kol, datë 29.04.2015;
l. Hec Ll. ï Kontrata nr. 2295 Prot, datë 20.06.2017, rivlerësuar me vendimin nr. 39, datë 12.04.2018. Kontrata nr. 1749 Rep, nr. 415/1 Kol, datë 07.07.2017.

Në strukturën e saj Bashkia Pogradec që në shkurt të vitin 2020 ka krijuar Sektorin e Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve si pjesë e Drejtorisë së Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve. Ky sektor ka në përbërje 9 punonjës për inventarizimin e aseteve dhe monitorimin e kontratave. Puna e sektorit konsiston në evidentimin e kontratave të lidhura dhe saktësimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata si dhe a zbatohen nga subjektet kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Nga proces-verbalet që iu paraqitën grupit të auditimit rezulton se Sektori i Monitorimit të Kontratave për vitin 2020 ka mbajtur 11 proces-verbale lidhur

me monitorimet që ka bërë. Këto monitorime kanë qenë mbi tokën bujqësore të dhënë me qira nga Bashkia Pogradec për mbjelljen e saj me kultura të ndryshme sipas planeve përkatëse të biznesit. Nga monitorimet nuk kanë rezultuar ndryshime në sipërfaqen e dhënë me qira por mund të thuhet se ka disa probleme në zbatimin e kushteve të kontratave lidhur me mos mbjelljen e sipërfaqes së dhënë me qira si dhe me pagesën në kohë të detyrimeve të qerasë vjetore.
Lidhur sa trajtuar më sipër, për vitet 2019-2020 nga 26 kontrata qiraje të audituara rezultojnë debitorë ndaj bashkisë **9** qiramarrës në shumën totale të qirave, **6,598,996 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
Kriteret: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.
Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.
VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar.
VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.
Kontratat përkatëse të secilit qiramarrës.
Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i detyrimeve të qirave të aseteve të bashkisë të dhëna me qira.
Shkaku: Strukturat e Bashkisë Pogradec nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Sektori i Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të angazhohen që subjektet qiramarrëse të zbatojnë me përpikmëri kushteve e kontratave të qirasë me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **6,598,996 lekë.**

Observacione mbi projekt raportin e auditimit në Bashkinë Pogradec
Për sa trajtuar më sipër është paraqitur observacion nga subjekti i audituar me shkresën nr. 355/54 Prot. datë 15.06.2021 ñShpjegime dhe komente për Projekt Raportin e Auditimit nr. 102/20 Prot, datë 14.05.2021ò nga Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Statistikës në Bashkinë Pogradec.
Sqarimet e subjektit
- Referuar *Raportit Përfundimtar* të auditimit Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Statistikës është identifikuar si përgjegjës për mos arkëtimin e vlerës 6,598,996 lekë nga kontratat që janë lidhur për dhënie me qira të aseteve të bashkisë. Subjekti ñMe. He. & Sp.ò me vlerë detyrimi vjetor 2,142,400 lekë plus kamatë vonesa, vlera totale e detyrimit për periudhën objekt auditimi 2019-2020 është 4,713,280 lekë, përbën pjesën më të madhe të detyrimit....nga verifikimi ky subjekt nuk ka paguar detyrimin e qirasë për vitet 2019-2020 sepse Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural më datë 11.06.2019 ka hapur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ndaj Bashkisë Pogradec duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së qirasë. Ky proces gjyqësor vazhdon në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë.
- Baza e të dhënave për administrimin e pagesave të qirave bëhet nga Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, e cila bën hedhjen dhe evindentimin e pagesave të qirave.
Qëndrimet e Audituesve të KLSH-së:
- Gjatë kryerjes së auditimit grupi i auditimit të KLSH-së është shprehur vetëm për mos zbatimin e kushteve të kontratës së qirasë nr. 235 Rep, nr. 134 Kol, datë 26.01.2017, amenduar me kontratën nr. 1565 Rep, nr. 1191 Kol, datë 07.08.2019, përkatësisht pagesën e detyrimit vjetor për marrjen me qira të sipërfaqes sipas përcaktimeve të kontratës. Fakti që Bashkia Pogradec është në proces gjyqësor me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me të drejtat e pronësisë së

sipërfaqes së dhënë me qira nuk përbën arsye që qiramarrësi të mos zbatojë kushtet e kontratës për pagesën e qirasë vjetore në vlerën 2,142,400 lekë.
- Theksojmë edhe një herë faktin se përgjegjësinë për monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratave e ka Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Statistikës dhe nga muaji shkurt 2020 Sektori i Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve, dhe pagesa e qirasë për sipërfaqen e dhënë me qira nga bashkia është një nga kushtet e kontratës.
Në përfundim grupi i auditimit të KLSH-së konkludon se pretendimet e paraqitura nga specialistët e Sektorit të Administrimit të Aseteve dhe Statistikës në Bashkinë Pogradec në observacionin nr. 355/54 Prot, datë 15.06.2021 nuk qëndrojnë.

Për problematikat e cituara më lart ngarkohen me përgjegjësi:
Z. N. T. - Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve, N/C;
Z. A. D. - Specialist për administrimin e aseteve dhe statistikave, N/C;
Znj. F. B. - Specialiste për administrimin e aseteve-Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Aseteve dhe Statistikës, N/C;
Znj. L. T. - Specialiste për administrimin e aseteve N/C.

2. *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave*

Në Bashkinë Pogradec ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave 13 subjekte. Nga auditimi i dosjeve fizike të tyre rezulton se DTTV në përmbushje të detyrimeve ligjore ka bërë njoftimet periodike lidhur me detyrimin që kanë subjektet për taksat dhe tarifat vendore dhe ri njoftimet në rastet kur afatet e pagesave ishin duke përfunduar apo kishin përfunduar. Për subjektet që kanë paguar rregullisht detyrimet për taksat dhe tarifat vendore konfirmimet e pagesave janë vendosur në dosje. Me 5 subjekte (Ch. As., J-2008 Shpk, R-M Shpk, J-06 Shpk dhe Mi. Shpk) DTTV ka nënshkruar marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve tatimore (zbatimi i akt marrveshjeve për likuidimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore është trajtuar në rubrikën ñZbatimi i akt marrëveshjeveò). Për vitin 2019 nga 13 subjekte rezultojnë pa paguar detyrimet e taksave dhe tarifave 2 subjekte, Mi. Shpk dhe A. Shpk përkatësisht në vlerat 324,220 lekë dhe 236,767 lekë.
Për vitin 2020 nga 13 subjekte rezultojnë pa paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore 6 subjekte:

- Mi. Shpk me vlerë 394,120 lekë;
- P. Shpk me vlerë 368,665 lekë;
- Ch. As. me vlerë 361,420 lekë;
- S. M. me vlerë 316,120 lekë;
- A. Shpk me vlerë 327,120 lekë;
- O. Shpk me vlerë 316,120 lekë.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave janë trajtuar në rubrikat më sipër për taksat dhe tarifat vendore, qiratë e aseteve dhe akt marrëveshjet për pagesat me këste të detyrimeve.

7. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

(Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjes ekonomike; Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnjësisë; Opinioni mbi pasqyrat financiare.**)**

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 1</u>: Mos likuidim i faturave të prapambetura sipas afateve për mungesë fondesh nga Bashkia Pogradec.**

Situata: Nga auditimi mbi raportimit financiar për periudhën 2019, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, nuk është realizuar inventarizimi fizik i mallrave dhe aktiveve afat mesëm dhe afatgjatë;

- Nuk është ngritur komisioni i vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtëra dhe afatgjata për Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.
- Nuk është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë perdorimi të aktiveve afatshkurtëra dhe afatgjata në Bashki dhe njësitë administrative.

Për sa me siper është vepruar në kundershim me Udhezimin Nr 30 date 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publikò, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 ñPer vetqeverisjen vendoreò si dhe ligjin 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Financës.

Kriteri: Udhezimin Nr 30 date 27.12.2011 ñPer menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publikò, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 ñPer vetqeverisjen vendoreò si dhe ligjin 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò. dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Financës.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme nga mos kryerja e inventarizimit për vitin 2019, ka rezultuar pasqyrimi i inventarit në fund të vitit jo fizik por kontabël.

Shkaku: Neglizhencë në kryerjen e detyrave për inventarizimin e aktiveve. *<u>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. I. K., me detyrë Drejtore e Financës.</u>*

Rëndësia : *E lartë*

Rekomandime:

<u>Rekomandime</u>: Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që në vazhdimësi të realizojnë në kohë ngritjen e komisioneve për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të papërdorshme, për të krijuar hartimin me saktësi të pasqyrave financiare në fund të vitit ushtrimor.

<u>Nga auditimi i pasqyrimit të bilancit. Aktivi.</u>

- Gjendja e llogarisë 520 ñ Disponibilitete ne thesarò paraqitet në mbyllje të vitit 2018 në shumën 201,749,748 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 194,189,979 lekë. Kjo llogari është tepricë e granteve të pa perdorura nga granti dhe nje pjesë e të ardhurave te muajit Dhjetor e cila çelet në muajin pasardhes. Kjo vlerë parashikohet në rritjen e buxhetit të vitit 2020.

Gjendja e llogarisë 532 ñVlera të tjera ò paraqitet në mbyllje të vitit 2019 në shumën 6,443,000 lekë, e cila perfshin vlerën e blloqeve të letrave me vlerë ne magazinë (bileta ,pulla poste).

Gjendja e aktiveve qarkulluese në shumen 9,283,158 lekë, nga kjo llogaria 31 materiale në shumën 2,514,644 dhe llogaria 32 inventar i imët në shumën 6,768,514 lekë. Në ndryshim nga viti i kaluar kjo llogari është pakësuar me shumën 721,949 lekë qe perfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit (llogaria 63.)

Gjendja e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 121,153,065 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 116,789,922 lekë. Kjo vlere

përfaqëson detyrimet ndër vite te akumuluara që nga viti 2010. kundrejt Bashkisë, dmth përfaqëson detyrimet e të tretëve ndaj Bashkise. Krahasuar me vitin e mëparshem ka nje ulje në shumën 4,363,143 lekë

Gjendja e llogarisë 4342 ñOperacione me shtetin të drejta ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 58,004,165 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 56,146,497 lekë. Kjo vlerë perfaqëson vlerën e financimit te pritshëm 17,590,394 lekë ,vlerën e detyimeve të faturave të akumuluara ndër vite qe nga vitet 2010-2015 me dokumentacione qe perfaqesojne kryesisht kamt vonesa e OSHEE etj. në vlerën 37,233,822 lekë dhe detyrimet e dhjetorit të cilat nuk përfshihen të detyrimet e prapambetura.

Gjendja e llogarisë 486 ñshpenzime të periudhave të ardhshmeò paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 315,442,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 316,383,902 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e detyimeve të faturave të akumuluara ndër vite (vitet 2010,2011,2012) të pa likujduara nga ana e Bashkisë.

Gjëndja e llogarisë 202 ñStudime dhe Kërkimeò në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 9,503,041 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 8,077,585 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur për 1,425,456 lekë.

Gjëndja e llogarisë 210 ñToka, troje, terreneò në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 3,088,720 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 3,088,720 lekë.

Gjëndja e llogarisë 211 ñPyje e plantacione ò në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 23,737,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 23,737,562 lekë.

Gjendja e Llogarisë 212 ñNdërtesa Konstruksioneò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 68,434,760 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 71,778,422 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2018 paraqitet në vlerën Shumen 71,778,422 lekë janë shtuar gjatë vitit 115,129,407 lekë dhe janë transferuar te ndermarrjet e varesisë shuma 114,884,148 lekë (rikonstruksion shkolla dhe rrugë).

Gjendja e llogarisë 213 ñRrugë rrjete vepra ujore ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 712,406,280 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 718,993,168 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën Shumen 712,406,280 lekë janë shtuar gjatë vitit 506,094,397 lekë dhe janë transferuar të ndermarrjet e varesise shuma 476,731,627 leke (rrugë).

Gjendja e Llogarisë 214 ñInstalime teknike makineri e pajisje ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 9,948,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 10,472,171 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 9,949,562 lekë janë shtuar gjatë vitit 4,798,800 lekë dhe janë transferuar të ndermarrjet e varësisë shuma 4,798,800 lekë si dhe amortizuar në vlerën 523.609 lekë (material ndriçimi).

Gjendja e llogarisë 215 ñMjete transporti ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 452,543 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 452,543 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në 452,543 lekë. Kjo vlerë përfaqëson mjetet e transportit të trashëguara nga ish komunat.

Gjëndja e llogarisë 218 ñInventar ekonomik ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 5,980,780 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 6,835,093 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në 5,980,780 lekë. Janë pakësuar gjatë vitit 854,313 lekë.

Gjendja e llogarisë 24 ñAktive afatgjata të demtuara ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 4,631,125 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 4,631,125 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në 4,631,125 lekë. Janë vlera aktivesh të paraqitura nga bashkimi i njësive administrative ish komunave.
Gjendja e llogarisë 28 ñCaktime te aktiveve afatgjata ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 9,314,707 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 9,314,707 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në 9,314,707 lekë. Janë vlera aktivesh të dëmtuara të paraqitura nga bashkimi i njesive administrative .
Gjendja e Llogarisë 26 ñPjesmarrje ne kapitalin e vete ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 300,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 300,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në 300,000 lekë. Është një vlerë e mbartur prej shumë vitesh për të cilen nuk ka një shpjegim të saktë (projekt punesimi) .
Gjendja e Llogarisë 230 ñAktive afatgjata jomateriale ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 415,109 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 415,109 lekë. Kjo vlere ka ardhë nga bashkimi i ish komunave.
Gjendja e Llogarisë 231 ñPer aktive afatgjata material ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 32,709,792 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 291,949,148 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 6 ñInvestimet dhe burimet e financimit)ò në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 291,949,148 gjatë vitit 2019 janë kryer investime në vlerën 366,783,248 lekë dhe janë kapitalizuara 626,022,604 lekë.

- Nga auditimi i pasqyrimit të bilancit. PASIVI

Gjendja e Llogarisë 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 28,465,262 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 42,131,099 lekë. Përfaqëson vlerën e detyrimeve të Bashkisë të faturave të papaguara të operatorëve ekonomik.
Gjendja e llogarisë 42 ñDetyrime ndaj personelitò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 12,748,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 9,413,607 lekë. Përfaqëson vleren e detyrimeve të Bashkisë për pagat e muajit Dhjetor.
Gjendja e llogarisë 466 ñKreditorë për mjete në ruajtje ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 39,830,330 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 41,613,259 lekë. Kjo vlere perfaqëson vlerën e ngurtësimit të investimeve të kryera gjendje në thesar (5% i garancise), bashkëngjitur Aneks 3.
Gjendja e llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshemò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 318,405,388 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 326,474,743 lekë. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet e bashkise ndër vite të akumaluara që nga viti 2010 sipas dokumentacionit sherbime etj.
Gjendja e llogarisë 4341 ñOperacione me shtetinò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 118,385,015 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 112,986,522 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vleren e llogarise 468 + vleren 3,803,400 lekë e cila përben shumën e detyrimeve të ngarkuara nga punonjesit që terheqin bileta tregu ose pulla poste.
Gjendja e llogarisë 475 ñTe ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhese ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 5,657,850 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,246,400 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e letrave me vlerë llogaria 532 ne shumen 6,443,000 + vlerën e personave te ngarkuar 3,803,400 leke e cila përbën shumën e detyrimeve të ngarkuara nga punonjësit që terheqin bileta tregu ose pulla poste.

Gjendja e llogarisë 16 ñHuatë Afatgjata ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 10,146,159 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 6,026,491 lekë. Kjo vlere përfaqëson vleren e detyrimit te mbetur të kredisë të marrë ne vitin 2010,2011 nga Bashkia.
Gjendja e llogarisë 85 ñRezultati i veprimtarisë ushtrimore ò paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 161,764,712 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 151,854,771 lekë. Kjo vlere përfaqëson rezultatin ushtrimor vlere e cila trashëgohet në të ardhmen si e ardhur e trashëguar.
Nga informacioni i kerkuar ne lidhje me pjesmarrjet në aksione të bashkise në ndermarrje të tjera u informuam që Bashkia Pogradec është Aksionere në UK sha dhe të KF Pogradeci SHA i cli përfshihet te klubi shumesportesh. UK sha ka bilanc në vete.
Nga informacioni i kerkuar per kryerjen e inventareve fizik u informuam se per vitin 2019 nuk është kryer inventari fizik.
Për sa me sipër është vepruar në kundershim me Udhezimin Nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publikò, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 për vetqeverisjen vendore si dhe ligjin 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.
Për sa me sipër mban pergjegjësi Zj. I. K. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar.
Për vitin 2020 janë kryer inventaret fizike, sipas Urdherave të mëposhtëm:
Urdhër Nr.891, datë 05.11.2020 me Nr. 5684 prot., datë 05.11.2020 për krijimin e komisionit të vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në njesite administrative Buçimas, Dardhas, Çerrave dhe Udenisht.
Urdhër Nr. 893 datë 05.11.2020 me Nr. 5684/2 prot., datë 05.11.2020 për krijimin e e komisionit të vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në njesitë administrative Velçan. Urdhër Nr. 892, datë 05.11.2020 me Nr. 5684/1., prot datë 05.11.2020 për krijimin e komisionit të vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në njesitë administrative Proptisht. Urdhër Nr. 894, datë 05.11.2020 me Nr. 5684/3 prot., datë 05.11.2020 për krijimin e komisionit të vleresimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në njesitë administrative Trebinje. Urdhër Nr. 895, datë 05.11.2020 me Nr. 5685 prot., datë 05.11.2020 për krijimin e komisionit të nxjerrjes jashtëperdorimi të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në Bashki dhe njesitë administrative.
Urdhër Nr. 896.,datë 05.11.2020 me Nr. 5685/1 prot., datë 05.11.2020 për krijimin e komisionit të nxjerrjes jashtë perdorimi të aktiveve afatshkurtera dhe afatgjata në Bashki dhe njesitë administrative. Eshtë kryer inventari fizik dhe totali totali i inventarit kontabel është 1,362,365,946 lekë.
Kontrolli i shpenzimeve te bilancit te vitit 2019.
U krye rakordimi i shpenzimeve te bilancit me situacionet e thesarit dhe rezultoi si më poshtë.

Tabela 7/1 Rakoordimi i shpenzimeve të bilancit me situacionet e thesarit.

Shpenzimet e situacioneve te rakorduara me thesarin	**1,382,736,729**
Shpenzime sipas bilancit	1,034,265,826.00
Zbriten shpenzimet per investime	366,783,248.00
Diferenca	(18,312,345.00)
shtohet financimi i pritshem llog 7206 vlera	17,590,394
shtohet vlera e ndryshimit të vleres së inventarit	721,949.00
Diferenca	0

(Hollesitë mbi shpenzimet janë trajtuar në aneksin nr. V.2.5)

- Nga verifikimi mbi rregullshmërinë e likujdimit të faturave tatimore për investimet publike për periudhën e auditimit (2019+2020) së bashku me situacionet e punimeve rezulton, që faturat tatimore të pranuara nga ana e Bashkisë nga kontraktorët e punimeve të ndërtimit rezultojne me

date ndryshe nga data e situacionit të punimeve në total për 17 raste sipas tabeles nr.1, (likuidimi bëhet me situacione mujore) por datat janë të mëvonshme duke mos gjetur zbatim kërkesat sipas: Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet: Neni 50 - Fatura tatimore me TVSH, pika 1; Neni 49 - Fatura tatimore, pika 3; Neni 51- Lëshimi i faturës tatimore, pika 1; Ligjin nr 92/2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Neni 99 pika 5 - ñMomenti i lëshimit të faturësò; Udhëzim i MF nr. 6 , datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, Neni 20 **-** Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes, pikat: 2 ñVlera e tatueshme e punimeve të ndërtimitò dhe pika 3 ñModalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtimò. Në zbatim të dispozitave të mësiperme ligjore u konstatua që në 17 raste fatura tatimore nuk perputhet në kohë me situacionin e punimeve fatura te cilat janë firmosur nga punonjësit sipas tabeles se mëposhtme. Për këtë është mbajtur akt konstatimi nr 6 dhe janë përcaktuar përgjegjësitë për punonjësit që kanë kryer kontrollin e faturës me situacionin. Diferencat me faturat nuk janë konstatuar pasi situacioneve u zbriten paradheniet e marra si dhe ndalesat e garancise

Tabela nr. 7/2 (Mospërputhja e datës së faturës tatimore me datën e situacionit).

Nr	uyx 37	Datë	Vlera e likuidimit	Shoqeria	Nipti	Data e fatures	Vlera e situacionit	Data e situacionit	Punonjesi kontrollues
1	730	28.09.2020	5,128,787	H. ndertim	L64507603U	30.01.2020	5,398,723	31.12.2019	V. Ç.
2	93	06.02.2020	3,023,858	R. shpk	J93711608Q	06.01.2020	3,023,858	Dhjetor 2019	O. B. & .Z. Ç.
3	191	18.03.2020	1,419,473	R. shpk	J93711608Q	05.03.2020	1,419,472	29.02.2020	O. B. & .Z. Ç.
4	240	16.04.2020	9,510,962	R. shpk	J93711608Q	03.04.2020	9,510,962	Mars2020	O. B. & .Z. Ç.
5	393	09.06.2020	11,781,675	R. shpk	J93711608Q	04.06.2020	11,781,675	31.05.2020	O. B. & .Z. Ç.
6	394	09.06.2020	465,757	R. shpk	J93711608Q	04.06.2020	465,727	31.05.2020	O. B. & .Z. Ç.
7	489	08.07.2020	11,680,117	R. shpk	J93711608Q	03.07.2020	11,680,117	30.06.2020	O. B. & .Z. Ç.
8	518	29.07.2019	3,350,308	R. shpk	J93711608Q	03.07.20219	3,350,308	Qershor 2019	O. B. & .Z. Ç.
9	664	10.09.2020	10,168,312	R. shpk	J93711608Q	10.09.2020	10,168,312	31.08.2020	O. B. & .Z. Ç.
10	781	07.10.2020	9,562,047	R. shpk	J93711608Q	02.10.2020	9,562,047	30.09.2020	O. B. & .Z. Ç.
11	856	10.11.2020	11,471,815	R. shpk	J93711608Q	05.11.2020	11,471,815	31.10.2020	O. B. & .Z. Ç.
12	888	23.11.2020	819,736	R. shpk	J93711608Q	28.10.2020	862,880	30.09.2020	V. Ç.
13	889	23.11.2020	4,070,092	R. shpk	J93711608Q	28.10.2020	4,285,308	30.09.2020	Vj. B.
14	958	10.12.2020	12,874,267	R. shpk	J93711608Q	10.12.2020	12,874,267	Nentor 2020	O. B. & .Z. Ç.
15	319	14.05.2020	9,886,839	R. shpk	J93711608Q	07.05.2020	9,886,839	Prill 2020	O. B. & .Z. Ç.
16	728	28.09.2020	3,432,627	R. shpk	J93711608Q	10.09.2020	4,594,583	04.12.2019-04.06.2020	F. B.
17	758	02.10.2020	13,233,826	V.N.	K77524909Q	18.09.2020	18,664,657	31.12.2019	E. P.

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar.

8. MBI PLANIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT NR. 9643, DATË 20.11.2016 ñPËR PROKURIMIN PUBLIKòI NDRYSHUAR, VKM NR. 914, DATË 29.12.2014 ñPËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIKò I NDRYSHUAR, ME VKM NR. 797, DATË 29.12.2017, UDHËZIMI I AGJENSISË SË PROKURIMIT PUBLIK NR. 2, DATË 24.04.2017 ñPËR PROCEDURËN E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËLò.
(Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve; Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara; Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit); Auditim mbi zbatimin e kushteve të kontratave në realizimin të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike; Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punëve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues).

8.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB, pasqyra aneks 6/1, 6/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pogradec *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Tabela 8/1 Rakoordimi i shpenzimeve të bilancit me situacionet e thesarit.

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2020	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	**56**	**1,385,109,078**	**1,240,373,606**
-Të hapura	14	1,212,561,752	1,075,650,183
- Hapura me lote	3	18,599,407	18,559,107
- Kërkesë me propozim	25	82,908,644	77,055,314
- Kërkesë me propozim me lote	10	8,289,276	7,537,173
-Negocim pa shpallje	2	55,666,666	54,558,496
-Shërbim konsulence	1	5,833,333	5,763,334
-Amendament kontrate	1	1,250,000	1,250,000
Sipas objekteve	***27***	**197,049,712**	**186,062,354**
-Objekte në fushën e investimeve	22	643,079,831	622,530,349
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	34	742,029,247	617,843,257

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Pogradec*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **56** procedura me fond limit 1,385,109 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 144,736 mijë lekë ose 10.5%, *nga e cila:* në ***vitin 2019*** janë realizuar

gjithsej **27** procedura me fond limit 197,049 mijë lekë dhe vlerë kontrate 186,062 mijë lekë, dhe për ***vitin 2020*** janë realizuar **29** procedura me fond limit 1,188,059 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,054,311 mijë lekë
Kanë marrë pjesë në procedura **168** OE/BOE dhe janë skualifikuar **77** OE/BOE ose 45.8%.
Sipas llojit të aktivitet, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **22** procedura me vlerë kontrate 622,530 mijë lekë ose 50% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **34** procedura me vlerë kontrate 617,843 mijë lekë.
Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **13** procedura ose 23 % e procedurave të zhvilluara, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Pogradec janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.
Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **56** procedura me vlerë kontrate 1,240,373 mije lekë janë vlerësuar për auditim **21** procedura me vlerë kontrate 1,186,232 mijë lekë ose 95.6%, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet sipas gjetjes si më poshtë vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 1: KLSH-ja,** konstatoj së në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2020, janë konstatuar kritere jo në përputhje me procedurën dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja**.**

Situata: Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020, nga Bashkia Pogradec janë realizuar gjithsej **56** procedura me fond limit 1,385,109 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë, *nga e cila:* në ***vitin 2019*** janë realizuar gjithsej **27** procedura me fond limit 197,049 mijë lekë dhe vlerë kontrate 186,062 mijë lekë dhe për ***vitin 2020*** janë realizuar **29** procedura me fond limit 1,188,059 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,054,311 mijë lekë.
Grupi i KLSH-^{së}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **56** procedura me vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **21** procedura ose 37.5% me vlerë kontrate 1,186,232 mijë lekë ose 95.6% të vlerës së kontratave të lidhura, *nga e cila:* për *vitin 2019* nga **27** procedura me vlerë kontrate 186,062 mijë lekë janë audituar **11** procedura me vlerë kontrate 166,180 mijë lekë ose 89% e vlerës së kontratave, dhe për *vitin 2020* nga **29** procedura me vlerë kontrate 1,054,311 mijë lekë janë audituar **10** procedura me vlerë kontrate 1,020,052 mijë lekë ose 96.7% e kontratave.
Nga auditimi i **21** procedurave me vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **16** procedura, *nga të cilat*: në **12** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura, në **11** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **224,926 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar nenet 2, 20, 24, 46, 47, 53, 55, 58, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61 *konkretisht sipas periudhave:*
a- ***Për aktivitetin e vitit 2019***, nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 166,180 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **10** procedura me vlerë kontratë **131,871 mijë lekë ose 79 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **5** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **7** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Pogradec, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **121,870 mijë lekë pa TVSH**.

b- ***Për aktivitetin e vitit 2020***, nga auditimi i **10** procedurave me vlerë kontratë 1,054,311 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **8** procedura me vlerë kontratë **551,125 mijë lekë ose 52 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **7** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **4** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Pogradec, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **103,056 mijë lekë pa TVSH**.

Kriteri:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar: **Neni 2,** *"Parimet e përzgjedhjeje",* **Neni 20, "***Mosdiskriminim,* **Neni 24,** *"Anulimi i një procedure",* **Neni 46,** *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, ku është përcaktuar se**: Neni 53,** *"Shqyrtimi i ofertave",* pika3.

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*ò, i ndryshuar, nenet: **Neni 26**, pika 5, ñ*Kontratat për punë publike*ò, **Neni 27,** pika 3, ñ*Kontratat e mallrave*ò,**Neni 28,** pika 2**Neni 61**, pika 2, *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit";* **Neni 74**, pika 3, *"Bashkimi i operatorëve ekonomikë"*

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kritereve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kritereve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kritereve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve për vlerën **224,926 mijë lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT dhe KVO, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pogradec, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, të cilët në hartimin e kritereve të aplikohen kritere të cilat i përshtaten procedurës së zhvilluar, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke mos lejuar veprime me dy standarde në klasifikimin e tyre dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor ñ*Çmimi më i leverdishëm",* midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të fondeve të prokuruara për vlerën **224,926 mijë lekë**.

Procedurat e periudhës 01.01.2019 – 31.12.2019

-*Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01/01/2019 ï 31/12/2019, nga Bashkia Pogradec referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **27** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 197,049 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 186,062 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 10,987 mijë lekë ose 5.6 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Tabela 8/2 Shpenzime të programuara në nivelin e fondeve buxhetore.

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2019	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	**27**	**197,049,712**	**186,062,354**
-Të hapura	5	115,927,585	108,667,188
- Hapura me lote	3	18,599,407	18,559,107
- Kërkesë me propozim	19	62,522,720	58,836,059
Sipas objekteve	***27***	**197,049,712**	**186,062,354**
-Objekte në fushën e investimeve	10	156,711,506	146,694,268
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	17	40,338,206	39,368,086

Burimi: *Sektori i prokurimeve.*

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **82** OE/BOE, nga të cilat janë sõkualifikuar **30** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **8** procedura ose 29 % e procedurave të zhvilluara, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Pogradec janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditmit nga **27** procedura prokurimi me vlerë kontrate të lidhur prej 186,062 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e të **11** procedurave me vlerë kontrate 166,180 mijë lekë ose 89 % e vlerës së kontratave të lidhura.

Nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 166,180 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **9** procedura me vlerë kontratë **131,871 mijë lekë ose 79%** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **5** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **7** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Pogradec, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **121,870 mijë lekë pa TVSH**., veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 **"** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave,** *si më poshtë vijon*:

I- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Vrojtimi dhe sinjalizimi me kamera, sistem alarmi dhe akses kontrolli për vitin 2019"rezultoi:*

►**Titulli i gjetjes nr. 2:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3** e DST e cila kërkon 1 inxhinier Mekatronik për zbatimin e kësaj kontrate, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me shërbimin objekt prokurimi. Fakti që janë paraqitur 2 ankesa në AK për ndryshimin e këtij kriteri, është tregues i kufizimit që ky kriter jep për ofertuesit.

2.Kërkesa e pikës **2.3.2** e cila kërkon nga OE që të kenë pjesë të stafit për përmbushjen e kësaj kontrate ku **në zërat konkretë të preventivit, numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 3 punonjës**, është kërkesë e paargumentuar, jo e qartë dhe evazive e cila nuk i shërben AK.

Ankesa - Janë paraqitur 2 ankesa nga OE ñR.ò shpk me nr. 4447 prot., datë 05.06.2019 si dhe ñEl.ò shpk me nr. 4453 prot., datë 05.06.2019. Të dy OE ankohen për kërkesën për 1 inxhinier mekatronik. KSHA e ngritur me vendimin nr. 154, datë 05.06.2019, pas shqyrtimit të tyre, nuk ka pranuar ankesën për modifikimin e kriterit dhe heqjen e kërkesës për 1 inxhinier mekatronik.

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

1.Në lidhje me vlerësimin për OE të sõkualifikuar, KVO ka vepruar në përputhje me LPP, pasi 2 OE nuk kishin paraqitur ofertë, ndërsa OE ñX. S.ò nuk përmbushte kriterin për punë të ngjashme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se BOE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:

a)OE ñShk.ò SHPK nuk përmbush pikën **2.1/dh** të Kritereve të Veçanta për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*

-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 1143 prot., datë 29.05.2019 të Drejtorisë Rajonale Fier sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 29.05.2019 duke përfshirë faturën koherente te muajit Shtator 2019. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 21.06.2019, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Maj të vitit 2019 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
b)BOE nuk përmbush pikën **2.3.1** të kapacitetit teknik për përvojë të suksesshme në shërbime të së njëjtën natyrë ose kontrata të ngjashme, pasi asnjëri nga OE nuk ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për të provuar përmbushjen e kësaj pike. OE ñIò sh.r.s.f ka paraqitur 3 kontrata të lidhura me Zyrën Arsimore Pogradec, por nuk ka paraqitur Vërtetime ose fatura tatimore të shitjes për shërbimin e realizuar sipas kërkesës në DST. OE ñShk. ò, ka paraqitur 2 kontrata me objekt ñ*Rikonstruksion + shtesë anësore e Shkollës 9 vjeçare, fshati Çermë-Shkumbin, Bashkia Divjake"* dhe *"Rikonstruksion i gjimnazit "Dituria" Krutje".* Në asnjërën nga këto kontrata, nuk ka zëra shërbimi të natyrës objekt prokurimi.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. P. B., z. B. M. dhe znj. A. Ç.,* si dhe *anëtarët e KSHA dhe KVO z. A. Ç., z. E. B. dhe znj. A. P..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **3,950,000 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **3,950,000 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarja e NJP A. Ç. është paraqitur observacioni nr. 102/31 prot., datë 18.06.2021, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *1.Anëtarja e NJP A. Ç., sqaron se nuk ka firmosur asnjë akt të mbajtur nga NJP, dhe nuk mund të cilësohet si person që mbart përgjegjësi. Për këtë arsye kërkon që në raport ti paraqitet emri.*
1.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier mekatronik, sqarohet se kërkesa për këtë lloj inxhinieri është në përputhje me natyrën e shërbimit, pasi nën mbikëqyrjen e tij garantohet realizimi i shërbimit me cilësi shumë të mirë, dhe sipas standardeve. Në kushtet që është trajtuar nga KSHA ankesa, është ky komision që mbart përgjegjësi dhe jo Njësia e Prokurimit.
2.Në lidhje me kriterin ku kërkohen jo me pak se 3 persona sipas zërave konkret të preventivit për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, kërkesa është e argumentuar, pasi OE i shpallur fitues duhet të realizojë edhe vendosjen e pjesëve të preventivit në 13 institucione shkollore.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Në lidhje me pikën 1, sqarohet se bazuar në urdhrin nr. 163, datë 20.05.2019 jeni njëri ndër anëtarët e Njësisë së Prokurimit në cilësinë e inxhinierit. Bazuar në pikën 2 të nenit 57 ñNjësia e prokurimitò të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, NJP ndër të tjera është përgjegjëse për *"Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre,* ***përshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimit teknike",*** *nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.* Sa më sipër, si njëra ndër anëtarët e NJP, ke hartuar dhe

firmosur dokumentet standarde të tenderit, përfshirë kriteret e veçanta të kualifikimit. Sa më sipër observacioni juaj është i paargumentuar.
2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, pranohet pjesërisht observacioni juaj. Kërkesa për inxhinier mekatronik nuk mirëargumentohet nga AK dhe si e tillë përbën kufizim për OE. Kjo lloj inxhinierie duke qenë një përzierje e inxhinierisë mekanike dhe elektronike, gjen fushë në zhvillimin e avancuar teknologjik siç është robotika. Sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"* Mekatronika nuk përfshihet në lidhjen 5 për arsimimet universitare që duhet të kenë drejtuesit teknik. Shërbimi i kërkuar objekt trajtimi është vrojtim me kamera dhe sisteme alarmi, shërbim i cili nuk ka ndonjë specifikë tejet të veçante për ta kufizuar me nevojën për inxhinier mekatronik. Në kushtet kur kërkesa është trajtuar nga KSHA, e cila nuk ka pranuar ankesën e subjekteve ankimuese, bazuar në nenin 78, pika 6 e VKM-së nr. 914, është përgjegjës për kriterin e mësipërm.
3.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, pretendimi nuk qëndron, pasi kërkesa e bërë në DST është e hartuar jo qartë, dhe jo në përputhje me kriteret ligjore. Konkretisht në DST është kërkuar që **<u>në zërat konkretë të preventivit, numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 3 punonjës.</u>** Sipas nenit 28, pika 5 germa (c), AK kërkon dëshmi për fuqinë punëtore të OE e nevojshme për ekzekutimin e kësaj kontrate, ndërkohë që mënyra e hartuar nga NJP është evazive dhe nuk përcakton një numër të qartë të fuqisë punëtore dhe profesionit të kërkuar. Formulimi krijon paqartësi për OE.

II- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Linja e jashtme e ujësjellësit "Uji i Zi – Dalja e Tunelit, Bishnicë, Njësia Administrative Velçan",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

►**<u>Titulli i gjetjes nr. 3</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3** e cila kërkon që *Kandidati ofertues të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt.....**i cili duhet të jetë i paangazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt**,* është kërkesë e paargumentuar dhe në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **10,330,097 ose 3 herë më të ulët se vlera e përcaktuar në UKM për të kërkuar drejtuesin teknik me kohë të plotë në kantier.**
2.Kërkesa e pikës **2.3.4** e DST e cila kërkon një punësim mesatar i të paktën **50** personave për **periudhën Janar 2017 – Shkurt 2019**, është kërkesë e paargumentuar, e ekzagjeruar dhe kufizuese në lidhje me periudhën **2 vjeçare** të numrit të personave të punësuar. Kjo kërkesë nuk argumentohet, dhe është kufizuese për OE për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. AK në shumicën e procedurave të tjera ka kërkuar periudha më të shkurtra të punësimit mesatar që varion nga pak muaj deri në 1 vit. Siç konstatohet nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim në këtë procedurë.
3.Kërkesa e pikës **2.3.7** e DST e cila kërkon punësimin e një mjeku, ndër të tjera kërkon që në **rast bashkimi operatorësh, secili prej tyre duhet të ketë të punësuar 1 mjek të përgjithshëm.** Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe kufizuese. Qëllimi i bashkimit është pikërisht bashkimi i

kapaciteteve, dhe kjo kërkesë duhet të jetë në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim, në përputhje me pikën 3 të nenit 74 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. P. B., z. N. T. dhe z. E. M..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

III-Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin: *"Karburant për nevojat e bashkisë Pogradec dhe të N.I.R",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr.4</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
1.Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht pikën **2.1/dh** e cila kërkon *vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike...*-OE ka paraqitur vërtetimin nr. 258 prot., datë 18.04.2019 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Korçë, sipas të cilit OE ka likuiduar faturat e llogaritura deri në datë 18.04.2019, pa përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2019**.** Në kushtet kur data e tenderit është 29.04.2019, është detyrim për OE për të marrë pjesë në tendera, likuidimi i faturës së maturuar të energjisë elektrike, në rastin konkret ajo e muajit Mars 2019, e cila rezulton e pa paguar.
2.OE nuk përmbush pikën **2.1.4** të DST për autorizimin e tregtimit me pakicë, pasi ka paraqitur vetëm 1 vërtetim/autorizim nga 2 të kërkuar, pasi në DST kërkohet që OE të disponojë 2 karburante, dhe rrjedhimisht duhet të paraqesë 2 vërtetime. Gjithashtu, vërtetimi i paraqitur, rezulton se është fotokopje e panoterizuar, në kundërshtim me kërkesën e vendosur në DST.
3.OE nuk përmbush pikën **2.3.6** të DST, në lidhje me shërbimin e furnizimit të karburantit me kartë elektronike. OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në SPE për të provuar se disponon shërbimin e mësipërm.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e KVO z. A. Ç., z. E. B. dhe z. B. I..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **9,516,666 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **9,516,666 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

IV- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Rehabilitim i shkollës së mesme Gjergj Pekmezi",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 5</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4** për 1 inxhinier mekanik në kushtet kur nuk ka asnjë zë punimesh në preventiv, është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e punës.
2.Kërkesa e pikës **2.3.5** *për mjekun e përgjithshëm,* ku kërkohet në rast bashkimi operatorësh që secili nga OE duhet të ketë pjesë të stafit 1 mjek, është kërkesë e ekzagjeruar dhe e paargumentuar. Qëllimi i bashkëpunimit është pikërisht bashkimi i kapaciteteve për të bërë të mundur zbatimin e kontratës, dhe kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 74 të VKM-së me nr. 914, datë 29.12.2014.
3.Kërkesa e pikës **2.3.5** *për inxhinierin Mekatronik i cili duhet të jetë në listë për 12 muajt e fundit*, është kërkesë e paargumentuar. Nuk argumentohet nevoja për këtë kategori inxhinierësh, ndërkohë që edhe kërkesa për 1 inxhinier të tillë që të jetë i punësuar të paktën 12 muajt e fundit, pengon OE për të bërë ofertat e tyre. NJP në raste të tilla mund të kërkojë disponimin e kësaj kategorie inxhinieri me kontratë pune në lidhje me zbatimin e një kontrate të veçantë, pasi mund të jetë e panevojshme kontrata me kohë të plotë për këtë kategori.
Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1. OE nuk përmbush pikën **2.1/f** e cila kërkon *vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike...*
-OE ka paraqitur vërtetimin nr. 1143 prot., datë 29.05.2016 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Fier, sipas të cilit OE ka likuiduar faturat e llogaritura deri në datë 29.05.2019, përfshirë faturën koherente të muajit Prill**.** Në kushtet kur data e tenderit është 17.06.2019, është detyrim për OE për të marrë pjesë në tendera, likuidimi i faturës së maturuar të energjisë elektrike, në rastin konkret ajo e muajit Maj 2019, e cila rezulton e pa paguar.
2.OE nuk përmbush pikën **2.3.4** të DST për stafin e inxhinierëve, pasi për asnjërin nga inxhinierët nuk ka paraqitur librezën e punës, sipas kërkesës së bërë nga NJP.
3.OE nuk përmbush kërkesën e vendosur nga NJP në lidhje me dokumentacionin e kërkuar për furnizimin me materiale hidraulike. Dokumentacioni në lidhje me certifikatat ISO të paraqitura është i gjithi në gjuhë të huaj anglisht/frëngjisht, i pa përkthyer dhe i panoterizuar. Disa prej certifikatave u ka kaluar afati i vlefshmërisë. Dokumentet teknike të paraqitura nga furnitori, janë të gjitha katalogë në gjuhë të huaj, të pa përkthyer dhe të panoterizuar. Paraqitja e dokumenteve të pa përkthyer është në kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, e cila përcakton ***nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe***. Gjithashtu paragrafi i fundit i kërkesave të veçanta për kualifikim, përcakton se ***certifikatat të jenë në gjuhë shqipe, ose të përkthyera dhe të noterizuara.***
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. P. B., z. N. T. dhe znj. E. M.,* si dhe *anëtarët e KVO z. A. Ç. dhe z. K. G..*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **61,921,356 lekë** pa TVSH.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **61,921,356 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës..

V- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Shërbime për dru zjarri për ngrohje",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 6</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:
1.Kërkesat e pikës **2.3.1** të DST, për përvojë të ngjashme. OE ñL. B.ò ka paraqitur kontratë të lidhur me Bashkinë Pogradec për *blerje lëndë djegëse dru zjarri për institucionet shkollore të qytetit dhe njësive administrative*. Ky OE nuk ka paraqitur faturat tatimore të shitjes për shërbimin e realizuar, në kundërshtim me kërkesën e vendosur nga NJP në DST.
2.OE ñKò shpk, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar se përmbush kriteret për përvojën e ngjashme sipas pikës **2.3.1** të DST.
3.OE nuk ñL. B.ò, nuk përmbush pikën **2.4.1** të DST, për numrin mesatar të punonjësve (10 punonjës) për zbatimin e kësaj kontrate për periudhën Mars 2018 ï Mars 2019. Ky OE rezulton nga listëpagesat se ka të punësuar vetëm 2 punonjës, ndërkohë që ka marrë përsipër kryerjen e shërbimit në masën 73%, çka përkthehet në mesatarisht në 7-8 punonjës për zbatimin e kësaj kontrate.
4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.4.6** të DST për 2 kamionë me kapacitet mbajtës minimumi 7.5 Ton. Mjeti me Targa AA800VG, i marrë me kontratë qiraje nga OE ñKò shpk, rezulton sipas lejes së qarkullimit me kapacitet mbajtës 6.15 Ton, ose 1.35 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar.
5.OE ñKò shpk nuk përmbush kriteret e pikës **2.1/dh** të DST për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.
-Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 286 prot., datë 02.05.2019 të drejtorisë rajonale Korçë sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e energjisë deri në datë 02.05.2019 pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019. Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 20.05.2019, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Prill 2019 për të përmbushur kriterin e vendosura në DST.
6.BOE nuk përmbush kriteret e pikës **2.1** të DST për një dokument që vërteton shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore kudo ku ka ushtruar aktivitetin për vitin 2017-2018. Në

SPE nuk ka asnjë dokumentacion për të provuar shlyerjen e detyrimeve pranë njësive vendore nga ky BOE.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e KVO z. A. Ç., z. A. A. dhe z. M. D..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **7,951,469 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **7,951,469 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

VI- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Mirëmbajtje ndërtesash",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:
► **<u>Titulli i gjetjes nr. 7</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.6** për 1 agronom është e paargumentuar, pasi objekti i punës është shërbim për mirëmbajtje ndërtesash, dhe jo shërbim për produktet dhe prodhimet bujqësore.
Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE ñA.l. -Dò SHPK nuk përmbush pikën **2.3.5/b** të DST, pasi vërtetimi i lëshuar nga punëdhënësi për koordinatorin e punimeve, është pa vulë dhe pa firmë.
2.OE ñA.l. -Dò SHPK nuk përmbush pikën **2.3.6** të DST, pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 murator nga 6 të kërkuar, dhe 1 bojaxhi nga 8 të kërkuar. I vetmi punonjës i deklaruar Hiqmet Dokollari, rezulton edhe murator, edhe bojaxhi. Gjithashtu OE nuk përmbush kriteret e kësaj pike për 1 Saldator, pasi nuk ka provuar se disponon një të tillë.
3.OE ñA.l. -Dò SHPK nuk përmbush pikën **2.3.7** të DST, për mjetin vetëshkarkues kamionçinë me kapacitet deri 1 Ton, pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 mjet të tillë nga 2 të kërkuar. Mjetet tjera të paraqitura kanë kapacitet më të madh se 1 Ton.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. P. B., z. B. M. dhe znj. E. M.,* si dhe *anëtarët e KVO z. A. Ç., zj. M. D. dhe znj. A. B..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **8,011,692 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **8,011,692 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë

faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni me nr. 102/30 prot., datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me mos përmbushjen e kriterit për fuqi punëtore jo më pak se 35 punonjës, sqarohet se referuar pikës 8.b të nenit 26 të VKM-së nr. 914 ky kriter plotësohet nga të 2 OE sipas përqindjes në prokurë dhe akt marrëveshje.*
2.Në lidhje me vërtetimin pa vulë dhe pa firmë, sqarohet se është konsideruar mangësi e vogël sipas pikës 4 të nenit 53 të LPP.
3.Në lidhje me konstatimet e pikës "ç" dhe "d", sqarohet se janë përmbushur së bashku nga të dy OE, në përputhje me përqindjen e ndarë në prokurë dhe në marrëveshjen e bashkëpunimit.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Pranohen pika 1 e observacionit. Provohet se BOE disponon numrin e punonjësve në përputhje përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër.
2.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, sqarohet se pretendimi juaj nuk qëndron, pasi siç përcakton neni 53 pika 4 e LPP, *AK mund të vlerësojë një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla,* ***të argumentuara....*** KVO nuk ka evidentuar mangësinë e OE, si dhe nuk ka argumentuar devijimin e vogël sipas kërkesës së ligjit.
3.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, sqarohet se pretendimi juaj nuk qëndron. OE ñA.l. -Dò SHPK ka marrë përsipër kryerjen e 54.7% të punimeve, pra më shumë se gjysmën e tyre, ndërkohë që nuk ka stafin e nevojshëm të kualifikuar për përmbushjen e kontratës. Neni 74 pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcakton qartë që ñ*Kërkesat ekonomike, financiare,* ***profesionale*** *dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje"*. Sa më sipër, OE nuk përmbush numrin e stafit të kualifikuar në përputhje me përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër.

VII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim blloku tek ish ferma loti I",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 8</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE **"I" SHPK** nuk përmbush pikën **2.1/g** të Kritereve të Veçanta për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 385 prot., datë 07.06.2019 të Drejtorisë Rajonale Korçë sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 07.06.2019 pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2019. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë

08.07.2019, duhej të likuidohej fatura e maturuar e muajit Maj 2019 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
2.BOE nuk përmbush pikën **2.3.15 të DST**, për mjetin ***Cordonatriçe***. BOE ka paraqitur kontratën me nr. 387 Rep, 317/1 Kol, datë 24.06.2019 me shoqërinë ñCo. Se. It.ò për marrjen me qira të mjetit Cordonatriçe. Me përjashtim të kontratës, mungojnë aktet e zhdoganimit apo fatura tatimore e blerjes së mjetit, sipas kërkesës së përcaktuar nga NJP në DST.
3.BOE nuk përmbush pikën **2.3.15 të DST,** për mjetin ***Minieskavator*.** OE ñSh.ò shpk ka paraqitur vetëm një faturë të lëshuar në Greqi, të panoterizuar dhe të pa përkthyer për blerjen e një minieskavatori. Gjithashtu mungon foto e mjetit sipas kërkesës së vendosur nga NJP në DST.
4.BOE nuk përmbush pikën **2.3.15 të DST,** për mjetin ***Grejder, Autopresë betoni dhe Autobot Uji*.** BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar se disponon mjetet e mësipërme në kundërshtim me kërkesën e vendosur nga NJP në DST.
5.BOE, ka paraqitur kontratën e bashkëpunimit të përkohshme për procedurën e prokurimit me objekt ñPër një shtesë fondi tek objekti sistemim blloku ish fermaò ku kanë përcaktuar përqindjet e punimeve në masën **80%** subjekti ñSh.ò shpk dhe **20%** subjekti ñIò shpk. Në formularin e ofertës së paraqitur, mungon ndarja e punimeve sipas përqindjes që kanë marrë përsipër. Rezulton se BOE ñIò shpk nuk përmbush pothuajse gjitha pikat për disponimin e mjeteve sipas pikës **2.3.15**, pavarësisht se ka marrë përsipër **20% të punimeve.**
6.OE ñInfinitò shpk, nuk përmbush pikën **2.3.5 të DST,** për asnjë nga inxhinierët e kërkuar. Nuk provon se ka të punësuar një inxhinier hidroteknik, ndërsa për inxhinierin e ndërtimit, ing.elektrik dhe ing. Gjeodet, dokumentacioni i paraqitur është i paplotë, dhe jo në përmbushje të kritereve të vendosura në DST. Në gjitha rastet mungon libreza e punës. Inxhiniere elektrike gjithashtu, rezulton se në diplomë me emrin M. N., ndërkohë që në kontratën e lidhur, është me emrin M. C.. Nuk provohet që kemi të njëjtin person.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *e KVO z. A. Ç., z. T. F. dhe z. A. Sh..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **19,574,639 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **19,574,639 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

VIII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim rrugësh blloku Goricë",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes r. 9</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.6** sipas së cilës kërkohen 5 manovratorë, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me vet kërkesat e NJP në lidhje me numrin e

mjeteve që kërkohet. Në DST është kërkuar mjet i rëndë vetëm 1 fadromë. Me këto kërkesa, NJP bëhet pengesë për OE për të marrë pjesë në procedura prokurimi.
2.Kërkesa e NJP për fabrikë asfaltobetoni jo më larg se 25 km, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me volumet e punimeve. Vlen te theksohet se vet AK, në procedurën për ñ*Për nje shtesë fondi tek objekti "Sistemim blloku tek ish ferma loti I",* ka bërë ndryshime të kritereve, duke hequr kërkesën për fabrikë asfalto betoni. Me këto kërkesa, NJP bëhet pengesë për OE për të marrë pjesë në procedura prokurimi.
Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE ñ**R." SHPK** nuk përmbush pikën **2.1/f** të Kritereve të Veçanta për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 11057/1 prot., datë 20.05.2019 të Drejtorisë së Divizionit Tregtar Tiranë sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 17.05.2019 përfshirë faturën koherente te muajit Prill 2019. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 17.06.2019, nga OE duhej likuiduar fatura e muajit Maj 2019 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
2.OE nuk përmbush pikën **2.3.6 të DST,** në lidhje me kërkesën për 2 teknik ndërtimi. OE ka paraqitur dokumentacion të plotë vetëm për 1 teknik. Për personat e tjerë rezulton se njëri është inxhiniere ndërtimi, dhe jo teknik siç kërkohet në DST, ndërkohë për punonjësin Yllson Beqirllari, nuk disponohet dëshmia e kualifikimit e lëshuar nga ISHTI ose ndonjë institucion tjetër ekuivalent.
3.OE nuk përmbush pikën **2.3.8 të DST,** në lidhje me kërkesën për 5 manovratorë. OE ka paraqitur dokumentacion për 5 manovratorë, ndërkohë rezulton se 3 prej tyre janë të certifikuar si eskavatoristë me goma. Në listën e makinerive nuk kërkohet asnjë eskavator, që të jetë e nevojshme prezenca e ekskavatoristit. Ndërkohë, për punonjësin Alban Abazi, nuk disponohet gjithashtu dëshmia e lëshuar nga ISHTI ose institucion tjetër ekuivalent, sipas kërkesës së bërë nga NJP në DST.
4.OE nuk përmbush pikën **2.3.8 të DST**, në lidhje me kërkesën për kamion vetëshkarkues 3.5 deri 5 Ton. OE ka paraqitur mjetin me targa AA442JK marrë me kontratë qiraje nga S.F Marinela Kapri i cili rezulton me kapacitet mbajtës **0.765 Ton**. Ndërkohë për këtë mjet, është paraqitur polica e sigurimit e cila rezulton jashtë afateve të vlefshmërisë pasi ka skaduar me datë 02.05.2019, ndërkohë që tenderi zhvillohet me datë 17.06.2019.
5.OE nuk përmbush pikën **2.3.1/a të DST**, për punimet e ngjashme. OE ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes me Bashkinë Tiranë me objekt ñAsfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Mushqetaò. Për këtë kontratë, OE nuk ka paraqitur ***Certifikatën e marrjes në dorëzim*** sipas kërkesës së bërë nga NJP në DST.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. P. B., z. N. T. dhe znj. V. Ç.,* si dhe *anëtarët e KVO z. A. Ç., zj. A. A. dhe z. D. K..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **10,953,640 lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë

përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **10,953,640 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

IX- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Rikualifikim urban i lulishtes qendrore pranë Bashkisë Pogradec",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 10</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE fitues nuk përmbush pikën **2.1/f** të Kritereve të Veçanta për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 2433 prot., datë 01.11.2019 të Drejtorisë Rajonale Fier sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 01.11.2019 pa përfshirë faturën koherente te muajit Tetor 2019. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 18.11.2019, nga OE duhej likuiduar fatura e muajit Tetor të vitit 2019 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
2.OE nuk përmbush pikën **2.3.9** të DST, në lidhje me kërkesën për 1 Autobot Uji. Mjeti i paraqitur me targa AA592MN, rezulton nga Certifikata e pronësisë së mjetit, leja e qarkullimit si dhe certifikata e transportit brenda vendit si mjet i tipit kamion dhe jo Autobot Uji. Gjithashtu, nga fotografitë e paraqitura, duket qartë se mjeti është kamion dhe jo autobot uji.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 102/32 prot, datë 21.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *1. Në lidhje me mospërmbushjen e kriterit për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike, sqarohet se në zbatim të nenit 9, pika 1 e kontratës Tip që përdor OSHEE, e miratuar nga ERE me vendimin nr. 109, datë 21.10.2011, citohet se Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike, si dhe kur është rasti kamatëvonesat dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*
2. Në lidhje me mospërmbushjen e pikës 2.3.9 për mjetin autobot, sqarohet se pavarësisht se mjeti nuk është cituar si autobot, përshtatet për atë funksion duke pasur cisternën me ujë. Termi autobot nuk është i përkufizuar nga legjislacioni për transportin. Gjithashtu KVA sqaron se kjo nuk është kërkesë thelbësore për kualifikim sipas nenit 53 pika 4 të LPP.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Pas shqyrtimit të komenteve të subjektit, pranohet observacioni për mjetin autobot duke qenë se mjeti i deklaruar e kryen funksionin e kërkuar, ndërkohë që mangësia e konstatuar për likuidimin e faturave të energjisë elektrike, do konsiderohet shmangie e vogël, e cila në thelb nuk cënon zbatimin e kontratës.

Procedurat e periudhës 01.01.2020 – 31.12.2020

-*Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01/01/2020 ï 31/12/2020, nga Bashkia Pogradec referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **29** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **1,188,059 mijë lekë** dhe vlerë kontrate të lidhur prej **1,054,311 mijë lekë**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **33,748 mijë lekë ose 11.3 %.** Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pogradec *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2020 ï 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Tabela 8/3 Shpenzime të programuara në nivelin e fondeve buxhetore 2020.

Procedura 01/01/2020 - 31/12/2020	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	**29**	**1,188,059,366**	**1,054,311,252**
-Të hapura	9	1,096,634,167	966,982,995
- Kërkesë me propozim	6	20,385,924	18,219,255
- Kërkesë me propozim me lote	10	8,289,276	7,537,172
- Negocim pa shpallje	2	55,666,666	54,558,496
-Shërbim konsulence	1	5,833,333	5,763,334
-Amendament kontrate	1	1,250,000	1,250,000
Sipas objekteve	***23***	**1,188,059,366**	**1,054,311,252**
-Objekte në fushën e investimeve	12	486,368,325	475,836,081
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	13	701,691,041	578,475,171

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **86** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **47** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **5** procedura ose 17 % e procedurave të zhvilluara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditmit nga **29** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 1,054,311 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **10** procedurave me vlerë kontrate 1,020,052 mijë lekë ose 96.7 % e vlerës së kontratave të lidhura.

-Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga KVO janë mbajtur procesverbalet për hapat e zhvillimit të procedurës, veprime në përputhje me nenin 64 pika 5 dhe nenit 68 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

- Nga auditimi i **10** procedurave me vlerë kontratë 1,054,311 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **8** procedura me vlerë kontratë **551,125 mijë lekë ose 52 %**e vlerës së kontratave të audituara, ku në **7** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **4** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Pogradec, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **103,056 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 **"** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin

e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave,** *si më poshtë vijon*:

I- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Ujësjellësi Mokër, Faza I",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 11</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.1 e DST**, e cila kërkon nga OE punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 5,000,000 lekë**, është kërkesë e paargumentuar, minimaliste dhe jo në përputhje me vlerën dhe rëndësinë e objektit të prokurimit. Vlen te theksohet se NJP në shumicën e procedurave kërkesën e mësipërme për punë të ngjashme e ka kërkuar për një vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një investim në vlerën **125,000,000 lekë**, do duhej nga NJP të kërkohej punë e ngjashme në një vlerë më të madhe, njëkohësisht të arsyeshme për të provuar përvojën e ngjashme nga OE.
2.Kërkesa e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon nga OE kategoritë e licencës nuk është në përputhje me vlerën e punimeve. Kërkesa për licencën **NP-7-C** nuk është në përputhje me vlerën kësaj procedure. Në kushtet kur vlera e këtij investimi është 125,000,000 lekë, sipas nivelit të klasifikimit dhe vlerës së përcaktuar do duhej që NJP të përcaktonte kategorinë **NP-7-D**. Kërkesa për kategorinë **NP-9-B** nuk është në përputhje me natyrën e punimeve objekt prokurimi. Kërkesa për kategorinë NS-4-**C** nuk është në përputhje me vlerën e prokurimit. Kategoria **C** është për punime nga 51 deri 100 milion lekë. Nuk ka zë punimesh në këtë vlerë për kategorinë e mësipërme. Kërkesa për kategorinë **NS-18-B** për punime topogjodezike nuk argumentohet nga NJP. Vlen të theksohet se e njëjta NJP në tenderin me objekt ñNdërtim Ujësjellësi Udenisht-Memëlishtò ka kërkuar kategorinë NS-18-D pikërisht për shkak të vlerës mbi 100 milion. Në këto kushte NJP për të njëjtën punim me vlerë mbi 100 milion, duhet të kërkonte kategorinë **NP-18-D.**
3.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST**, e cila kërkon mesatarisht 110 punonjës për periudhën Qershor ï Shtator 2020, është kërkesë e paargumentuar. Ky numër kufizon operatorët pjesëmarrës të cilët mund të kryejnë për të njëjtën periudhë këto punime me numër më të ulët punonjësish.
4.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST**, e cila ndër të tjera kërkon 3 inxhinierë ndërtimi, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizon pjesëmarrjen e OE.
5.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST,** e cila kërkon që 2 inxhinierë të jenë të pajisur me certifikatë për sigurinë dhe shëndetin në punë, 1 inxhinier të jetë i pajisur me certifikatë përgjegjës për dëmet në mjedis, 1 inxhinier të jetë i pajisur me certifikatë për vlerësimin në mjedis dhe 1 inxhinier të jetë i pajisur me certifikatë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, janë kërkesa të ekzagjeruara, të paargumentuara. Vlen të theksohet se në procedurën e prokurimit me objekt ñNdërtim i Ujësjellësit Udenisht ï Memëlishtò prokuruar për vitin 2020 me të njëjtën NJP, nuk janë vendosur asnjë nga këto kërkesa.
6.Kërkesa e pikës **2.3.13 e DST** e cila kërkon nga OE licencë/leje të lëshuar nga QKL me kod III.7.B (Shpues profesionist për ujë) dhe III.1.B (Magazinim i mbetjeve), janë kërkesa kufizuese. NJP duhej të krijonte mundësinë që OE ta mundësonin nëpërmjet një kontrate shërbimi me subjekte që disponojnë këto licenca, dhe jo domosdoshmërish të disponojnë vet këto licenca.

➢ Në lidhje me kriteret është bërë ankesë në AK nga 2 OE të cilat kanë kundërshtuar kriteret duke i konsideruar si të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumet e punës. KSHA e ngritur për trajtimin e tyre, nuk ka pranuar ankesat duke rrëzuar çdo pikë të tyre. Audituesit sqarojnë se kriteret në lidhje me disa prej kategorive të licencave, numrin e punonjësve

të kërkuar etj, qëndrojnë dhe KSHA duhej ti merrte parasysh.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP z. N. T., zj. D. S. dhe z. A. T.,* anëtarët e *KSHA z. N. Ç., zj. V. B. dhe z. K. G..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.1 për punë të ngjashme jo më të vogël se 5,000,000 lekë, sqarohet se kërkesa është në përputhje me pikën 6 të nenit 26 të VKM nr. 914, pasi vlera e kërkuar është më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit.*
2.Në lidhje me kërkesën për katëgorinë e licencave, NJP ka argumentuar se kategoritë janë kërkuar në përputhje me vlerën e preventivit.
3.Në lidhje me kërkesën për 110 punonjës, sqarohet se ky numër është në përputhje me nenin 46 pika 1 germa (b) të LPP, nenit 26 pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe parashikimet e Kodit të Punës për kohëzgjatjen javore të punës, festat zyrtare, lejet vjetore etj.
4.Në lidhje me kërkesën për 3 inxhinier ndërtimi, sqarohet se kërkesa është në përputhje me LPP, pasi duke qenë një objekt i shpërndarë gjeografikisht, është vlerësuar se dy inxhinier do merren me punimet në terren dhe 1 inxhinier të merret me librin e masave.
5.Në lidhje me kërkesën që disa prej inxhinierëve të kërkuar të jenë të pajisur me certifikata për sigurinë dhe shëndetin në punë, certifikatë për dëmet në mjedis, certifikatë për vlerësimin në mjedis, certifikatë për parandalimin dhe mbrojtja nga zjarri, janë kërkesa në përputhje me nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP, ku AK krijon besueshmëri për kualifikimin e personelit kryesor.
6.Në lidhje me kërkesën për leje/licenca me QKL Kodi III.1.B (Magazinim i mbetjeve), dhe III.7.B (Shpues profesionist për ujë), janë kërkesa në përputhje me nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP. Referuar preventivit të punimeve, është parashikuar kryerja e gërmimeve dhe transporti i dheut dhe materialeve të tjera gjatë punimit. Këto licenca si Magazinimi i mbetjeve dhe Shpime për profesioniste për ujë, janë ngushtësisht të lidhura me objektin që prokurohet.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me vlerësimin e ofertave, anëtarët e KVO japin sqarimet si më poshtë:*
1.Në lidhje me mungesën në listë pagesa për 2 muaj për inxhinier ***T. B.****, sqarohet se është konsideruar devijim i vogël, i cili në thelb nuk përbën kriter thelbësor. Gjithashtu, KVO ka vënë*

re se OE ka të punësuar në listëpagesa ing.Brunilda Hasanaj, dhe ka krijuar bindjen se OE ka të punësuar 3 inxhinierët.
2.Në lidhje me disponimin e 5 kamionçinave, sqarohet se mjetet teknologjike AJMT75 dhe AJMT76 kryejnë funksionin e kërkuar, dhe KVO ka krijuar bindjen se mjeti teknologjik i ka kapacitetet e kërkuara në DST.
3.Në lidhje me 2 mjetet autovinxh, sqarohet se mjeti AJMT72 ka të montuar vinxhin dhe kryen funksionin për të cilin kërkohet, ndërsa për mjetin AA382NL, duke qenë mjet me qira, do pajisej nga Bashkia në rast shpallje fitues.
4.Në lidhje me mungesën e 100 jelekë, sqarohet se në SPE janë paraqitur fatura nr. 891 datë 19.06.2017 për 50 jelekë, fatura nr. 10312 datë 25.09.2020 për 10 jelekë dhe fatura nr. 1413 datë 15.07.2020 për 50 jelekë.
*5.Në lidhje me mungesën e dokumentacionit për fabrikën e betonit, sqarohet se në SPE është ngakuar dokumenti Akt-Miratimi i lejes mjedisore Tipi B, ku cilësohet përsoni juridik "**Gj.**" shpk, dhe KVO ka krijuar bindjen e pronësisë së fabrikës.*
*6.Në lidhje me kontratën për furnizim materiale Tubo HDPE dhe PVC, sqarohet se është paraqitur dokumenti Akt Miratimi nga Ministria e Mjedisit, dhe KVO ka kryer verifikime në website zyrtar dhe rezulton se subjekti **"T. I." shpk** është pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.A.*

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Pas shqyrtimit të komenteve të subjektit, arrihet në konkluzion se pretendimet e subjektit qëndrojnë, **dhe merren në konsideratë.**

II- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Ndërtim i Ujësjellësit Udenisht – Memëlisht Pogradec*, u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 12</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST**, sipas së cilës kërkohet mesatarisht punësimi i 165 punonjësve për periudhën Tetor 2019 ï Shkurt 2020, është e paargumentuar. Pavarësisht modifikimit të bërë nga 180 të kërkuar fillimisht, sërish ky numër është i lartë, dhe nuk argumentohet nga NJP.
2.NJP, në pikat **2.3.3, 2.3.4, 2.3.7** të DST, ka kërkuar që stafi të jetë i punësuar për periudhën Tetor 2019 ï Shkurt 2020. Në kushtet kur tenderi zhvillohet në Qershor 2020, nuk argumentohet mos përfshirja e muajve Mars dhe Prill për listëpagesat, çka ngre dyshime për kritere favorizuese.
3.Kërkesa e pikës **2.3.14 e DST**, e cila kërkon nga OE pajisjen me QKL Kodi III.1.A (stacion transferimi), është kërkesë e cila mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në këtë procedurë. NJP duhej të përfshinte në këtë kriter edhe mundësinë që OE të dispononinin kontrata me subjekte që zotërojnë licencën përkatëse.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP zj. D. S.; z. N. T. dhe z. A. T..*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me hartimin e kritereve, anëtarët e NJP japin sqarimet si më poshtë: 1.Në lidhje me kërkesën për 165 punonjës, sqarohet se kërkesa është vendosur në përputhje me nenin 46 pika 1 germa (b) të LPP. Duke marrë parasysh volumin e punimeve, kohëzgjatjen 18 muaj dhe terrenin ku do kryhen punimet, ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin zbatimin e kësaj kontrate.*

2. Në lidhje me kërkesën për periudhën e punësimit Tetor 2019 – Shkurt 2020, sqarohet se ky kriter është kondicionuar nga periudha Covid – 19 dhe karantinimi vendit.

3.Në lidhje me kërkesën për QKL Kodi III.1.A (stacion transferimi), ky kriter është kondicionuar shumë nga fakti se në shtrirjen gjeografike ku do të ndërtohej ky ujësjellës, është zonë bregliqenore dhe është zonë e mbrotjur nga UNESKO.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

III- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin Gurras dhe zona e Dr"I."nit, Pogradec",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 13</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **NP-12 B** (Punime të inxhinierisë së mjedisit), është e paargumentuar. NJP ndërkohë që kërkon që licenca profesionale të përfshijë këtë kategori punimesh, nuk kërkon inxhinier mjedisi pikërisht si zbatues i licencuar për këtë kategori punimesh. Në kushtet kur punimet do kryhen në parkun kombëtar të Drilonit, kërkesa për kategorinë e mësipërme duhej të përfshinte dhe kërkesën për inxhinier mjedisi.

2.Kërkesa e pikës **2.3.8** e DST, e cila kërkon nga OE 5 Automekanistë, 5 Manovratorë dhe 5 shofer, është e paargumentuar. Kjo pikë e DST, ka lidhje të drejtpërdrejt me pikën **2.3.10** të DST në lidhje me mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Sipas kësaj pike janë kërkuar 19 kamionë të ndryshëm, 3 fadroma dhe 3 minifadroma, 8 ekskavator dhe miniekskavator, 3 buldozer, 3 autovinç, 3 autobetoniere dhe 2 autopompa betoni, 3 autobot uji dhe 2 autobot nafte, 5 rrulë, 3 tërheqës dhe rimorkiator. Sa më sipër, rezulton se janë kërkuar 57 mjete të cilat kërkojnë drejtues manovrator/automakinist/shofer.

3.Kërkesat e pikës **2.3.7** e cila kërkon një numër prej 120 punonjësish për periudhën Tetor 2019 ï Mars 2020, është kërkesë e paargumentuar, kufizuese e cila përbën shkak për shumë OE për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Numri 120 punonjësish është relativisht i lartë.

4. Kërkesa e pikës **2.3.10/c** për fabrikë prodhim betoni në pronësi, me qira ose kontratë **porosie**, është e paargumentuar, dhe kufizuese. NJP duhet të merrte në konsideratë se ky shërbim mund të sigurohet edhe nëpërmjet kontratave të **furnizimit** me prodhuesin, dhe jo domosdoshmërish OE ofertues duhet të ketë në pronësi, apo me qira fabrikë prodhimi betoni.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP zj. E. K.; z. N. T. dhe z. A. T.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarja e NJP zj. E. K. është paraqitur observacioni nr. 102/26 prot., datë 18.06.2021, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me kërkesën për kategorinë NP-12B (punime të inxhinierisë së mjedisit), për të cilën nuk është kërkuar inxhinieri i mjedisit, sqarohet se në bazë të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 për dhënien e licencave, për një subjekt juridik është e detyrueshme të jetë e mbuluar nga Drejtues Teknik, inxhinier në fushën përkatëse ku jepet licenca. Pavarësisht faktit që kërkohet apo jo inxhinieri i mjedisit në kriteret e veçanta të kualifimit, në rastin konkret inxhinieri i mjedisit është drejtues teknik në licencën e shoqërisë, pasi në të kundërt në zbatim të VKM ky OE nuk do të merrte këtë kategori.*

2.Në lidhje me mospërputhjen e numrit të manovratorëve të kërkuar me numrin e mjeteve (10 manovratorë/5 shoferë), sqarohet se NJP në bashkëpunim me grupin e projektimit të objektit është munduar të krijojë një balancë të arsyeshme midis faktit se objekti është kompleks, dhe ka të nevojshme sasi të konsiderueshme mjetesh dhe rrjedhimisht edhe manovratorëve. Sa i përket numrit të lartë të mjeteve, marrë parasysh vlerën e preventivit, punimet e parashikuara nga projektuesi, afatin e kryerjes së punimeve si dhe natyrën dhe objektin e kontratës, nga specialisti i fushës është parë e nevojshme të përcaktohet ky numër i lartë makinerish.

3.Në lidhje me kërkesën për 120 punonjës, sqarohet se NJP ka gjykuar se duke qenë një kriter strikt teknik, llogaritja është bërë nga specialisti i fushës, na bashkëpunim me projektuesit e projektit. Gjykimi dhe llogaritja është bërë mbi 2 elementë vlerësues: së pari duke llogaritur forcën punëtore të nevojshme në bazë të llogaritjes së zërave në preventiv, dhe së dyti, forca punëtore është gjykuar për të pasur një kapacitet të caktuar të OE i cili në rastin konkret duhet të kishte kapacitet të lartë për vetë vlerën e preventivit.

4.Në lidhje me kërkesën fabrikën e betonit, për të cilën nuk është kërkuar disponimi me kontratë furnizimi, sqarohet se është kërkuar me kontratë porosie për të mos krijuar detyrime për palët në rast refuzimi të ofertës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

IV- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Sistemim i Odeonit në qendër të qytetit",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 14</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST**, e cila kërkon 5 manovratorë, është kërkesë e ekzagjeruar, e paargumentuar, dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të kërkuara. Kjo kërkesë është kufizuese dhe pengon OE për të paraqitur ofertat e tyre.
2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST**, e cila kërkon nga OE që të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesa *elektricist, hidraulik, murator, etj,* konstatohet që për të provuar aftësinë profesionale të tyre nuk është kërkuar asnjë dokumentacion apo dëshmi kualifikimi. NJP në raste të ngjashme për punë publike, ka kërkuar certifikata trajnimi/kualifikimi apo dëshmi nga institucione të specializuara, ndërkohë në tenderin objekt trajtimi, është mjaftuar me kritere minimaliste.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP z. N. T., zj. D. S. dhe z. Dh. Gj.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kritereve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me kërkesën për 5 manovratorë, sqarohet se është në përputhje me mjetet e kërkuara, 2 ekskavatorë, 2 mjete teknologjike dhe 1 autobot uji.*
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Në lidhje me observacionin e bërë, pretendimet nuk qëndrojnë. Kërkesa për 5 manovratorë nuk është në përputhje me numrin e mjeteve. AK nuk mban të njëjtin qëndrim na hartimin e kritereve, pasi për procedurën me objekt ndërtim i *Ujësjellësit Udenisht – Memëlisht* me vlerë 6 herë më të lartë, në të cilën kërkohen 36 mjete, ka kërkuar në total 5 manovratorë, ndërkohë për 2 mjete ekskavator, 2 mjete teknologjike dhe 1 autobot uji (i cili nuk kërkon manovrator), kërkohen 5 të tillë. Sa më sipër, NJP nuk ka argumentuar numrin e lartë të tyre.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me mos likuidimin e faturës së maturuar të energjisë elektrike për muajin Gusht 2020, sqarohet se OE ka pasur afat për likuidimin e saj deri me 30.09.2020.*
2.Për mjetet teknologjike, OE ka paraqitur mjetet me targa AJMT75 dhe AJMT76 të deklaruara në shtojcën 10. Për këto mjete ka paraqitur certifikatën e transportit të mallrave brenda vendit të lëshuar nga Bashkia Pogradec. KVO thekson se mjeti teknologjik është mjet multifunksional i cili kryen edhe funksionin e kamionçinës.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1. Pas shqyrtimit të komenteve të subjektit, pranohet observacioni për mjetin AJMT75 duke qenë se mjeti i deklaruar e kryen funksionin e kërkuar, ndërkohë që mangësia e konstatuar për likuidimin e faturave të energjisë elektrike, do konsiderohet shmangie e vogël, e cila në thelb nuk cënon zbatimin e kontratës.

V- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Përmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 15</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST**, për 1 inxhinier hidroteknik. Inxhinieri i paraqitur D. O., rezulton e deklaruar drejtuese teknike në tenderin për ñSistemim i odeonit në qendër të qytetitò e cila nuk do angazhohej në kontrata të tjera dhe do jetë gjithë kohën në objekt.
2.OE fitues nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** e cila kërkon staf teknik 16 punonjës, ku ndër të tjera kërkohet edhe punonjës i specializuar në punime në lartësi. OE ka deklaruar punonjësin G. D. s i Bojaxhi dhe Punonjës për punime në lartësi. Në kushtet kur OE ka kërkuar 16 punonjës për zbatimin e kësaj kontrate, punonjësi i mësipërm duhej të mbulojë vetëm njërin pozicion pune.
3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.8 të DST** për 1 Autobot Uji, pasi mjeti me targa AA134UF, rezulton i deklaruar në tenderin për ñSistemim i odeonit në qendër të qytetitò. Në DST përcaktohet se të gjitha mjetet dhe pajisjet do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Në rast angazhimi në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, janë shkak për sõkualifikim.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e KVO: z. D. T.; z. E. P. dhe z. E. B.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **23,456,764 lekë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **23,456,764 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me deklarimin e inxhinierit hidroteknik D. O. sqarohet se OE e përmbush këtë kriter. Sipas kontratës së punës së ngarkuar në SPE rezulton e punësuar me kohë të plotë dhe nuk është e angazhuar në kontrata të tjera.*
2.Në lidhje me mjetin AJMT72, sqarohet se KVO ka krijuar bindjen se ky mjet plotëson kriteret për kamion.

3.Në lidhje me mjetin autobot uji me targa AA134UF, sqarohet se ky mjet është deklaruar me datë 09.09.2020 në tenderin "Sistemim i Odeonit në qendër të qytetit të Pogradecit", ndërsa Banesat në datën 29.09.2020. OE ka bërë deklaratën për këtë mjet pa ditur nëse do shpallej fitues apo jo i ndonjërës procedurë. Nisur nga natyra e punimeve, në dy objekte, nuk shfaqet e nevojshme përdorimi i autobotit në çdo ditë të punës, por puna me këtë mjet mund të bëhet me alternime.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet argumentimi juaj për mjetin me targa AJMT72, duke qenë se mjeti i deklaruar e kryen funksionin e kërkuar, ndërsa pjesa tjetër e observacioneve janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

VI- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Kabashit",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 16:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3** e cila kërkon që *Kandidati ofertues të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt.....**i cili duhet të jetë i paangazhuar në kontrata të tjera..*** është kërkesë e paargumentuar dhe në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **20,823,715 lekë** ose **9,176,285 lekë** më e ulët se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik. Pavarësisht se ky kriter është modifikuar duke hequr pjesën *të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do kryhen punimet*, sërish është kërkuar nga OE të deklarohet mos angazhimi i tij në kontrata të tjera, çka e bën të paplotë modifikimin.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST**, e cila kërkon Nyje prodhimi asfalto betoni të pajisur me leje mjedisore III.1.B **me largësi nga objekti e cila përmbush distancën e qëndrueshmërisë se materialit asfalt sipas VKM,** është kërkesë e paargumentuar dhe e paqartë. Vlen të theksohet se në procedura të tjera të prokuruara nga ky AK, kërkesat për nyje prodhimi asfalto betoni nuk specifikohej me distanca.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon krahas deklaratës për disponimin e mjeteve, edhe dokumentacion që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetet, është e paplotë. NJP në të gjitha procedurat tjera të prokuruara, krahas dokumentacionit të mësipërm, ka kërkuar edhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokument ky i rëndësishëm i cili ndër të tjera specifikon edhe llojin e mjetit, detaj ky i rëndësishëm për të verifikuar përputhshmërinë e mjetit të kërkuar më atë të paraqitur nga OE. Gjithashtu vjen të theksohet mangësia e përsëritur nga NJP në procedura të ndryshme, ku në disa prej tyre kërkon lejen e transportit të lëshuar nga autoriteti vendor, dhe në të tjera nuk e kërkon këtë dokument, përfshirë edhe procedurën objekt auditimi.

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tû kualifikuar dhe konkretisht:
a)OE ñR.ò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 kamion me kapacitet mbajtës 5-10 Ton, pasi njëri nga mjetet konkretisht me targa AJMT72 rezulton nga Certifikata e Pronësisë Mjet Teknologjik dhe jo kamion sipas kërkesës së DST.
b)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për **3 betoniere 500 l.** OE ka paraqitur faturën e TVSH me nr. serianl 41654948, datë 26.02.2009 sipas së cilës ky OE ka blerë ndër të tjera 3 betoniere. Nuk ka asnjë specifikim teknik për katacitetin e tyre, ndërkohë që në DST kërkohet 500 l.
d)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 5740/1 prot., datë 15.07.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 14.07.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Qërshor 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 10.08.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
e)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST**, për autorizim/kontratë bashkëpunimi.....për pajisjet elektrike, për të cilat **duhet të paraqesë katalogjet përkatëse.** Nga shqyrtimi në SPE rezulton se nuk janë paraqitur katalogjet e kërkuara.
f)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 Autobitumatriçe. Mjeti me targa KO6730B rezulton kamion i montuar + bitumatriçe. Gjithashtu në certifikatën e pronësisë së mjetit nuk specifikohet lloji i mjetit.
2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE ñB-Xò, i kualifikuar në këtë procedurë, nuk përmbush gjithashtu kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:
a)Nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 mjete Dumper 4x4 me kapacitet 3.5-5 Ton. Mjetet e paraqitura me targë AA014AH dhe AA523VO me kapacitet mbajtrës 25 dhe 26 Ton, rezultojnë kamionë, dhe njëkohësisht janë tej kapacitetit të kërkuar në DST.
b)Nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 kamionçina ma kapacitet 5-10 Ton. Mjeti me targa AA453SM ka kapacitet mbajtës 1.4 Ton, ndërsa mjeti me targa AA583SI ka kapacitet mbajtës 1.1 Ton. Siç konstatohet asnjëri nga mjetet nuk përmbush kriterin e kërkuar në DST.
c)OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 autovinç me kapacitet jo më të vogël se 8 Ton. Mjeti me targa AA736SM rezulton se ka peshë maksimale të autorizuar bruto dhe neto 25 Ton, po nuk ka kapacitet mbajtës apo transportues mbi 8 Ton siç kërkohet në DST.
d)OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 5861/1 prot., datë 20.07.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 20.07.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Qërshor 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 10.08.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP z. N. T., zj. D. S. dhe z. V. Ç.,* si dhe *anëtarët e KVO z. F. H., z. E. P. dhe zj. V. B.*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **19,591,210 lekë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **19,591,210 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *1. Në lidhje me kërkesën deklarimin e Drejtuesit Teknik i cili të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, sqarohet se ky kriter është kërkuar që Drejtuesi i Projektit të mos jetë i punësuar në subjekte të tjera, pasi ky fakt do ndikonte në mbarëvajtjen e realizimit të kontratës.*
2.Në lidhje me kërkesën për Nyje prodhimi asfalto betoni të pajisur me leje mjedisore III.1.B ***me largësi nga objekti e cila përmbush distancën e qëndrueshmërisë se materialit asfalt sipas VKM,*** *sqarohet se afati i realizimit të kësaj pune është 4 muaj, dhe në grafikun e punimeve shtresa asfalto beton është e përcaktuar në muajin e fundit të realizimit të punimeve. Sipas grafikut, në muajin Dhjetor 2020 do bëhej shtrimi, dhe materiali asfalto beton ka një temperaturë prej 130 – 150 gradë celcius. Duke qenë se ka temperatura të ulta do ndikonin në qëndrueshmërinë e këtij materiali.*
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1*.Në lidhje betonierët me kapacitet 500 kg, sqarohet se kriteret vendosen për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve të OE. KVO kualifikon ofertues të cilët kanë përmbushur kriteret e DST dhe AK i vlerëson të nevojshme. OE ka paraqitur 3 betoniere dhe 1 Autobetoniere duke krijuar bindjen se plotëson kapacitetin e duhur teknik.*
2.Në lidhje ma faturën e maturuar të papaguar të energjisë elektrike, sqarohet se OE ka afat deri në 30 Gusht 2020 për të likuiduar faturën e muajit Korrik.
3.Në lidhje me kërkesën për pajisjet elektrike, për të cilat ***duhet të paraqesë katalogjet përkatëse,*** *ssqarohet se KVO ka kryer verifikime në faqen zyrtare të subjektit kontraktues, dhe ka kontrolluar katalogjet e materialeve dhe pajisjeve që ky prodhues prodhon.*
4.Në lidhje me mjetin autobitumatriçe me targa KO6730B, sqarohet se ky është mjet teknologjik sipas certifikatës së pronësisë, dhe jo kamion. Edhe sipas fotovo dallohet qartë që mjeti është Autobitumatriçe.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:
1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

VII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, në tenderin me objekt: *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Mokrës",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 17:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3** e cila kërkon që *Kandidati ofertues të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt.....**i cili duhet të jetë i paangazhuar në kontrata të tjera..*** është kërkesë e paargumentuar dhe në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **20,823,715 lekë** ose **9,176,285 lekë** më e ulët se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik. Pavarësisht se ky kriter është modifikuar duke hequr pjesën *të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do kryhen punimet*, sërish është kërkuar nga OE të deklarohet mos angazhimi i tij në kontrata të tjera, çka e bën të paplotë modifikimin.
2.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST**, e cila kërkon Nyje prodhimi asfalto betoni të pajisur me leje mjedisore III.1.B **me largësi nga objekti e cila përmbush distancën e qëndrueshmërisë se materialit asfalt sipas VKM,** është kërkesë e paargumentuar dhe e paqartë. Vlen të theksohet se në procedura të tjera të prokuruara nga ky AK, kërkesat për nyje prodhimi asfalto betoni nuk specifikohej me distanca.
3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon krahas deklaratës për disponimin e mjeteve, edhe dokumentacion që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetet, është e paplotë. NJP në të gjitha procedurat tjera të prokuruara, krahas dokumentacionit të mësipërm, ka kërkuar edhe certifikatën e pronësisë së mjetit, dokument ky i rëndësishëm i cili ndër të tjera specifikon edhe llojin e mjetit, detaj ky i rëndësishëm për të verifikuar përputhshmërinë e mjetit të kërkuar më atë të paraqitur nga OE. Gjithashtu vjen të theksohet mangësia e përsëritur nga NJP në procedura të ndryshme, ku në disa prej tyre kërkon lejen e transportit të lëshuar nga autoriteti vendor, dhe në të tjera nuk e kërkon këtë dokument, përfshirë edhe procedurën objekt auditimi.
Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se BOE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:
a)OE ñR.ò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për mjetin Ekskavator. Rezulton se ky mjet është deklaruar në të njëjtën kohë në tenderin me objekt ***"Sistemim asfaltim rrugësh***

blloku i banimit te Rruga e Mokrës"**,** vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO në të njëjtën ditë.
b)BOE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 mjetet Dumper 4x4 me kapacitet 3.5-5 Ton. Të dy mjetet e paraqitura janë deklaruar në të njëjtën kohë në tenderin me objekt ***"Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*****,** vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO në të njëjtën ditë.
c)BOE shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 mjetet kamionçina me kapacitet 5 ï 10 Ton. Mjetet e paraqitura nga OE ñR.ò SHPK me targa AJMT72 rezulton mjet teknologjik dhe jo kamionçinë, ndërsa mjeti me targa AA382 NL rezulton autovinç dhe jo kamionçnë, ndërkohë të dy mjetet rezultojnë të deklaruara në të njëjtën kohë në tenderin me objekt ***"Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*****,** vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO në të njëjtën ditë. Vetëm mjeti i paraqitur nga ñR.S.M- C.ò shpk me targa 01-479-GT plotëson kriterin e vendosur.
d)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 rrul dhe 2 tokmak. Këto mjete rezultojnë të dyja të deklaruara në tenderin me objekt ***"Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*****,** vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO në të njëjtën ditë.
e)BOE shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për **3 betoniere 500 l.** OE ñR.ò SHPK ka paraqitur faturën e TVSH me nr. serianl 41654948, datë 26.02.2009 sipas së cilës ky OE ka blerë ndër të tjera 3 betoniere. Nuk ka asnjë specifikim teknik për katacitetin e tyre, ndërkohë që në DST kërkohet 500 l, ndërkohë që të njëjtat mjete rezultojnë të deklaruara në tenderin me objekt ***"Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*****,** vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO në të njëjtën ditë. OE ñR.S.M- C.ò shpk ka paraqitur faturën e tvsh me nr. serial 44253593 datë 11.01.2017 sipas së cilës rezulton se disponon 1 betoniere 500 l. Sa më sipër nuk provohet se BOE disponon numrin e kërkuar të betonierëve 500 l.
f)OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 5740/1 prot., datë 15.07.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 14.07.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Qërshor 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 10.08.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
g)OE ñRSMò shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 2386 prot., datë 17.07.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 15.07.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Qërshor 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 10.08.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
h)BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për mjetin Autovinç jo më pak se 8 Ton. Mjeti me targa KJ8736A i marrë me kontratë qiraje nga subjekti ñXh.ò shpk, rezulton sipas lejes së qarkullimit me kapacitet mbajtës 7.55 Ton. Sa në sipër mjeti është poshtë kapacitetit të kërkuar në DST.
i)BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 mjete teknologjike 4x4 për transportin e materialeve të gërmuara si dhe për 1 autobitumatriçe. OE ñR.S.M- C.ò shpk ka paraqitur kontratë qiraje me shoqërinë ñMi.ò L.L.C për marrjen e disa mjete me qira, përfshire dhe mjete e mësipërme. Bashkëlidhur mungojnë fotot e mjeteve të kërkuara, në kundërshtim me DST.
2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE ñB-Xò, i kualifikuar në këtë procedurë, nuk përmbush gjithashtu kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:

a)Nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 mjete Dumper 4x4 me kapacitet 3.5-5 Ton. Mjetet e paraqitura me targë AA014AH dhe AA523VO me kapacitet mbajtrës 25 dhe 26 Ton, rezultojnë kamionë, dhe njëkohësisht janë tej kapacitetit të kërkuar në DST.
b)Nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 kamionçina ma kapacitet 5-10 Ton. Mjeti me targa AA453SM ka kapacitet mbajtës 1.4 Ton, ndërsa mjeti me targa AA583SI ka kapacitet mbajtës 1.1 Ton. Siç konstatohet asnjëri nga mjetet nuk përmbush kriterin e kërkuar në DST.
c)OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 autovinç me kapacitet jo më të vogël se 8 Ton. Mjeti me targa AA736SM rezulton se ka peshë maksimale të autorizuar bruto dhe neto 25 Ton, po nuk ka kapacitet mbajtës apo transportues mbi 8 Ton siç kërkohet në DST.
d)OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 5861/1 prot., datë 20.07.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 20.07.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Qershor 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 10.08.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP z. N. T., zj. D. S. dhe z. Dh. Gj.,* si dhe *anëtarët e KVO z. F. H.i, z. E. P. dhe zj. V. B.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **14,326,357 lekë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **14,326,357 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Anëtarët e KVO, sqarojnë se mjetet e deklaruara në kontrata të tjera në zbatim, nuk janë detyrim ligjor për zbatim dhe KVO nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Terminologjia e disponueshmërisë është strikt deklarative e OE dhe ligjërisht ai mund ta vërtetojë çdo moment. KVO e konsideron absurde të pretendohet se një ofertues i cili oferton në 4 prokurime njëherësh të ketë mjete për 4 prokurime. Në këtë rast nuk do të ishin të mjaftueshme të gjitha mjetet për të gjitha ofertat. Ligjvënësi jo pa qëllim nuk e ka vendosur një dispozitë të tillë në legjislacion pasi në këtë rast ka minimalisht 2 faktorë që përligjin deklarimet e mjeteve në më shumë se 1 ofertë:*
-E para deklarimi i disponueshmërisë së mjetit nuk do të thotë që këtë mjet e mban të bllokuar dhe të papërdorshëm për oferta apo prokurime të tjera, pasi e para deklarimi për disponueshmëri nuk do të thotë që në rast të lidhjes së kontratës me këtë ofertues do jenë po këto mjete me të cilat do të punohet në kantier gjatë zbatimit.
-E dyta, është totalisht e përligjur nevoja për mjetet në kontrata të mëparshme, konkretisht nevoja për një asfalto shtruese në një objekt publik nuk është e nevojshme për 16 – 18 muaj të zbatimit të

kontratës. Nevoja për këtë mjet është e shumta 2 – 3 javë. Sipas anëtarëve të KVO, s'kualifikimi i OE sipas pretendimeve të audituesve të KLSH mos mosdisponueshmërinë e mjeteve kur janë të deklaruara në kontrata tjera publike, do të çonte në hapjen e një procesi ankimimi në të cilin OE në çdo rast do të ishte fitues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

XIII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë, për tenderin me objekt: *"Ndërtim Ura Zall i Torrës, Njësia Administrative Proptisht",* u konstatua problematika sipas gjetjes, si vijon:

► **<u>Titulli i gjetjes nr. 18</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3** e cila kërkon që *Kandidati ofertues të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt.....**i cili duhet të jetë i paangazhuar në kontrata të tjera..*** është kërkesë e paargumentuar dhe në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi **30,000,000 lekë**, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **12,417,536 lekë** ose **17,582,464 lekë** më e ulët se vlera e kërkuar për të deklaruar drejtuesin teknik se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** për 5 Ekskavatorë me zinxhirë dhe 2 mjete teknologjike 4x4 për transportin e materialeve të gërmuara, janë kërkesa të paargumentuara. Kërkesa për 5 ekskavatorë me zinxhirë nuk është në përputhje me volumet e punës, dhe mund të përbëjë kufizim për OE, ndërkohë që nuk argumentohet kërkesa për mjet teknologjik 4x4 për transport materialesh.

3.Kërkesa e pikës **2.3.4/iii** për Autorizim përdorimi civil të lëndëve plasëse, është kërkesë e paargumentuar, kufizuese dhe jo në përputhje me zërat në preventiv. Vlen të përmendet gjithashtu fakti se në rast nevoje të kësaj kërkesë, NJP duhej të parashikonte edhe mundësinë që ky shërbim të mundësohej me kontratë shërbimi.

Vlerësimi i kritereve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:

1.OE ñR.ò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 kamion me kapacitet mbajtës mbi Ton. Mjetet me targa AA517NL me Rimorkio ADR405 dhe AA117NT me rimorkio ADR402 rezultojnë të deklaruar në tenderin me objekt ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objektñPërmirësim/Rikonstruksion I banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.

2.OE ñR.ò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 kamionçinë me kapacitet mbajtës 5-10 Ton. Mjeti me targa AA854YA rezulton i deklaruar në tenderin me objekt ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò.
3.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 pompë betoni**.** Pompa e deklaruar me Deklarratë Doganore nr. R 20934 datë 08.12.2005, rezulton e deklaruar në tenderin me objekt ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objektñPërmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.
4.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 Autovinç me kapacitet jo më pak se 8 Ton. Mjeti me targa AA382NL rezulton i deklaruar edhe në tenderin ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objektñPërmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.
5.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për mjet teknologjik 4x4, pasi mjetet e deklaruara AJMT76 dhe AJMT75 rezultojnë të deklaruara në tenderin me objektñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objekt ñPërmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.
6.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/gj të DST** për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.*
-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 8587091-AQ datë 24.09.2020 të OSHEE sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me datë 24.09.2020 përfshirë faturën koherente te muajit Gusht 2020. Në kushtet kur tenderi është zhvilluar me datë 14.10.2020, nga OE duheshin likuiduar fatura e muajit Korrik të vitit 2020 për të plotësuar kriterin e vendosur në DST.
7.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 5 ekskavatorë me zinxhirë, pasi gjitha mjetet e deklaruara rezultojnë në zbatim në tenderin ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objektñPërmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.
8.OE ñR.ò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3.2 të DST** për 5 manovratorë dhe 3 shoferë, pasi të gjithë janë të deklaruar në kontrata tjera që janë në zbatim në të njëjtën kohë si në tenderin për ñSistemim asfaltim rrugësh në bllokun Rruga e Kabashitò, në tenderin me objekt ñPërmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradecò.
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP z. N. T., zj. D. S. dhe zj. E. Xh.,* si dhe *anëtarët e KVO z. P. Z., zj. M. K. dhe zj. V. B.*
Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **11,411,885 lekë lekë** pa TVSH**.**
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **11,411,885 lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *1.Në lidhje me pikën 2.3.3 për stafin kryesor dhe mbështetës, sqarohet se janë bërë ndryshime në DST, sipas të cilave NJP nuk ka kërkuar drejtues teknik të paangazhuar.*
*2.Në lidhje me kërkesën për 5 ekskavatorë dhe 2 mjete 4*4 transportuese, sqarohet se është kërkesë minimaliste, në përputhje me zërat e preventivit. Objekti është ndërtim ure, dhe gërmimi i themeleve të saj është në prezencë të ujit në një terret të fortë shkëmbor.*
3.Në lidhje me kërkesën për Autorizim për përdorim civil lënde plasëse, sqarohet se kjo kërkesë është në përputhje me nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni nr. 355/57 prot., datë 16.06.2021, protokolluar në KLSH me nr. 102/27 datë 18.06.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me mos likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike, sqarohet se OE ka afet deri në fund të muajit Tetor 2020 për kryerjen e likuidimi të faturës së muajit Shtator.*
2.Në lidhje me deklarimin e të njëjta mjeteve në kontrata të tjera që zbatohen në të njëjtën kohë, sqarimet janë të njëjta me ato të trajtuara në procedurën "Sistemim asfaltim rrugës, Blloku banimit rruga e Mokrës"
3.Në lidhje me mjetin me targa autovinxh me targa AA382NL, sqarohet se është sipas kapacitetit të kërkuar mbi 8 Ton.
4.Në lidhje me mos përmbushjen e kriterin për 5 manovratorë dhe 3 shoferë pasi janë të deklaruar në kontrata të tjera, sqarohet se në DST nuk kërkohet një gjë e tillë për deklarimin apo jo të shoferëve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

8.3/4. AUDITIM MBI ZBATIMIN E KUSHTEVE NË REALIZIMIN E PUNIMEVE PUBLIKE, KOLAUDIMI DHE MARRJA NË DORËZIM E PUNËVE TË KRYERA NË KONTRATAT E LIDHURA ME OPERATORËT EKONOMIK FITUES.

Në zbatim të pikës 6.5 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Pogradec, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 2019 -2020 dhe rezulton se janë realizuar **26** investime dhe shërbime publike në vlerën **1,687,262,160.8 lekë me TVSH**, respektivisht:

Për vitin 2019: Janë realizuar 12 investime për punë publike në vlerën **447,434,476.80 lekë me TVSH.**
Për vitin 2020: Janë realizuar 14 investime për punë publike në vlerën **1,239,827,684 lekë me TVSH.**
Nga analiza e bërë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për tâu audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të lartë në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë (Viti 2019; viti 2020):

Viti 2019

Nr.	Objekti i prokurimit	**Oferta fituese**	**Op, Fitues**	**Vl. Kont. me TVSH**	**Dt. Lidhjes kontrates**	**Afati i kontrates**
1	Sistemim blloku tek ish ferma Loti 1	102,714,890	BOE "I. & Sh."	123,257,868.00	28.09.2018	17.06.2019
2	Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim rrugësh blloku **Goricë"**	56,828,914	"R." Shpk	68,194,696.80	20.07.2018	30.04.2019
	Rehabilitim i shkollës së mesme ñMuharrem Çollakuò		"V. N. I.Sò SHPK	92,119,956.00	17.10.2018	17.07.2019
3	Rehabilitim i shkollës së mesme Gjergj Pekmezi	61,921,356	"Sh."Shpk	74,305,627.20	18.07.2019	17.04.2020
4	Rehabilitim/përforcim banesash ekzistuese Komunitetet në nevojë.	19,730,193	"R." Shpk	23,676,231.60	27.11.2019	27.05.2020
5	Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim blloku tek ish ferma Loti I" **Shtese Kontrte**	19,574,639	BOE "I. & Sh."	23,489,566.80	07.08.2019	07.09.2019
6	Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim rrugësh blloku **Goricë". Shtesë Kontrate**	10,953,640	"R." Shpk	13,144,368.00	18.07.2019	17.09.2019
7	Linja e jashtme e Ujësjellësit "Uji i Zi" - Dalja e Tunelit Bishnicë. Njësia Administrative Velcan	9,999,999	OE "S." SHPK	11,999,998.80	13.05.2019	15.07.2019
8	Rikualifikim urban i lulishtes qendrore pranë Bashkisë Pogradec	7,129,037	"B." Shpk	8,554,844.40	11.12.2019	11.03.2020
9	Ujësjellësi Rrodokal - Golik	4,519,044	"K. b." shpk	5,422,852.80	16.04.2019	14.08.2019
10	Mirëmbajtje e sistemit ujitës në bashkinë Pogradec për vitin 2019, me lote	820,122	"K. b." shpk	984,146.40	16.04.2019	14.07.2019
		770,560	"R." shpk	924,672.00	17.06.2019	16.07.2019
		566,520	"AL. D." shpk	679,824.00	17.05.2019	07.07.2019
11	Mirëmbajtje kanali ushqyes Bletas	566,520	"AL.D." shpk	679,824.00	17.05.2019	07.07.2019
	Totali	**296,095,434**		**447,434,476.80**		

Viti **2020**

Nr.	Objekti I prokurimit	Oferta fituese	Op.Fitues	Vl. kont. me TVSH	Dt.Lidhjes kontrates	Përfundimi i punimeve	Afati i kontrates	Realizimi
1	Pastrimi, grumbullimi dhe largimi I mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Nj. Administrative	504,284,660	ñR.ò Shpk	605,141,592	30.07.2020	31.07.2025	5 vite	12%
2	Ndërtimi i ujësjellësit Udënisht-Memëlisht, Pogradec	179,617,618	BOE ñM. & Al. Ko. & B.ò SHPK	215,541,142	14.07.2020	14.01.2022	18 muaj	40-50%
3	Ujësjellësi I Mokrës, Faza 1	122,932,895	ñR.ò Shpk	147,519,474	09.12.2020	09.03.2022	15 muaj	Nuk ka filluar
4	Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin Gurraz dhe zona e DròI.ònit, Pogradec	59,782,894	ñ4. A. M.ò shpk	71,739,473	29.06.2020	30.09.2020	3 muaj	100%
5	Vazhdimi i shërbimit të pastrimit grumbullimit dhe largimi I mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësive administrative për nevojat e fillimit për shkaqe të paparashikuara.	53,068,996	ñR.ò shpk	63,682,795	25.02.2020	25.08.2020	6 muaj	100%
6	Sistemim i Odeonit në Qender të Qytetit	31,578,712	ñR.ò shpk	37,894,454	01.12.2020	01.04.2021	4 muaj	30%
7	Përmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec	23,456,764	ñR.ò Shpk	28,148,117	10.11.2020	12.07.2021	8 muaj	15%
8	Sistemim asfaltim rrugësh blloku I banimit Rruga e **Kabashit**	19,591,210	ñR.ò Shpk	23,509,452	14.09.2020	14.01.2021	4 muaj	100%
9	Sistemim asfaltim rrugësh blloku I banimit te Rruga e Mokrës	14,326,357	ñR.ò Shpk & ñR.S.M. Co.ò SHPK	17,191,628	17.09.2020	18.01.2021	4 muaj	100%
10	Ndërtim Ura Zarr I Torrës, Nj.Administrative Proptisht	11,411,885	ñR.ò shpk	13,694,262	12.11.2020	12.05.2021	6 muaj	40%
11	Rikonstruksion Rruga e Çervenakës. Njësia Administrative Udënisht	5,555,555	ñS.ò SHPK	6,666,666	27.01.2020	26.02.2021	1 muaj	90%
12	Sistemim Blloku nr. 5 "Segmenti Jani Basho"	3,570,256	ñ R.ò shpk	4,284,307	13.07.2020	12.10.2020	3 muaj	100%
13	Pritat e lumenjve	3,292,869	ñXh.ò shpk	3,951,443	08.02.2021	09.03.2021	1 muaj	50%
14	Rikonstruksion i Ures te rruga e Kabashit, Lgj. Nr. 4, Pogradec	719,066	ñR.ò shpk	862,879	24.07.2020	24.08.2020	1 muaj	100%
	Totali	**1,033,189,737**		**1,239,827,684**				

Nga objektet e prokuruara, u konsideruan si objekte me risk dhe u vendos për tû audituar nga grupi i auditimit investimet/shërbimet si vijon:

Për periudhën e auditimit (2019 + 2020), u audituan **11 (njëmbëdhjetë)** kontrata për punë publike, përkatësisht 9 (nëntë) investime për punë publike dhe 2 (dy) kontrata shërbimi në vlerën totale **1,175,777,022.8 lekë me TVSH** ose në **masën 76 %**, respektivisht:

Për vitin 2019: U audituan 6 (gjashtë) kontrata për punë publike në vlerën **394,512,082.80 lekë me TVSH** ose në **masën 88.17 %.**
Për vitin 2020: U audituan 5 (pesë) kontrata nga këto: (3 kontrata për punë publike + 2 kontrata shërbimi) në vlerën **781,264,940 lekë me TVSH** ose në **masën 63.01 %.**
- Nga grupi i auditimit janë audituar 5 dosje teknike të objekteve të poshtëshënuar për vitin 2019, për të cilat nga auditimi në terren i zbatimit të punimeve kanë përfunduar punimet në masën 100 %. Për vitin 2020 u audituan si vijon:
Nga auditimi i dosjeve teknike si dhe auditimit në objekte mbi verifikimin e punimeve të ndërtimit për zërat e punëve të realizuara, në vijim, po paraqesim mangësitë si vijon:

8.4.1. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec", rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 1: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situac. përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 1(3.88 /b)	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji, kategori III, me shkarkim në tokë.	m^3	500	4,354	4,354	3490	863	431,500
Zëri 1(3.88 /b)	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.35 ï 0.4 m^3, në themele gjerësi > 2 m, prani uji, kategori III, me shkarkim në tokë.	m^3	300	5,620	5,620	4601	1019	305,700
	Totali në lekë pa TVSH							**737,200**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2297/7 prot, datë 23.07.2020. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.*
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **737,200 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.
Rëndësia : *E lartë*
Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **737,200** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñ4 A-Mò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3044 prot, datë 29.06.2020 me objekt ñ*Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e

njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

8.4.2. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemim rrugësh blloku Goricë*", rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 2: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 7(2.26 2/3)	Shtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunete t=10cm	m^3	8,173	60	60	-	60	490,380
	Totali në lekë pa TVSH							**490,380**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2297/7 prot, datë 23.07.2020.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **490,380 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.
Rëndësia : *E lartë*
Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot, datë 20.07.2018 me objekt ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

8.4.3. Zbatimi i kontratës për një shtesë fondi në kontratën: "*Sistemim rrugësh blloku Goricë*", rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 3: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 7(2.26	Shtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunete t=10cm	m^3	8000	8.7	8.7	-	8.7	69,600

2/3)								
	Totali në lekë pa TVSH							**69,600**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 5288 prot, datë 18.07.2019.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **69,600 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.
Rëndësia : *E lartë*
Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **69,600** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot, datë 20.07.2018 me objekt për një shtesë fondi në kontratë ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G. S. dhe z. L. H., me detyrë mbikëqyrës të kontratës së sipërmarrjes.

8.4.4. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"*, rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 4: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 11(2-286+persh)	FV pllaka betoni C 25/30, t=8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t=10 cm	m^2	1,800	388.50 m^2 pllaka betoni me t=8cm	388.50 m^2 pllaka betoni me t=8cm	388.50 m^2 pllaka betoni me t=7 cm	388.50 m^2 pllaka betoni me t=1 cm	87,412
Zëri 11(2-286+persh)	FV pllaka betoni C 25/30, t=8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t=10 cm	m^2	1,900	2379.50 m^2 pllaka betoni me t=8cm	2379.50 m^2 pllaka betoni me t=8cm	2379.50 m^2 pllaka betoni me t=7 cm	5192 m2 pllaka betoni me t=1 cm	565,131
	Totali në lekë pa TVSH							**652,543**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 1757/15 prot, datë 14.09.2020. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.M., me detyrë mbikëqyrës të kontratës së sipërmarrjes.*

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **652,543 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.

Rëndësia : *E lartë*

Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot, datë 14.09.2020 të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

8.4.5. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te "Rruga e Mokrës"*, rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► Titulli i gjetjes nr. 5: Ecuri e dobët në realizimin e punimeve të ndërtimit për disa zëra pune
dhe mungesë dokumentacioni për punimet e kryera.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te "Rruga e Mokrës"* Bashkia Pogradec, me vlerë 17,191,628.40 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñR.S.M- C.ò SHPK & ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt vonesa në realizimin e punimeve për zërat ñShtresë stabilizanti t=5cmò, ñFV tub p.v.c shkarkim Ø80mmò , si dhe përsëritje dy herë i zërit ñFV tub p.v.c shkarkim Ø110 mmò dhe ñFV tub fleksibël Ø 40; 60 mm me tel bari në tëò në preventiv e projektit. Gjthashtu u konstatua mungesa të disa dokumenteve tekniko-ligjorë në dosjen teknike të zbatimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1779/12 prot datë 17.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñR.S.M- C.ò SHPK & ñR.ò SHPK, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, pika 4.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 1779/15 prot, datë 17.09.2020. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. M., me detyrë mbikëqyrës të kontratës së sipërmarrjes.*

Impakti: Ndikim negativ në cilësinë e punimeve.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.

Rëndësia : *E lartë*

Rekomandime: Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e projekt ï preventivit nga palët: Sipërmarrësi i punimeve ñR.S.M- C.ò SHP & ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1779/12 prot, datë 17.09.2020 të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te "Rruga e Mokrës"* nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Bashkia Pogradec në cilësinë e AK, për zërat e punimeve: ñShtresë stabilizanti t=5cmò, ñFV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mmò , ñFV tub p.v.c shkarkim Ø110 mmò dhe ñFV tub fleksibël Ø 40;60 mm me tel bari në tëò si zë i përsëritur në preventivin e projektit.
Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve tõ kërkojë sipërmarrësit të punimeve plotësimin e dosjes teknike me dokumentet: (Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit; Ndryshimet në projekt-preventiv dhe miratimin e tyre nga AK; Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; Librezën e masave; Situacionet mujore pjesore dhe progresive; Proces verbalet e miratimit të materialeve; Ditarin e objektit; Pasqyrën e realizimit të punimeve; Procesverbalet e punimeve të maskuara; Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton etj; Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse; Çertifikat e cilësisë së materialeve).

8.4.6. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"*, rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 6: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 3 (2.383)	F.V Dyer druri cilësia I brendshme.	m^2	20,000	103.6	103.6	Nuk është realizuar sipas specifikimeve teknike	-	592,695
Zëri 7 (2.206)	Kastë shkarkimi	Copë	1,000	8	8	-	8	8,000
Zëri 5 (Anal)	F. Instalim pompë qarkulluese me prurje deri në 3 m3/orë, presion deri në 7 mkH2O e kompletuar me ventila 1 ¼ò, hollandeze, lidhjet elektriek etj.	Copë	32,600	1	1	-	1	32,600
	Totali në lekë pa TVSH							**633,295**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 4964/3 prot, datë 18.07.2019. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës të kontratës së sipërmarrjes.*

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **633,295 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.
Rëndësia : *E lartë*
Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **633,295** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñShk. 07ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4964/3 prot, datë 18.07.2019 të kontratës me objekt ñ*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

8.4.7. Zbatimi i kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemim blloku tek ish ferma Lot I*", rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 7: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.**

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 14(An 169)	FV mbjellje peme dekorative Bli Ø 16-18 cm në trotuar	copë	10,196	86	86	10	76	774,896
Zëri 15(3. An 164)	Vijëzim me shirit gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm	ml	253	75	75	-	75	18,975
	Totali në lekë pa TVSH							**793,871**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 7137 prot, datë 28.09.2018. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. R. N., me detyrë mbikëqyrës të kontratës së sipërmarrjes.*
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **793,871 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Pogradec.
Rëndësia : *E lartë*
Rekomandime: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **793,871** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i përkohshëm i shoqërive ñIò SHPK & ñSh.ò SHPK, në

cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7137 prot, datë 28.09.2018 të kontratës me objekt ñ*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditmit, nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "R-95" SHPK është paraqitur observacioni me shkresë pa nr. prot., dhe pa datë (Protokolluar në KLSH me nr. prot. 102/23, datë 10.06.2021), në lidhje me diferencën në volume të pakryera në vlerën 793,871 lekë në objektinñSistemim blloku tek ish Ferma loti 1ò Pogradec.

Pretendimi i subjektit:

1. *Përfundimi se janë vendosur vetëm 10 pemë nuk qëndron. Në trotuar janë vendosursaktësisht 86 pemë, një pjesë e të cilave mund të jetë dëmtuar pas vendosjes por kjo nuk është përgjegjësi e mbikëqyrësit të punimeve për sa kohë në momentin që është dorëzuar objekti sasia ishte 86 copë. për të ilustruar ktë fakt pu ju sjellim materialin fotografik i cili tregon pemët e vendosura në objekt..*

2. *Pretendimi se zëri "Vijëzim me shirit gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm" është realizuar ...por me kalimin e kohës vijat e bardha janë fshirë por kjo ka ndodhur mbas mbarimit të afatit të garancisë së punimeve dhe nuk është përgjegjësi e mbikëqyrësit të punimeve. Difektet e mundshme do të do të riparohen gjatë periudhës së garancisë e cila përfundon në datë 26.06.2020.*

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. *Grupi i auditimit ka bërë verifikimin në terren mbi vendosjen e pemëve në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të Bashkisë Pogradec, dhe rezultouan pemë të mbjellura në objekt 10 copë. Fotografitë e pasqyruara në observacion tregojnë faktin për 10 pemët e vendosura në trotuare me kornizë ashtu siç është parashikuar në Projektin e Zbatimit, por, shumisa e pemëve sipas fotografive në observacion (fotot në vijim) jo vetëm që nuk janë vendosur në trotuar, por janë fotografuar pemë jashtë trotuarit të rrugës dhe madje edhe jashtë kufit të rrugës.*

2. *Lidhur për zërin e punës "Vijëzim me shirit gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm" nga auditimi në fakt konstatohet se:*

- Nuk ka asnjë gjurmë të realizimit të vijave (lehtësisht e dallueshme në objekt).

- Ju shpreheni se, mbas përfundimit të periudhës së Garancisë së Punimeve gjithashtu u kontrollua në vend objekti në prani të të gjithë personave të bashkisë dhe sërish nuk u konstatuan mangësitë e përmendura nga KLSh. Por, si është e mundur që k'te pretendim nuk e vërtetoni me ndonjë fotografi realizimin e këtij zëri pune, siç keni tentuar për rastin e pemëve?? Pra, nuk keni sjellur fakte apo argumente që vërtetojnë të kundërtën e mendimit të grupit të auditimit të KLSH-së. Sa më sipër trajtuar observacioni Juaj nuk merret në konsiderate.

67

63
64

53
51
52

61

49


48

46

43
44

41
40

38
39

36
37

35

31

28

8.4.8. Zbatimi i kontratës për punë publike për një shtesë fondi: "*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I"*, rezultoi si vijon:

- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr. 5662 Prot, datë 07.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec , të përfaqësuar nga Titullari Z. E. K. dhe BOE ñIò SHPK me licencë NZ. 2611/7 dhe NIPT J74304623M me administrator Z. K. B. & ñSh.ò SHPK , me licencë NZ.2611/3 dhe NIPT K07924803N me administrator Z. Y. B.. Vlera e kontratës është 23,355,457 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është parashikuar 60 ditë nga data e e nesërme e nënshkrimit të kontratës, me mbikëqyrësin e punimeve, e cila do të jetë ditë pune. Garacia e punimeve të objektit është 12 muaj.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontratë shërbimi me nr. 6217 prot, datë 06.09.2019 ndërmjet Bashkisë Pogradec përfaqësuar nga Z. I. Xh. dhe shoqërisë ñI. D. - Albò SHPK, me licence nr. MK. 1886/4 për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Z. D.H.. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 300,067.476 lekë me TVSH.
Nga AK nuk u paraqitën kontrata e lidhur me kolaudatorin dhe urdhëri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të objektit.
- *Zbatimi i punimeve të ndërtimit dhe grafikut të punimeve.*
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet për ñ*Për një shtesë fondi "Sistemim blloku tek ish ferma Loti 1"* kanë filluar me datë 16.09.2019 (sipas aktit të dorëzimit të sheshit, akt piketimit në objekt dhe njoftimit për fillim punimesh) dhe kanë përfunduar, brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve të kontratës, me datë 15.11.2019.

8.4.9. Zbatimi i kontratës së shërbimit me objekt: "*Vazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara*", rezultoi me problematikën sipas gjetjes si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 8: Mos plotësim dhe mbajtje dokumentacioni sipas dokumenteve të tenderit; Specifikimet Teknike dhe kushteve të kontratës.**

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për kontratën e shërbimit ñ*Vazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara*ò me vlerë 63,682,795 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i shërbimit ñR.ò SHPK me nr. 767/6 prot, datë 25.02.2020 me afat realizimi 6 muaj, si dhe për kontratën e shërbimit ñ*Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*ò me vlerë 605,141,592 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i shërbimit ñR.ò SHPK me nr. 767/6 prot, datë 25.02.2020, dhe afat të realizimit 5 vjet, u konstatua se:
- Mungojnë *grafikët e shërbimeve sipas preventivave të cilët duhet të zbatohen rigorozisht nga shoqëria e realizimit të shërbimit. Në zbatimi të Specifikimeve Teknik dhe shoqëria e shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të shërbimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.*
- Nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe grafikët e shërbimit për secilën zë punimi/shërbimi dhe nuk janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit duhet të përgatiten nga shoqëria e sipërmarrjes së shërbimeve dhe miratohet çdo vit nga AK.
- Në grafikët e punimeve nuk janë përcaktuar saktë:
Oraret e punimit në secilën rrugë dhe trotuar, etj.
Numri i punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh.

Makineritë që do të punojë në çdo operacion punimesh
- Nuk është paraqitur listë prezenca për çdo ditë pune nga shoqëria e shërbimit të kontratës që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë, minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit.
- Kontrata me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Nj. Administrative," me vlerë 605,141,592 lekë me TVSH, me OE fitues sipërmarrësin e shërbimeve "R," SHPK, u auditua në masën 12 % për periudhën nga fillimi i kontratës deri me datë 14.03.2021, pjesa e mbetur do të auditohet nga KLSH në Auditimin e radhës.
Sa më sipër trajtuar, nga komisioni për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të kontratës së shërbimit publik për kontratat e mësipërme, i përbërë nga: D. T.; O. B. dhe Z. Ç., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në: Dokumentet e Tenderit; Specifikimet Teknike; Urdhri i Kryetarit nr. 139, datë 25.02.2020 për monitorimin e kontratës me nr. 767/6 prot., datë 25.02.2020 ñ*Vazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara*ò Neni 48 ñDetyrat e supervizorit të sipërmarrjeve privateò i Rregullores së brendshme të Bashkisë Pogradec.
Kriteri: Kontrata e shërbimit me nr. 767/6 prot, datë 25.02.2020 ñVazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuaraò; Kontrata e shërbimit me nr. 2295/3 prot, datë 30.07.2020 ñPastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe njësive administrativeò; Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 154, datë 28.02.2020 (protokolluar në Bashkinë Pogradec me nr. 980/1 prot, datë 28.02.2020); Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 599, datë 30.07.2020 (protokolluar në Bashkinë Pogradec me nr. 2295/5 prot, datë 30.07.2020); Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 598, datë 30.07.2020 (protokolluar në Bashkinë Pogradec me nr. 2295/4 prot, datë 30.07.2020).
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pogradec.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të shërbimeve në verifikimin e zbatimit të zërave të preventivit të shërbimit të qytetit Pogradec dhe njësive administrative.
Rëndësia : *E mesme*
Rekomandime: Grupi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të kontratës së shërbimit me objekt ñ*Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*ò, të marrë masa që në vazhdimësi tõ kërkojë sipërmarrësit të shërbimeve ñR,ò SHPK, të plotësojë dokumentet për:

- Hartimin e planeve të punës dhe grafikët e shërbimit për zërat e shërbimeve sipas preventivit dhe të miratohen nga titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec.
- Hartimin e listë prezencës dhe makinerive dhe pajisjeve ditore dhe mujore dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec.
- Shtimin e kontrolleve nga mbikëqyrësit e punimeve për pasqyrimin e saktë të realizimit të zërave të shërbimeve në zbatim të kushteve të kontratës me nr. 2295 prot, datë 30.07.2020 dhe afat të realizimit 5 vjet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. D. T., me detyrë Drejtor i Drejtorisë K.M.T
2. O. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së shërbimit
3. Z. Ç, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së shërbimit

8.4.10. Zbatimi i kontratës së shërbimit me objekt: "*Rehabilitim i shkollës së mesme "Muharrem Çollaku*".

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko – ligjor në dosjen e zbatimit dhe auditimi i realizimit të punimeve të ndërtimit në terren, rezultoi si vijon:

Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin ñRehabilitim i shkollës së mesme ñMuharrem Çollakuò në datën 31.03.2021 në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve Ing. L.H. dhe Ing. G. S., lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezulton se:

1. Në zbatimin e punime të objektit, nuk ka shmangie në formë, dimensione, sipërfaqe e vëllim dhe punimet e ndërtimit janë kryer sipas projektit të rishikuar dhe të miratuar nga projektuesi Bashkia Pogradec.

2. Strukturat bazë /mbajtëse janë realizuar sipas kërkesave dhe materialeve të parashikuara në projekt.

3. Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuara në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec.

4. Pas përfundimit është bërë azhurnimi i tij, dhe nuk u konstatuan defekte pas periudhë së mbarimit të garancisë së punimeve.

5. Nga auditimi i situacioneve pjesore dhe përfundimtar, projekt - preventivit bazë dhe të ndryshuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime të kryera jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, përkundrazi janë kryer më tepër volume pune në vlerën **3,265,200 lekë me TVSH.** Në Dosjen teknike të zbatimit nuk ka shtesë kontrate për volumet e kryera në vlerën 3,265,200 dhe rezulton që për këto punë ndërtimi, nuk është likuiduar sipërmarrësi i punimeve. Në praktikën e rishikimit të projekt ï preventivit vlera e preventivit rezulton 95,385,042 lekë me TVSH dhe ky ndryshim është miratuar nga palët: Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec Z. E. K., Sipërmarrësi i punimeve shoqëria ñV.N. ISò SHPK me drejtues ligjor dhe teknik Z. A. Ç. dhe Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ñG & Lò SHPK me drejtues ligjor dhe teknik Z. L. H.. Nga auditimi në fakt rezulton se janë kryer këto punime.

6. Punime të situacionuara rezultojnë në shumën 92,119,842 lekë me TVSH dhe janë realizuar brenda afatit të miratuar për shtesë afti të përfundimit të punimeve me datë 06.09.2019. Për shtesën e afatit është mbajtur dokumentacioni përkatës i miratuar nga Titullari i AK.

7. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me:

- Kontrata e sipërmarrjes me Nr. 7583 Prot datë 17.10.2018 ñ*Rehabilitim i shkollës së mesme "Muharrem Çollaku"* Pogradec.
- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò, i ndryshuar.
- UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò.

- Kontrata me objekt: ñNdërtimi i ujësjellësit Udënisht-Memëlisht, Pogradecò u auditua vetën dokumentacioni tekniko-ligjor në dosjen teknike të zbatimit. Auditimi i zbatimit të punimeve në terren nuk u realizua sepse mbikëqyrësi i punimeve për arsye objektive i sëmurë me ñCovid 19ò për një kohë të gjatë dhe gjatë periudhës së auditimit nuk u paraqit. Realizimi i punimeve 30 %.

Kontratat (Sipërmarrje, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve).

Për objektin e mësipërm është lidhur kontrata për punë publike me Nr. 1596/8 Prot, datë 14.07.2020 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec, të përfaqësuar nga Titullari Z. I. Xh. dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive ñMò SHPK & ñB.93.IIò SHPK & ñA. K.ò SHPK, me NIPT/NUIS J61812013R me administrator Z. E. B.. Vlera e kontratës është 215,541,141.6 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është parashikuar 18 muaj. Periudha e garancisë së difekteve është përcaktuar 12 muaj nga data e marrjes së përkohshme në dorëzm të punimeve.
Me nr. 1151 rep dhe nr. 357 kol me datë 01.06.2020 është hartuar kontratë (për bashkimin e përkohshëm të shoqërive) përpara S. R. D. notere mes palëve:
- Shoqëria ñMò SHPK me nr. NIPT L26310801C, përfaqësuar nga administratori Z. E.B.
- Shoqëria ñA. K.ò SHPK me nr. NIPT J61812013R përfaqësuar nga administratori Z. A. K..
- Shoqëria ñB93IIò SHPK me nr. NIPT L52209050O, përfaqësuar nga administratori Z. A. L..

Llojet e punimeve në %, që do të kryejë secila palë për sipërmarrjen e përbshkët janë:
- Shoqëria ñMò SHPK do të kryejë 30.40 %
- Shoqëria ñA. K.ò SHPK do të kryejë 51.40 %.
- Shoqëria ñB93IIò SHPK do të kryejë 18.20 %.

Sipas prokurës së posaçme, me datë 01.06.2020 me nr. 1152 rep dhe nr. 358 kol, Shoqëria ñA. K.ò SHPK me nr. NIPT J61812013R përfaqësuar nga administratori Z. A. K..
dhe shoqëria ñB93IIò SHPK me nr. NIPT L52209050O, përfaqësuar nga administratori Z. A. L., emëruar si përfaqësues Shoqërinë ñMò SHPK me nr. NIPT L26310801C, përfaqësuar nga administratori Z. E.B.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontratë shërbimi me nr. 2297/10 prot, datë 29.07.2020 ndërmjet Bashkisë Pogradec përfaqësuar nga Z. I. Xh. dhe shoqërisë ñA. MKò SHPK, me licence nr. MK. 2892/3 për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, dhe NIPT L67619801Q përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Z. E.M.. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 3,072,794.79 lekë me TVSH.
- Për punimet e ndërtimit për objektin **"**Ndërtimi i ujësjellësit Udënisht-Mëmëlisht, Pogradecò nga titullari i Bashkisë Pogradec është lëshuar leje infrastrukturore nr. 2936 prot, datë 23.06.2020 me zhvillues Bashkia Pogradec me afat kohor 18 muaj nga data e fillimit të punimeve. Leja e infrastrukturës është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 27.07.2020 nga Z. I. Xh..

9. AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME.

Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna ne auditimin e mëparshëm, u audituan rekomandimet e dërguara në Bashkinë Pogradec me shkresën nr. 390/60, datë 22.10.2019.
Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
a.*Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar* ***9 masa organizative****, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa organizative, ndërkohë 4 masa organizative nuk janë zbatuar.*
b.*Për* ***shpërblim dëmi*** *janë rekomanduar 3 masa me vlerë* ***562,463 lekë****, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.03.2021, janë arkëtuar* ***56,890 lekë.***
-Janë nisur njoftimet për 2 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet në vlerën **505,573 lekë.**
d*. I janë rekomanduar* Kryetarit të Bashkisë Pogradec tõ kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor ***të vlerësojë shkeljet e konstatuara****, duke vendosur marrjen e* masave administrative (dënim me gjobë) **4 persona, 3 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator.**
Nga verifikimi rezultoi se: Kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë gjobat për 4 personat e konstatuar të cilat janë pajisur me urdhër ekzekutimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Prej tyre deri më datën e verifikimit është arkëtuar 1 gjoba në vlerën 50,000 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar nga 3 persona shuma prej 600,000 lekë.
1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò.
1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Pogradec rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 390/60, datë 22.10.2019, protokolluar në Bashkinë Pogradec me shkresën nr.7372, datë 23.10.2019, ndërsa nga Bashkia Pogradec për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, në kundërshtim me germën (j) të nenit 15 ñTë drejtat dhe detyrat e KLSHò të ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò. (**Pa zbatuar**).
2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Pogradec, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 390/60, datë 22.10.2019, protokolluar në Bashkinë Pogradec me shkresën nr. 7372, datë 23.10.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 ñPër funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). Nga ana e Bashkisë rezulton që nuk është paraqitur Raportimi i 6 mujorit. (***Pa zbatuar***).
3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.
3. Nga verifikimi rezulton se Bashkia Pogradec ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 390/60 prot., datë 22.10.2019, ndërkohë nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), ku duhet të paraqiste ñRelacion për Këshillin Bashkiakò, bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të

jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij. (Pa zbatuar).

► **Titulli i gjetjes nr. 1:** Realizimi i rekomandimeve sipas plan veprimit të hartuar nga subjekti, duke pasqyruar punën e bërë dhe analizuar rekomandimet e realizuara plotwsisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë realizuar.

Situata: B. Masa Organizative: 1.3.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të analizojë situatën e krijuar, duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që sektori i auditimit të jetë efiçent dhe të zbatojë standardet e auditimit në organizimin dhe funksionimin e saj në të gjitha fazat e procesit të auditimit dhe të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit.
Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dosjeve të Njësisë së Auditit të Brendshëm, rezulton se janë zbatuar standardet e auditimit në të gjitha fazat e procesit. Raportet dhe rekomandimet janë paraqitur titullarit të institucionit, por menaxhimi nuk i ka përcjellë pranë Këshillit Bashkiak. (***Në proces zbatimi).***
2.5.1. Rekomandimi: Të merren masa për organizimin e punës në Drejtorinë ekonomike të Bashkisë sektorin financiar dhe Drejtorinë e Tatimeve dhe Taksave Vendore, duke mënjanuar veprimet nëpërmjet arkës me lekë në dorë (cash) jashtë limitit ditor prej 1,000 lekë dhe të kryhen vetëm nëpërmjet bankës sipas kërkesave ligjore në fuqi.
Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoresha e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, me shkresën nr. ekstra, datë 05.03.2021 drejtuar KLSH, ka argumentuar se veprimet me arkë nuk janë limituar deri në shumën 1,000 lekë, për shkak të kërkesës nga qytetarët të cilën nuk kanë mundësi të paguajnë komisionet bankare për vlerë të vogla. Çdo javë, janë bërë derdhjet në bankë të vlerës së arkëtuar pranë Bashkisë Pogradec.(***Pa zbatuar).***
3.6.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financës, DTTV, policia bashkiake dhe IVNMT), të analizojë situatën duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për plotësimin e veprimeve administrative në vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, duke përdorur vula me shënimin ñArkaò ose ñU arkëtuaò, kjo për arsye se mandat arkëtimet me numër serial të trajtohet si letra me vlerë dhe lëvizja dhe administrimi i tyre të bëhet si letra me vlerë, duke plotësuar kontekstin e veprimit dhe qëllimit të përdorimit të këtij dokumenti.
Nga verifikimi rezultoi se: Këshilli i Bashkisë Pogradec, ka miratuar me vendimin nr. 37, datë 05.03.2020 akt marrëveshjen me Ujësjellës Kanalizime Pogradec, për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe gjobave të vendosura, nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm. Pikërisht në lidhje me vjeljen e gjobave të policisë bashkiake nëpërmjet faturës së UK, Prefekti i Qarkut Korçë, në shkresën me nr. 345 prot., datë 02.04.2020, ka kthyer përgjigje mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit, ku konsideron vendimin e këshillit për arkëtimin e gjobave si të pambështetur në ligj. ***(Pa zbatuar).***
4.7.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financës) të marrë masa për plotësimin e veprimeve me anë të bankës me dokumentacionin shoqërues të pagesave, që të plotësojnë kërkesat e ñgjurmës së auditimitò në vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, duke evidentuar përgjegjësitë dhe masat që nevojiten të merren për uljen e riskut abuziv në nivelin më të mundshëm.
Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi i veprimeve me anë të bankës, u konstatua se janë plotësuar kërkesat e ñgjurmës së auditimitò, duke bashkëshoqëruar me dokumentacion justifikues pagesat e kryera nga Drejtoria e Financës. ***(Zbatuar).***

5.8.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të analizojë situatën duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që për të gjitha rastet e zbatimit të kontratave të shërbimeve apo blerje mallra, të vlerësojë veçanërisht respektimin e afatit të caktuar dhe për rastet e konstatuara të kryejë rillogaritjet **dhe të arkëtojë detyrimet e evidentuara** për mos respektim afati (penalitete) të caktuar në kontratë.

Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me respektimin e afatit të caktuar të punimeve të ndërtimit për kontratat për punë publike, rezulton se sipërmarrësit e punimeve kanë zbatuar afatet kohore sipas grafikut të punimeve si në rastet për kontratat bazë, ashtu edhe për shtesat e kontratave me një afat të ri. Në këto kushte nuk janë evidentuar detyrime për likuidim për mos respektim afati.(***Në proces zbatimi).***

6.11.2. Rekomandimi: Nga sektori i Menaxhimit të Aseteve të Bashkisë Pogradec, të merren masat e duhura për pronat e njësive administrative, të cilët me VKM u janë miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim dhe të përgatitet dokumentacioni ligjor sipas kërkesave të VKM nr.500, datë 14.08.2001 i ndryshuar, si dhe (Zyra e kadastrës) të marrë masa për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Pogradec, rezulton se ka vijuar me kërkesat pranë Zyrës Shtetërore të Kadastrës Pogradec me nr. 8604 prot., datë 18.12.219, nr. 1181 prot., datë 05.03.2020, nr. 1925 prot., datë 11.05.2020, nr. 3222 prot., datë 07.07.2020 për regjistrimin e pronave shtetërore të kaluara me VKM, që transferohen në pronësi ose në përdorim. Kërkesa është bërë për 16 pasuri me sipërfaqe 23,441 m^2, e përbërë nga tokë truall, ndërtesa dhe rrugë. Gjithashtu, për 6 mujorin e parë të vitit 2019, është aplikuar për 20 pasuri publike me sipërfaqe 24,605 m^2, nga të cilat 5,090 m^2 ndërtesa. ***(Në proces zbatimi).***

7.12.1 Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa për përfundimin e procesit të depozitimit të dokumentacionit ligjorë, në lidhje me transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-komunat.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Pogradec nuk disponon ambiente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për arkivimin e dosjeve. Në këto kushte deklarohet se vetëm vendimet e ish ï komunave janë arkivuar pranë Bashkisë Pogradec. Dokumentet tjera, administrohen sipas nevojave të palëve të interesuara. ***(Pa zbatuar).***

8.17.1. Rekomandimi: Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës të analizojë të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 të nenit 50 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.

Nga verifikimi rezultoi se: Nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Pogradec, për të analizuar në Këshillin e Bashkisë gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH. ***(Pa zbatuar).***

9.30.1 Rekomandim: Bashkia Pogradec në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa, duke ju kërkuar mbikëqyrësve dhe operatorëve ekonomik të kontraktuar, plotësimin e dosjes me dokumentacionin teknik ligjor të munguar, që vërteton cilësinë e materialeve të vendosura në objekt, në të kundërt ndaj kontraktorit të aplikohen masa penalizuese sipas përcaktimeve ligjore e kontraktuale.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Pogradec, ka miratuar në strukturën organike të saj me vendimin nr. 51, datë 14.02.2020 *Sektorin e monitorimit të kontratave, evidentimit dhe menaxhimit të aseteve*. Objekt i punës së këtij sektori, është pikërisht mbikëqyrja e operatorëve ekonomikë të kontraktuar, plotësimi dhe mbajtja e dosjeve me dokumentacionin tekniko ï ligjor procedurave. ***(Zbatua).***

B/1. Masa Shpërblim Dëmi:

1.1.1. Rekomandim: Bashkia Pogradec të marrë masa të rillogarisë e vlerësojë detyrimin **në vlerën 207,373 lekë si e ardhur e munguar nga moszbatimi i penaliteteve** për mos respektim afati të caktuar në kontratë**,** shkaktuar nga ***subjekti "R." SHPK Pogradec dhe mbikëqyrësit "R-95 SHPK "*** .

Nga auditimi rezultoi se: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec me nr. 29, datë 29.01.2019, urdhërohet marrja e masave për shpërblimin e dëmit sipas rekomandimit të KLSH.

Bashkia Pogradec, ka njoftuar subjektin ñR.ò SHPK me shkresën nr. 4470 prot., datë 05.06.2019 për shpërblimin e dëmit. Nuk është marrë asnjë masë tjetër nga administrata e Bashkisë Pogradec për arkëtimin e shumës. ***(Pa zbatuar).***

2.2.1. Rekomandim: Bashkia Pogradec të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 56,890 lekë dëm ekonomik shkaktuar nga person fizik përfaqësuar nga **Sh.A.**, për përdorim fatura të parregullta tatimore.

Nga auditimi rezultoi se: Është arkëtuar shuma prej 56,890 lekë nga p.f Sh.A., në zbatim të rekomandimit të KLSH, sipas faturës nr. 389, datë 08.11.209 me përfitues dega dega e thesarit Pogradec.(***Zbatuar).***

3.3.1. Rekomandim: Bashkia Pogradec të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit ***në vlerën 298,200 lekë dem ekonomik shka*****ktuar** nga personi fizik Halit Dervishi, Çerravë, evidentuar për mos respektim afati të caktuar në kontratë.

Nga auditimi rezultoi se: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec me nr. 29, datë 29.01.2019, urdhërohet marrja e masave për shpërblimin e dëmit sipas rekomandimit të KLSH.

Bashkia Pogradec, ka njoftuar subjektin **H.D.** me shkresën nr. 4470/2 prot., datë 05.06.2019 për shpërblimin e dëmit. Nuk është marrë asnjë masë tjetër nga administrata e Bashkisë Pogradec për arkëtimin e shumës. ***(Pa zbatuar).***

D.Masa Administrative:

d. Mbi gjobat e rekomanduara Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Juridike, të ndërmarrë gjithë hapat ligjore për arkëtimin e 4 gjobave për vlerën **650,000 lekë ndaj 4 personave si më poshtë:**

1. T.S., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.7, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën **50.000** lekë.

2. E.B., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.10, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën **500.000** lekë.

3. E.N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.8, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën **50.000** lekë.

4. E.M., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Me vendimin e IMTV nr.9, datë 19/06/2019 është gjobitur në shumën **50.000 lekë**.

Nga auditimi rezultoi se: Është zbatuar vendimi nr. 8 i IMTV për mbikëqyrësin Emil Nova, i cili rezulton se ka likuiduar shumën 50,000 lekë, me përfitues dega e thesarit Pogradec.(***Zbatuar***).

Për vendimet e gjobave të IMT me nr. 7, 9 dhe 10, rezulton se janë bërë kërkesa drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për dënimin me gjobë për 3 subjektet e mësipërme, në vlerën 600,000 lekë, nga të cilët 2 mbikëqyrës në vlerën 100,000 lekë, dhe 1 kolaudator në vlerën 500,000 lekë. Sipas vendimeve të gjykatës, rezulton se janë pranuar kërkesat për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për gjobat e mësipërme, duke ngarkuar zyrën përmbarimore për ekzekutimin e këtij vendimi. Pas rikërkimit të bërë nga audituesit e KLSH, vendimet e gjykatës për ekzekutimin e urdhrit i janë dërguar një zyre përmbarimi privat me shkresat nr. 1459, 1460, 1461 prot., datë 31.03.2021.(***Në proces zbatimi***).

Kolaudatori **E.B.**, ka paditur IMT Bashkia Pogradec duke kërkuar pavlefshmërinë e aktit administrativ vendim gjobe në masën 500,000 lekë, dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, ka vendosur pranimin e padisë, dhe konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ .

Vendimi i mësipërm rezulton se është ankimuar nga IMT, Bashkia Pogradec, me shkresën nr. 5090/10 prot., datë 30.12.2019.

Rekomandime: Një kopje e Raportit Përfundimtar të zbatimit të rekomandimeve dhe shkresën e rikërkimit të masave të pazbatuara për Bashkinë Pogradec, t'i dërgohet për dijeni edhe Këshillit Bashkiak Bashkia Pogradec.

Nga auditimi rezultoi se: Raporti përfundimtar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nuk është dërguar për dijeni pranë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec. (***Pa zbatuar***).

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò neni 15, ñ*Të drejtat e KLSH*ò, germa j), **S**hkresa Nr. 390/60, datë 22.10.2019 ñ*Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e kryer në Bashkinë Pogradec*ò.

Shkaku: Neglizhencë e strukturave drejtuese.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekje e procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masën shpwrblim dëmi në vlerwn **505,573 lekë,** dhe mos arkëtim i gjobave të IMT në vlerën **600,000 lekë.**

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 390/60, datë 22.10.2019 ñ*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pogradec*ò, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

10. TË NDRYSHME.

Në zbatim të pikës 8 të programit të Auditimit ñTë ndryshme të dala gjatë auditimitò, u auditua ankesa e shtetasit **M. K.**, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1245 prot., datë 21.12.2020.

A. Ky shtetas, në ankesën e tij drejtuar KLSH, ankohet për abuzimin e fondeve dhe aseteve publike të Ujësjellës-Kanalizime Pogradec, sipas të cilit është përgjegjës ish ï kryetari i Bashkisë z. **E. K.** së bashku më të vëllain **G. K.**. Sipas tij, përmes kushëririt të tij, **V. G.** ish drejtues i ujësjellësit, ky institucion ka pasur shumë afera korruptive. Me ardhjen në krye të bashkisë, ish ï kryetari ka caktuar në krye të ujësjellësit nipin e tij, **M. I.**. Ky i fundit, me pretendimin e nevojës për mjedise të reja për punën e Ujësjellësit, ka lidhur kontrata qiraje me pronat e E. K. dhe G. K. me afat 13 vjeçar, dhe çka e bën edhe më të rëndë, është se këto qira janë dhënë paradhënie për 13 vite.

Audituesit e KLSH-së kërkuan informacion nga Ujësjellës Kanalizime Pogradec në lidhje me objektin e ankesës. Nga ana e audituesve u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1.Kërkesa e datës 28.10.2015 e Drejtorit V. G. drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të UK SHA Pogradec me objekt ñKërkesë për marrjen me qira të ambienteve në fshatin Buçimas me qëllim përdorimin si arkëò. Arsyet e kësaj kërkese janë:

-Rritja e arkëtimit për zonat rurale.

-Lehtësimi i punës për zyrën e shërbimit, duke i ofruar mundësinë klientëve të fshatrave

-Rritjen e cilësisë së shërbimit, duke i ofruar mundësinë klientëve të fshatrave.

Sipas kësaj shkrese, pas verifikimit të kryer në terren, është gjetur ambienti i përshtatshëm në qendër të fshatit Buçimas, shumë pranë zyrave të ish-komunës dhe zyrës së postës. Ambienti është me sipërfaqe 20 m^2.

Bazuar në kërkesën e mësipërme, me vendimin nr. 28, datë 30.10.2015, Këshilli Mbikëqyrës i UK Sha Pogradec ka vendosur miratimin e marrjes me qira të disa ambienteve në zonën e shërbimit Pogradec, me qëllim shfrytëzimin e këtyre ambienteve për shërbime të ndryshme. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i UK SHA për zbatimin e këtij vendimi. Drejtori i Përgjithshëm, z. V. G., me shkresën nr. 139/1 prot., datë 09.11.2015 ka autorizuar punonjësin e UK Sha z. F. T. për firmosjen e kontratave për marrjen me qira që do të lidhë UK Sha.

Me urdhrin nr. 15, datë 20.01.2016 të DP z. **V. G.** ka protokolluar me nr. 51 prot., është ngritur grupi i punës për marrjen me qira të disa ambienteve në zonën e shërbimit Pogradec për shfrytëzimin e tyre për shërbime të ndryshme të ñUKò Sha Pogradec. Komisioni përbëhet nga

1.M. B.; 2.E. M.; 3.A. Ç; 4.O. K; 5.I. V..

1.Me procesverbalin nr. 51/2 prot., datë 21.01.2016 të këtij komisioni, rezultoi se pas verifikimit në terren në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec, i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e ñUKò Sha Pogradec është në lagjen 1, rr. R.Ç. pranë ProCredit Bank. Referuar çmimeve të tregut për marrjen me qira, u vlerësua oferta e dhënë për këtë ambient në vlerën **150,000 lekë.**

ñUKò Sha Pogradec, përfaqësuar nga punonjësi F. T., ka lidhur kontratë qiraje nr. 35 Rep, 28/3 Kol, datë 22.01.2016 me qiradhënësin G. K. për Njësinë e Shërbimit me sipërfaqe **42.5 m^2**, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec me nr. 1/374-N14, ZK 8581. Afati i kontratës është për 12 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me marrëveshje midis palëve. Vlera e qirasë mujore është **150,000 lekë.** Likuidimi i qirasë do bëhet brenda datës 5 të çdo muaji, **ose me marrëveshje të lirë mes palëve, likuidimi mund të bëhet i menjëhershëm për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës ose pjesore**, sipas të ardhurave që do të ketë vetë UK Sha. Në pikën 9.3 të kontratës ñSanksionetò, është përcaktuar se në rast zgjidhjeje të njëanshme të kontratës para afatit të caktuar dhe në mënyrë të paarsyeshme, pala që zgjidh kontratën **detyrohet të paguajë në favor të palës tjetër shumën prej 70,000 Euro.**

ñUKò Sha, ka kryer likuidimin e gjithë shumës objekt qiraje në emër të qiradhënësit nëpërmjet 4 transfertave bankare në shumën **21,600,000 lekë.**

Data e likuidimit	**Përshkrimi**	**Banka**	**Shuma e likuiduar**
15/02/2016	Likuidim pjesor G.K.	S. G.	3,000,000
15/02/2016	G.K. likuidim qiraje	S. G.	7,000,000
03.08.2016	G.K. likuidim qiraje	Cr. B.	10,000,000
16.07.2018	G.K. likuidim total	Cr. B.	1,600,000
Total			**21,600,000**

2. Me procesverbalin nr. 51/3 prot., datë 21.01.2016 të këtij komisioni, rezultoi se pas verifikimit në terren në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec, i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e ñUKò Sha Pogradec është në lagjen 3, rr. R. Ç. (pranë lumit). Referuar çmimeve të tregut për marrjen me qira, u vlerësua oferta e dhënë për këtë ambient në vlerën **150,000 lekë.**

ñUKò Sha Pogradec, përfaqësuar nga punonjësi z. F. T., ka lidhur kontratë qiraje nr. ... Rep, ... Kol, datë 22.01.2016 me qiradhënëse **A. K.** për Njësinë e Shërbimit me sipërfaqe **75.4 m^2**, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec me nr. 7/67-N2, ZK 8582. Afati i kontratës është për 12 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me marrëveshje midis palëve. Vlera e qirasë mujore është **150,000 lekë.** Likuidimi i qirasë do bëhet brenda datës 5 të çdo muaji, **ose me marrëveshje të lirë mes palëve, shuma e cila do jetë e menjëhershme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës ose pjesore**, sipas të ardhurave që do të ketë vetë UK Sha. Në pikën 9.3 të kontratës ñSanksionetò, është përcaktuar se në rast zgjidhjeje të njëanshme të kontratës para afatit të caktuar dhe në mënyrë të paarsyeshme, pala që zgjidh kontratën **detyrohet të paguajë në favor të palës tjetër shumën prej 70,000 Euro.**

Data e likuidimit	Përshkrimi	Banka	Shuma e likuiduar
17/02/2016	A.K. likuidim qira	T. B.	3,060,000
02/01/2018	A.K. likuidim qira	S. G.	10,000,000
15/05/2019	A.K. likuidim qira	T. B.	4,490,000
28/06/2019	A.K. likuidim qira	T. B.	4,050,000
Total			**21,600,000**

3. Me procesverbalin nr. 439/6 prot., datë 18.11.2016 të këtij komisioni, rezultoi se pas verifikimit në terren në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec, i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e ñUKò Sha Pogradec është ai që ndodhet tek kryqëzimi i lumit, Bulevardi R. Ç., lagjja nr. 3. Ambienti ka sipërfaqe **22.2 m^2**. Në këtë procesverbal nuk përcaktohet vlera e qirasë.

ñUKò Sha Pogradec, përfaqësuar nga punonjësi z. F.T., ka lidhur kontratë qiraje nr. .. Rep, ... Kol, datë 17.12.2015 me qiradhënës B. B. për Njësinë e Shërbimit me sipërfaqe **22.2 m^2**, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec me nr. 7/205+1N2, ZK 8582. Afati i kontratës është për 12 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me marrëveshje midis palëve. Vlera e qirasë mujore është **70,000 lekë** Qiramarrësi do të paguajë qiranë për 8 vjet, e cila fillon prej datës 10.12.2015 në vlerën **5,712,000 lekë**. Në pikën 9.3 të kontratës ñSanksionetò, është përcaktuar se në rast zgjidhjeje të njëanshme të kontratës para afatit të caktuar dhe në mënyrë të paarsyeshme, pala që zgjidh kontratën **detyrohet të paguajë në favor të palës tjetër shumën prej 50,000 Euro.**

Data e likuidimit	Përshkrimi	Banka	Shuma e likuiduar
21/12/2015	B.B. likuidim pjesor	S. G.	5,712,000
01/0/2016	B.B. likuidim pjesor	S. G.	400,000
01/07/2016	B.B. likuidim pjesor	S. G.	700,000
07/07/2016	B.B. likuidim pjesor	S. G.	300,000
07/05/2019	B.B. likuidim total	T. B.	1,456,000
Total			**8,586,000**

4. Me procesverbalin nr. 51/5 prot., datë 21.01.2016 të këtij komisioni, rezultoi se pas verifikimit në terren në të gjithë zonën e shërbimit Pogradec, i vetmi ambient i përshtatshëm për nevojat e ñUKò Sha Pogradec është në lagjen 3, rr. R. Ç. (pranë lumit). Referuar çmimeve të tregut për marrjen me qira, u vlerësua oferta e dhënë për këtë ambient në vlerën **120,000 lekë.**
ñUKò Sha Pogradec, përfaqësuar nga punonjësi z. F. T., ka lidhur kontratë qiraje nr. ... Rep, ... Kol, datë 22.01.2016 me qiradhënës z. B. B. për Njësinë e Shërbimit me sipërfaqe **36 m^2**, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec me nr. 7/67-N1, ZK 8582. Afati i kontratës është për 12 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje me marrëveshje midis palëve. Vlera e qirasë mujore është **120,000 lekë.** Likuidimi i qirasë do bëhet brenda datës 5 të çdo muaji, **ose me marrëveshje të lirë mes palëve, shuma e cila do jetë e menjëhershme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës ose pjesore**, sipas të ardhurave që do të ketë vetë ñUKò Sha. Në pikën 9.3 të kontratës ñSanksionetò, është përcaktuar se në rast zgjidhjeje të njëanshme të kontratës para afatit të caktuar dhe në mënyrë të paarsyeshme, pala që zgjidh kontratën **detyrohet të paguajë në favor të palës tjetër shumën prej 70,000 Euro.**

Data e likuidimit	Përshkrimi	Banka	Shuma e likuiduar
22/02/2017	B.B. likuidim qira	S. G.	223,000
22/02/2017	B.B. likuidim qira	S. G.	580,000
22/02/2017	B.B. likuidim qira	T. B.	1,645,000
16/03/2017	B.B. likuidim qira	T. B.	2,448,000
13/10/2017	B.B. likuidim për 6 vjet	S. G.	3,744,000
10/03/2018	B.B. likuidim qira	T. B.	4,000,000
19/10/2018	B.B.likuidim total	T. B.	4,640,000
Total			**17,280,000**

5. ñUKò Sha Pogradec, përfaqësuar nga punonjësi z. F. T., ka lidhur kontratë qiraje nr. ... Rep, ... Kol, datë 22.01.2016 me qiradhënës znj. F. G. për Njësinë e Shërbimit me sipërfaqe **20 m^2**, Ambienti është në proces legalizimi me nr. ... prot., Index .... paraqitur me vetë deklarimin nr. .... prot., datë ..... Afati i kontratës është për një periudhë 2 mujore, me të drejtën e preferencës për të lidhur kontratë qiraje për një periudhë 10 vjeçare. Vlera e qirasë mujore është **50,000 lekë muaj.**

Sa më sipër konstatohet se:

- Kërkesa e datës 28.10.2015 e Drejtorit të Përgjithshëm të UK Sha z. V. G., drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të ñUKò Sha për marrje ambiente me qira, është vetëm për marrje ambienti në fshatin Buçimas.
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës i datës 30.10.2015, ka vendosur marrjen e disa ambienteve me qira në zonën e shërbimit Pogradec. Vendimi i mësipërm, është marrë bazuar në kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të datës 28.10.2015, e cila nuk specifikon kërkesën për disa ambiente. Kërkesa e mësipërme është vetëm për ambient në fshatin Buçimas.
- Me shkresën nr. .... prot., datë ...., Drejtori i Përgjithshëm ka autorizuar punonjësin e ñUKò SHA z. F. T., me detyrë menaxher i burimeve humane, për firmosjen e kontratave për marrjen me qira që do të lidhë ñUKò Sha.
- Me shkresën nr. ... prot., datë .... të Drejtorit të Përgjithshëm, urdhërohet ngritja e komisionit për verifikimin dhe testimin e tregut, komision i cili përbëhet nga M.B.; E.M.; A. Ç.; O.K.; dhe I. V.
- Në lidhje me vlerësimin dhe argumentimin për testimin, rezulton se komisioni ka paraqitur vetëm një dokument të nënshkruar prej tyre sipas të cilit është bërë testimi i tregut nga ku ka rezultuar se ambientet e cituara më sipër plotësojnë kushtet. Nuk ka asnjë gjurmë të këtij testimi, dhe asnjë përllogaritje të vlerës së tregut të qirave në qytetin e Pogradecit. Nuk disponohen procesverbale për ofertat e marra, nëse ka pasur të tilla, si dhe nuk

argumentohet me një analizë nga komisioni vendndodhja e përcaktuar për tu marrë me qira. Mungojnë foto të ambienteve.

- Në lidhje me veprimet e mësipërme, rezulton se të gjitha janë kryer mbi bazë urdhrash me shkrim të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm, apo Këshilli Mbikëqyrës, por nuk specifikohet asnjë kriter vlerësimi për tû ndjekur nga personat përgjegjës për vlerësimin e ofertave si dhe për nënshkrimin e termave të kontratave.
- Nga punonjësi i autorizuar z. F. T., janë lidhur 5 kontrata për marrje me qira ambientesh, dhe në mënyrë të paargumentuar dhe me terma totalisht jo në favor të ñUKò Sha Pogradec, është përcaktuar ndër të tjera mundësia e likuidimit total të vlerës së qirasë me marrëveshje të lirë mes palëve, sipas të ardhurave që do të ketë vetë UK (Neni 4 i kontratës). Gjithashtu, penalitetet e përcaktuara në nenin 9 të kontratës, sipas së cilës zgjidhja e njëanshme e kontratës shoqërohet me penalitete në vlerën 70,000 Euro, përbën tjetër zgjidhje jo në favor të Bashkisë Pogradec. Punonjësi i mësipërm, rezulton se me lidhjen e këtyre kontratave, haptazi ka vendosur në një pozicion të pafavorshëm Drejtorinë e ñUKò SHA Pogradec.
- Në lidhje me likuidimet e plota të bëra në zbatim të kontratave të mësipërme, rezulton se të gjitha likuidimet janë urdhëruar nga ish Drejtorët e Përgjithshëm të shoqërisë ñUKò Sha z. V. G. dhe z. M. I., konkretisht 14 urdhër shpenzime të autorizuara nga z. M. I. me vlerë 51,936,000 lekë dhe 6 urdhër shpenzime të autorizuara nga z. V. G. me vlerë 17,112,000 lekë, me vlerë totale **69,048,000 lekë.**
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit (urdhër shpenzimet), nuk argumentohet parapagesa e kryer nga drejtuesit e mësipërm, cilat janë favoret që ka përfituar ñUKò Sha, nga likuidimi i kryer, mbi çfarë kërkese është investuar veprimi i tyre për të kryer likuidimet e mësipërme, ndërkohë që neni 4.2 i kontratës përcakton likuidimin mujor brenda datës 5 të çdo muaji pasardhës. Praktikisht duke kryer likuidimin e plotë, ñUKò SHA është vendosur në një pozicion jo të favorshëm në raport me qiradhënësit. Veprimet e mësipërme, janë kryer në kundërshtim me nenin 3, pika 19 ñGjurma e auditimitò, si dhe nenin 16 pika 2 ñDetyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimitò të ligjit me nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, pasi nuk janë dokumentuar veprimet e kryera nga ish drejtorët e ñUKò SHA për likuidimet e kryera në favor të qiradhënësve.

-Nga përllogaritja e vlerës së qirasë së paguar për 4 kontratat e mësipërme, rezulton se ñUKò SHA Pogradec, ka kryer pagesa në vlerën 69,048,000 lekë për 4 ambiente sipërfaqe totale e të cilave është 176.1 m^2. Po tû referohemi çmimit mesatar të blerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2015, sipas tabelës nr. 2 të Udhëzimit nr. 4, datë 30.09.2015, rezulton se Bashkia Pogradec ka çmimin mesatar 49,956 lekë për m^2. Po të llogarisim vlerën totale të qirave të likuiduara, me sipërfaqen e marrë me qira, vlera totale e çmimit rezulton 392,095 lekë për m^2, ose gati 8 herë me e lartë se sa çmimi mesatar sipas udhëzimit të EKB.

Sa më sipër, rezulton se "UK" SHA Pogradec, krahas vlerës së lartë dhe të paargumentuar të qirasë, ka kryer likuidimin e plotë të vlerës së saj, vlerë e cila po të investohej për blerje ambientesh do ishte disa herë me e ulët, dhe "UK" SHA Pogradec mund të shtonte asetet e saj. Me veprimet e tyre, ish drejtorët e përgjithshëm z. V. G. dhe z. M. I., kanë kryer shpenzime haptazi në disfavor të institucionit, duke kryer keqpërdorimin e të ardhurave për kontrata me çmime të larta dhe të pafavorshme.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni me nr. 102/29 prot, datw 18.06.2021 si më poshtë:
Observacion nga anëtarët e komisionit për testimin e tregut:

Pretendimi i subjektit: *1.Anëtarët e komisionit sqarojnë se bazuar në urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të UK sha V.G "për ngritje komisioni", jemi urdhëruar për të verifikuar ambientet dhe testimin e tregut. Si anëtarë, pas verifikimeve e kushteve teknike dhe të sigurisë, kemi pyetur për çmimet e qirave në këto zona. Në këtë komision nuk ka juristë për të përcaktuar bazën ligjore dhe kriteret që duhej ndjekur. Pra si anëtarë të komisionit, pas verifikimeve të ambienteve dhe çmimin që kanë ofruar pronarët e këtyre ambienteve, ua kemi vënë në dispozicion titullarëve për ta pranuar apo për ta refuzuar ofertat sipas interesit të "UK" sha. Pra është detyrë e titullarëve që pasi të merrnin mendimin juridik, dhe analizën ekonomike, të vendosnin për konstatimet tona. Aktet e konstatimit nuk janë vendime, dhe ne si anëtarë nuk jemi vendimmarrës pasi ato i marrin titullarët. Gjithashtu me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të "UK" sha nr. 132, datë 21.08.2019 "Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të KLSH-së" ne si anëtarë të komisionit kemi marrë masë disiplinore "Vërejtje" lidhur me këtë çështje.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Nga shqyrtimi i observacioneve, ka rezultuar se situata është trajtuar nga audituesit e KLSH-së në auditimin e ushtruar në ñUKò SHA Pogradec sipas programit të auditimit me nr. 1147/1 prot., datë 18.10.2019, dhe i është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet subjektit të audituar ñUKò SHA Pogradec me shkresën nr. 1147/9 prot., datë 13.09.2019 sipas së cilës janë rekomanduar 2 masa *"për eliminimin e shpenzimeve jo të ligjshme"*, si dhe është kërkuar të merren masa disiplinore për punonjësit e mësipërm. Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve në ñUKò Sha Pogradec, subjektit i është dërguar Raporti Përfundimtar me shkresën nr. 520/58 prot., datë 04.12.2020, nga ku rezulton se në zbatim të rekomandimit të KLSH, janë dhënë masat disiplinore ndaj punonjësve të mësipërm. Në këto kushte, çështja konsiderohet e ezauruar.

B. Mbi auditimin lidhur me ankesën e **z. <u>M. K.</u>** protokolluar në KLSH me nr. 12/5 prot, datë 21.12.2020 me pretendimin se: **"...veprimtaria korruptive dhe antiligjore e ish Kryetarit të Bashkisë Pogradec z. E. K., duke mos kursyer as bregun e liqenit dhe bustin e heroit të popullit R. Ç., busti i të cilit është hequr për t'i hapur vend pallatit të G. K. (sipas ankesës) pasi leja e ndërtimit ka shkelur vijën breg liqenore të gjolit të Pogradecit...".**

Në vijim po pasqyrojmë të gjithë kronologjinë e dhënies së lejeve për objektin ñKompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banimò dhe konkretisht:

I. <u>Vendimi 48, datë 07.11.2009</u> (Këshilli i Rregullimit të Territorit) dalë nga arkiva e DPKZHT për miratimin e lejes së sheshit për objektin ñKompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banimò me investitor shoqërinë ñGò Shpk me administrator z. G. K. në pasurinë e z. E. B. (pronar trualli), me afat deri më datën 09.12.2014, me treguesit zhvillimorë, si vijon: [Sipërfaqe sheshi 474,50 m^2; Sipërfaqe ndërtimi 332 m^2; Koefiçenti i shfrytëzimit 0,70; Lartësia e përgjithshme 41m, 12 kat].

Studim i planit pjesor urbanistik është miratuar me vendim Nr. 46, datë 17.10.2009.

Vendimi 48, datë 07.11.2009 është në përputhje me Ligjin. nr. 8405, datë 17.09.1998 ñPër urbanistikënò, Ligjin Nr.10119, datë 23.04.2009 ñPër planifikimin e territoritò.

<u>Dokumente të aplikimit për leje ndërtimi</u>

[Formati i aplikimit (Kërkesa); - Preventiv punimesh; - Studim Inxhiniero ï Sizmologjik ; - Kontratë shoqërie midis palëve Shoqëria ñGò Sh.p.k dhe z. E. B.u; - Vetëdeklarim për projektin e instalimeve hidro- Sanitare; - Vetëdeklarim për projektin e ngrohjes dhe ventilimit; - Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë Truall me sipërfaqe 475,5 m^2 me pronar E. Ç. B. me këto të dhen: ZK nr. 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13; Fq. 9. (Lëshuar më datë 06.02.2009); - Hartë treguese e regjistrimit ZK 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13, Fq. 9; me pronar E. B.; - Vërtetim noterial të

dokumentacionit origjinal Nr. 1731 REP, datë 14/10/2009; - Licencë arkitekti; - Studim urbanistik pjesor; - Plan vendosje objekti SH 1:500; - Plan piketimi SH 1:200; - Gen plan i azhornuar; - Pamje volumore të objektit; - Projekt impianti i ngrohjes qendrore; - Projekt impianti elektrik; - Projekt impianti hidrosanitar; - Projekt impianti i mbrojtjes nga zjarri; - Armimi i soletës shkalla 0.00; - Harta gjeologjike e zonës Pogradec ï Buçimas; - Vetëdeklarim për projektin gjeologjik; - Kontratë porosie (mbikqyrje); - Licensë ndërtimi; - Licencë mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi ñE.ò; - Certifikatë regjistrimi (E.); - Kontratë Shoqëria ñGò Shpk dhe ñI. Gj.ò; - Studim Gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit; - Vetëdeklarim për projektin gjeologjik; - Grafik punimesh; - licencë Ing. Elektroteknik (zbatim, projektim); - Vetëdeklarim për projektin elektrik; - licencë Ing. Ndërtimi drejtimi strukturist; - licencë Ing. Mekanik teknolog; - licencë shoqëria ñG.ò SHPK (zbatim, projektim), ekstrakt regjistrimi,

- Vërtetim taksash E. B.; - Kartelë e pasurisë së paluajtshme ZK. 8582; Nr. Pas. 1/127, Vol. 13, Fq. 9; me sipërfaqe 474,5m^2 pronar E. B.; - Preventiv punimesh; - Pagesë takse infrastrukturë; - Certifikatë pastërtie; - Lidhja e objektit më infrastrukturën inxhinierike; - Plan Rilevimi; - Licensë shoqëria ñGB-a S.ò SHPK (projektim); - Llogaritjet analitike; - Projekti arkitektonik; - Projekti konstruktiv].

Dokumente që mungojnë në dosjen fizike:

[- Projekti i sistemimit të ujërave të shiut; - Projekti i i vendosjes së kutisë postare; - Foto].

II. Vendim Nr. 99, datë 31.03.2016, ñRishikimi të kushteve të lejes së ndërtimit me objekt ñKompleks banimi dhe shërbimi 1 kat + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banimò, me afat deri më 09.05.2018. Baza ligjore: Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.

Dokumente për aplikim.

[- Formati i aplikimit (Kërkesa); - Urdhër pagese + mandat për aplikim; - Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë Truall me sipërfaqe 475,5 m^2 me pronar E. Ç. B. me këto të dhena: ZK nr. 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13; Fq. 9. (Lëshuar më datë 24.02.2009); - Hartë treguese e regjistrimit ZK 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13, Fq. 9; me pronar E. B.; - Vendimi i KRRT Nr. 48, datë 07.11.2009 + Lejë ndërtimi; - Licencë shoqëria ñGò SHPK (zbatim, projektim); - Licencë projektimi; - Licencë mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi; - Licencë projektimi Ing. Hidroteknik; - Licencë projektimi Ing. Mekanik; - Licencë projektimi Ing. Elektrik.

- Licencë projektimi, zbarimi, Ark;- Licencë projektimi Ing. Ndërtimi; - Proces verbal për llogaritje dëmi ndaj subjektit ñG.ò SHPK; - Vërtetim noterial të dokumentacionit origjinal Nr. 453 Rep datë 10.03.2016.; - Kartelë e pasurisë së paluajtshme ZK. 8582; Nr. Pas. 1/127, Vol. 13, Fq. 9; me sipërfaqe; 474,5m^2 pronar z. E. B..; - Kontratë shoqërie midis palëve Shoqëria ñGò Sh.p.k dhe z. E. B.; - Kontratë mbikëqyrje; - Proces verbal konstatimi për shkelje të kushteve të lejes, vendim gjobe dhe pagesa e gjobës.; - Informacion për zbatimin e punimeve.

- Planvendosje objekti SH 1:500 dhe treguesit e zhvillimit; - Relacion teknik; - Projekti arkitektonik; - Projekti konstruktiv; - Projekt elektrik; - Projekti hidrosanitar; - Plan sistemimi

- Preventiv punimesh; - Grafik punimesh; - Raport mbi shqyrtimin ligjor e teknik për rishikimin e kushteve të lejes; - Kontroll i dokumentacionit teknik dhe ligjor të paraqitur; - Njoftim për plotësim dokumentacioni; - Deklaratë për konflikt interesi; - Vendim Nr. 99 datë 31.03.2016, ñRishikimi të kushteve të lejes së ndërtimit me objekt ñKompleks banimi dhe shërbimi 1 kat + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banimò, miratuar me vendim të KRRT-së së së Bashkisë Pogradec Nr. 48.; - Urdhër pagese për taksë ndikimi në infrastrukturë, planet e detajuara dhe fasadë; - Faturë për arkëtim dhe pagesa; - Leja e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit].

III. Vendim Nr. 228, datë 19.05.2017, leje ndryshim funksioni ñNga objekt banimi në objekt shërbimi hoteleri. (Aplikuar në sistemin e-leje, Nr. 107 Prot, datë 10.04.2017). Ky vendim është

në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.
Dokumente të aplikimit.
[- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë Truall me sipërfaqe 475,5 m^2 me pronar E. Ç. B. me këto të dhen: ZK nr. 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13; Fq. 9. (Lëshuar më datë 24.02.2009);
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme ZK. 8582; Nr. Pas. 1/127, Vol. 13, Fq. 9; me sipërfaqe 474,5m^2 pronar z. E. B..; - Hartë treguese e regjistrimit ZK 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13, Fq. 9; me pronar E. B..;- Akt ï marrëveshje noteriale për ndryshim funksioni midis shoqërisë dhe pronarit të truallit; - Deklaratë për plotësim dokumentacioni datë 18.04.2017; - Preventiv dhe grafik punimesh për punimet e kërkuara; - Akt marrëveshje me pronarin e truallit, që ai është dakort me ndryshimet e kërkuara; - Kopje e lejes së ndërtimit dhe e projektit të miratuar; - Grafik punimesh; - Leja e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit; - Preventiv; - Projekti arkitektonik; - Projekti konstruktiv; - Vendim Nr. 99 datë 31.03.2016, ñRishikimi të kushteve të lejes së ndërtimit me objekt ñKompleks banimi dhe shërbimi 1 kat + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banimò, miratuar me vendim të KRRT ï së së Bashkisë Pogradec Nr. 48; - Projekti arkitektonik me ndryshim; - Relacion; - Deklaratë Arkitekti; - Formular aplikimi ; - Mandat pagese ; - Prokurë e posaçme për aplikim; - Konfirmim dokumentacioni dhe projekti paraqitet në ZVRPP Pogradec datë 20.04.2017; -Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit Nr. 967, datë 12.05.2017; - Ndryshimet e dorëzuara në sistem datë 16.05.2017; - Raport Vlerësimi teknik 18.05.2017].
- Vendim për ndryshim projekti Nr. 228, datë 19/05/2017 dhe leja (shtojca C)
IV. <u>Vendim me Nr. 164, datë 06.07.2018</u>, ka miratuar leje ñZgjatje afati të lejes së ndërtimit për punimet në objektin: ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi 1 kat nën tokë + 1 kat ambjent shërbimi + 12 kate banim" miratuar leja e ndërtimit me vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 99, datë 31.03.2016, me afat kohor deri në datën 09.05.2018.(Aplikuar më datë 07.06.2018 me Nr. 3863 Prot.*
Baza ligjore: Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.
Dokumente të aplikimit.

- Kërkesën e arsyetuar të zhvilluesit për shtyrjen e afatit e cila parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit të lejes së ndërtimit.
- Kalendari i ri i punimeve (grafiku), sipas të cilit kërkohet shtyrja e afatit për një periudhë 2 vjet.
- Akt Kontrolli mbi zbatimin e punimeve për objektin ñKompleks banimi dhe shërbimi 1 kat nën tokë +2 kate ambient shërbimi + 9 kate banimò, nga specialistët e DPKZHT të Bashkisë Pogradec.
- Kontratë shoqërie nr. 451 Rep. nr. 262kol. dt.10.03.2016 ndërmjet ñGò sh.p.k. dhe z. E. B.
- Relacion mbi gjendjen aktuale të punimeve të ndërtimit në objekt dhe foto të gjendjes ekzistuese.
- Dokumentet e pronësisë,
- Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve datë12.06.2018 + Licenca e mbikëqyrësit.
- Licenca e subjektit zbatues dhe dokumentacioni i regjistrimit në QKR.
- Leja e Ndërtimit me vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 99 datë 31.03.2016, zbardhur leja e ndërtimit në datë 09.05.2016, me afat kohor deri në datën 09.05.2018.
- Planin e sheshit të ndërtimit të miratuar
- Projekti i miratuar.
- Grafiku i punimeve

- Preventivi i punimeve.
- Pagesa e gjobës për shkelje të afatit të përfundimit të punimeve

Me shkresën me Nr. 4081 Prot, datë 13.06.2018, është kërkuar plotësim dokumentacioni:

- Relacion argumentues për shtyrjen e lejes,
- Për zhvilluesin, Investitorin - dokumentacionin e regjistrimit në QKR
- Dokumentacioni i pronësisë së truallit
- Leja e sheshit të ndërtimit, plan vendosja e sheshit të ndërtimit të miratuar
- Projekti i miratuar
- Preventivi i plote i objektit të miratuar
- Aktet e kontrollit të punimeve sipas fazave të zbatimit të objektit
- Kontratën me mbikqyrësin e punimeve për periudhën e shtyrjes së afatit të punimeve dhe dokumentet e regjistrimit në QKR
- Foto; gjendja ekzistuese e objektit

Më datë 19.06.2018 është bërë konfirmimi i dokumentacionit dhe projekti është paraqitur për mëndim në institucionet:
ÅDrejtoria ALUIZNIT Korçë ÅInspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes se Territorit ÅOSHEE Korçë Å PMNZSH Pogradec ÅUjësjellës Kanalizime Pogradec ÅZVRPP Pogradec.

-Drejtoria e Aluiznit Korçë ka aprovuar në heshtje
-Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes ka aprovuar në heshtje
-OSHEE Korçë: Në përgjigje të aplikimit me nr protokolli 3863, me zhvillues ñGò SHPK pas verifikimit në vend të truallit objekt ndërtimi konstatojmë se:
Nuk ka intersektime me linjat tona TM, TU. Lejohet ndërtimi në ketë truall.
- PMNZSH ka aprovuar në heshtje
- UK Pogradec: Ndërtimi në fjale nuk pengon rrjetet e ujësjellës kanalizime, është i mundur shërbimi me ujë të pijshëm dhe me kanalizime.
- ZVRPP Pogradec ka aprovuar në heshtje.

- Njoftim për vlerësim pozitiv të projektit dhe pagesë të gjobës datë 06.07.2018.
- Raport vlerësimi teknik (Shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit) datë 11.07.2018.

- Vendim për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit Nr. 164 Prot, datë 06.07.2018 me afat 2 (dy) vjeçar.
- Lejë për zgjatje afati konfirmuar në sistem më 17.07.2018.

V. <u>Vendim me Nr. 176, datë 21.06.2019</u>, <u>ka miratuar Certifikatë Përdorimi</u> për objektin ñKompleks banimi dh shërbimi 1 kat nën tokë + 1 kat ambient shërbimi + 12 kate banimò. (Aplikuar në sistemin e - leje më datë 05.06.2019, Nr. 4472 Prot) në përputhje me: Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.

<u>Dokumente të aplikimit</u>

1. Akt-Kolaudimi tekniko ekonomik, datë 19.10.2018
2. Relacioni i kolaudatorit, të hartuara sipas legjislacionit në fuqi.
3. Deklarata e teknike përputhshmërisë e sipërmarrësit që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me projektin e zbatimit , me normat dhe standartet e sigurisë në fuqi.
4. Relacioni teknik i zbatimit të punimeve i mbikqyrësit të punimeve.
5. Aktet e kontrollit sipas fazave të realizimit të punimeve:

- Proces verbal mbi Akt piketimi në datë 23.07.2013

- Akt kontrolli mbi zbatimin e punimeve për objektin në datën 06.09.2018, nga DPKZHT në datë 12.09.2018.
- Proces verbal mbi përfundimin e karabinasë për gjithë objektin në datën 06.10.2018, dhe Akt kontrolli për aktin e përfundimit të karabinasë nga DPKZHT në datë 12.09.2018.
- Proces verbal mbi përfundimin e fasadës dhe rifiniturës në datën 01.10.2018, dhe Akt kontrolli për aktin e përfundimit të fasades nga DPKZHT në datë 03.10.2018.
- Proces verbal mbi përfundimin e sistemimeve të jashtme të objektit në datën 05.10.2018, dhe Akt kontrolli për aktin e përfundimit të sistemimeve të jashtme nga DPKZHT në datë 05.10.2018.

- Lejat e ndërtimit
- Projektet: [-arkitektonik, -konstruktiv, -elektrik,ngrohje,instalimet H/S]
- Liçenca e subjektit ndërtues
- Kontratat e sipërmarrjes
- Kontrata me mbikqyrësin e punimeve, kolaudatori, liçensat përkatëse
- Dokumentacioni që vërteton pronësinë e truallit ku është ndërtuar objekti
- Lidhjen me infrastrukturën e zonës, formulari 3/1

6. Dokumentacioni tekniko ligjor i zbatimit të punimeve i konfirmuar nga zbatuesi dhe mbikqyrësi që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit të objektit sipas projektit të miratuar dhe kushteve teknike të zbatimit:

- Relacioni teknik i zbatimit të punimeve
- Ditari i objektit
- Libreza e masave
- Proçedurat e kontrollit të punimeve, (proçes-verbalet e punimeve të maskuara të hekurit, betoneve)
- Çertifikatat e materialeve të përdorura në objekt.
- Preventivi
- Grafiku i punimeve
- Situacioni përfundimtar i punimeve

7. Dokumenta që vërtetojnë që subjekti ka shlyer detyrimet (urdhër pagesat, vërtetimet nga arkivi teknik i D.P.K.ZH.T për detyrimet financiare ndaj Bashkisë, pagesa e taksës së infrastrukurës,tarifa etj), vërtetim nga ñUKò SHA , OSHEE, për lidhjen e objektit me infrastrukturën e zonës, vërtetim nga Drejtoria e Taksave, vërtetim nga IMT, vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Çertifikaten e Pastertisë.

Më datë 11.06.2019, me Nr. 4472/1 është bërë kërkesa për plotësim dokumentacioni
Më datë 20.06.2019 është bërë konfirmimi i dokumentacionit :
Dokumentacioni i dorëzuar elektronikisht është i plotë dhe, për pasojë propozohet të vijohet me shqyrtimin në themel të kërkesës për Certifikatë Përdorimi.
Më datë 20.06.2019, me Nr. 4472/2 Prot është bërë kërkesë për plotësim ku duhet të kryhen ndryshimet:
- Në aktin e kolaudimit tek dokumentacioni tekniko ligjor i lejes së ndërtimit të saktësohet emërtimi i objektit përsa i përket lejes nr. 48, dat 07.11.2009.
- Ne relacionin teknik të kolaudatorit, tek leja e sheshit dhe ndërtimit të saktësohet emërtimi i objektit përsa i përket Vendimit të KRRT nr.48, datë 07.11.2009.

- Tek proces verbali për ngritjen e kantierit , të saktësohet emërtimi i objektit sipas lejes së dhënë me nr 48, dt. 07.11.2009 - Tek proces verbali për fillimin e punimeve, të saktësohet emërtimi i objektit sipas lejes së dhenë me nr. 48, dt. 07.11.2009.
- Të firmoset dokumentacioni përkatës edhe nga administratori aktual i subjektit.

Më datë 21.06.2019 me Nr. 4472/4 Prot është bërë njoftimi për pagesën e taksës.
Më datë 21.06.2019 është bërë Raporti tekniko ï ligjor.
Më datë 21.06.2019 me Nr. 4472/3 është marrë vendimi për miratimin e Certifikatës së Përdorimitò.
Më datë 24.06.2019 është konfirmuar Certifikata e përdorimit në sistemin e ï leje.
Gjendja faktike e objektit:



VI. <u>Me vendimin Nr. 233, datë 16.08.2019</u>, është miratuar leje Deklaratë paraprake ñVendosje strukturë e përkohshmeò, me afat 6 muaj. (Aplikuar në sistemin e ï leje më datë 15.08.2019 me Nr. 5846 Prot)
Baza ligjore: Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.
<u>Dokumente të aplikimit.</u>
[- Deklarata e përgjegjësisë profesionale Ing. Ndërtimi; - Deklarata e përgjegjësisë; - profesionale Arkitekt; - Licensa e aplikuesit; - Ekstrakt ñGò Shpk; - Grafik punimesh; - Planvendosje; - Preventiv; - Projekti; - Relacion; - Format Aplikimi; - Foto te objektit; - Mandat pagesa; - Prokure per aplikim; - Kontratë qeraje; - Kontratë sipërmarrje; - Kontratë shoqërie; - Dokumentacion pronësie: Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë Truall me sipërfaqe 475,5 m^2 me pronar E. Ç. B. me këto të dhen: ZK nr. 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13; Fq. 9. (Lëshuar më datë 24.02.2009); Kartelë e pasurisë së paluajtshme ZK. 8582; Nr. Pas. 1/127, Vol. 13, Fq. 9; me sipërfaqe 474,5m^2 pronar z. E. B.; Hartë treguese e regjistrimit ZK 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13, Fq. 9; me pronar z. E. B.].
Më datë 16.08.2019, me Nr. 5846/1 Prot është miratuar ñ Deklarata paraprakeò me Vendimin Nr. 233, datë 16.08.2019 me afat 6 (gjashtë) muaj.

Për sa është trajtuar në Akt Verifikimin Nr. 3, janë paraqitur observacionet me nr. 355/45 prot, datë 09.04.2021 Znj. B. N., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së:....se mungon Akti i Përputhshmërisë (mendimi i institucionit) nga AZHT, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar; nuk përfshihet në asnjë rast përjashtimore në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2014 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", të ndryshuar, observuesi sqaron se: autoriteti i planifikimit të territorit është AKPT e cila i mori këto kompetenca më vonë dhe në përputhje me Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për Përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të terriorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e PPV" jepte konformitetin e zhvillimit të propozuar me rastet përjashtimore, në rrugë elektronike nëpërmjet Regjistrit të Integruar të Territorit dhe më pas bashkitë mund të vijonin me miratimin e kërkesave për leje ndërtimi (pika 5 e Vendimit nr. 1 të KKT).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Në lidhje me rastin përjashtimor në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimn e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar grupi i auditimit merr në konsideratë argumentet e paraqitura në observacion duke bërë reflektimet në projekt raportin e auditimit, por ju sqarojmë se dokumentet bashkëlidhur këtij observacioni nuk i janë vënë në dispozicion për shqyrtim audituesit.

Për sa është trajtuar në Akt Verifikimin Nr. 3, janë paraqitur observacionet me nr. 355/45 prot, datë 09.04.2021(protokolluar në KLSH me nr. prot. 102/8, datë 14.04.2021) nga z. B. M., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së:....se mungon Akti i Përputhshmërisë (mendimi i institucionit) nga AZHT, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar; nuk përfshihet në asnjë rast përjashtimore në kundërshtim në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2014 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", të ndryshuar, observuesi sqaron se: se kërkesa e subjektit dhe vendimi i zbardhur është për rishikimin e kushteve të lejes dhe jo leje nërtimi për objekt të ri.

- .... Rishikimi i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen e ndërtimit, mbi kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi të shoqëruar me relacionin përkatës, të firmosur nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se: Grupi i auditimi pasi shqyrtoi argumentet e paraqitura, merr në konsideratë argumentimin e bërë në observacion duke bërë reflektimin në projekt raportin e auditimit, por ju sqarojmë se dokumentet bashkëlidhur këtij observacioni nuk i janë vënë në dispozicion për shqyrtim audituesit

<u>Mbas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko – ligjor në dosje, grupi i auditimit arrin në këtë konkluzion:</u>

1. Kronologjia e zbatimit të procedurës administrative së dhënies së lejeve për objektin ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi, 1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banim*ò është në përputhje me kuadrin rregullator ligjor të urbanistikës dhe konkretisht:

1.1. Vendimi Nr. 48, datë 07.11.2009 për miratimin e lejes së sheshit për objektin ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banim*ò me afat deri me datë 09.12.2014, është në përputhje me: - Planin pjesor urbanistik të miratuar me Vendim Nr. 46, datë 17.10.2009. - Ligjin. Nr. 8405, datë 17.09.1998 ñ*Për urbanistikën*ò, - Ligjin Nr.10119, datë 23.04.2009 ñ*Për planifikimin e territorit*ò.

1.2. Vendimi Nr. 99, datë 31.03.2016 për ñRishikimin e kushteve të lejes së ndërtimitò me objekt ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banim*ò me afat deri me datë 09.05.2018, është në përputhje me: - Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar; - VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*ò i ndryshuar.

1.3. Vendimi Nr. 228, datë 19.05.2017 për leje ndryshim funksioni ñNga objekt banimi në objekt shërbimi hoteleriò, është në përputhje me: - Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar; - VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*ò i ndryshuar.

1.4. Vendimi Nr. 164, datë 06.07.2018, për miratim leje ñZgjatje afati të lejes së ndërtimit për punimet në objektin: ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi 1 kat nën tokë + 1 kat ambjent shërbimi + 12 kate banim" miratuar leja e ndërtimit me vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 99, datë 31.03.2016, me afat kohor deri në datën 09.05.2018,* është në përputhje me: - Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar; - VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*ò i ndryshuar.

1.5. Vendimi Nr. 176, datë 21.06.2019, për miratimin e Certifikatës së Përdorimit për objektin ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi 1 kat nën tokë + 1 kat ambient shërbimi + 12 kate banim është* në përputhje me: Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar.

1.6. Vendimi Nr. 233, datë 16.08.2019, për miratuar leje Deklaratë paraprake ñ*Vendosje strukturë e përkohshme*ò, me afat 6 muaj, është në përputhje me: -Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñ*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*ò i ndryshuar; - VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*ò i ndryshuar.

2. Objekti ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banim*ò me investitor shoqërinë ñGò Shpk me administrator z. G. K. është zhvilluar në pasurinë e z. E. B. (pronar trualli) **<u>me dokumentacion të rregullt pronësie</u>** me këto të dhëna: - ZK nr. 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13; Fq. 9. (Lëshuar më datë 06.02.2009); - Hartë treguese e regjistrimit ZK 8582; Nr. Pas. 1/127; Vol. 13, Fq. 9:

3. Aplikimet për lejet e mësipërme, janë bërë me dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator ligjor në fuqi dhe **<u>nuk rezulton të jenë lëshuar në mënyrë antiligjore siç pretendon ankuesi z. M. K.</u>**

4. Nga auditimi me kujdes i plan vendosjes së objektit, por edhe nga auditimi në objekt (terren), nuk rezulton se objekti ñ*Kompleks banimi dhe shërbimi,1 kat nën tokë + 2 kat ambient shërbimi + 9 kat banim*ò të jetë ndërtuar në bregun e liqenit dhe nuk rezulton se ka shkelur vijën breg liqenore të gjolit të Pogradecit.

Sa më sipër trajtuar, rezulton se ankesa e z. M. K. me pretendimin se ñ...veprimtaria korruptive dhe antiligjore e ish Kryetarit të Bashkisë Pogradec z. E. K., duke mos kursyer as bregun e liqenit dhe bustin e heroit të popullit Reshit Çollaku, busti i të cilit është hequr për tëi hapur vend pallatit të z. G. K. (sipas ankesës) pasi leja e ndërtimit ka shkelur vijën breg liqenore të gjolit të Pogradecit...ò **<u>nuk qëndron dhe nuk është e argumentuar</u>**.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, rezulton se, sistemi i MFK në Bashkinë Pogradec ka funksionuar por ka ende nevojë për përmirësime me qëllim përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, adresimin e risqeve dhe për të dhënë garanci të mjaftueshme që objektivat e njësisë publike do të arrihen duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë. Më saktësisht:

- GMS nuk është mbledhur rregullisht si dhe nuk ka hartuar asnjë raport periodik mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, progresin e bërë në arritjen e objektivave të Bashkisë Pogradec, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve, etj, mos veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 8, pika 8/b.
- Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve.
- Bashkia Pogradec nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut. Jo të gjitha strukturat e bashkisë, njësitë administrative dhe ndërmarrjet e varësisë, kanë hartuar regjistrat e tyre të riskut për vitin 2019-2020, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 21.
- Dokumentimi i komunikimit ka probleme, pasi komunikimi verbal përdoret masivisht. Komunikimi shkresor brenda institucionit të bashkisë është i pa formalizuar. Komunikimi elektronik gjithashtu ka probleme pasi vetëm 41 % e punonjësve kanë një adresë e-maili zyrtar. Përdoret masivisht komunikimi elektronik me adresat personale të emailit, në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores nr. 1 datë 30.09.2018 ñPër përdorimin e postës elektronike në Administratën Publikeò, Kapitulli 3, pika e.
- Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar Gjurmën e Auditimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 16. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>1.1 Rekomandimi:</u>

a) Titullari i Bashkisë Pogradec në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut të marrë masa për ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut si dhe të hartojë dhe miratojë strategjinë e menaxhimit të riskut me qëllim që të sigurojë përdorimin e fondeve publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet.

b) Titullari i Bashkisë Pogradec të miratojë gjurmën e auditimit të paktën për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

c) Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

d) Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Pogradec të bëjë vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve dhe bazuar në rezultatet të hartojë Planin e Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të nëpunësve rregullisht në trajnimet e ofruara nga ASPA si dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të trajnimeve brenda institucionit.

e) Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të bërë të mundur që të gjithë punonjësit të mund të përdorin postën elektronike të bashkisë për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

Deri më datë 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, rezulton se, sistemi i NjAB në Bashkinë Pogradec për periudhën e audituar 2019 ï 2020 ka funksionuar në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò por ka ende nevojë për përmirësime me qëllim përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, adresimin e risqeve dhe auditimin e sektorëve me rrisk të lartë në veprimtarinë ekonomike dhe financiare në Bashkinë Pogradec, për të dhënë garanci të mjaftueshme që objektivat e njësisë audituese do të arrihen duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë. Nga NjAB janë audituar një numër i vogël Njësish Administrative dhe u konstatua se stafi i kësaj njësie nuk ka zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën audituesve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 25-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>2.1 Rekomandimi</u>: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për forcimin e procesit të auditimit të brendshëm duke planifikuar auditime në sektorë me risk të lartë dhe të rrisë numrin e auditimeve në Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

<u>2.2 Rekomandimi</u>: Titullari i Bashkisë të marrës masa, për trajnim stafit të NjAB dhe bazuar në rezultatet të hartojë Planin e Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të nëpunësve rregullisht në trajnimet e ofruara nga Ministria e Financës (Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) apo ASPA si dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të trajnimeve brenda institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për periudhën 2019 - 2020, *u konstatua se*:

a. Janë kryer ndryshime të vazhdueshme të buxhetit, konkretisht *për vitin 2019* kanë pësuar ndryshime të brendshme parashikimet e fondeve buxhetore për shpenzime në shumen 28,300,000 lekë, duke i diversifikuar nga një zë shpenzimi në një riklasifikim zëri shpenzimi tjetër pa pësuar rritje apo pakësim të shpenzimeve buxhetore në total.

Për vitin 2020, ndryshimet në buxhet kanë ndodhur: Pakësohet shpenzimet për kodin e artikullit 602 në shumën 680,019 lekë. Shtohet kodi i artikullit 1,661,300 në shumën 17,600 lekë dhe kodi 6,511,300 në vlerë 662,419 lekë. Të pakësohet zëri ñProjektimi dhe Restaurimi dhe Rikualifikimin Urban të Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të Pogradecitò kodi 230 në vlere 4,000,000 leke, të shtohet me 3,000,000 lekë diferenca në zbritje 1,000,000 lekë. Pakësohet zëri 602 shpenzime COVID 19 në shumën 7,500,000 lekë, të shtohet i njëjti zë për vlerën 7,500,000 lekë efekti në ndryshim nuk ndryshon. Të shtojë në buxhet zërin llogaria 604 shumën 3,000,000 lekë. Të shtohet zëri Projektime artikulli 230 në Shumen 3,000,000 lekë. Të miratojë shtesën e buxhetit të Bashkisë Pogradec në vlerën 8,526,255 lekë në bazë të shkresës së ministrisë. Të shtohet zëri ñShpenzime për COVID 19ò artikulli 602 në shumën 6,500,000 lekë. Të pakësohet zëri ñSistemimi i bllokut në krah rrugës ñAvdyl Frashëriò me kod 231 në vlerën 2,800,000 lekë. Të shtohet zëri mbikëqyrje rikonstruksion të banesave për familjet e varfëra në

bashkinë Pogradec në shumën 400,000 lekë. Të shtohet zëri ñMbikëqyrje Pritat e Lumenjveò kodi 231 në shumën 150,000 lekë. Të shtohet zëri projektime me kod 230 në shumen 2,000,000 lekë. Të pakësohet zëri ñmirëmbajtje ndërtesash +dezinfektimò kodi 602 në shumën 9,767,100 lekë. Të pakësohet zëri përmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradec, si më poshtë: kodi 231 në shumen 14,000,000 lekë. Të bëhet zëri përmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradec, si më poshtë: kodi 231 në shumen 6,000,000 lekë. Shtohet në zërin e investimeve bashkëfinancimi për vitin 2020 me objekt ñPërmirësim rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëri dhe të pafarorizura në bashkinë Pogradecò, si me poshtë : kodi 231 në shumën 20,000,000 lekë.

Veprimet e mësipërme tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

b. Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, nuk është bërë përcaktimi në vlerë dhe detajimi për çdo program i detyrimeve të papaguara të vitit paraardhës, ku *për vitin 2019* paraqiten në vlerën 316,383,903 lekë dhe *për vitin 2020* paraqiten në vlerën 292,389,248 lekë.

c. Nga auditimi i programimit i PBA për periudhën e auditimit tavani i buxhetit të bashkisë për vitin 2019 është 890,596 mijë lekë dhe planifikimi i buxhetit është 1,059,402 mijë lekë, pra konstatohet që nga bashkia Pogradec nuk është bërë një parashikim i saktë në lidhje me programimin e PBA.

d. Nga auditimi i programimit i PBA për periudhën e auditimit tavani i buxhetit të bashkisë për vitin 2020 është 905,890 mijë lekë dhe planifikimi i buxhetit është 1,007,164 mijë lekë, pra konstatohet që nga bashkia Pogradec nuk është bërë një parashikim i saktë në lidhje me programimin e PBA.

e. Realizimi i buxheteve për periudhën objekt auditimi paraqitet: *për vitin 2019* nga **1,467,129** mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën **1,326,697** mijë lekë ose në masën 90.42 %, *për vitin 2020* nga **1,597,292** mijë lekë të planifikuara janë realizuar **1,612,951** lekë ose në masën **100.5** %. Peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë transferta të buxhetit familjarë dhe individ, të cilat për *vitin 2019* zënë në vlerën 763,305 mijë lekë ose 57.5 % dhe për *vitin 2020* në vlerën 936,895 mijë lekë zënë ose 60 % të shpenzimeve totale *(me shpenzimet e transfertave të ndihmave ekonomike dhe invalid)*.

f. Për vitet 2019 dhe 2020, rezulton se nga bashkia Pogradec nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për çdo zë të tij sipas programeve të hartuara në bazë të funksioneve të kësaj njësie vendore për tû paraqitur në Këshillin e Bashkisë, duke mos evidentuar në çûmasë janë arritur objektivat, shkaqet e mosrealizimeve të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, me qëllim përmirësimin e planifikimit të kërkesave të programit në periudhat e ardhshme si dhe përcaktimin e masave që duhet të merren për përdorimin e fondeve me efektivitet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 32-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>3.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës dhe sidomos për personat që janë larguar nga puna dhe kanë fituar të drejtën e çdëmtimit, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimit financiar për periudhën 2019, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, nuk është realizuar inventarizimi fizik i mallrave dhe aktiveve afat mesëm dhe afatgjatë:

- Nuk është ngritur komisioni i vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtër dhe afatgjata për Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.
- Nuk është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve afatshkurtër dhe afatgjata në Bashki dhe Njësitë Administrative.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò si dhe ligjin 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 81-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që në vazhdimësi në realizojnë në kohë ngritjen e komisioneve për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të papërdorshme, për të krijuar hartimin me saktësi të pasqyrave financiare në fund të vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec nuk ka dërguar informacion periodik në Bashkinë Pogradec lidhur me regjistrimet e reja dhe ndryshimet e gjendjes së pronave, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, neni 24. ASHK, nuk i ka kthyer përgjigje shkresave të DTTV mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës në zbatim të detyrimeve të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 ñPër metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ñndërtesaò neni 2, neni 4,. Si rezultat, metodologjia e përdorur nga DTTV për llogaritjen e taksës së pasurisë ndërtesë nuk është plotësisht e saktë pasi regjistrat e njësive administrative nuk janë të përditësuar duke sjellë që planifikimi i kësaj takse që mos jetë real. Nga ana e DTTV janë bërë verifikime në terren vetëm për Njësitë Administrative Velçan dhe Proptisht për të saktësuar regjistrin e bazës së të dhënave mbi të cilin llogaritet taksa e pasurisë-ndërtesë, ndërsa për njësitë e tjera procesi është ndërprerë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 43-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në mungesë të informacionit periodik nga ASHK mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë saj, të angazhohet në kryerjen e verifikimeve periodike në terren për të përditësuar dhe saktësuar informacion dhe të dhënat mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës. Gjithashtu, DTTV nga ana e saj, të vazhdojë të ndjekë në rrugë institucionale për të marrë informacionin periodik nga ASHK në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 ñPër metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ñNdërtesaò.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të taksës së fjetjes në hotel rezulton se DTTV ka të regjistruar vetëm 30 subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë, nga të cilët 3 janë mbyllur në vitin 2020. Specialistët e DTTV nuk kanë kryer verifikime në terren për të identifikuar dhe më pas regjistruar njësi të tjera akomoduese apo subjekte që japin dhoma me qira. Gjithashtu, nga ana e DTTV nuk janë bërë përpjekje as për të verifikuar nëpërmjet faqeve të internetit për rezervime online të hoteleve si një mënyrë për të kontrolluar nëse ka hotele apo njësi të tjera akomoduese që japin dhoma me qira dhe nuk janë të regjistruara për tõ paguar bashkisë taksën e fjetjes në hotel sipas përcaktimeve të VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 51-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të kryejë verifikime në terren si dhe në faqet e internetit që ofrojnë rezervime për akomodim në territorin e Bashkisë Pogradec, për të identifikuar njësitë akomoduese që ushtrojnë aktivitet të pa regjistruar duke iu shmangur pagesës së taksës së fjetjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec nuk ka të miratuar me VKB sipërfaqen për parkimin e mjeteve me pagesë. Nuk është e qartë si bëhet llogaritja e kësaj takse nga Sektori i Transportit në Bashkinë Pogradec kur nuk janë miratuar sipërfaqet që janë të disponueshme për parkim, pra Bashkia Pogradec nuk ka të dhëna mbi numrin e vend parkime në territorin e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 43-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit (Sektori i Transporteve dhe Supervizimit të Shërbimeve) në bashkëpunim me strukturat e tjera në Bashkinë Pogradec të identifikojnë sipërfaqen që është në dispozicion për parkim me pagesë dhe të nxjerrin aktet e nevojshme për miratimin e kësaj sipërfaqe si të disponueshme për parkim, sipërfaqe kjo që duhet të jetë baza për llogaritjen e taksës së parkimit.

Deri më datë 31.12. 2021

8. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake Pogradec për vitet 2019-2020 ka vendosur 186 gjoba me vlerë 338,500 lekë. Nga auditimi rezulton se, struktura e Policisë Bashkiake nuk ka dërguar pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrimin kontabël të gjobave si dhe nuk ka bërë akordimin në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1[87], pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 43-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve që nuk kanë paguar gjobat e vendosura. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të kryejë kontabilizimin në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake për individët që nuk i paguajnë ato dhe kanë kontratë me UK Pogradec bëhet nëpërmjet faturës së Ujësjellësit bazuar në

[87] ..... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për tõu paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

Vendimin nr. 37 datë 05.03.2020 ñPër disa ndryshime në Akt-Marrëveshjen nr. 18, datë 31.01.2012, ñPër vendosjen e taksave dhe tarifave vendore tek Ndërmarrja e ñUKò Sh. A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga Bashkia Pogradec, rezulton se Vendimi nr. 37, datë 05.03.2020 për vjeljen e gjobave të Policisë Bashkiake nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm nga Prefekti i Qarkut Korçë është klasifikuar si i pa bazuar në legjislacion. Fatura e ujit të pijshëm përbën titull ekzekutiv[88], ndërsa vendosja dhe vjelja e kundërvajtjeve administrative të bashkisë ndaj të tretëve bazohet në akte të tjera ligjore dhe parashikon afate ankimi administrativ apo dhe ankimim në gjykatë.[89] *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 44-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake në bashkëpunim dhe në konsultim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve të identifikojnë dhe zbatojnë mekanizma ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake bazuar në faktin që vjelja e tyre në faturën e ujit të pijshëm është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Deri më datë 31.12.2021

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresën nr. 08 prot., datë 14.01.2020 ñPër subjektet debitorë për taksat dhe tarifat vendore 2019ò, ka dërguar në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar listën e debitorëve për vitin 2019. Rezulton se, nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar nuk janë marrë masa për të bërë regjistrimin e debitorëve në librat e kontabilitetit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 45-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar bazuar në informacionin periodik vjetor të dërguar nga DTTV si dhe konform përcaktimeve të VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3, të regjistrojë në kontabilitet detyrimet e subjekteve debitorë ndaj bashkisë për taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave pjesë e DTTV paraqet probleme në menaxhimin e dokumentacionit të debitorëve. Përkatësisht, kjo njësi nuk disponon listat e debitorëve progresiv të konsoliduar për periudhën objekt auditimi. Grupit të auditimit iu vunë në dispozicion listat e debitorëve nga Sektori i Vlerësimit dhe Regjistrimit në DTTV, i cili gjithashtu nuk dispononte një listë të konsoliduar të debitorëve progresiv por lista specifike të grupuara sipas njësive administrative, sipas llojeve të bizneseve, sipas mënyrës së pagesës (në faturën e ujit të pijshëm ose jo). Mos hartimi i një liste përmbledhëse për të gjithë debitorët progresiv bëhet shkas për pasaktësi në llogaritjen e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 45-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave të hartojë rregullisht dhe me saktësi listat e debitorëve progresiv si për subjektet fizik/juridik ashtu edhe për familjet debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

[88] Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 ñPër trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutivò, i ndryshuar.
[89] Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 7 dhe neni 9.

12. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019, DTTV ka lidhur 13 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitorë në likuidimin e detyrimeve me këste. Nga auditimi rezulton se, vetëm 4 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa 9 subjekte të tjera nuk i kanë zbatuar. Për vitin 2020, nga 17 akt marrëveshje që DTTV ka lidhur për likuidimin e detyrimeve me këste, 3 subjekte i kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë, 7 subjekte kanë paguar rregullisht detyrimet në zbatim të kushteve të akt marrëveshjes, ndërsa 7 subjekte nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes.
Nga auditimi u konstatuan mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, përkatësisht;
- Në asnjë rast nuk kemi kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste;
- Dy marrëveshje (me subjektet ñH.E.ò SHPK dhe ñP.E.ò SHPK) janë të pa firmosura nga ana e tatimpaguesit;
- Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste;
- Në lidhjen e 3 akt marrëveshjeve nuk janë respektuar kërkesat ligjore për kohëzgjatjen e tyre (akt marrëveshja nr. 275 Prot, datë 18.09.2019, lidhur 3 muaj më shumë se afati i lejuar, akt marrëveshja nr. 176 Prot, datë 07.08.2020, lidhur për 14 muaj më shumë se afati i lejuar dhe akt marrëveshja nr. 278 Prot, datë 11.12.2020, lidhur për 5 muaj më shumë se afati i lejuar).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 45-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>12.1 Rekomandimi</u>: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të zbatojë plotësisht kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 2,3,4,5 si dhe ti referohet Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 77.4 gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë si dhe të monitorojë me shumë përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec nuk ka një sistem për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore, si dhe nuk kryen regjistrim manual të dhënave, pra nuk ka regjistra fizik. Informacioni që administron DTTV menaxhohet në programin Excel në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Menaxhimi i taksave dhe tarifave nëpërmjet një sistemi të mirëfilltë do të zvogëlonte apo eliminonte pasaktësitë. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 43-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>13.1 Rekomandimi:</u> Bashkia Pogradec të përfshijë në objektivat e saj krijimin e një sistemi me qëllim menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë sa më efektive dhe të saktë. Menaxhimi i taksave dhe tarifave vendore me anë të sistemit do të përmirësonte performancën e specialistëve të DTTV, do të ndikonte në uljen e gabimeve, mbrojtjen nga humbja e të dhënave si dhe në rritjen e të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

Deri më datë 31.12.2021

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te "Rruga e Mokrës"* Bashkia Pogradec, me vlerë 17,191,628.40 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñR.S.M. C.ò SHPK & ñR.ò SHPK, u konstatuan vonesa në realizimin e punimeve për zërat ñShtresë stabilizanti t = 5 cm ò, ñFV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mmò , ñFV tub p.v.c shkarkim Ø 110 mmò si dhe përsëritje dy herë i zërit ñFV tub fleksibël Ø 40; 60 mm me tel bari në tëò në preventivin e projektit. Gjithashtu u konstatua mungesa të disa dokumenteve tekniko-ligjorë në dosjen teknike të zbatimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1779/12 prot datë 17.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñR.S.M. C.ò SHPK & ñR.ò SHPK, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 122-123 të Projektraporit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e projekt ï preventivit nga palët: Sipërmarrësi i punimeve ñR.S.M. C.ò SHPK & ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1779/12 prot, datë 17.09.2020 të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te "Rruga e Mokrës"* nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Bashkia Pogradec në cilësinë e AK, për zërat e punimeve: ñShtresë stabilizanti t=5cmò, ñFV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mmò , ñFV tub p.v.c shkarkim Ø110 mmò dhe ñFV tub fleksibël Ø 40;60 mm me tel bari në tëò si zë i përsëritur në preventivin e projektit.

Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve tï kërkojë sipërmarrësit të punimeve plotësimin e dosjes teknike me dokumentet: (Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit; Ndryshimet në projekt-preventiv dhe miratimin e tyre nga AK; Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; Librezën e masave; Situacionet mujore pjesore dhe progresive; Procesverbalet e miratimit të materialeve; Ditarin e objektit; Pasqyrën e realizimit të punimeve; Procesverbalet e punimeve të maskuara; Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton, etj; Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse; Çertifikat e cilësisë së materialeve).

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) raste, nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për kontratën e shërbimit ñ*Vazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara*ò me vlerë 63,682,795 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i shërbimit ñR.ò SHPK me nr. 767/6 prot, datë 25.02.2020 me afat realizimi 6 muaj, si dhe për kontratën e shërbimit ñ*Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*ò me vlerë 605,141,592 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i shërbimit ñR.ò SHPK me nr. 767/6 prot, datë 25.02.2020, dhe afat të realizimit 5 vjet, u konstatua se:

- Mungojnë *grafikët e punimeve të cilët duhet të zbatohen rigorozisht nga shoqëria e realizimit të shërbimit.*
- Nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe grafikët e shërbimit për secilën zë punimi/shërbimi nga shoqëria e sipërmarrjes së shërbimeve dhe nuk janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Nuk është paraqitur listë prezenca për çdo ditë pune nga shoqëria e shërbimit të kontratës që detyrimisht duhet të ketë çdo ditë/natë në punë, minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit si dhe lista e makinerive dhe pajisjeve.
- Nuk janë mbajtur procesverbale apo akte të tjera nga mbikëqyrësit e punimeve që të pasqyrojë inspektimin e realizimit të shërbimit në çdo kohë apo në përfundim të kryerjes së shërbimeve të

kontratës, respektimin e standardeve, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mos përmbushje detyre.
Sa më sipër trajtuar, nga komisioni për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të kontratës së shërbimit publik për kontratat e mësipërme, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në: Dokumentet e Tenderit; Specifikimet Teknike; Urdhri i Kryetarit nr. 139, datë 25.02.2020 për monitorimin e kontratës me nr. 767/6 prot., datë 25.02.2020 ñ*Vazhdimi i shërbimit të pastrimit, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit për shkaqe të paparashikuara*ò Neni 48 ñDetyrat e supervizorit të sipërmarrjeve privateò i Rregullores së brendshme të Bashkisë Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 129-130 të Projektraporit të Auditimit).*
<u>15.1. Rekomandimi</u>: Grupi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së kushteve të kontratës së shërbimit me objekt: ñ*Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*ò, të marrë masa që në vazhdimësi tôi kërkojë sipërmarrësit të shërbimeve ñR.ò SHPK, të plotësojë dokumentet për:
- Hartimin e planeve të punës dhe grafikët e shërbimit për zërat e shërbimeve sipas preventivit dhe të miratohen nga titullari i AK.
- Hartimin e listë prezencës dhe makinerive dhe pajisjeve ditore dhe mujore dhe të miratohet nga titullari i AK.
- Shtimin e kontrolleve dhe mbajtjen e proces verbaleve nga mbikëqyrësit e punimeve për pasqyrimin e saktë të realizimit të zërave të shërbimeve në zbatim të kushteve të kontratës me nr. 2295 prot, datë 30.07.2020 dhe afat të realizimit 5 vjet.

Në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi dhe krahasimi i të dhënave të marra nga DTTV dhe DMT rezulton së ka mospërputhje në sipërfaqen e tokës të marrë nga familjet me AMTP. Përkatësisht, sipërfaqja totale mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore nga DTTV është **2,289 ha** me detyrim vjetor për tôu arkëtuar **2,464,800 lekë**, ndërsa nga të dhënat e DMT sipërfaqja e tokës që familjet kanë me AMTP është **6,957 ha,** sipërfaqe e cila duhet të tatohet për detyrimin e taksës së tokës, me vlerë detyrimi vjetor **7,704,050 lekë**.
Për vitin 2020 sipas të dhënave të DTTV, planifikimi i taksës së tokës është **5,171,000 lekë**, ndërsa referuar të dhënave nga DMT, pritshmëria për taksën e tokës bujqësore është **7,704,050 lekë**, **diferenca në planifikim është 2,533,050 lekë për vitin 2020 dhe 2,543,050 lekë për vitin 2019, duke sjellë të ardhura të planifikuara më pak në buxhetin e bashkisë për të dy vitet në shumën 5,076,100 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 45-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>16.1 Rekomandimi:</u> Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës për evidentimin e të gjitha familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën 2,533,050 lekë.

Deri më datë 31.12.2021

17. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i të dhënave mbi pagesën e taksës së tokës bujqësore konstatohet se për vitin 2019 janë debitorë për taksën e tokës bujqësore 3773 familje me vlerë 2,542,219 lekë dhe për vitin 2020 janë debitorë 5311 familje me vlerë 2,709,529 lekë, në total për periudhën e auditimit 2019-2020 detyrimet e pa arkëtuara për taksën e tokës bujqësore janë në shumën **5,251,748 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të angazhohet në marrjen e masave dhe identifikimin e mekanizmave për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet që nuk e paguajnë atë nëpërmjet agjentit tatimor ñUKò Pogradec, por dhe ato familje që paguajnë në faturën e ujit të pijshëm, me qëllim rritjen e arkëtimeve për taksën e tokës nga familjet debitorë në vlerën 5,251,748 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 329 subjekte të legalizuara, me vlerë **11,442,106 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin e tarifës së planit të detajuar vendor 329 subjekte të legalizuara me vlerë **21,204,148 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. Në total **të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec** nga mos arkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës së planit të detajuar vendor që përbëjnë *taksën për legalizimet*[90] janë **32,646,254 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 329 subjekte debitorë me vlerë 32,646,254 lekë. Gjithashtu nga strukturat e Bashkisë Pogradec të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Zyra Vendore Pogradec për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më datë 31.102021 dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Detyrimi i familjeve për tarifat e pastrimit gjelbërimit dhe ndriçimit për vitin 2019 është 14,659,273 lekë për 5604 familje, ndërsa për vitin 2020 është 22,516, 658 lekë për 7622 familje. Në total për vitet 2019-2020 shuma e detyrimit është **37,175,931 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të intensifikojë punën dhe të marrë masa konkrete për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të familjeve për tarifat e pastrim-gjelbërim-ndriçimit në vlerën 37,175,931 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 2019-2020, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ka vendosur 45 gjoba me vlerë totale 9,160,000 lekë. IMT në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, nuk ka kërkuar në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes, në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò. Për periudhën 2019-2020 **të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMT janë në vlerën **13,136,000 lekë.** Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2020

[90] Detyrimi për legalizimet në vetvete përbëhet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë 0.5% e vlerës së investimit dhe tarifa e planit të detajuar vendor 1%.

janë vendosur 20 gjoba me vlerë totale 4,750,000 lekë, vlerë e cila nuk është kontabilizuar si detyrim sepse IMT nuk ka përcjellë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar dokumentacionin e duhur për regjistrim kontabël pas vendosjes së gjobës si dhe në fund të vitit për totalin e gjobave të vendosura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, të kërkojnë në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe të marrë masa për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitet 2019-2020 në vlerën 13,136,000 lekë. Gjithashtu, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, kapitulli 1, pika 2.3 ñRregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetitò.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake për vitet 2019-2020 ka vendosur 186 gjoba me vlerë 338,500 lekë. Janë paguar 115 gjoba me vlerë 197,500 lekë dhe janë ende pa u paguar **71 gjoba me vlerë 141,000 lekë** që përbëjnë **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 57-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake të bëjë përpjekje në bashkëpunim dhe në konsultim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve të identifikojnë mekanizma ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të Policisë Bashkiake në vlerën 141,000 lekë.

Deri më datë 31.102021 dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se numri i debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Pogradec në fund të vitit 2020 është **për 370 subjekte, 44,428,186 lekë**. Detyrimet totale nga taksat dhe tarifat familjare për vitet 2019-2020 janë në vlerën **63,720,809 lekë,** nga të cilat:

- Detyrime të pa arkëtuara për taksën e tokës bujqësore në vlerën **5,251,748 lekë**;
- Detyrime të pa arkëtuara të familjeve për tarifat e pastrimit-gjelbërimit-ndriçimit në vlerën **37,175,931 lekë**;
- Detyrime nga taksa dhe tarifa të tjera vendore në vlerën **21,293,130 lekë.**

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, për mbledhjen me forcë të detyrimeve për subjektet debitorë Bashkia Pogradec ka ndjekur hapat ligjor si:

1. Njoftim dhe kërkesë për të paguar ndaj subjekteve;
2. Urdhrin i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesve;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;

Bashkia Pogradec nuk ka aplikuar masën ñSekuestrim i pasurisëò për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet ndaj bashkisë. Për arkëtimin e detyrimeve të vitit 2020 rezulton se DTTV ende nuk ka filluar marrjen e masave për subjektet debitorë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e vitit 2019 të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekare, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò dhe ñPër bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorëò.[91]
Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 apo rezultojnë debitorë ndër vite në vlerën **44,428,186 lekë**, të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisëò.
Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi xhirimet që UK Pogradec ka bërë për bashkinë rezulton se në janar të vitit 2019 (detyrimi i vitit 2018) shuma që UK nuk ka kaluar në llogari të bashkisë është **31,303,063 lekë**, në janar të vitit 2020 shuma e pa kaluar është **23,303,266 lekë**, në dhjetor të vitit **2020 shuma e pa kaluar është 13,624,890 lekë**. DTTV nga ana e saj është përpjekur që të rrisë bashkëpunimin me Ujësjellësin me qëllim derdhjen e shumës së arkëtuar në llogari të bashkisë. Me shkresat nr. 15/1 Prot, datë 15.02.2019 dhe nr. 46/2 Prot, datë 14.02.2020, DTTV i drejtohet UK Pogradec ku i kërkon kalimin e arkëtimeve të taksave dhe tarifave vendore. Nga akt-akordimet vërehet se nga shkurti i vitit 2019 dhe në vazhdim paraqitet përmirësim në kalimin e taksave dhe tarifave të mbledhura për llogari të bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të rrisë bashkëpunimin me Agjentin Tatimor ñUKò Pogradec për arkëtimin e të ardhura të mbledhura për llogari të bashkisë duke bërë të mundur arkëtimin e vlerës 13,624,890 lekë, dhe në rast të lindjes së problemeve të zbatojë procedurat ligjore për penalizmin e Agjentit Tatimorë sipas ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 117.

Deri më datë 31.10. 2021 dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: DTTV ka konstatuar biznese që kryejnë aktivitet në territorin e saj dhe nuk janë të regjistruar për të paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, neni 12, pika 6. Nga auditimi rezulton se nga 6 subjekte të konstatuara, 5 subjekte i kanë paguar detyrimet vendore për periudhën që kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Pogradec ndërsa 1 subjekt ñN.ò Shpk nuk ka paguar detyrimet vendore. Rezulton se subjekti ka paraqitur pranë DTTV ankimin administrativ dhe DTTV është duke e ndjekur procesin për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve. Vlera totale e detyrimeve për periudhën 2018-2020 përfshirë edhe kamatëvonesat është 340,451 lekë, **por për periudhën objekt auditimi 2019-2020**

[91] Urdhër nr. 248, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 814, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò, Urdhër nr. 250, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 813, datë 13.10.2020 ñPër bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorëò, Urdhër nr. 249, datë 07.04.2020 dhe Urdhër nr. 815, datë 13.10.2020 ñPër vendosjes së masës siguruese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshmeò

detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë 221,598 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 70-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vijojë ndjekjen e procedurave ligjore kundrejt subjektit ñNò Shpk deri në përfundim të ankimimit dhe të marrë masat e duhura shtrënguese për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit që subjekti ka ndaj bashkisë në vlerën totale 340,451 lekë.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Pogradec për periudhën objekt auditimi ushtrojnë aktivitetin e shitjes së lëndëve djegëse 16 subjekte. Nga auditimi rezulton se problematika kryesore e konstatuar në auditimin e dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e hidrokarbureve të jetë në pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit sipas kërkesave ligjore në fuqi, përkatësisht ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4 ñUshtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe *autorizimet përkatëse*, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në Bashkinë Pogradec janë 9 subjekte që ushtrojnë aktivitet në 13 adresa që nuk janë pajisur me autorizimin përkatës brenda afateve ligjore. Ushtrimi i aktivitetit nga ana e këtyre subjekteve të pa pajisur me autorizim për periudhën 2019-2020 ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën **2,083,266 lekë.** Subjektet ñH.ò dhe ñG.ò (për adresën në Buçimas) janë ende të pa pajisura me autorizimin për ushtrimin e aktivitetit edhe pse janë njoftuar nga DTTV që më datë 31.08.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet ñH.ò SHPK dhe ñG.ò SHPK për adresën në Buçimas, të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9. Periudha e fillimit të autorizimit duhet të përkojë me afatin kur ka përfunduar autorizimi i fundit me qëllim që të bëhet e mundur edhe arkëtimi i vlerës prej **2,083,266 lekë** që përfaqëson detyrimin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit pa autorizimò.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 44 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 5 vjet deri në 99 vjet. Kontratat janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për ndërtimin e HEC-ve, për aktivitet bujqësor apo për mbjellje arrorësh, etj. Grupi i auditimit me përzgjedhje auditoi 26 kontrata (59 %) ose 21 subjekte qiramarrëse. Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2019-2020 rezultojnë debitorë ndaj bashkisë **9** qiramarrës në shumën totale të qirave **6,598,996 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Sektori i Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të angazhohen që subjektet

qiramarrëse të zbatojnë me përpikmëri kushteve e kontratave të qirasë me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën 6,598,996 lekë.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 12 procedurave me vlerë kontrate 535,070 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, si dhe nuk janë argumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 86-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
27.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Pogradec, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Pogradec, KLSH ka njoftuar Bashkinë Pogradec me shkresën 390/60, datë 22.10.2019. Bashkia Pogradec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu nuk është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në shkelje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò. Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se: Nga 9 masa organizative, janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa. Nga 3 masa shpërblim dëmi për vlerën **562,463 lekë**, është zbatuar plotësisht 1 masa në vlerën **56,890 lekë**, janë nisur njoftimet për 2 rekomandime në vlerën **505,573 lekë,** por ende nuk kanë filluar arkëtimet ose proceset gjyqësore. Nga 4 masa administrative për vlerën **650,000,** është zbatuar 1 masë për vlerën **50,000 lekë,** dhe janë në proces zbatimi 3 masa për vlerën **600,000 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 134-139-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
28.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën 360/60, datë 22.10.2019 ñ*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pogradec*ò, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 ñKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Pogradec), të nxirren

aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim ***shpërblimin e dëmit në vlerën* 3,376,889 *lekë***, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 71,739,473.28 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi shoqëria ñ4 A. M.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve të kryera ñGërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji, kategori III, me shkarkim në tokë në punimet KUZ në zonën e Drilonit dhe fshati Gurasò, në vlerën **737,200 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3044/15 prot., datë 29.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñ4 A. M.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 119-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>1.1. Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **737,200** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñ4 A. M.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3044 prot, datë 29.06.2020 me objekt ñ*Mbulimi me rrjet kanalizimi për fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 68,194,693.70 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volum pune të zërit të punimeve: Shtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunete t = 10 cm, në vlerën **490,380 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5532/1 prot datë 20.07.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>2.1. Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018 me objekt ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit për shtesën e kontratës ñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 13,144,368 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñShtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunetë t = 10 cmò dhe ñVijëzim shirita tërtho, kalim këmbësorë 15 cm, biokomponentò, në vlerën **69,600 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5288 prot datë 18.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>3.1. Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **69,600** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1

prot., datë 20.07.2018 me objekt për një shtesë fondi në kontratëñ*Sistemim rrugësh blloku Goricë*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"* Bashkia Pogradec, me vlerë 13,144,368 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñR.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve , ñFV pllaka betoni C 25/30, t = 8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t = 10 cmò dhe ñFV pllaka betoni C 25/30, t = 8 cm mbi shtresë betoni C 12/15 t = 10 cmò, në vlerën **652,543 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1757/15 prot datë 14.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñR.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñR.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot, datë 14.09.2020 të kontratës me objekt ñ*Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit "Rruga e Kabashit"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt ñ*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"* Bashkia Pogradec, me vlerë 73,669,667 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñSh. ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñF.V Dyer druri cilësia I brendshmeò, ñKastë shkarkimiò, ñF. Instalim pompë qarkulluese me prurje deri në 3 m^3/orë, presion deri në 7 mkH2O e kompletuar me ventila 1 ¼ò, hollandeze, lidhjet elektriek etjò dhe ñRadiator me 10 elementë së bashku me aksesorët e montimit, valvula radiatori ½" me hollandes, ajërnxjerrës ½ ", tapë ½ " etj me çmim 26,500 lekëò, në vlerën **633,295 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4964/3 prot datë 18.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe Kontraktorit ñSh.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **633,295** lekë pa TVSH nga Kontraktori ñSh.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4964/3 prot, datë 18.07.2019 të kontratës me objekt ñ*Rehabilitim i shkollës mesme "Gjergj Pekmezi"*, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñ*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I*ò Bashkia Pogradec, me vlerë 123,257,868 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñI.ò SHPK & ñSh.ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve ñShtresë betoni C 12/15 nën pllaka kunetë t=10 cmò, ñFV mbjellje peme dekorative Bli Ø 16-18 cm në trotuarò dhe ñVijëzim me shirit gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm", në vlerën **793,871 lekë pa TVSH.** Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7137 prot datë 28.09.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Pogradec dhe BOE ñI.ò SHPK & ñSh.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **793,871** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i përkohshëm i shoqërive ñItò SHPK & ñSh.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7137 prot, datë 28.09.2019 të kontratës me objekt ñ*Sistemim blloku tek ish ferma Loti I*ò, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 21 procedurave me vlerë kontrate 1,240,373 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 14 procedura me vlerë kontrate 224,926 mijë lekë ose 31 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **224,926 mijë lekë**, **respektivisht**:

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Vrojtimi dhe sinjalizimi me kamera, sistem alarmi dhe akses kontrolli për vitin 2019"*, me fond limit 4,166,500 lekë, me fitues BOE ñIò shpk & ñSh. 07ò SHPK me vlerë të ofertës 3,950,000 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **3,950,000 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Karburant për nevojat e bashkisë Pogradec dhe të N.I.R"*, me fond limit 9,516,666 lekë, me fitues OE ñG.ò SHPK me marzh fitimi 7%, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **9,516,666 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Rehabilitim i shkollës së mesme Gjergj Pekmezi"*, me fond limit 64,913,231 lekë, me fitues OE ñSh.ò SHPK me ofertë 61,921,356 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **61,921,356 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Shërbime për dru zjarri për ngrohje"*, me fond limit 7,985,386 lekë, me fitues BOE ñL. B.ò SHPK & ñK.ò SHPK me ofertë 7,951,469 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,951,469 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje ndërtesash"*, me fond limit 8,198,333 lekë, me fitues OE ñA.l. D.ò SHPK me ofertë 8,011,692 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT,

me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **8,011,692 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim blloku tek ish ferma loti I"*, me fond limit 19,574,639 lekë, me fitues BOE ñI.ò SHPK & ñSh.ò SHPK me ofertë 19,574,639 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **19,574,639 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Për një shtesë fondi tek objekti "Sistemim rrugësh blloku Goricë"*, me fond limit 10,958,968 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 10,953,640 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **10,953,640 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Përmirësim/Rikonstruksion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec"*, me fond limit 24,246,649 lekë, me fitues OE ñR,ò SHPK me ofertë 23,456,764 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **23,456,764 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 107-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Kabashit"*, me fond limit 20,823,715 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 19,591,210 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **19,591,210 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 110-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Sistemim asfaltim rrugësh, blloku i banimit te Rruga e Mokrës"*, me fond limit 15,259,601 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 14,326,357 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **14,326,357 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 113-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Ndërtim Ura Zall i Torrës, Njësia Administrative Proptisht"*, me fond limit 12,417,536 lekë, me fitues OE ñR.ò SHPK me ofertë 11,411,885 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **11,411,885 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 ñObjekti dhe qëllimiò pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñParimet e përzgjedhjesò shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 ñKualifikimi i ofertuesveò pika 1, dhe nenin 55 ñShqyrtimi i ofertaveò pika 3.

1.1 Rekomandim: Bashkisa Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **224,926 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë

publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. Masat disiplinore.

Referuar shkeljeve të konstatuara:
- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò.
- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.
- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; germat (b, c, ç) e nenit 58 ñLlojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 ñKodi i punës në Republikën e Shqipërisëò; shkronja (b) e nenit 9 ñMasa disiplinore ò, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pogradec që tã kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT